REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT

MBI

ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT


2025



KONTROLLI
I LARTË
I SHTETIT

RAPORTI I ZBATIMIT TË BUXHETIT

2025



PËRMBAJTJA

	Faqja
HYRJE	2
TREGUESIT KRYESORË FISKALË TË KONSOLIDUAR	3
KONKLUZIONI I AUDITIMIT	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT	15
A. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE	24
A.1. Planifikimi dhe realizimi i përgjithshëm i të ardhurave	24
A.2. Të ardhurat nga ndihmat	25
A.3. Të ardhurat tatimore	26
A.4. Të ardhurat jo tatimore	42
A.5. Problematikat e konstatuara nga auditimet në administrimin e të ardhurave publike	43
B. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I SHPENZIMEVE	46
B.1. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore	46
B.2. Shpenzimet korrente	48
B.3. Fonde të tjera të pashpërndara	60
B.4. Shpenzime kapitale	61
B.5. Problematikat e konstatuara nga auditimet në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike	69
B.6. Risqet fiskale dhe impakti buxhetor	74
C. DEFICITI BUXHETOR	86
D. BORXHI PUBLIK: MENAXHIMI DHE RAPORTIMI	90
E. KONTABILITETI I SEKTORIT PUBLIK, MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI, SI DHE AUDITIMI I BRENDSHËM	103
E.1. Raportimi financiar i njësive të qeverisjes së përgjithshme	103
E.2. Auditimi i brendshëm në sektorin publik	105
E.3. Menaxhimi financiar dhe kontrolli në sektorin publik	108
F. ANEKSET	115

Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në mbështetje të nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 31 të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe nenit 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, paraqet në Kuvend Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2025, së bashku me mendimin mbi raportin e Këshillit të Ministrave.

Raporti është hartuar mbi bazën e rezultateve të veprimtarisë audituese të KLSH-së, duke përfshirë shqyrtimin dhe vlerësimin e raporteve të Ministrisë së Financave mbi zbatimin e buxhetit vjetor, treguesit makroekonomikë dhe fiskalë, realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike, administrimin e borxhit publik, menaxhimin e likuiditetit dhe detyrimeve financiare, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik. Gjithashtu, në hartimin e raportit janë marrë në konsideratë rezultatet e auditimeve të kryera në institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, fondet speciale, kompanitë me kapital shtetëror dhe subjektet e tjera që administrojnë fonde dhe pasuri publike. Këto auditime janë kryer në mbështetje të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), kuadrit ligjor dhe rregullator të KLSH-së, si dhe objektivave, kritereve dhe procedurave të përcaktuara për angazhimet përkatëse të auditimit.

Në kushtet kur mungesa e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit kufizon mundësinë e kryerjes së një auditimi financiar mbi to, raporti ka përfshirë vlerësimin e përputhshmërisë së zbatimit të buxhetit me kuadrin ligjor dhe rregullator, mbështetur në objektin, fushëveprimin dhe evidencën e administruar në angazhimet përkatëse të auditimit.

Nëpërmjet këtij raporti, KLSH paraqet një vlerësim të pavarur mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2025, duke analizuar realizimin e treguesve kryesorë buxhetorë dhe fiskalë, përputhshmërinë e proceseve të planifikimit, miratimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe administrimin e fondeve, detyrimeve dhe risqeve fiskale. Në këtë kuadër, raporti paraqet konstatimet, konkluzionin dhe rekomandimet e KLSH-së, duke evidentuar ndikimin e mangësive të konstatuara në disiplinën fiskale, transparencën, besueshmërinë e raportimit dhe llogaridhënien në administrimin e financave publike.

TREGUESIT KRYESORË FISKALË TË KONSOLIDUAR

Me ligjin nr. 115/2024, "Për Buxhetin e vitit 2025", u miratuan treguesit kryesorë fiskalë, të cilët gjatë vitit u rishikuan nëpërmjet katër akteve normative. Në këtë kuadër, bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave, tabela e mëposhtme paraqet një krahasim ndërmjet planit fillestar, planit përfundimtar dhe realizimit faktik të treguesve kryesorë fiskalë të konsoliduar për vitin 2025.

Treguesit kryesorë fiskalë

milionë lekë

EMËRTIMI	Fakti 2024	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025
TË ARDHURAT	**710,587**	**757,036**	**758,036**	**758,036**	**770,140**	**770,140**	**754,608**
Ndihmat	7,797	18,995	18,995	18,995	20,295	20,295	**7,383**
Të ardhura tatimore	659,096	712,240	712,240	712,240	718,102	718,102	**716,283**
Tatime & Dogana	456,984	501,573	501,573	501,573	499,621	499,621	**496,225**
Pushteti vendor	40,331	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	**40,911**
Fondet speciale	161,780	169,893	169,893	169,893	177,707	177,707	**179,147**
Të ardhura jozatimore	43,694	25,800	25,800	25,800	31,743	31,743	**30,941**
TË SHPENZIMET	**728,571**	**825,088**	**826,088**	**826,088**	**831,784**	**831,784**	**801,696**
Shpenzime korrente	606,289	656,014	656,014	660,521	663,246	669,356	**653,532**
Fonde të pashpërndara	–	6,700	6,700	6,700	5,400	5,400	–
Shpenzime kapitale	115,433	163,374	163,374	158,867	164,138	157,028	**131,578**
DEFICITI	**(17,984)**	**(68,052)**	**(68,052)**	**(68,052)**	**(61,644)**	**(61,644)**	**(47,089)**
FINANCIMI I DEFICITIT	**17,984**	**68,052**	**68,052**	**68,052**	**61,644**	**61,644**	**47,089**
Financimi i brendshëm	33,360	59,828	59,828	59,828	52,734	52,734	**38,847**
Financimi i huaj	(15,376)	8,224	8,224	8,224	8,910	8,910	**8,242**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Të ardhurat totale buxhetore janë realizuar në shumën 754,608 milionë lekë, ose 97.98% të planit përfundimtar prej 770,140 milionë lekë, duke rezultuar 15,532 milionë lekë më pak se parashikimi. Krahasuar me planin fillestar prej 757,036 milionë lekë, ato kanë rezultuar 0.32% më të ulëta, ndërsa kundrejt vitit 2024 të ardhurat janë rritur me 44,021 milionë lekë, ose 6.2%. Në raport me PBB-në, të ardhurat publike kanë arritur në 28.49%[1], nga 28.08% një vit më parë.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë realizuar në shumën 801,696 milionë lekë, ose 96.4% të planit përfundimtar, duke rezultuar 30,088 milionë lekë më pak se niveli i planifikuar. Mosrealizimi është përqendruar kryesisht te shpenzimet kapitale, të cilat janë realizuar në shumën 131,578 milionë lekë, ose 25,450 milionë lekë më pak se plani përfundimtar, të cilat përfaqësojnë rreth 84.6% të mosrealizimit të përgjithshëm të shpenzimeve. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet e përgjithshme janë rritur me rreth 73,125 milionë lekë, ose 10%.

Deficiti buxhetor për vitin 2025 është realizuar në shumën -47,089 milionë lekë, ose 76.4% të planit përfundimtar prej -61,644 milionë lekë, duke respektuar kufirin e miratuar. Krahasuar me vitin 2024, deficiti është rritur me 29,105 milionë lekë. Nga pikëpamja e financimit, burimi kryesor ka vijuar të jetë huamarrja e brendshme. Ecuria mujore e treguesve fiskalë evidenton një përqendrim të shpenzimeve në fund të vitit, ku vetëm gjatë muajit dhjetor është regjistruar një deficit prej -96,207 milionë lekë, i cili ka tejkaluar suficitin kumulativ prej 49,118 milionë lekë të krijuar gjatë periudhës janar–nëntor. Megjithëse deficiti ka rezultuar brenda kufirit të planifikuar, nga auditimi janë konstatuar elementë të mbivlerësimit dhe/ose nënvlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilët kanë ndikuar në nivelin e deficitit të raportuar.

[1] PBB në vlerën 2,648.5 miliardë lekë sipas PBB të përdorur në World Economic Outlook, Prill 2026.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Objekti dhe fushëveprimi i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025 me kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm për menaxhimin e financave publike. Auditimi ka përfshirë vlerësimin e proceseve të planifikimit, miratimit dhe rishikimit të buxhetit, administrimit dhe realizimit të të ardhurave publike, ekzekutimit të shpenzimeve, menaxhimit të likuiditetit dhe detyrimeve financiare, administrimit të borxhit publik dhe risqeve fiskale, regjistrimit dhe raportimit të treguesve fiskalë, si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Vlerësimi është mbështetur në rezultatet e auditimeve të kryera në strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave, institucionet e administrimit të të ardhurave, njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe subjektet e tjera publike të audituara, si dhe në analizën e të dhënave mbi realizimin e buxhetit të konsoliduar për vitin 2025.

Kriteret e auditimit mbështeten kryesisht nga ligji nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", i ndryshuar, si dhe nga legjislacioni dhe aktet nënligjore që rregullojnë administrimin e të ardhurave, përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin, administrimin e borxhit publik dhe raportimin financiar.

Përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe institucioneve të qeverisjes së përgjithshme

Ministria e Financave është përgjegjëse për koordinimin e proceseve të përgatitjes, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit të shtetit, administrimin e treguesve fiskalë, menaxhimin e likuiditetit dhe borxhit publik, si dhe për raportimin mbi realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Institucionet e qeverisjes së përgjithshme, strukturat përgjegjëse për administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike kanë përgjegjësinë për respektimin e kërkesave ligjore në planifikimin, angazhimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, regjistrimin dhe raportimin e transaksioneve financiare, administrimin e detyrimeve, si dhe ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm financiar publik. Këto përgjegjësi përfshijnë sigurimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të besueshëm mbi veprimtarinë buxhetore dhe financiare, si dhe parandalimin, identifikimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve me kërkesat ligjore dhe rregullatore.

Përgjegjësitë e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Përgjegjësia jonë është të kryejmë auditimin e përputhshmërisë dhe të formulojmë një konkluzion të pavarur mbi respektimin e kritereve ligjore dhe rregullatore nga proceset dhe transaksionet e përfshira në objektin e auditimit. Në ushtrimin e këtij funksioni, KLSH vepron në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor, të përcaktuar në nenin 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për paraqitjen në Kuvend të raportit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mendimit përkatës mbi raportin e Këshillit të Ministrave. Auditimi është kryer duke u mbështetur në parimet dhe kërkesat e zbatueshme të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, përfshirë ISSAI 100 dhe ISSAI 4000, nëpërmjet një qasjeje të bazuar në risk, identifikimit të kritereve të auditimit, vlerësimit të mospërputhjeve dhe administrimit të evidencës së nevojshme për mbështetjen e përfundimeve.

Procedurat e auditimit kanë përfshirë shqyrtimin dhe analizën e dokumentacionit buxhetor dhe financiar, testimin e transaksioneve dhe proceseve të përzgjedhura, krahasimin e të dhënave të raportuara me evidencat mbështetëse dhe vlerësimin e mekanizmave përkatës të kontrollit.

Përfundimet e auditimit mbështeten në evidencën e administruar për objektin dhe shtrirjen e procedurave të kryera dhe nuk përbëjnë një vlerësim të veçantë të çdo transaksioni të realizuar nga të gjitha institucionet e qeverisjes së përgjithshme.

Konkluzioni i kualifikuar i auditimit të përputhshmërisë[2]

Bazuar në procedurat e auditimit të kryera dhe evidencën e administruar, ne konkludojmë se, me përjashtim të mospërputhjeve materiale të përshkruara në seksionin "Baza për konkluzionin e kualifikuar", proceset dhe transaksionet e audituara në kuadër të zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025, kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për menaxhimin e financave publike.

Mospërputhjet materiale që qëndrojnë në bazë të këtij konkluzioni janë evidentuar në proceset e planifikimit dhe rishikimit të buxhetit, ekzekutimit të shpenzimeve, administrimit të të ardhurave, regjistrimit dhe raportimit të treguesve fiskalë, si dhe në administrimin e detyrimeve financiare dhe monitorimin e risqeve fiskale. Këto mospërputhje, të përshkruara në seksionin përkatës të raportit, përbëjnë bazën mbi të cilën KLSH shpreh *konkluzionin e kualifikuar mbi përputhshmërinë e zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025*.

Baza për konkluzionin e kualifikuar


Nga auditimi i zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin 2025 janë evidentuar mospërputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në procese të rëndësishme të administrimit të financave publike, të cilat përbëjnë bazën për kualifikimin e konkluzionit të auditimit.

- Në procesin e planifikimit dhe rishikimit të buxhetit janë evidentuar mangësi në respektimin e afateve dhe procedurave, mospërputhje ndërmjet planit buxhetor të miratuar dhe atij të regjistruar në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, pasaktësi në listën e investimeve publike që shoqëron projektbuxhetin, ndryshime të shpeshta të planit buxhetor, përfshirë rishikime me akte normative në mospërputhje me kërkesat ligjore, si dhe mangësi në respektimin e prioriteteve në buxhetim.
- Në ekzekutimin e shpenzimeve buxhetore janë konstatuar mangësi në zbatimin e procedurave për angazhimin e fondeve publike dhe në respektimin e kufijve të miratuar për këto angazhime, regjistrimin në kohë të kontratave dhe faturave, kryerjen e parapagimeve, administrimin e investimeve publike, përfshirë shpenzimet kapitale me financim të huaj, përdorimin e fondeve në përputhje me destinacionin dhe klasifikimin ekonomik të miratuar, si dhe problematika lidhur me mbivlerësimin e shpenzimeve përmes transferimit të mjeteve monetare në llogari të ndryshme buxhetore dhe përdorimin e fondeve të buxhetit të vitit 2025 për shlyerjen e detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.
- Në raportimin fiskal janë evidentuar pasaktësi në njohjen dhe klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, me ndikim në deficitin e raportuar, si dhe mospërputhje në evidentimin, kontabilizimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura.
- Janë konstatuar mangësi në monitorimin e detyrimeve nga nënhuatë dhe garancitë shtetërore, respektimin e kushteve kontraktuale të shlyerjes, si dhe në identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e detyrimeve faktike dhe kontingjente, si dhe risqeve fiskale që burojnë nga kompanitë me kapital shtetëror dhe entitete të tjera, apo angazhimet e tjera financiare të shtetit.

Mospërputhjet e mësipërme, të trajtuara në mënyrë të detajuar në seksionet përkatëse të raportit, përbëjnë bazën për konkluzionin e kualifikuar të auditimit të përputhshmërisë.

[2] *Në përputhje me kërkesat e ISSAI 4000, paragrafët 37–38 dhe 191–195, si dhe me udhëzimet metodologjike të IDI Compliance Audit Handbook, në auditimet e përputhshmërisë me raportim të drejtpërdrejtë (direct reporting), formulimi i konkluzionit mbështetet në vlerësimin e materialitetit të mospërputhjeve të identifikuara, shkallës së përhapjes së tyre në raport me objektin e auditimit, si dhe në evidencën e mjaftueshme dhe të përshtatshme të administruar. Në këtë kuadër, kur mospërputhjet vlerësohen materiale, por jo të përhapura gjerësisht, mund të shprehet një konkluzion i kualifikuar (qualified conclusion), për sa kohë që shtrirja e auditimit dhe evidenca e administruar ofrojnë bazë të mjaftueshme për formulimin e tij.*

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Shënim: Deficiti paraqitet në vlerë absolute. Vlerat në miliardë lekë.

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi i zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025 janë konstatuar problematika në planifikimin dhe administrimin e fondeve publike, realizimin e të ardhurave, ekzekutimin e shpenzimeve, menaxhimin e investimeve publike, administrimin e likuiditetit dhe detyrimeve financiare, si dhe në saktësinë dhe plotësinë e raportimit të treguesve fiskalë. Gjetjet e auditimit përfshijnë mospërputhje ndërmjet treguesve buxhetorë të miratuar dhe atyre të raportuar, mosrealizime të fondeve të planifikuara, detyrime të papaguara, mangësi në administrimin e kontratave, si dhe ekspozime të buxhetit të shtetit ndaj risqeve financiare.

Nga auditimi i *procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027 dhe buxhetit vjetor 2025* janë konstatuar mosrespektime të afateve dhe mangësi në përgatitjen e kërkesave buxhetore, përfshirë paraqitjen e kërkesave përtej tavaneve të miratuara, pasaktësi në të dhënat e planifikimit dhe dokumentacion mbështetës të paplotë. Gjithashtu, udhëzimi për zbatimin e buxhetit është miratuar pas fillimit të vitit buxhetor, ndërsa nga detajimi i ligjit të buxhetit janë evidentuar diferenca ndërmjet vlerave të miratuara me ligj dhe atyre të pasqyruara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), në lidhje me të ardhurat jotatimore, shpenzimet korrente dhe kapitale, fondet e tjera të pashpërndara dhe treguesit e financimit të deficitit.

Gjatë vitit 2025, në SIFQ janë regjistruar 28,412 *ndryshime në zërat buxhetorë*, që u përkasin 3,106 rishikimeve unike, ku rreth 17% janë kryer në muajin dhjetor. Nga auditimi janë konstatuar raste të rishikimit të planit buxhetor të vitit 2025 edhe pas përfundimit të vitit buxhetor, deri në muajin shkurt 2026, si dhe ndryshime të kryera pas afatit ligjor të datës 15 nëntor 2025, të lidhura me zbatimin e Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, i cili është miratuar pak ditë përpara përfundimit të vitit buxhetor. Mangësi janë konstatuar edhe në planifikimin dhe detajimin e investimeve publike, ku 32 kontrata në vazhdim nga vitet e mëparshme nuk kanë pasur fonde të çelura në buxhetin fillestar të vitit 2025, ndërsa 17 projekte, me vlerë kontratash 2,445 milionë lekë, janë përfshirë gjatë vitit pa qenë pjesë e PBA-së dhe pa ndjekur plotësisht procedurat e menaxhimit të investimeve publike. Gjithashtu, janë çelur fonde investimi në vlerën totale 5,256 milionë lekë pa u detajuar në projekte konkrete, ndërsa në fund të vitit kanë rezultuar 188 projekte me fonde të planifikuara prej 3,588 milionë lekë, pa realizim dhe pa u rishpërndarë fondet drejt projekteve të tjera me nevoja financimi, duke sjellë mosshfrytëzimin e këtyre fondeve brenda vitit buxhetor.

Ekzekutimi i buxhetit gjatë vitit 2025 është shoqëruar me mangësi në mbështetjen teknike të sistemeve informatike financiare, ku Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar Shqiptar ka funksionuar pa mbështetje që prej korrikut 2024, ndërsa SIFQ ka mbetur pa mirëmbajtje dhe mbështetje funksionale të jashtme pas përfundimit të kontratës në tetor 2025, duke vijuar ekzekutimin e buxhetit nëpërmjet dorëzimit fizik të dokumentacionit pranë degëve të Thesarit. Nga auditimi janë konstatuar gjithashtu vonesa në dorëzimin e faturave dhe regjistrimin e angazhimeve buxhetore, ku 748 njësi shpenzuese kanë dorëzuar jashtë afatit ligjor 25,793 fatura, me vlerë 64,244 milionë lekë, ndërsa 5,868 kontrata, me vlerë 119,551 milionë lekë, janë regjistruar përtej afatit 5-ditor. Janë evidentuar edhe kontrata të lidhura pas afatit ligjor të datës 15 tetor 2025, me vlerë 25,244 milionë lekë, regjistrime të vonuara të urdhër-prokurimeve dhe kontratave të viteve të mëparshme. Gjithashtu, janë konstatuar raste të shlyerjes së pjesshme të faturave dhe në 40 raste

me vlerë faturash prej 3,261 milionë lekë mosrespektim i radhës kronologjike të ekzekutimit të pagesave sipas parimit FIFO. Në lidhje me administrimin e angazhimeve dhe ekzekutimin e pagesave, janë evidentuar ndryshime të shpeshta të nivelit të fondeve të miratuara, pa i dhënë përparësi financimit në kohë të detyrimeve të mbartura dhe atyre sipas planeve të pagesave të kontratave përkatëse, si dhe mangësi në regjistrimin e plotë dhe të saktë të angazhimeve buxhetore, me ndikim në planifikimin dhe administrimin e fondeve të miratuara në nivel programi, sipas buxhetit trevjeçar.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi në procesin e *monitorimit të buxhetit*, kryesisht në analizën e devijimeve ndërmjet planit dhe realizimit, raportimin e treguesve të performancës, si dhe në dokumentimin dhe ndjekjen e masave korrigjuese.

Gjithashtu, nga auditimi ka rezultuar *se kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor* paraqet mungesë harmonizimi ndërmjet ligjit organik të buxhetit, ligjit vjetor të buxhetit për vitin 2025 dhe akteve nënligjore përkatëse, veçanërisht lidhur me afatet e marrjes së angazhimeve buxhetore, mundësinë e lidhjes së kontratave përtej këtyre afateve dhe lejimin e parapagimeve përpara dokumentimit të shpenzimeve. Gjithashtu, në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe listën e investimeve publike 2025–2027 janë evidentuar mangësi në pasqyrimin e kostove të plota të projekteve dhe pasaktësi në evidentimin e angazhimeve financiare që shtrihen përtej periudhës trevjeçare të planifikimit buxhetor. Problematika të tjera lidhen me parashikimin ligjor për transferimin e fondeve të papërdorura për bonusin e pensionistëve, i cili nuk përbën realizim shpenzimi, përdorimin e transfertës së pakushtëzuar për financimin e projekteve të rindërtimit për të cilat është përcaktuar një destinacion specifik i fondeve, si dhe parashikimin e përdorimit të fondit rezervë për përballimin e shpenzimeve të parashikueshme.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2025 janë realizuar në shumën 754,608 milionë lekë, duke rezultuar 15,532 milionë lekë më pak se parashikimi, kryesisht si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga ndihmat, të cilat kanë rezultuar 12,913 milionë lekë nën planin përfundimtar, për shkak të mosdisbursimit të granteve të planifikuara. Edhe të ardhurat nga tatimet dhe doganat kanë rezultuar 3,396 milionë lekë nën plan, ndërsa të ardhurat nga fondet speciale dhe pushteti vendor kanë tejkaluar parashikimet përkatësisht me 1,440 dhe 137 milionë lekë. Nga auditimet janë evidentuar mangësi në planifikimin, realizimin dhe administrimin e të ardhurave publike, përfshirë monitorimin e treguesve të realizimit, përputhshmërinë e procedurave për mbledhjen e të ardhurave, evidentimin dhe ndjekjen e debitorëve, si dhe saktësinë e raportimit të të ardhurave.

Në administrimin *e të ardhurave tatimore* janë konstatuar mangësi në planifikimin dhe monitorimin e realizimit të tyre. Pavarësisht tejkalimit të planit vjetor të kontrolleve tatimore, në fund të vitit 2025 kanë rezultuar 793 kontrolle të papërfunduara, të shoqëruara me vonesa në administrimin dhe finalizimin e procedurave. Në veprimtarinë e hetimit tatimor janë konstatuar tejkalime të afateve ligjore, mbartje ndër vite e çështjeve hetimore dhe mangësi në monitorimin e ecurisë së tyre, duke krijuar risqe për vlefshmërinë e procedurave dhe efektivitetin e ndjekjes së shkeljeve. Nga auditimet në Drejtoritë Rajonale Tatimore janë evidentuar mangësi në kryerjen e kontrolleve tatimore, përfshirë verifikimin e deklarimeve fiskale, trajtimin e kreditimit të TVSH-së, vlerësimin e transaksioneve dhe shpenzimeve të zbritshme, si dhe identifikimin dhe ndjekjen e tatimpaguesve me risk fiskal, me efekt në detyrimet tatimore dhe penalitetet përkatëse, me pasoja në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Për rimbursimin e TVSH-së, janë evidentuar mangësi në respektimin e afateve dhe të radhës së trajtimit të kërkesave, ku në 280 raste është tejkaluar afati 60-ditor, ndërsa në 160 raste nuk është respektuar radha kronologjike e trajtimit të tyre, sipas metodologjisë FIFO.

Në administrimin e *të ardhurave doganore* janë konstatuar mangësi në shpërndarjen e objektivave të të ardhurave ndërmjet degëve doganore dhe në monitorimin e realizimit të tyre në baza mujore. Gjithashtu, janë evidentuar problematika në veprimtarinë e drejtorisë së antikontrabandës dhe përdorimin e analizës së riskut për përzgjedhjen e kontrolleve, ku pjesa më e madhe e tyre ka rezultuar pa konstatime, pa u shoqëruar me analiza të mjaftueshme. Në veprimtarinë e hetimit doganor janë evidentuar mungesa të planeve të miratuara të hetimit, mangësi në dokumentimin e veprimeve hetimore, si dhe vonesa në trajtimin e çështjeve. Problematika janë konstatuar edhe në

vlerësimin doganor të mallrave, procedurat e skanimit dhe administrimit të mostrave, mbikëqyrjen e regjimeve dhe magazinave doganore, si dhe ndjekjen e detyrimeve dhe penaliteteve të konstatuara nga kontrollet.

Nga auditimi i administrimit *të borxhit tatimor dhe doganor* është konstatuar rritje e konsiderueshme e stokut të detyrimeve të papaguara, ndërkohë që pjesa më e madhe e tij përbëhet nga detyrime të mbartura prej vitesh, shoqëruar me mangësi në ndjekjen e debitorëve dhe zbatimin në kohë të procedurave të mbledhjes me forcë. Konkretisht, në fund të vitit 2025 borxhi tatimor ka arritur në 194,432 milionë lekë, me një rritje prej 31,897 milionë lekë, ose 19.6% krahasuar me vitin 2024, ku 60% e stokut përbëhet nga detyrime me vjetërsi mbi 5 vjet. Ndërkohë, borxhi doganor ka arritur në 61,833 milionë lekë, me një rritje prej 12,713 milionë lekë, ose 25.9%, krahasuar me vitin 2024, ku 77% e stokut përbëhet nga detyrime mbi 5 vjet.

Në administrimin e *të ardhurave të pushtetit vendor*, megjithëse në nivel të konsoliduar është tejkaluar plani, nga auditimet e kryera në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë konstatuar mangësi në planifikimin, përllogaritjen, evidentimin, arkëtimin dhe kontabilizimin e taksave, tarifave dhe të ardhurave jotatimore, si dhe në zbatimin e masave për mbledhjen e detyrimeve të papaguara. Konkretisht, janë evidentuar raste të përllogaritjes së pasaktë dhe mosarkëtimit të detyrimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, mangësi në identifikimin dhe përditësimin e bazës së taksueshme për taksat mbi pasurinë, si dhe në rakordimin e të dhënave me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Problematika janë konstatuar edhe në administrimin e tarifave të pastrimit dhe ndriçimit, në përllogaritjen dhe arkëtimin e taksës së fjetjes në hotel, si dhe në administrimin e të ardhurave jotatimore, përfshirë zbatimin e kushteve kontraktuale dhe ndjekjen e detyrimeve financiare.

Shpenzimet totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2025 janë raportuar në shumën 801,696 milionë lekë, ose 96.4% të planit përfundimtar, duke rezultuar 30,088 milionë lekë më pak se parashikimi. Në shpenzimet e raportuara është përfshirë edhe transferta prej 16,587 milionë lekë për Fondin e Pensioneve, e cila nuk përbën shpenzim. Nga analiza e shpërndarjes mujore të shpenzimeve është konstatuar përqendrim i konsiderueshëm i pagesave në fund të vitit. Në muajin dhjetor janë kryer shpenzime prej 162,544 milionë lekë, ose 20.3% e totalit vjetor. Gjatë këtij muaji janë shlyer rreth 14,960 milionë lekë fatura për investime kapitale dhe 8,902 milionë lekë për shpenzime operative, të lëshuara gjatë periudhës janar–nëntor 2025, si dhe rreth 955 milionë lekë fatura për investime të vitit 2024 dhe viteve të mëparshme.

Shpenzimet kapitale për vitin 2025 kanë rezultuar 25,450 milionë lekë më pak se parashikimi, kryesisht si rezultat i mosrealizimit të investimeve me financim të huaj. Investimet me financim të brendshëm kanë arritur në 107,258 milionë lekë, ose 93.9% të planit përfundimtar, ku janë përfshirë edhe transferta kapitale për agjenci dhe ndërmarrje publike në shumën 9,169 milionë lekë, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me krijimin e aktiveve të prekshme. Shpenzimet kapitale me financim të huaj për vitin 2025 janë realizuar në shumën 20,297 milionë lekë, duke rezultuar 15,825 milionë lekë nën planin përfundimtar, ndërkohë që janë evidentuar shpenzime prej 677 milionë lekë, të raportuara si kapitale, megjithëse për nga natyra përfaqësojnë shpenzime korrente, si dhe raste të realizimit të investimeve pa plan buxhetor ose në tejkalim të fondeve të miratuara.

Nga auditimi i investimeve publike janë konstatuar mangësi në respektimin e kufijve të financimit dhe administrimin e angazhimeve kontraktuale. Konkretisht, në 44 raste, me vlerë të kontraktuar 16,835 milionë lekë, janë iniciuar procedura prokurimi për vlera më të larta se fondet në dispozicion, ndërsa për 39 projekte janë marrë angazhime mbi fondet buxhetore të miratuara, me diferencë në shumën 4,281 milionë lekë. Gjithashtu, janë konstatuar mospërputhje ndërmjet kostove të projekteve dhe shpërndarjes shumëvjeçare të financimit, pakësime të fondeve pas lidhjes së kontratave, vonesa në realizimin e punimeve dhe mangësi në monitorimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Për tre projekte investimi me vlerë totale parapagimesh prej 1,154 milionë lekë, nuk është evidentuar dokumentacioni mbështetës për trajtimin e tyre si raste me rëndësi të veçantë, ndërsa për dy prej tyre, me parapagime prej 841.7 milionë lekë, nuk është dokumentuar miratimi paraprak nga Ministri i Financave për autorizimin e tyre, si dhe është konstatuar tejkalimi i kufirit maksimal të lejuar prej 10% të vlerës së kontratës, duke kryer parapagime në masën 20%.

Nga auditimet e kryera në institucionet publike janë evidentuar gjithashtu parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, përfshirë mangësi në hartimin e

preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit, përcaktimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit, copëzimin e fondeve të prokurimit, si dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë që nuk plotësonin kriteret e kërkuara. Problematika janë konstatuar edhe në administrimin dhe zbatimin e kontratave, përfshirë ndryshime të paargumentuara të afateve kontraktuale dhe të preventivave, vonesa në dorëzimin e mallrave dhe përfundimin e punimeve, mosaplikimin e penaliteteve të parashikuara në kontratë, si dhe raste të pagesës së punimeve të pakryera ose të pambështetura me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në mbikëqyrjen dhe marrjen në dorëzim të punimeve, verifikimin e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe vonesa në vënien në funksionim të aseteve publike, duke shkaktuar përdorim të fondeve publike pa respektuar parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Në lidhje me *shpenzimet për personelin*, është konstatuar nënrealizim i fondeve të planifikuara për paga dhe kontribute, i lidhur edhe me mosplotësimin e pozicioneve vakante, ku në fund të vitit 2025, numri faktik i punonjësve buxhetorë ka rezultuar 5,787 më pak se plani përfundimtar. Nga auditimet janë evidentuar gjithashtu transferime të përkohshme të punonjësve në tejkalim të afateve ligjore, të shoqëruara me efekte financiare për shkak të diferencave në pagë.

Në *shpenzimet operative*, gjatë vitit 2025, në zërin përkatës buxhetor për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna janë raportuar pagesa në vlerën 1,053 milionë lekë. Nga auditimet janë konstatuar mangësi në planifikimin e fondeve për shlyerjen e këtyre detyrimeve, funksionimin e komisioneve për sistemimin e nëpunësve civilë gjyqfitues, respektimin e radhës së shlyerjes së detyrimeve dhe hartimin e publikimin e grafikëve të pagesave, si dhe me shpenzime përmbarimore shtesë.

Nga auditimi i *shpenzimeve të sigurimeve shoqërore* ka rezultuar se, gjatë vitit 2025, të ardhurat nga kontributet dhe burimet e tjera kanë mbuluar 75.8% të shpenzimeve totale të ISSH-së, ndërkohë, në skemën e pensioneve, niveli i mbulimit të shpenzimeve përkatëse nga kontributet ka arritur në 91.5%. Skema e pensioneve ka rezultuar me deficit prej 14,842 milionë lekë, duke vijuar me nevojën për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Ndërkohë, stoku i detyrimeve të papaguara për kontributet e sigurimeve shoqërore, përfshirë gjobat dhe interesat, ka arritur në mbi 22,558 milionë lekë, me një rritje prej rreth 2,333 milionë lekë gjatë vitit 2025, nga të cilat sektori privat me 2,001 milionë lekë dhe sektori publik me 330 milionë lekë. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi në ndjekjen e debitorëve dhe administrimin e listëpagesave ndërmjet DPT-së dhe ISSH-së. Financimi shtesë i pensioneve të vitit 2025 është orientuar kryesisht drejt mbështetjes financiare të njëhershme të pensionistëve nëpërmjet bonusit të fundvitit, në raport me indeksimin e pensioneve, i cili ndikon në mënyrë të qëndrueshme në nivelin e përfitimeve dhe në ruajtjen e fuqisë së tyre blerëse. Fondi për indeksimin e pensioneve është reduktuar nga 1,618 në 1,140 milionë lekë, ndërsa fondi për bonusin e pensionistëve është rritur nga 3,750 në 9,700 milionë lekë. Me miratimin e bonusit të fundvitit, në vlerën 10,405 milionë lekë, diferenca prej 705 milionë lekë (nga 9,700 milionë me Aktin Normativ) është financuar nga pakësimi i fondeve të planifikuara për pensione, pa një analizë financiare të miratuar mbi ndikimin e këtij rialokimi në përmbushjen e detyrimeve të skemës.

Problematika të ngjashme janë konstatuar edhe në *administrimin e skemës së ndihmës ekonomike*, ku gjatë viteve 2023–2025 nuk është zbatuar indeksimi i përfitimeve, megjithëse kuadri rregullator parashikon rritjen e tyre sa herë indeksohet pensioni social dhe në të njëjtën masë. Konkretisht, pensioni social është indeksuar në masën 8.6% në vitin 2023, 4.1% në 2024 dhe 2.5% në 2025. Ndërkohë, mbështetja financiare shtesë, ashtu sikurse për kategorinë e pensionistëve, është orientuar drejt pagesave të njëhershme, përfshirë fondin prej 2,228 milionë lekë të akorduar në fund të vitit 2025 për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuara, pa sjellë rritje të qëndrueshme të masës mujore të përfitimeve.

Nga auditimi janë konstatuar gjithashtu problematika në administrimin dhe përllogaritjen e përfitimeve të skemave të sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, përfshirë pasaktësi në përcaktimin e masës së pensioneve, dokumentim të paplotë të pagesave dhe kontrolle të pamjaftueshme.

Nga auditimi i *skemës së sigurimeve shëndetësore* ka rezultuar se të ardhurat nga kontributet dhe burimet e tjera kanë mbuluar vetëm 36.8% të shpenzimeve të përgjithshme prej 63,927 milionë

lekë, duke evidentuar varësinë e konsiderueshme të financimit të skemës nga buxheti i shtetit. Pavarësisht rritjes së shpenzimeve me 8.8% krahasuar me vitin 2024, janë konstatuar fonde të pashfrytëzuara prej 366 milionë lekë për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve, ndërsa investimet nga FSDKSSH janë realizuar në masën vetëm 2.3% të planit vjetor. Në administrimin e Listës së Barnave të Rimbursueshme janë evidentuar 373 barna pa konsum, përfshirë 77 alternativa të para, për të cilat nuk janë kryer verifikime mbi disponueshmërinë e tyre në treg, si dhe 200 barna pa kontratë, nga të cilat 64 me konsum të realizuar. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi në ushtrimin e kontrolleve ndaj depove farmaceutike, inventarizimin fizik të barnave të rimbursueshme dhe monitorimin e qarkullimit të tyre nëpërmjet sistemit e-Depo. Kontrollet janë kryer mbi kampione të kufizuara barnash, pa një analizë risku dhe metodologji të dokumentuar për përzgjedhjen e tyre, ndërsa ka rezultuar se 19 importues dhe distributorë farmaceutikë kanë kryer dalje të 9.3 milionë njësi të barnave me vlerë zero, nga të cilat 283 mijë njësi në prag skadence, pa u kryer verifikime të mjaftueshme për destinacionin dhe përdorimin e tyre. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi në dokumentimin e kontrolleve dhe ndjekjen e zbatimit të detyrimeve kontraktuale, përfshirë aplikimin e penaliteteve për shkeljet e evidentuara.

KLSH ka kryer auditimin e *dy kontratave koncesionare në sektorin e shëndetësisë,* për kontrollin mjekësor bazë dhe sterilizimin e instrumenteve kirurgjikale, të cilat ndodhen në vitin e përfundimit të afatit kontraktual.

Nga auditimi i koncesionit të kontrollit mjekësor bazë rezultoi se, gjatë periudhës 2015–2025, volumi i projektuar prej 475,000 kontrollesh në vit është arritur dhe tejkaluar vetëm në vitin 2019, ndërsa në asnjë vit nuk është arritur ky projeksion për efekt pagesash. Deri më 31.12.2025, pagesat totale ndaj koncesionarit kanë arritur në 8,053 milionë lekë me TVSH, për 4,366,140 kontrolle të financuara, nga të cilat 3,877,008 kontrolle të realizuara dhe 489,132 kontrolle të pakryera. Pavarësisht volumit faktik të shërbimit, pagesat janë kryer mbi bazën e volumit minimal të garantuar prej 475,000 kontrollesh në vit, duke rezultuar në pagesa prej rreth 902 milionë lekë me TVSH për kontrolle të pakryera. Pavarësisht mosrealizimit të vazhdueshëm të projeksioneve, nuk rezulton të jetë kryer një rivlerësim i treguesve financiare të kontratës në raport me shërbimin faktik. Për koncesionin e sterilizimit, financimi buxhetor gjatë periudhës 2016–2025 ka arritur në 15,111 milionë lekë me TVSH, duke tejkaluar me 3,523 milionë lekë, ose 30.4%, vlerën maksimale të planifikuar, ndërsa janë konstatuar problematika në respektimin e tavaneve të financimit dhe monitorimin e investimeve. Gjithashtu, nga auditimi është konstatuar se të dyja kontratat koncesionare kanë vijuar të faturohen me TVSH, ndonëse shërbimet përkatëse duhet të trajtoheshin si të përjashtuara, duke sjellë një kosto shtesë, nga të cilat 1,342 milionë lekë për kontrollin mjekësor bazë dhe 2,518.5 milionë lekë për sterilizimin e instrumenteve kirurgjikale. Në prag të përfundimit të kontratave, marrin rëndësi të veçantë edhe problematikat e konstatuara në përmbushjen e detyrimeve për investimet, si dhe në përgatitjen për marrjen në administrim të shërbimeve nga autoritetet publike. Për kontratën e kontrollit mjekësor bazë, janë konstatuar mangësi në monitorimin dhe verifikimin e përmbushjes së detyrimeve për investimin fillestar dhe riinvestimet, si dhe mospërputhje ndërmjet dokumenteve kontraktuale lidhur me vlerën e parashikuar të investimit. Në veçanti, nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi për ngritjen dhe funksionimin e 20 laboratorëve në të gjithë territorin e vendit, duke cenuar modelin e organizimit dhe shpërndarjes territoriale të shërbimit të parashikuar në ofertën fituese, shoqëruar edhe me parregullsi në nënkontraktimin e një pjese të shërbimeve. Gjithashtu, nuk është hartuar dhe miratuar plani i daljes nga kontrata. Për koncesionin e sterilizimit janë konstatuar mangësi të konsiderueshme në mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, ku gjatë periudhës 2016–2021 nuk janë kryer monitorime nga strukturat përgjegjëse, ndërsa kontrollet e mëvonshme nuk kanë siguruar verifikimin e plotë të detyrimeve kontraktuale, investimeve dhe standardeve të shërbimit. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në dokumentimin e shërbimeve, si dhe në verifikimin e gjendjes teknike dhe funksionale të aseteve që duhet t'i transferohen autoritetit publik. Vendosja e qendrës së trajtimit të mbetjeve spitalore në pronë private dhe realizimi i transportit nga palë të treta kanë krijuar problematika shtesë për marrjen në administrim të infrastrukturës dhe garantimin e vijimësisë së shërbimit pas përfundimit të kontratës, me risk për lindjen e nevojave për financim shtesë nga buxheti i shtetit.

Për të dytin vit radhazi, Ministria e Financave nuk ka finalizuar Raportin e Performancës së Kontratave të Koncesionit/PPP për vitin 2025, duke mos mundësuar vlerësimin e konsoliduar të performancës financiare e jofinanciare të kontratave, si dhe identifikimin dhe monitorimin sistematik të risqeve fiskale që burojnë prej tyre.

Nga auditimi i administrimit të *Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit* për vitin 2025 rezultoi se, nga plani përfundimtar prej 2,900 milionë lekë, është miratuar përdorimi i 2,430 milionë lekëve, nëpërmjet 12 vendimeve të Këshillit të Ministrave. Nga shqyrtimi i këtyre vendimeve, në 5 prej tyre, me vlerë totale rreth 782 milionë lekë, janë evidentuar financime për veprimtari dhe detyrime me karakter të parashikueshëm, ndërkohë që nevojat përkatëse për financimin e tyre duhet të ishin përfshirë në planifikimin fillestar ose të trajtoheshin nëpërmjet procedurave të zakonshme të ndryshimit të buxhetit. Gjithashtu, për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2025, në buxhetin e shtetit ishte parashikuar një fond i posaçëm rezervë prej 2,500 milionë lekë, por pavarësisht këtij parashikimi, gjatë vitit është miratuar një financim shtesë prej 927.2 milionë lekë nga Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, duke e çuar financimin e përgjithshëm të zgjedhjeve 37.1% mbi nivelin e planifikuar fillimisht, pavarësisht parashikueshmërisë së këtij shpenzimi.

Nga auditimi i *Fondit të Rindërtimit* për vitin 2025 prej 5,000 milionë lekë, ka rezultuar se janë shpërndarë vetëm 1,733.5 milionë lekë, nëpërmjet 18 vendimeve të Këshillit të Ministrave, të gjitha të miratuara gjatë muajit dhjetor, nga të cilat 7 vendime, me vlerë 763.4 milionë lekë, më 30 dhjetor 2025. Gjithashtu, janë miratuar projekte të reja, pa siguruar më parë financimin e nevojshëm për përfundimin e projekteve të mbartura. Janë konstatuar mangësi në identifikimin dhe ndjekjen e projekteve, si dhe klasifikim i pasaktë i shpenzimeve operative dhe transfertave për të tretë, në shumën 1,286 milionë lekë, të raportuara si shpenzime kapitale.

Nga auditimi i *Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Shqipërinë*, për të cilin është parashikuar një financim i përgjithshëm prej 922.09 milionë euro, nga të cilat 657.46 milionë euro në formën e huasë, janë konstatuar vonesa në përfitimin dhe disbursimin e fondeve të parashikuara, si pasojë e mospërmbushjes së disa masave të reformës, kryesisht në fushat e qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore, klimës së biznesit, energjisë, sigurisë kibernetike, sistemit gjyqësor dhe transparencës së financave publike. Deri më 31.12.2025, disbursimet për mbështetjen buxhetore kanë arritur në 76.24 milionë euro, ndërkohë, nuk është realizuar asnjë disbursim nga komponenti prej 228.47 milionë euro për financimin e projekteve, për shkak të mosfinalizimit të marrëveshjeve të kontributit me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Gjithashtu, gjatë vitit 2025 nuk janë kryer auditime të brendshme specifike për Instrumentin RGF, duke kufizuar vlerësimin e pavarur të mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të reformave.

Nga auditimi i *menaxhimit të likuiditetit* rezultoi se, në fund të vitit 2025, gjendja e mjeteve monetare prej 120,782 milionë lekë (në llogarinë e unifikuar të thesarit dhe llogaritë speciale në BSH), duke përfshirë edhe investimet afatshkurtra në depozita prej 54,192 milionë lekë, arrin në një total prej 174,974 milionë lekë, duke tejkaluar me 36,343 milionë lekë kufirin maksimal të përcaktuar në nivelin e shpenzimeve buxhetore të planifikuara për dy muaj.

Në fund të vitit 2025, *stoku i raportuar i detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme* ka rezultuar rreth 5,903 milionë lekë, nga të cilat 2,933 milionë lekë i përkasin qeverisjes vendore, 1,558 milionë lekë qeverisjes qendrore dhe 1,411 milionë lekë detyrimeve për rimbursimin e TVSH-së. Nga auditimi janë konstatuar pasaktësi në regjistrimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura dhe të pagesave për shlyerjen e tyre. Konkretisht, nga testimi i 1,164 institucioneve dhe njësive buxhetore, në 373 prej tyre janë evidentuar mospërputhje ndërmjet pagesave faktike të regjistruara në SIFQ dhe atyre të raportuara, ku pagesat faktike rezultojnë rreth 1,793 milionë lekë më të larta. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi në zbatimin e skemës së kontabilizimit të faturave të prapambetura, me ndikim në saktësinë e raportimit të detyrimeve dhe njohjen e shpenzimeve në periudhën përkatëse. Në nivelin e vetëqeverisjes vendore, vetëm 14 bashki përbëjnë rreth 77% të stokut të detyrimeve të prapambetura dhe në fund të vitit 2025, pesë bashki vijojnë të klasifikohen me probleme ose në vështirësi financiare.

Risqet kryesore fiskale të evidentuara lidhen me detyrimet faktike dhe kontingjente që burojnë nga vendimet gjyqësore dhe arbitrazhet ndërkombëtare, veprimtaritë dhe detyrimet e ndërsjellta të

ndërmarrjeve me kapital shtetëror, kryesisht në sektorët e energjisë dhe ujësjellës-kanalizimeve, kontratat koncesionare dhe të partneritetit publik-privat, si dhe detyrimet e mundshme që rrjedhin nga fatkeqësitë natyrore dhe mjedisore. Nga auditimi janë konstatuar detyrime financiare të konsiderueshme që burojnë nga *vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar*, si dhe mangësi në shlyerjen në kohë dhe administrimin e tyre. Në fund të vitit 2025, detyrimet faktike dhe kontingjente të raportuara për vendimet e GJEDNJ-së kanë rezultuar në rreth 19.95 milionë euro, për 9 vendime për të cilat është tejkaluar afati tremujor i ekzekutimit. Vonesat në shlyerjen e këtyre detyrimeve kanë sjellë akumulimin e interesave, të cilat kanë arritur në rreth 4.59 milionë euro, nga rreth 4 milionë euro në fund të vitit 2024, të përqendruara kryesisht në 3 vendime. Për çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar, detyrimet faktike dhe kontingjente të raportuara në fund të vitit 2025 kanë rezultuar në rreth 179.95 milionë euro, ndërsa gjatë vitit janë përballuar nga buxheti i shtetit rreth 147.5 milionë lekë për shpenzime ligjore, mbrojtjeje dhe kosto të tjera të procedurave të arbitrazhit.

Nga *auditimi i marrëdhënieve financiare ndërmjet ndërmarrjeve publike në sektorin energjetik dhe atë të ujësjellës-kanalizimeve* janë konstatuar detyrime të konsiderueshme të pashlyera dhe të parakorduara ndërmjet operatorëve publikë, si dhe ndaj buxhetit të shtetit, shoqëruar me mangësi në monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e risqeve fiskale që burojnë nga gjendja financiare e këtyre kompanive. Në fund të vitit 2025, stoku i raportuar i këtyre detyrimeve arriti në 175.42 miliardë lekë, me një rritje prej 4.18 miliardë lekë krahasuar me vitin 2024, e ndikuar kryesisht nga rritja me 4.98 miliardë lekë e detyrimeve të KESH-it ndaj Ministrisë së Financave. Pavarësisht mbështetjes buxhetore prej 5.28 miliardë lekë për sektorin energjetik gjatë vitit 2025, detyrimet kanë vijuar të akumulohen, duke evidentuar mosarritjen e objektivave të masave të ndërmarra për reduktimin e detyrimeve të prapambetura.

Deficiti buxhetor për vitin 2025 është raportuar në shumën 47,089 milionë lekë, ose 76.4% të planit përfundimtar, duke respektuar kufirin e miratuar, por me një rritje prej 29,105 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Ecuria e tij është karakterizuar nga përqendrimi i shpenzimeve në fund të vitit, ku vetëm gjatë muajit dhjetor është regjistruar një deficit prej 96,207 milionë lekë, duke përthithur tërësisht suficitin prej 49,118 milionë lekë të akumuluar gjatë periudhës janar–nëntor. Në këtë muaj janë realizuar rreth 40.6% e shpenzimeve kapitale vjetore. Pavarësisht respektimit të kufirit të miratuar, nga auditimi janë konstatuar pasaktësi në njohjen, klasifikimin dhe raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, me ndikim në saktësinë dhe plotësinë e treguesve të raportuar për vitin 2025. Konkretisht, përfshirja e parapagimeve në të ardhurat tatimore ka sjellë mbivlerësimin e tyre me 3,759 milionë lekë, ndërsa regjistrimi si shpenzim buxhetor i transfertës prej 16,587 milionë lekë në Llogarinë e Fondit të Pensioneve ka ndikuar në mbivlerësimin e shpenzimeve dhe rrjedhimisht, të deficitit. Problematika janë konstatuar edhe në trajtimin e detyrimeve të prapambetura, ku në shpenzimet e vitit 2025 janë përfshirë pagesa prej 9,462 milionë lekë për detyrime të viteve të mëparshme, ndërsa stoku i detyrimeve të pashlyera në fund të vitit, prej 4,701 milionë lekë, nuk është njohur si shpenzim i periudhës. Nga ana tjetër, mosnjohja e interesave të akumuluara gjatë vitit për vendimet e GJEDNJ-së, në shumën 56.7 milionë lekë, ka ndikuar në nënvlerësimin e shpenzimeve dhe deficitit të raportuar. Mangësi janë evidentuar gjithashtu në njohjen dhe raportimin e detyrimeve financiare për skema të veçanta si kompensimi i pronës, dëmshpërblimi i ish-të përndjekurve politikë dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore, që raportohen vetëm në nivelin e detyrimit të financuar.

Në fund të vitit 2025, *stoku i borxhit publik* ka arritur në 1,401,519 milionë lekë, duke u rritur me 36,512 milionë lekë, ose 2.7%, krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së është ulur nga 54.21% në 52.87%, i ndikuar nga rritja e PBB-së nominale dhe nga efektet e kursit të këmbimit, ku vetëm rivlerësimi i borxhit në valutë ka ndikuar në uljen e stokut ,të shprehur në lekë, me rreth 19,276 milionë lekë. Në kuadër të financimit të nevojave buxhetore, gjatë vitit 2025 është emetuar Eurobondi prej 650 milionë euro, me afat maturimi 10-vjeçar dhe kupon 4.75%. Gjithashtu, janë evidentuar mospërputhje në klasifikimin e këtij financimi, i cili në aktin e rakordimit ndërmjet strukturave të Thesarit dhe borxhit është pasqyruar si mbështetje buxhetore, ndërsa në treguesit fiskalë të konsoliduar është klasifikuar si hua afatgjatë e marrë.

Nga auditimi është konstatuar se, pavarësisht uljes së *stokut të borxhit të garantuar nga shteti* në 29,088 milionë lekë në fund të vitit 2025, mospërmbushja e detyrimeve nga subjektet përfituese ka vijuar të krijojë kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Konkretisht, gjatë vitit 2025, buxheti ka përballuar pagesa prej 2,817 milionë lekë për detyrimet e kredive të garantuara, nga të cilat 2,384 milionë lekë për principalin dhe 433 milionë lekë për interesat.

Në fund të vitit 2025, *të drejtat e paarkëtuara ndaj buxhetit të shtetit nga subjektet përfituese* të nënhuasë dhe garancive kanë arritur në 73,434 milionë lekë, nga të cilat 51,079 milionë lekë nga marrëdhëniet e nënhuasë, 21,927 milionë lekë nga garancitë shtetërore dhe 428 milionë lekë nga kredi të tjera, me një rritje prej 1,372 milionë lekë, krahasuar me 2024. Detyrimet e paarkëtuara nga garancitë shtetërore janë rritur me 2,035 milionë lekë; detyrimet e paarkëtuara nga kredi të tjera kanë shënuar një rritje prej 25 milionë lekë, ndërsa detyrimet nga nënhuatë kanë pësuar një ulje prej rreth 688 milionë lekë. Megjithatë, kjo ulje është ndikuar kryesisht nga reduktimi i detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërkohë që në sektorin energjetik, sektorin e ujësjellësve dhe për Albcontrol janë regjistruar rritje të detyrimeve.

Gjithashtu, janë evidentuar raste të miratimit *të garancive të reja shtetërore* për subjekte me detyrime ekzistuese të pashlyera ndaj buxhetit të shtetit, si OSHEE sh.a., për financimin prej 45.75 milionë euro, dhe KESH sh.a., për financimin prej 30 milionë euro, të shoqëruara me mangësi në dokumentimin e vlerësimit ekonomiko-financiar të aftësisë paguese të subjekteve për të përmbushur angazhimet e reja financiare, duke rritur ekspozimin e buxhetit ndaj risqeve fiskale.

Nga auditimi i *raportimit financiar* rezultoi se vijojnë të mos hartohen pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit, duke mos mundësuar certifikimin e tyre për vitin 2025 dhe duke kufizuar vlerësimin e plotë dhe të besueshëm të aktiveve, detyrimeve dhe pozicionit financiar të sektorit publik. Gjithashtu, 38 institucione nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare vjetore individuale, ndërsa 5 institucione, nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të konsoliduara. Janë evidentuar edhe mangësi në rakordimin e të dhënave financiare me SIFQ, eliminimin e transaksioneve të ndërsjella dhe konsolidimin e informacionit financiar të ndërmarrjeve publike. Auditimet financiare të kryera nga KLSH në njësitë e qeverisjes së përgjithshme kanë evidentuar pasaktësi dhe gabime materiale në pasqyrat financiare, kryesisht në drejtim të njohjes dhe klasifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, regjistrimit dhe vlerësimit të aktiveve, evidentimit të plotë të detyrimeve debitore dhe kreditore, të cilat kanë kualifikuar opinionet e auditimit.

Në drejtim të *auditimit të brendshëm*, nga 1,043 angazhime të planifikuara gjatë vitit 2025 janë realizuar 963, ndërkohë që janë konstatuar mangësi në mbulimin institucional dhe kapacitetet profesionale. Konkretisht, 45 njësi publike rezultojnë të pambuluara me shërbim auditimi të brendshëm, ndërsa nga 533 pozicione të miratuara, 68 kanë qenë vakante. Gjithashtu, procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm nuk është realizuar për të tretin vit radhazi, ndërkohë që nga 465 audites në detyrë, 152 rezultojnë të pacertifikuar. Janë evidentuar gjithashtu mangësi në planifikimin e veprimtarisë audituese, ndryshime në strukturën e angazhimeve të realizuara kundrejt planit, si dhe dobësi në dokumentimin dhe monitorimin e rezultateve të auditimit. Nga auditimet e kryera nga KLSH janë konstatuar gjithashtu mangësi në organizimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm, planifikimin e angazhimeve mbi bazë risku, dokumentimin e veprimtarisë audituese, si dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe funksionimin e komiteteve të auditimit.

Sa i përket *sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK),* vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2025 evidenton përmbushje të pjesshme të kritereve në 16 nga 18 treguesit e vlerësuar, ndërsa dy treguesit e planifikimit dhe raportimit të MFK-së janë vlerësuar se plotësojnë kriteret, por kanë nevojë për përmirësim. Nga analiza e vetëvlerësimit të MFK-së, menaxhimi i riskut ka rezultuar komponenti me vlerësimin më të ulët, në nivelin 61.2%, ndërsa aktivitetet e kontrollit dhe monitorimi janë vlerësuar përkatësisht në nivelet 69.8% dhe 67.5%. Problematikat kryesore lidhen me identifikimin dhe trajtimin e risqeve, dokumentimin dhe zbatimin e procedurave të kontrollit, monitorimin e masave korrigjuese dhe përgjegjshmërinë menaxheriale. Nga auditimet e kryera nga KLSH janë konstatuar gjithashtu mangësi në funksionimin e strukturave përgjegjëse për MFK-në, mosmiratim të planeve të veprimit për zhvillimin e kontrollit

të brendshëm, parregullsi në procesin e vetëvlerësimit vjetor institucional, si dhe mungesë të analizave periodike mbi efektivitetin e sistemit.

Në mbështetje të auditimeve të kryera për efekt të zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025, me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara, forcimin e disiplinës buxhetore dhe përmirësimin e administrimit, kontrollit dhe raportimit të financave publike, ***KLSH rekomandon marrjen e masave*** *si më poshtë:*

1. Të forcohen mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes së procesit të planifikimit dhe rishikimit të buxhetit, duke garantuar respektimin e afateve dhe procedurave ligjore, argumentimin e ndryshimeve buxhetore dhe përputhshmërinë ndërmjet treguesve të miratuar në aktet buxhetore dhe atyre të regjistruar në sistemet informatike financiare.
2. Të merren masa për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, duke siguruar koherencën dhe përputhshmërinë e dispozitave përkatëse me parimet dhe kërkesat e ligjit organik të buxhetit.
3. Të përmirësohet disiplina e ekzekutimit buxhetor, nëpërmjet forcimit të kontrolleve mbi angazhimet financiare, respektimit të kufijve të financimit dhe parapagimeve, regjistrimit në kohë të kontratave dhe faturave, si dhe planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike.
4. Të merren masa për rritjen e saktësisë së treguesve fiskalë, nëpërmjet verifikimit dhe rakordimit të transaksioneve buxhetore, njohjes dhe klasifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre ekonomike dhe periudhës përkatëse, si dhe trajtimit të pasaktësive që ndikojnë në raportimin e treguesve fiskal.
5. Të forcohen mekanizmat e administrimit të likuiditetit dhe detyrimeve të prapambetura, duke siguruar rakordimin e plotë të detyrimeve të raportuara me regjistrimet në sistemin e Thesarit, përmirësimin e planifikimit të flukseve monetare dhe koordinimin e tyre me nevojat faktike të financimit.
6. Të forcohet administrimi dhe monitorimi i detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet e nënhuasë dhe garancitë shtetërore, nëpërmjet masave konkrete për rikuperimin e shumave të përballuara nga buxheti i shtetit. Paralelisht, të përmirësohen mekanizmat e identifikimit, vlerësimit dhe raportimit të risqeve fiskale që lidhen me ndërmarrjet publike, detyrimet kontingjente dhe angazhimet e tjera financiare të shtetit.
7. Të merren masa për forcimin e koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të Instrumentit RGF, me fokus përmbushjen në kohë të kushteve të disbursimit, finalizimin e marrëveshjeve për financimin e projekteve dhe sigurimin e mbulimit me auditim të brendshëm mbi bazë risku, me qëllim përthithjen në kohë të fondeve.
8. Të përshpejtohet procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, si dhe forcimi i mekanizmave të menaxhimit të riskut dhe monitorimit të përdorimit të fondeve publike.
9. Të merren masa për garantimin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, marrjen në dorëzim dhe transferimin e aseteve në përfundim të kontratave koncesionare dhe të partneritetit publik-privat nga autoritetet publike.
10. Të forcohen mekanizmat e administrimit, evidentimit dhe regjistrimit të pasurive shtetërore në regjistrat përkatës dhe në pasqyrat financiare, duke garantuar inventarizimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë të tyre, për të maksimizuar shfrytëzimin ekonomik të këtyre pasurive.

PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I BUXHETIT

1. Mbi procesin e përgatitjes së PBA-së 2025–2027 dhe projektbuxhetit të vitit 2025

Nga auditimi i procesit të përgatitjes dhe miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025–2027 dhe projektbuxhetit të vitit 2025, u konstatuan vonesa në miratimin dhe përcjelljen e dokumenteve të planifikimit buxhetor, mosrespektim i afateve dhe procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe mangësi në komunikimin në kohë të tavaneve buxhetore institucioneve përkatëse. Gjithashtu, u evidentuan problematika në përdorimin e sistemit AFMIS për përgatitjen e kërkesave buxhetore, duke ndikuar në zhvillimin e procesit të planifikimit buxhetor. Konkretisht:

Kalendari i menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2024 është paraqitur nga Ministri i Financave me shkresën nr. 23993, datë 29.12.2023 dhe është miratuar me VKM-në nr. 22, datë 17.01.2024, përtej afatit të përcaktuar në nenin 22 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2025–2027 është miratuar me VKM-në nr. 41, datë 24.01.2024.

Tavanet përgatitore të PBA-së 2025–2027 për fazën strategjike janë miratuar me VKM-në nr. 184, datë 27.03.2024, 28 ditë pas afatit të përcaktuar në Kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike, dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, të ndryshuar. Tavanet u janë përcjellë institucioneve të qeverisjes qendrore me shkresën nr. 4242, datë 02.04.2024, duke reduktuar kohën në dispozicion për përgatitjen dhe përshtatjen e kërkesave të fazës strategjike.

Udhëzimi plotësues nr. 4, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027” është miratuar brenda afatit, por pa i bashkëlidhur tavanet përgatitore të shpenzimeve buxhetore. Në pikën 2 të këtij udhëzimi, është parashikuar dërgimi i tyre në një moment të dytë, çka nuk ka mundësuar që institucionet të nisin përgatitjen e kërkesave buxhetore mbi bazën e tavaneve të miratuara që në momentin e përcjelljes së udhëzimit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1, shkronja ‘a’, të nenit 24, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar.

Kuadri Makroekonomik i Rishikuar është miratuar me VKM-në nr. 399, datë 19.06.2024, 7 ditë pas afatit të përcaktuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike.

Dokumenti i PBA-së 2025–2027 dhe relacioni shpjegues është miratuar me VKM-në nr. 398, datë 19.06.2024 dhe është përcjellë më datë 29.07.2024. Në përfundim të diskutimeve dhe komenteve, më datë 12.08.2024 është dërguar versioni përfundimtar, i miratuar po atë ditë, me VKM-në nr. 535, datë 12.08.2024. Miratimi i tavaneve përfundimtare është kryer pas afatit të përcaktuar në nenin 25 të ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar.

Udhëzimi Plotësues nr. 9, datë 10.07.2024, për përgatitjen e PBA-së 2025–2027 është miratuar dhe përcjellë brenda afatit të nenit 27 të ligjit nr. 9936/2008. Megjithatë, udhëzimit nuk i janë bashkëlidhur tavanet përfundimtare buxhetore në nivel programi, duke parashikuar përsëri dërgimin e tyre në një moment të dytë. Tavanet u janë përcjellë institucioneve me shkresën nr. 11027/2, datë 14.08.2024, në kundërshtim me pikën pikën 1, shkronja “a”, të nenit 27 të ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar.

Projektvendimi për miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA-së 2025–2027 është paraqitur nga Ministri i Financave më datë 10.10.2024, por është miratuar me VKM-në nr. 763, datë 13.12.2024, përtej afatit të përcaktuar në nenin 29 të ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2025” është paraqitur në Këshillin e Ministrave me shkresën nr. 13633, datë 10.10.2024. Më datë 24.10.2024 janë përcjellë saktësime për tabelën nr. 2 “Numri i punonjësve për vitin 2025” dhe relacionin shpjegues. Në vijim, me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 44, datë 28.02.2025, është miratuar dokumenti i rishikuar i PBA-së 2025–2027, në përputhje me tavanet e përcaktuara në ligjin nr. 115, datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”.

Nga verifikimi i përdorimit të sistemit AFMIS në procesin e përgatitjes së PBA-së 2025–2027 rezultoi se 4 institucionet e grupit 63 “Institucione të sistemit të drejtësisë” dhe 24 institucione të grupit 87, “Institucione të tjera qeveritare”, vijojnë të përgatisin kërkesat buxhetore manualisht, jashtë sistemit, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimeve vjetore për përgatitjen e PBA-së dhe të Udhëzimit nr. 36, datë 17.12.2019, “Për përgjegjësitë e përdoruesve në Sistemin Informatik të

Menaxhimit Financiar". Të dhënat janë regjistruar më pas në AFMIS nga strukturat e Ministrisë së Financave, ndërkohë që aksesi i drejtpërdrejtë i këtyre institucioneve në sistem vijon të mbetet i pazgjidhur.

Nga verifikimi i procesit të dorëzimit, shqyrtimit dhe konsolidimit të kërkesave buxhetore për PBA-në 2025–2027 rezultoi se:



Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

▸Nga 64 institucione të analizuara, 22 kanë depozituar kërkesat e fazës strategjike pas afatit të përcaktuar, ndërsa 11 institucione kanë depozituar me vonesë kërkesat e fazës teknike në kundërshtim me pikën 9, gërma "a" dhe pikën 10, gërma "a" të Udhëzimit Plotësues nr. 4, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027".

▸Në 3 nga 9 ministritë e përzgjedhura, konkretisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, u konstatuan mangësi në nënshkrimin dhe miratimin e formateve F2 dhe F3 në kundërshtim me pikat 3 dhe 4 të nënçështjes 2.3, Kreu II, të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", i ndryshuar.

▸Në 4 nga 9 ministritë e përzgjedhura, konkretisht në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, u konstatuan diferenca dhe mungesë shpjegimesh ndërmjet formateve F2, F3, Aneksit nr. 4 "Kërkesat shtesë" dhe relacioneve shpjeguese;

▸Në 2 nga 9 ministritë e përzgjedhura, konkretisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, kërkesat shtesë nuk rezultuan të argumentuara plotësisht nëpërmjet analizës së nevojave, lidhjes me objektivat dhe produktet e programeve, si dhe përllogaritjeve financiare përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e pikës 8 të Udhëzimit Plotësues nr. 4, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027".

▸Në 5 nga 9 ministritë e përzgjedhura, konkretisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, u konstatuan mangësi në dokumentacionin e projekteve të investimeve publike, si mungesa e formularëve përkatës, në kundërshtim me Shtojcat 1, 2 dhe 3 të VKM-së nr. 887, datë 27.12.2022, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar.

▸Të 9 ministritë e përzgjedhura kanë paraqitur në fazën teknike kërkesa për financimin e politikave të reja ose për mbulimin e mungesave të financimit të politikave ekzistuese, në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Plotësues nr. 9, datë 10.07.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025–2027".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkesave buxhetore dhe i procesit të konsolidimit të tyre, u konstatua se nuk rezulton e dokumentuar në mënyrë të plotë mënyra e trajtimit të mangësive të evidentuara gjatë fazave të përgatitjes së PBA-së.

Nga krahasimi i kërkesave fillestare dhe shtesë të ministrive me tavanet buxhetore dhe alokimet përfundimtare të miratuara për vitin 2025, rezultuan diferenca në nivelin e financimit të institucioneve, si rezultat i ndryshimeve të kryera gjatë fazave të planifikimit buxhetor. Të dhënat krahasuese paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në milionë lekë

Institucioni	PBA Faza I	Kërkesa shtesë Aneksi 4	PBA Faza II	Buxheti i miratuar 2025	PBA Faza III	Plani përfundimtar 2025
MBZHR	14,214	10,625	15,014	14,604	14,604	15,991
MIE	65,190	56,819	68,370	74,032	74,032	74,491
MF	10,286	1,830	10,356	11,060	11,060	10,440
MA	60,720	4,300	61,220	62,020	62,020	60,341
MEKI	52,144	6,853	49,322	56,006	56,006	45,874
MSHMS	81,829	620	81,844	80,730	80,730	82,369
MD	15,583	8,828	15,853	14,373	14,373	15,520
MEPJ	3,252	390	3,302	3,874	3,874	3,810
MB	27,481	6,546	28,446	31,007	31,007	31,403
MM	51,036	15,979	51,336	52,686	52,686	53,138
MKTS	—	—	—	—	—	7,571
MTM	3,487	1,217	3,536	3,975	3,975	—
TOTALI	**385,223**	**114,007**	**388,599**	**404,367**	**404,367**	**400,948**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Shënim: "—" tregon mungesë vlere në tabelën burim.

Nga auditimi konstatohet se procesi i vlerësimit dhe trajtimit të kërkesave buxhetore shtesë nga Ministria e Financave nuk është shoqëruar me dokumentacion të plotë mbi kriteret e zbatuara dhe arsyetimin e vendimmarrjes për përcaktimin e alokimeve përfundimtare. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, fondet e miratuara për ministritë kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme nëpërmjet akteve normative, veçanërisht në institucionet me peshë të lartë buxhetore.

KLSH ka kryer auditime në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat janë evidentuar problematikat e mëposhtme në procesin e planifikimit buxhetor:

▸ Në 8 njësi të qeverisjes qendrore, 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u konstatua mosngritja ose mosfunksionimi i Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP), ndërsa në 4 njësi të qeverisjes qendrore u evidentuan mangësi në hartimin e pasqyrave sipas formateve të përcaktuara.

▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 1 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentua planifikimi i shpenzimeve me burim financimi të ardhura të papërfshira në planin vjetor, si gjobat dhe kamatëvonesat.

▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 5 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatua mangësi në argumentimin e shpërndarjes së fondeve të investimeve, ndërsa në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonte planifikimi i fondeve për bashkëfinancimet.

▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentuan vonesa në përcjelljen e kërkesave buxhetore. Në 5 njësi të qeverisjes qendrore nuk janë ndjekur të dyja fazat e PBA-së dhe hierarkia e raportimit nga strukturat e varësisë drejt ministrisë përgjegjëse.

▸ Në 13 njësi të qeverisjes qendrore, 18 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në zhvillimin e mbledhjeve të Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS), pjesëmarrjen e EMP-ve, përgatitjen e formularëve të investimeve dhe studimeve të fizibilitetit.

▸ Në 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror nuk janë përfshirë në PBA kërkesat për financimin e detyrimeve të mbartura.

▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore dhe 4 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatua mungesa e analizave gjinore në PBA dhe moszhvillimi i seancave dëgjimore me shoqërinë civile.

▸ Në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 16 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mos argumentim të kërkesave buxhetore.

▸ Në 8 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan mangësi në raportimin e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave afatmesme. Në 8 njësi u konstatua mosmiratimi në afat i udhëzimit plotësues të kryetarit të bashkisë, ndërsa në 5 njësi planifikim jo realist i të ardhurave vendore, pa analiza të dokumentuara të kapaciteteve të arkëtimit.

▸ Në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror nuk janë përfshirë detyrimet e prapambetura në detajimin fillestar, duke u detajuar fonde për projekte të reja.

▸ Në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 13 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror mungonin analizat për planifikimin e shpenzimeve kapitale.

▸ Në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk është hartuar dhe miratuar kalendari i PBA-së; në 6 njësi nuk është miratuar nga këshilli bashkiak kalendari i konsultimeve publike për fazën e dytë; në 2 njësi projektdokumenti i fazës së parë nuk është paraqitur në këshillin bashkiak dhe nuk është

dërguar në Ministrinë e Financave, ndërsa në 3 njësi nuk janë respektuar të gjitha fazat dhe afatet e hartimit të PBA-së.

2.Mbi detajimin e ligjit të buxhetit sipas zërave

Nga auditimi rezultoi se Udhëzimi Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", është miratuar pas fillimit të vitit buxhetor, në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Pavarësisht se fondet për shpenzimet korrente ishin detajuar dhe vënë në dispozicion të institucioneve në SIFQ, deri në miratimin e udhëzimit nuk ishin formalizuar rregullat, procedurat dhe afatet specifike për zbatimin e buxhetit të vitit 2025. Kërkesat e institucioneve janë përcjellë gjatë muajve dhjetor 2024 dhe janar 2025, ndërsa miratimet nga Ministria e Financave kanë vijuar deri më datë 30.01.2025.

Nga auditimi janë konstatuar diferenca ndërmjet vlerave të miratuara në ligjin e buxhetit dhe atyre të reflektuara në SIFQ, për të ardhurat jo tatimore, shpenzimet korrente, fondet e tjera të pashpërndara, shpenzimet kapitale, dhe treguesit e financimit të deficitit. Këto diferenca lidhen kryesisht me reflektimin në SIFQ të burimeve të trashëguara nga transferta e pakushtëzuar dhe nga të ardhurat e veta, duke mos siguruar të drejtat e plota të shpenzimit të fondeve. Për këto burime nuk është pasqyruar plan në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar të miratuar me ligjin e buxhetit. Diferencat e konstatuara, sipas kategorive përkatëse, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

ZËRI	BUXHETI 2025	PLANI FILLESTAR NË SIFQ	DIFERENCA
Të ardhura nga institucionet buxhetore	13,300	10,897	−2,403
Dividendë	300	727	+427
Tarifa e shërbimeve	3,800	5,698	+1,898
Të tjera – të ardhura jotatimore	8,400	8,478	+78
Shpenzime korrente	**656,014**	**694,247**	**+38,233**
Personeli	127,929	126,929	−1,000
Shpenzime operative dhe mirëmbajtje	75,684	71,884	−3,800
Shpenzime për buxhetin vendor	**89,911**	**132,944**	**+43,033**
Shpenzime kapitale	**162,374**	**151,911**	**−10,463**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

3. Mbi rishikimet e ligjit të buxhetit 2025 nëpërmjet akteve normative

Gjatë vitit 2025, buxheti i shtetit ka pësuar ndryshime të ndjeshme krahasuar me planin fillestar, të cilat janë formalizuar nëpërmjet katër akteve normative (AN). Këto ndryshime kanë përfshirë rishikimin e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rialokimin e fondeve ndërmjet zërave buxhetorë, të cilat paraqiten si më poshtë:

Akti Normativ nr. 3, datë 29.04.2025

Sipas relacionit shpjegues, një nga ndryshimet e parashikuara me Aktin Normativ nr. 3, datë 29.04.2025, lidhet me sigurimin e financimit për pjesëmarrjen e Qeverisë Shqiptare në projektin startup "Thinking Machines Lab", të konsideruar me rëndësi strategjike në fushën e inteligjencës artificiale dhe inovacionit teknologjik. Për këtë qëllim, me Aktin Normativ është parashikuar rritja me 1,000 milionë lekë e të ardhurave jotatimore, në zërin "Të ardhura nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara", e shoqëruar me rritjen në të njëjtën masë të shpenzimeve kapitale në programin 01150 "Mbështetje për Inovacionin dhe Teknologjinë", duke mos sjellë ndryshim në nivelin e deficitit buxhetor të miratuar.

Akti Normativ nr. 6, datë 30.07.2025

Me Aktin Normativ nr. 6, datë 30.07.2025, rishikimi i treguesve buxhetorë është mbështetur në ecurinë e realizimit të buxhetit gjatë pesëmujorit të parë, rialokimin e kursimeve të evidentuara dhe financimin e prioriteteve të reja sektoriale. Ndryshimet e propozuara janë argumentuar gjithashtu me nevojën për forcimin e sigurisë kibernetike, centralizimin e sistemeve teknologjike dhe mbështetjen e sektorit të bujqësisë nëpërmjet garancisë sovrane. Në këtë kuadër, nëpërmjet Aktit Normativ është parashikuar rishpërndarje fondeve të shpenzimeve kapitale me pakësim neto në shumën 4,507 milionë lekë, për financimin e shpenzimeve korrente shtesë nëto në të njejtën shumë, pa ndryshuar nivelin e përgjithshëm të të ardhurave, shpenzimeve dhe të deficitit buxhetor. Gjithashtu, është parashikuar krijimi i një garancie sovrane prej 3,000 milionë lekë për sektorin e bujqësisë.

Akti Normativ nr. 10, datë 08.10.2025

Me Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, treguesit e buxhetit janë rishikuar bazuar në ecurinë e realizimit gjatë nëntëmujorit dhe në ndryshimet në organizimin e ministrive dhe fushat e tyre të përgjegjësisë. Në këtë kuadër, është parashikuar rritja e të ardhurave të përgjithshme me 12,104 milionë lekë dhe e shpenzimeve të përgjithshme me rreth 5,696 milionë lekë. Si rezultat, deficiti buxhetor është ulur në nivelin 61,644 milionë lekë, ose 2.4% të PBB-së. Gjithashtu, është parashikuar rialokimi i fondeve drejt projekteve dhe programeve.

Akti Normativ nr. 11, datë 19.12.2025

Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, është kryer rishikimi përfundimtar i treguesve të buxhetit të vitit 2025, bazuar në realizimin e periudhës 11-mujore dhe pritshmëritë deri në fund të vitit. Në këtë kuadër, miratimi i këtij akti në fund të vitit, pas realizimit të pjesës më të madhe të të ardhurave dhe shpenzimeve, ka sjellë përafrimin e planit buxhetor me ecurinë faktike të zbatimit të tij, duke kufizuar rolin e rishikimit si instrument për orientimin paraprak të administrimit të fondeve gjatë vitit. Gjithashtu, me këtë akt është miratuar një shtesë prej 1,200 milionë lekë në transfertën e pakushtëzuar, e shpërndarë për të gjitha bashkitë, me përjashtim të Bashkisë Tiranë, dhe e kushtëzuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se Akti Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, nëpërmjet të cilit janë rishikuar fondet buxhetore në pothuajse të gjithë zërat e tabelës së treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar dhe tabelave shoqëruese, është miratuar në fund të vitit buxhetor, ndërkohë që neni 46 i ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar, parashikon që propozimi për rishikimin ose jo të buxhetit të paraqitet në kuadër të raportimit të muajit qershor mbi zbatimin e buxhetit. Në këtë mënyrë, rishikimi është kryer në një fazë kur pjesa më e madhe e vitit buxhetor kishte përfunduar dhe procesi i përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të vitit pasardhës ishte në fazën përfundimtare, referuar afateve të përcaktuara në nenet 29 dhe 30 të ligjit nr. 9936/2008.

Ndryshimet më të rëndësishme buxhetore janë përqendruar në aktet normative nr. 10 dhe nr. 11, të cilat kanë ndikuar si në nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ashtu edhe në strukturën e tyre.

Në milionë lekë

TREGUESI	BUXHETI 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	NDR. NDAJ LIGJIT
Të ardhurat totale	**757,036**	**758,036**	**758,036**	**770,140**	**770,140**	**+13,104**
Shpenzimet totale	**825,088**	**826,088**	**826,088**	**831,784**	**831,784**	**+6,696**
Shpenzime korrente	656,014	656,014	660,521	662,246	669,356	**+13,342**
Shpenzime kapitale	162,374	163,374	158,867	164,138	157,028	**−5,346**
Deficiti	**(68,052)**	**(68,052)**	**(68,052)**	**(61,644)**	**(61,644)**	**+6,408**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Krahasuar me ligjin fillestar të buxhetit, në planin përfundimtar të miratuar me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, të ardhurat totale rezultojnë të rritura me 13,104 milionë lekë dhe shpenzimet totale me 6,696 milionë lekë. Si rezultat, deficiti i planifikuar është ulur me 6,408 milionë lekë, nga 68,052 milionë lekë në 61,644 milionë lekë.

Në milionë lekë



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH. Bonusi i pensionistëve është pjesë e fondeve speciale.

Në të ardhura, konstatohet se rritja ka ardhur kryesisht nga tatimi mbi të ardhurat personale (+13,507 milionë lekë), të ardhurat nga fondet speciale (+7,814 milionë lekë) dhe të ardhurat jotatimore (+5,943 milionë lekë). Nga ana tjetër, rezulton ulje e ndjeshme e TVSH-së (−10,097 milionë lekë) dhe e tatimit mbi fitimin (−5,362 milionë lekë). Për pasojë, të ardhurat nga tatimet dhe doganat kanë pësuar rënie, e cila është kompensuar nga rritja e të ardhurave nga fondet speciale.

Në shpenzime, konstatohet se rritjet më të mëdha janë evidentuar në shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (+10,303 milionë lekë) dhe në shpenzimet për fondet speciale (+8,931 milionë lekë). Brenda fondeve speciale, pjesa më e madhe e rritjes i atribuohet bonusit të pensionistëve, i cili është rritur nga 3,750 milionë lekë në 9,700 milionë lekë (+5,950 milionë lekë). Nga ana tjetër, rezulton ulje e shpenzimeve për interesa (−6,858 milionë lekë) dhe e shpenzimeve kapitale (−5,346 milionë lekë). Ulja e deficitit është reflektuar në financimin e brendshëm me 7,094 milionë lekë, ndërsa financimi i huaj është rritur me 686 milionë lekë.

Rishikimet buxhetore dhe ndikimi në funksionin e planifikimit

Në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë u konstatuan 28,412 rishikime buxhetore, që i përkasin 3,106 numrave unikë rishikimi[3]. Ecuria mujore e rishikimeve tregon përqendrim të lartë në muajt kur janë miratuar aktet normative. Në muajin dhjetor rezultojnë të kryera rreth 17% e të gjitha rishikimeve që kanë ndryshuar vlerat e buxhetit për vitin 2025. Gjithashtu, u konstatua se aktet normative gjatë vitit ushtrimor kanë formalizuar ndryshime të kryera më parë në SIFQ.

Nga auditimi rezultoi se plani buxhetor i vitit 2025 është ndryshuar edhe gjatë periudhës dhjetor 2025–shkurt 2026. Kjo periudhë mbivendoset me afatin përfundimtar për kryerjen e shpenzimeve (janar 2026) dhe e tejkalon atë. Rishikimet e kryera pas datës 15 nëntor 2025 janë në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Mbi ekzekutimin e buxhetit nëpërmjet sistemit të thesarit SIFQ


Nga analiza e të dhënave të regjistrimit të faturave dhe pagesave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), nëpërmjet të cilit kryhet ekzekutimi i buxhetit të shtetit, rezultoi se gjatë vitit 2025, 748 njësi shpenzuese kanë dorëzuar në Thesar 25,793 fatura, me vlerë totale 64,244 milionë lekë, përtej afatit 30-ditor, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Institucionet me numrin dhe vlerat më të larta të faturave të dorëzuara jashtë afatit paraqiten në tabelën e mëposhtme.

25,793 fatura jashtë afatit 30-ditor — **748** njësi shpenzuese — **64.244** mld lekë

QEVERISJA QENDRORE – TOP 5	MLD LEKË	QEVERISJA VENDORE – TOP 5	MLD LEKË
1 Autoriteti Rrugor Shqiptar (538 fatura)	12.67	1 Bashkia Tiranë (1,465 fatura)	4.95
2 AKSHI (1,408 fatura)	7.49	2 Bashkia Durrës (142 fatura)	0.88
3 QSUT “Nënë Tereza” (2,577 fatura)	5.89	3 Bashkia Kavajë (229 fatura)	0.61
4 AKUK (142 fatura)	4.04	4 Bashkia Elbasan (194 fatura)	0.39
5 Fondi i Zhvillimit Shqiptar (422 fatura)	3.62	5 Bashkia Vlorë (197 fatura)	0.38

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, MF, përpunuar nga KLSH.

Nga analiza e databazës së pagesave në SIFQ, u konstatuan 32 raste me vlerë totale 131 milionë lekë të ekzekutuara përtej afatit 30 ditor nga regjistrimi i tyre, si dhe raste të shlyerjes së pjesshme të faturave me vlerë totale 4,513 milionë lekë. Me buxhetin e vitit 2025, janë shlyer 5,592 fatura të detyrimeve të prapambetura të periudhës 2008–2024, në vlerë totale 9,462.18 milionë lekë, nga të cilat 5,582.32 milionë lekë për investime dhe 3,879.86 milionë lekë për shpenzime operative. Njohja e këtyre detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.




Burimi: Databaza e pagesave në SIFQ, përpunuar nga KLSH.


Konstatohet se janë regjistruar në sistem 981 transaksione, në shumën 40,063.63 milionë lekë, të cilat i takojnë urdhër prokurimeve me datë fizike të viteve 2019-2024, në kundërshtim me afatet e përcaktuara për regjistrim në udhëzimin standard për zbatimin e buxhetit. Gjithashtu, rezulton se

[3] Diferenca shpjegohet me faktin se një rishikim i vetëm mund të prekë njëkohësisht disa institucione, programe, kode projekti ose artikuj buxhetorë.


në vitin 2025 janë regjistruar 1,912 raste të kontratave me datë fizike në vite më të hershme se viti 2025, në vlerë totale 30,074.77 milionë lekë. Institucionet me vlerat më të larta të kontratave të regjistruara jashtë afatit paraqiten si më poshtë:



Gjithashtu, nga auditimi u konstatuan 5,868 kontrata[4], me vlerë totale 119,551 milionë lekë, të regjistruara në SIFQ gjatë vitit 2025 përtej afatit 5-ditor të përcaktuar në nenin 40 të ligjit nr. 9936/2008, të ndryshuar. Vonesat janë evidentuar si në njësitë e qeverisjes vendore, ashtu edhe në ato të qeverisjes qendrore, përfshirë institucionet e pavarura, paraqitur si vijon:



Pas datës 15 tetor 2025, janë lidhur kontrata me vlerë totale 25,244 milionë lekë, në tejkalim të afatit të përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rastet më përfaqësuese paraqiten në tabelën në vijim:



Gjithashtu, u konstatuan vonesa dhe mospërputhje në regjistrimin në SIFQ të urdhër-prokurimeve dhe kontratave që lidhen me ndërmarrjen dhe regjistrimin e angazhimeve buxhetore, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit Standard për Zbatimin e Buxhetit dhe të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga kryqëzimi i databazës së urdhër-prokurimeve me databazën e kontratave, u konstatuan:

▸ 33 raste kur data fizike dhe regjistrimi në sistem i urdhër-prokurimit i përkasin vitit buxhetor 2025, ndërsa data fizike e kontratës i përket vitit 2024;

▸ 327 raste kur urdhër-prokurimi është regjistruar në sistem në vitin 2025, ndërsa urdhër-prokurimi fizik dhe kontrata i përkasin viteve të mëparshme (2019–2024).

[4] për 9,718 raste, pasi një kontratë përfshin disa rreshta regjistrimi në sistem

▸ 19 raste, në vlerë 270.96 milionë lekë, ku diferenca midis datës fizike të kërkesë-blerjes dhe datës fizike të kontratës është 0–10 ditë. Ky afat është praktikisht i pamjaftueshëm për zhvillimin e një procedure prokurimi;
▸ 175 raste, në vlerë 9,122.2 milionë lekë, me diferencë negative në kohë, pra data fizike e kontratës i paraprin datës fizike të kërkesë-blerjes.
Gjithashtu, bazuar në modulin e regjistrimit të investimeve sipas angazhimit, të publikuar nga Ministria e Financave, rezultojnë 44 raste me vlere të kontraktuar gjithsej 24,083.5 milionë lekë, që kanë plan pagesash vetëm për vitin e tretë ose të katërt të angazhimit. Kjo situatë mbart riskun se plani i pagesave të kontratës nuk është regjistruar në SIFQ, për shkak se plani buxhetor për projektet e investimeve nuk është detajuar sipas kërkesave të udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit.
Nga krahasimi i datës së ekzekutimit të pagesës në SIFQ me datën e regjistrimit të urdhër-shpenzimit, u konstatuan 40 raste me vlerë totale të faturave prej 3,261 milionë lekë, kur pagesat nuk janë ekzekutuar sipas parimit "hyrja e parë, dalja e parë" (FIFO).

Ekzekutimi i buxhetit në kushtet e problematikave në funksionimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve informatike financiare
Nga auditimi është konstatuar se ekzekutimi i Buxhetit të Shtetit për vitin 2025 është shoqëruar me problematika në funksionimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve informatike financiare. Sistemi AFMIS ka funksionuar pa mbështetje teknike që prej muajit korrik 2024. Megjithëse në buxhetin e vitit 2025 ishin parashikuar fonde për mirëmbajtjen e tij, gjatë vitit nuk është siguruar kontraktimi i shërbimit të mirëmbajtjes, për shkak të problematikave të hasura në procedurën e prokurimit. Kjo situatë ka krijuar pengesa në veprimtarinë e institucioneve buxhetore dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave, pavarësisht njoftimeve të përsëritura drejtuar AKSHI-t.
Problematika janë evidentuar edhe për Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, për të cilin, pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes në tetor 2025, ka munguar mbështetja funksionale e jashtme. Pavarësisht njoftimit zyrtar të AKSHI-t, nuk rezulton të jenë marrë në kohë masat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit të mbështetjes teknike dhe funksionale të sistemit. Në kushtet e mosfunksionimit normal të AFMIS-it dhe pamundësisë së përdorimit të Arkivës Elektronike, Ministri i Financave ka nxjerrë Urdhrin nr. 164, datë 30.12.2025, “Për vijimin e procesit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit për vitin 2025 në kushtet e mosfunksionimit të sistemit AFMIS”, ku është parashikuar vijimi i procesit të ekzekutimit të buxhetit përmes dorëzimit fizik të dokumentacionit mbështetës të transaksioneve buxhetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme pranë degëve përkatëse të thesarit. Nga auditimi konstatohet se dokumentacioni mbështetës për transaksionet e kësaj periudhe nuk është arkivuar elektronikisht as pas zgjidhjes së problematikave të sistemit.

5. Mbi monitorimin e buxhetit

Nga auditimi i procesit të monitorimit të buxhetit për vitin 2025 u konstatua se, në të 11 rastet e audituara, raportet e monitorimit të dërguara nga institucionet qendrore nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat për formatin dhe përmbajtjen e tyre. Konkretisht, në këto raporte mungojnë, ose paraqiten në mënyrë të paplotë analiza e devijimeve ndërmjet planit dhe realizimit, informacioni mbi treguesit e performancës, numrin e punonjësve, detyrimet e prapambetura, si dhe shkaqet që kanë ndikuar në realizimin e treguesve buxhetorë, në mospërputhje me pikën 49 të Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”.
Mangësitë e evidentuara në raportet vjetore rezultojnë të pranishme edhe në raportimet periodike, pa u shoqëruar me dokumentimin e masave konkrete korrigjuese nga institucionet përgjegjëse dhe të ndjekjes së tyre nga Ministria e Financave. Për rrjedhojë, procesi i monitorimit është përqendruar kryesisht në raportimin e treguesve të realizimit buxhetor, duke kufizuar efektivitetin e monitorimit në identifikimin në kohë të problematikave dhe ndjekjen e masave korrigjuese.

KLSH ka kryer auditime në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga ku kanë rezultuar problematika në lidhje me procesin e monitorimit të buxhetit që konsistojnë në:
▸ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore dhe 4 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan vonesa në hartimin dhe dërgimin e raporteve të monitorimit; në 4 njësi të qeverisjes qendrore dhe 2 njësi të

vetëqeverisjes vendore raportet nuk janë dërguar, ndërsa në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror raportet e paraqitura nuk kanë qenë në përputhje me kërkesat e udhëzimit përkatës.

▸ Në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 13 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentua mospublikimi në faqet zyrtare i raporteve të monitorimit.

▸ Në 7 njësi të qeverisjes qendrore, 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në formatin dhe përmbajtjen e raporteve të monitorimit, përfshirë mungesën e analizës së devijimeve nga plani dhe treguesve të performancës.

6. Mbi menaxhimin e likuiditetit

Bazuar në pikën 3 të nenit 20, të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", kufiri maksimal i gjendjes së akumuluar të likuiditetit në mbyllje të vitit buxhetor përcaktohet në nivelin e vlerës mesatare të shpenzimeve buxhetore të planifikuara për dy muaj. Për vitin 2025, referuar shpenzimeve totale buxhetore të planifikuara prej 831,784 milionë lekë, ky kufi përllogaritet në rreth 138,630.7 milionë lekë. Nga auditimi konstatohet se, në datën 31.12.2025, gjendja e llogarisë së unifikuar të thesarit (TSA), përfshirë mjetet në lekë dhe në valutë, ishte 82,329 milionë lekë, pra brenda kufirit të mësipërm. Megjithatë, duke përfshirë edhe gjendjet e llogarive speciale të mbajtura jashtë TSA-së, në Bankën e Shqipërisë dhe në bankat e nivelit të dytë, gjendja e mjeteve monetare arrin në 120,782 milionë lekë. Llogaritë speciale, sipas nenit 8 të ligjit të buxhetit, krijohen për fondet speciale, financimet e projekteve, ose për qëllimet e menaxhimit eficient të mjeteve monetare. Duke marrë në konsideratë se llogaritë speciale përbëjnë burime financiare që janë në dispozicion për financimin e shpenzimeve buxhetore, rrjedhimisht përjashtimi i tyre shkakton mbajtjen e panevojshme të mjeteve monetare ose huamarrje jo optimale. Gjithashtu, gjendja prej 120,782 milionë lekë nuk përfshin investimet afatshkurtra të kryera në kuadër të menaxhimit të likuiditetit, të cilat në datën 31.12.2025 rezultojnë në katër depozita, me vlerë të konvertuar prej 54,192 milionë lekë. Duke përfshirë TSA-në, llogaritë e mbajtura jashtë saj në Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, si dhe investimet afatshkurtra të mjeteve monetare në valutë, gjendja totale e mjeteve monetare dhe e investimeve afatshkurtra arrin në 174,974 milionë lekë. Kjo vlerë është rreth 36,343 milionë lekë më e lartë se kufiri i përllogaritur mbi bazën e shpenzimeve të planifikuara për dy muaj. Për të menaxhuar likuiditetin e lirë janë përdorur investimet në depozitë, konvertimi outright (i njëanshëm), si dhe blerja e valutave për të mbuluar nevojat për likuiditet. Nga analiza e ecurisë së likuiditetit gjatë vitit evidentohen luhatje të konsiderueshme të gjendjeve monetare, të cilat lidhen ndër të tjera edhe me vendosjen e tepricave të përkohshme në depozita. Janë kryer në total 38 veprime të vendosjes së tepricave të likuiditetit në depozita, nga të cilat 18 raste në vlerë totale 235 miliardë lekë, 3 raste në vlerën 50 milionë USD dhe 17 raste në vlerën 5.45 miliardë EUR. Të ardhurat e akumuluara nga interesat e depozitave të vendosura gjatë vitit dhe nga remunerimi i gjendjeve monetare rezultojnë në vlerën 1,626.6 milionë lekë. Në fund të vitit 2025 rezultojnë të jenë vendosur në depozitë investimet në shumën 30 miliardë lekë dhe 250 milionë Euro, të cilat maturohen në vitin 2026. Megjithatë, sipas raportimit të llogarisë TSA më 31.12.2025, gjatë vitit janë evidentuar humbje nga kursi i këmbimit dhe diferenca nga rivlerësimi i monedhave të huaja me kursin e fundit të vitit. Këto efekte, së bashku me fitimet/humbjet nga kursi i këmbimit për depozitat në valutë dhe elemente të tjera, janë pasqyruar në zërin "Të tjera" të financimit të deficitit në tabelën analitike të treguesve fiskalë të konsoliduar, i cili rezulton në vlerën totale −1,695 milionë lekë. Investimet në depozita, veçanërisht në EUR, paraqesin humbje prej rreth 1,445 milionë lekë, pasi efekti negativ i rënies së kursit të këmbimit ka tejkaluar përfitimin nga interesat.

Nga auditimi rezultoi se, pavarësisht përmirësimeve të evidentuara gjatë vitit 2025 në përdorimin e instrumenteve të menaxhimit të likuiditetit, procesi vijon të përballet me kufizime operacionale dhe mangësi në koordinimin e planifikimit të flukseve monetare me zbatimin e buxhetit. Një tjetër faktor ndikues është përqendrimi i daljeve të mëdha të mjeteve monetare gjatë pjesës së fundit të vitit buxhetor, duke krijuar presion të lartë në menaxhimin e flukseve dalëse. Për më tepër, ndryshimet e shpeshta të buxhetit përmes akteve normative, të cilat shpesh argumentohen si përgjigje ndaj ngjarjeve të paparashikuara, e deformojnë planifikimin fillestar të arkës dhe e bëjnë të vështirë parashikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të likuiditetit në harmonizimin me aktivitetin e huamarrjes.

A. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE


A.1. Planifikimi dhe realizimi i përgjithshëm i të ardhurave

Të ardhurat e buxhetit të shtetit përbëhen nga të ardhurat që shteti mbledh përmes tatimeve, taksave, kontributeve, si dhe burimeve të tjera, përfshirë ndihmat dhe të ardhurat nga pasuritë shtetërore.

A.1.1 Planifikimi fillestar dhe ndryshimet e planit gjatë vitit 2025

Me ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", të ardhurat janë planifikuar në shumën 757,036 milionë lekë, e cila rezulton 46,449 milionë lekë ose 6.5% më shumë se viti 2024. Krahasuar me projektbuxhetin (754,650 milionë lekë), plani i miratuar rezulton 2,386 milionë lekë më i lartë. Rritja është përqendruar te të ardhurat nga tatimet dhe doganat.

Gjatë vitit, plani i të ardhurave është ndryshuar me aktet normative nr. 3/2025 dhe nr. 10/2025. Ecuria e planit të të ardhurave sipas akteve normative paraqitet në tabelën në vijim:



Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Me Aktin Normativ nr. 3/2025, plani i të ardhurave është rritur me 1,000 milionë lekë, në zërin e të ardhurave jo tatimore, e lidhur me arkëtimin në buxhet të vlerave të konfiskuara nga AAPSK. Ndryshimet më të mëdha janë miratuar me Aktin Normativ nr. 10/2025, i cili e ka rritur planin me 12,104 milionë lekë dhe ka ndryshuar pothuajse të gjithë zërat e të ardhurave. Kryesisht:

- të ardhurat nga fondet speciale janë rritur me 7,814 milionë lekë;
- të ardhurat jo tatimore janë rritur me 4,943 milionë lekë;
- të ardhurat nga ndihmat janë rritur me 1,300 milionë lekë;
- të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë ulur me 1,952 milionë lekë. Brenda këtij zëri, tatimi mbi të ardhurat personale është rritur me 13,507 milionë lekë, ndërsa TVSH-ja është ulur me 10,097 milionë lekë dhe tatimi mbi fitimin me 5,362 milionë lekë.

Të ardhurat nga pushteti vendor nuk kanë ndryshuar gjatë vitit dhe kanë mbetur në 40,774 milionë lekë. Si rezultat, plani përfundimtar i të ardhurave ka rezultuar 770,140 milionë lekë, ose 13,104 milionë lekë (1.7%) më shumë se plani fillestar. Në planin përfundimtar, të ardhurat tatimore kanë peshën kryesore, me 93.2% të totalit. Prej tyre, të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë 64.9% të totalit, fondet speciale 23.1% dhe pushteti vendor 5.3%. Të ardhurat jo tatimore përbëjnë 4.1% të totalit, ndërsa ndihmat 2.6%. Ndryshimet sipas zërave të të ardhurave, krahasuar me planin fillestar, paraqiten në tabelën në vijim:

Në milionë lekë

NR.	EMËRTIMI	PROJEKT-BUXHETI	BUXHETI 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	DIFERENCA
I.	Të ardhura nga ndihmat	18,995	18,995	18,995	18,995	20,295	20,295	+1,300
II.	Të ardhura tatimore	712,240	712,240	712,240	712,240	718,102	718,102	+5,862
III.	Të ardhura jotatimore	25,800	26,800	26,800	26,800	31,743	31,743	+4,943
TOTAL	TOTALI I TË ARDHURAVE	754,650	757,036	758,036	758,036	770,140	770,140	+13,104

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Të ardhurat tatimore janë rishikuar në rritje për shumën 5,862 milionë lekë, të ardhurat jotatimore për shumën 5,943 milionë lekë dhe të ardhurat nga ndihmat për shumën 1,300 milionë lekë, krahasuar me planin fillestar të miratuar. Rritja e të ardhurave tatimore ka ardhur tërësisht nga fondet speciale, plani i të cilave është rritur me 7,814 milionë lekë. Plani i të ardhurave nga tatimet dhe doganat është ulur me 1,952 milionë lekë, ndërsa plani i të ardhurave nga pushteti vendor nuk ka ndryshuar gjatë vitit. Ndryshimet sipas kategorive kryesore të të ardhurave, krahasuar me ligjin fillestar të buxhetit, paraqiten në grafikun në vijim:

Në milionë lekë

EMËRTIMI	◂ ulje	rritje ▸	LIGJI → AN 11/2025	NDR. %
I. Të ardhura nga ndihmat		+1,300	18,995 → 20,295	**+6.8%**
II. Të ardhura tatimore		+5,862	712,240 → 718,102	**+0.8%**
II.1 Tatimet dhe doganat	-1,952		501,573 → 499,621	**−0.4%**
II.2 Pushteti vendor		*pa ndryshim*	40,774 → 40,774	0.0%
II.3 Fondet speciale		+7,814	169,893 → 177,707	+4.6%
III. Të ardhura jotatimore		+4,943	25,800 → 31,743	**+23.0%**
TOTAL TOTALI I TË ARDHURAVE		+13,104	757,036 → 770,140	**+1.7%**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

A.1.2 Realizimi i përgjithshëm i të ardhurave buxhetore


Për vitin 2025, të ardhurat e buxhetit të shtetit janë realizuar në shumën 754,608 milionë lekë, kundrejt 770,140 milionë lekë të planit përfundimtar, duke realizuar 98% të planit, me 15,532 milionë lekë të pa realizuara. Krahasuar me vitin 2024, të ardhurat janë rritur me 44,021 milionë lekë, ose 6.2%. Realizimi sipas zërave kryesorë, kundrejt planit të rishikuar, paraqitet në tabelën në vijim:

Në milionë lekë

NR.	EMËRTIMI	Fakti 2024	Buxheti 2025	AN 11/2025	**Fakti 2025**	Diferenca fakt − plan
	TOTALI I TË ARDHURAVE	**710,587**	**757,036**	**770,140**	**754,608**	**−15,532**
I.	**Të ardhura nga ndihmat**	**7,797**	**18,995**	**20,295**	**7,383**	**−12,913**
II.	**Të ardhura tatimore**	**659,096**	**712,240**	**718,102**	**716,283**	**−1,819**
II.1	Nga tatimet dhe doganat	456,984	501,573	499,621	**496,225**	−3,396
II.2	Të ardhura nga pushteti vendor	40,331	40,774	40,774	**40,911**	+137
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	161,780	169,893	177,707	**179,147**	+1,441
III.	**Të ardhura jotatimore**	**43,694**	**25,800**	**31,743**	**30,941**	**−801**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH. Diferenca: fakt − plan; vlerat negative tregojnë mosrealizim.

Pesha e secilit zë në totalin e të ardhurave faktike, si dhe diferencat ndërmjet planit dhe faktit, paraqiten në grafikun në vijim.



Shënim: Pesha specifike llogaritet mbi të ardhurat faktike totale prej 754.6 mld lekësh.
Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Mosrealizimi i përgjithshëm i të ardhurave, në shumën 15,532 milionë lekë, lidhet kryesisht me të ardhurat nga ndihmat, të cilat rezultojnë 12,912 milionë lekë nën planin e rishikuar. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat paraqesin një diferencë negative prej 3,396 milionë lekë, ndërsa ato jotatimore prej 802 milionë lekë. Nga ana tjetër, fondet speciale kanë tejkaluar planin me 1,440 milionë lekë dhe të ardhurat nga pushteti vendor me 137 milionë lekë. Analiza e detajuar e realizimit të të ardhurave kundrejt planit, sipas nënzërave, paraqitet në vijim për secilën kategori.

A.2. Të ardhurat nga ndihmat

Të ardhurat nga ndihmat për vitin 2025 janë raportuar në shumën 7,383 milionë lekë, duke rezultuar 12,913 milionë lekë nën planin përfundimtar dhe 11,612 milionë lekë nën planin fillestar. Krahasuar me vitin 2024, këto të ardhura kanë shënuar një rënie prej 414 milionë lekë. Diferencat kundrejt parashikimeve buxhetore lidhen kryesisht me mosdisbursimin e granteve të planifikuara. Në këtë drejtim, peshën kryesore e zë projekti i investimit “Kapacitete të ofruara në modernizim”, me kod 18AZ208, i planifikuar për Repartin Ushtarak nr. 3001, Tiranë, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, për të cilin ishte parashikuar financim në formë granti në shumën 11,061 milionë lekë, dhe ka rezultuar pa disbursime gjatë vitit 2025.

Gjithashtu, në financimin e përgjithshëm të ndihmave kanë ndikuar edhe programet IPARD për zhvillimin rural, ku që prej korrikut 2023, janë ndërprerë disbursimet për rimbursimin e shpenzimeve të programit, duke reduktuar financimin e sektorit bujqësor.

A.3. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore janë realizuar në shumën 716,283 milionë lekë, ose 1,819 milionë lekë më pak se plani përfundimtar. Mosrealizimi lidhet tërësisht me të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat rezultojnë 3,396 milionë lekë nën planin përfundimtar, edhe pse plani i tyre ishte rishikuar në ulje me 1,952 milionë lekë. Mosrealizimi është kompensuar pjesërisht nga të ardhurat nga fondet speciale, të realizuara 1,440 milionë lekë mbi planin përfundimtar, dhe nga të ardhurat nga pushteti vendor (+137 milionë lekë).

Në raport me vitin 2024, të ardhurat tatimore rezultojnë 57,187 milionë lekë më të larta, kryesisht nga rritja e të ardhurave nga tatimet dhe doganat (+39,241 milionë lekë) dhe nga fondet speciale (+17,367 milionë lekë). Megjithatë, kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për të arritur nivelin e planifikuar për vitin 2025. Në tabelën në vijim paraqitet ecuria e të ardhurave tatimore sipas nënzërave, nga plani fillestar deri te plani përfundimtar, si dhe diferenca e realizimit faktik me planin përfundimtar dhe me faktin e vitit 2024:

milionë lekë

NR.	EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt-buxheti	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Δ AN 11/2025	Δ Fakti 2024
II.	**TË ARDHURA TATIMORE**	**659,096**	**709,854**	**712,240**	**712,240**	**712,240**	**718,102**	**718,102**	**716,283**	**▼ 1,819**	**▲ 57,187**
II.1	Nga tatimet dhe doganat	456,984	499,187	501,573	501,573	501,573	499,621	499,621	**496,225**	**▼ 3,396**	**▲ 39,241**
II.2	Nga pushteti vendor	40,331	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	**40,911**	**▲ 137**	**▲ 580**
II.3	Nga fondet speciale	161,780	169,893	169,893	169,893	169,893	177,707	177,707	**179,147**	**▲ 1,440**	**▲ 17,367**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH. Δ = Fakti 2025 minus kolona e referuar; ▲ mbi plan / rritje ▼ nën plan / rënie

A.3.1. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë realizuar në shumën 496,225 milionë lekë, me një mosrealizim prej 3,396 milionë lekë ndaj planit përfundimtar dhe 5,348 milionë lekë ndaj planit fillestar. Mosrealizimi ndaj planit përfundimtar ka ardhur kryesisht nga tatimi mbi fitimin (−1,840 milionë lekë), tatimi mbi të ardhurat personale (−1,680 milionë lekë), akcizat (−1,362 milionë lekë) dhe taksa doganore (−781 milionë lekë). Ky mosrealizim është kompensuar pjesërisht nga taksat nacionale (+1,692 milionë lekë) dhe TVSH-ja (+574 milionë lekë). Megjithatë, TVSH-ja rezulton mbi planin përfundimtar vetëm pas rishikimit të planit me ulje prej 10,097 milionë lekë. Krahasuar me planin fillestar, të ardhurat nga TVSH-ja rezultojnë 9,523 milionë lekë më të ulëta se parashikimi, ndërsa ato nga tatimi mbi fitimin paraqesin një diferencë negative prej 7,202 milionë lekë. Në raport me vitin 2024, të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë rritur me 39,241 milionë lekë, por kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për të përmbushur as planin fillestar dhe as atë të rishikuar për vitin 2025.

Këto të ardhura përfshijnë tatimet dhe taksat në kompetencë të mbledhjes nga administrata doganore dhe ajo tatimore, si dhe tatimet dhe taksat në kompetencë të përbashkët, sipas planeve të detajuara për secilin autoritet. Ecuria e tyre sipas zërave paraqitet në tabelën në vijim:

Në milionë lekë

NR. EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt Buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Δ ndaj AN 11/2025	Δ ndaj Faktit 2024
II.1 TATIMET DHE DOGANAT	**456,984**	**499,187**	**501,573**	**501,573**	**501,573**	**499,621**	**499,621**	**496,225**	**▼ 3,396**	**▲ 39,241**
Tatimi mbi vlerën e shtuar	213,999	236,040	236,784	236,784	236,784	226,687	226,687	**227,261**	**▲ 574**	**▲ 13,262**
Tatimi mbi fitimin	56,995	65,749	65,749	65,749	65,749	60,387	60,387	**58,547**	**▼ 1,840**	**▲ 1,552**
Akcizat	63,437	66,984	67,620	67,620	67,620	70,961	70,961	**69,599**	**▼ 1,362**	**▲ 6,162**
Tatimi mbi të ardhurat personale	66,163	70,040	70,705	70,705	70,705	84,212	84,212	**82,532**	**▼ 1,680**	**▲ 16,369**
Taksa nacionale dhe të tjera	47,418	49,296	49,637	49,637	49,637	47,107	47,107	**48,799**	**▲ 1,692**	**▲ 1,381**
Taksa doganore	8,973	11,078	11,078	11,078	11,078	10,267	10,267	**9,486**	**▼ 781**	**▲ 513**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH. Δ = Fakti 2025 minus referenca; ▲ mbi plan / rritje ▼ nën plan / rënie

Planifikimi dhe realizimi për tatimet, taksat *në kompetencë mbledhjeje të autoritetit tatimor* paraqitet në tabelën e mëposhtme:

milionë lekë

EMËRTIMI	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Δ Plani 2025	Δ Fakti 2024
TVSH	59,623	65,854	**68,519**	**▲ 2,665**	**▲ 8,896**
Tatimi mbi fitimin	56,994	60,387	**58,547**	**▼ 1,840**	**▲ 1,553**
Tatimi mbi të ardhurat personale	66,141	84,212	**82,532**	**▼ 1,680**	**▲ 16,391**
Taksa nacionale	44,685	45,118	**46,945**	**▲ 1,827**	**▲ 2,260**
TOTALI I TATIMEVE	**227,443**	**255,572**	**256,543**	**▲ 971**	**▲ 29,100**

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit. Δ = Fakti 2025 minus kolona e referuar; ▲ mbi plan / rritje ▼ nën plan / rënie

Të ardhurat nga tatimet, pa përfshirë kontributet që mblidhen për llogari të fondeve speciale, janë realizuar në shumën 256,543 milionë lekë, me një tejkalim prej 971 milionë lekë të planit përfundimtar. Megjithatë, dy nga katër zërat kryesorë rezultojnë të parealizuar. Tatimi mbi fitimin

është realizuar 1,840 milionë lekë nën planin përfundimtar (97.0%), edhe pse plani i tij ishte ulur gjatë vitit nga 65,749 në 60,387 milionë lekë. Tatimi mbi të ardhurat personale nuk është realizuar me 1,680 milionë lekë (98.0%), pas rritjes së planit të tij me 13,507 milionë lekë me Aktin Normativ nr. 10/2025. Tejkalimi i planit në total është arritur nga TVSH (+2,665 milionë lekë) dhe taksat nacionale (+1,827 milionë lekë), që kanë mbuluar mosrealizimin e dy zërave të tjerë. TVSH-ja e arkëtuar bruto është 93,818 milionë lekë, ndërsa rimbursimet e TVSH-së janë 25,299 milionë lekë, ose 27% e arkëtimit bruto. Rimbursimet janë rritur me 2,925 milionë lekë (13.1%) krahasuar me vitin 2024. Në raport me vitin 2024, të ardhurat nga tatimet janë 29,100 milionë lekë më të larta, kryesisht nga TAP-i (+16,391 milionë lekë) dhe TVSH-ja (+8,896 milionë lekë). Tatimi mbi fitimin ka rritjen më të ulët, vetëm 1,553 milionë lekë (2.7%), dhe mbetet zëri me performancën më të dobët si ndaj planit, ashtu edhe ndaj vitit të kaluar.
Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave në *kompetencë mbledhjeje të autoritetit doganor* paraqitet në tabelën e mëposhtme:

milionë lekë

EMËRTIMI	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Δ Plani 2025	Δ Fakti 2024
Taksa doganore	8,973	10,267	**9,486**	▼ 781	▲ 513
TVSH	154,376	160,832	**158,742**	▼ 2,090	▲ 4,366
Akcizat	63,437	70,961	**69,599**	▼ 1,362	▲ 6,162
Të tjera (renta)	2,734	1,989	**1,854**	▼ 135	▼ 880
TOTALI I DOGANAVE	**229,521**	**244,049**	**239,682**	▼ 4,367	▲ 10,161

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit. Δ = Fakti 2025 minus kolona e referuar; ▲ mbi plan / rritje ▼ nën plan / rënie

Të ardhurat nga doganat janë realizuar në shumën 239,682 milionë lekë, me një mosrealizim prej 4,367 milionë lekë ndaj planit përfundimtar (98.2%). Ky mosrealizim ka ndodhur pavarësisht se plani i të ardhurave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave është rishikuar dy herë në ulje gjatë vitit: me Aktin Normativ nr. 6 dhe me Aktin Normativ nr. 10. Me këto ndryshime, plani është ulur nga 251,708 milionë lekë në 244,049 milionë lekë, pra me 7,659 milionë lekë (3.0%). Megjithatë, realizimi faktik ka mbetur nën planin e rishikuar. Krahasuar me planin fillestar, mosrealizimi arrin në 12,026 milionë lekë (4.8%). Të gjithë zërat analitikë të të ardhurave doganore kanë rezultuar nën planin përfundimtar. Efektin më të madh e ka pasur TVSH-ja, me një mosrealizim prej 2,090 milionë lekë (98.7%), që përbën 47.9% të mosrealizimit total. Pas saj vijnë akcizat me 1,362 milionë lekë (98.1%), taksa doganore me 781 milionë lekë dhe rentat me 135 milionë lekë. Taksa doganore ka pasur nivelin më të ulët të realizimit (92.4%), e ndjekur nga rentat (93.2%). Në krahasim me vitin 2024, të ardhurat doganore janë rritur me 10,161 milionë lekë (4.4%), kryesisht nga akcizat (+6,162 milionë lekë) dhe TVSH-ja (+4,366 milionë lekë). Megjithatë, TVSH-ja në doganë, që përbën zërin më të madh, është rritur vetëm 2.8%. Rentat kanë rënë me 880 milionë lekë (−32.2%), duke qenë i vetmi zë në rënie edhe ndaj vitit të kaluar.

Nga auditimet e kryera në administratën tatimore dhe doganore, janë konstatuar mangësi në bashkërendimin me Ministrinë e Financave lidhur me hartimin dhe rishikimin e planit të të ardhurave. Në administratën tatimore, nuk është dokumentuar kontributi i saj në këto procese përmes analizave ekonomiko-financiare, projeksioneve të arkëtimeve dhe vlerësimeve të bazës tatimore. Nga ana tjetër, në administratën doganore, ndonëse parashikimet janë paraqitur në fazën fillestare të planifikimit, ndryshimet e planit përgjatë vitit janë kryer pa përfshirjen e strukturave përgjegjëse të DPD-së nëpërmjet propozimeve mbi bazën e analizave përkatëse.
Mangësi janë evidentuar edhe në procesin e detajimit dhe shpërndarjes në kohë të objektivave dhe planit të të ardhurave. Plani vjetor i të ardhurave tatimore është përcjellë nga Ministria e Financave në shkurt të vitit 2025. Më tej, dërgimi i objektivave dhe planit ka vijuar në baza mujore, në disa raste edhe pas fillimit të muajit përkatës. Për të ardhurat doganore nuk është hartuar në fillim të vitit, një plan mujor i të ardhurave për secilën degë doganore. Objektivat e të ardhurave janë përcaktuar dhe detajuar në mënyrë progresive, kryesisht duke u bazuar në peshën e realizimeve të periudhave të mëparshme, duke sjellë si pasojë diferenca të konsiderueshme ndërmjet të ardhurave të planifikuara dhe arkëtimeve faktike, si në nivelin e degëve doganore, ashtu edhe sipas zërave të të ardhurave. Gjithashtu, monitorimi i realizimit të të ardhurave është mbështetur kryesisht në krahasimin e treguesve plan-fakt, pa u shoqëruar me analiza mbi faktorët që kanë ndikuar në devijimet nga objektivat e përcaktuara, duke kufizuar identifikimin e shkaqeve të

mosrealizimit të të ardhurave, dhe bazën analitike për rishikimin e parashikimeve dhe për përcaktimin në kohë të masave korrigjuese.
Analiza e detajuar e realizimit kundrejt planit, sipas nënzërave të të ardhurave nga tatimet dhe doganat trajtohen në vijim, për secilën kategori të të ardhurave.

A.3.1.1. Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, të mbledhura nga administrata tatimore dhe doganore, janë realizuar në shumën 227,261 milionë lekë. Kjo shumë është 574 milionë lekë mbi planin përfundimtar prej 226,687 milionë lekë, sipas Aktit Normativ nr. 11, datë 19.12.2025. Megjithatë, ky tejkalim është arritur vetëm pas uljes së planit të TVSH-së gjatë vitit me 10,097 milionë lekë. Krahasuar me planin fillestar prej 236,784 milionë lekë, të ardhurat nga TVSH-ja kanë rezultuar 9,523 milionë lekë më pak.

milionë lekë

NR.	AUTORITETI / EMËRTIMI	DPT		DPD		Totali	
		Plani	**Fakti**	Plani	**Fakti**	Plani	**Fakti**
a.	TVSH e arkëtuar	65,855	**93,819**	160,832	**158,742**	226,687	**252,561**
b.	TVSH e rimbursuar	-	**25,299**	-	**-**	0	**25,299**
	TVSH NETO	**65,854**	**68,519**	**160,832**	**158,742**	**226,687**	**227,261**

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit. DPT – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; DPD – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Administrata doganore nuk ka realizuar planin e TVSH-së, me një mosrealizim prej 2,090 milionë lekë, ndërsa administrata tatimore ka realizuar 68,519 milionë lekë TVSH neto, ose 2,665 milionë lekë mbi plan, duke kompensuar mosrealizimin e administratës doganore. TVSH-ja bruto e arkëtuar nga administrata tatimore ka qenë 93,819 milionë lekë, ndërsa rimbursimet kanë arritur në 25,299 milionë lekë, ose 27% të arkëtimit bruto; këto rimbursime nuk janë planifikuar veçmas, pasi plani është hartuar në terma neto. Në krahasim me vitin 2024, të ardhurat nga TVSH-ja janë rritur me 13,262 milionë lekë. Sipas MF-së, rritja e TVSH-së së arkëtuar nga administrata tatimore lidhet me rritjen e qarkullimit në aktivitetin vendas, siç pasqyrohet në të dhënat e fiskalizimit. Mosrealizimi i planit të TVSH-së në doganë lidhet kryesisht me efektin e kursit të këmbimit, pra me mbiçmimin e lekut ndaj monedhave kryesore me të cilat kryhet aktiviteti importues.
Në treguesit analitikë fiskalë të publikuar, të ardhurat nga TVSH-ja raportohen në shumën 68,519 milionë lekë. Sipas raportit të të ardhurave nga SIFQ, të ardhurat faktike për periudhën 12-mujore në llogarinë 7030100 të Aparatit të DPT-së paraqiten në shumën 68,312 milionë lekë, me një diferencë në shumën 207 milionë lekë, si pasojë e parapagimeve dhe rimbursimeve të kryera nga drejtoritë rajonale tatimore. Nga auditimi ka rezultuar se, në të njëjtën mënyrë me një vit më parë, parapagimet për TVSH-në në shumën 213.45 milionë lekë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë raportuar si të ardhura në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar, duke ndikuar në realizimin e raportuar të planit. Këto parapagime nuk përmbushin kushtet e raportimit si të ardhura nga TVSH-ja.

Gjithashtu, në treguesit analitikë fiskalë për të ardhurat nga TVSH-ja konstatohen rimbursime në shumën 6.33 milionë lekë, të kryera nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës në llogarinë 7030100, në kundërshtim me nenin 75/1, pika 1, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". *Nga auditimi në DPT i procesit të rimbursimit të TVSH-së* rezultoi se koha mesatare e procesimit, nga data e paraqitjes së kërkesës deri në datën e miratimit për rimbursim, ka qenë 48 ditë, krahasuar me 31 ditë në vitin 2024. Pesha më e lartë e rimbursimit të TVSH-së për periudhën e raportuar i takon Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, e cila ka ekzekutuar pagesa rimbursimi në shumën 15,594 milionë lekë, (62% të realizimit faktik të rimbursimit), duke tejkaluar planin e miratuar me 9%. Nga auditimi i një kampioni prej 1,658 kërkesash të tatimpaguesve "jo-eksportues" është konstatuar se:
- 280 kërkesa (16.9% e kampionit) janë miratuar jashtë afatit 60-ditor;
- 160 kërkesa (9.7% e kampionit) janë miratuar para kërkesave të tjera të paraqitura më herët, në kundërshtim me metodologjinë FIFO;
- në 89 raste janë tejkaluar afatet prej 5 (pesë) ditësh kalendarike për verifikimin paraprak të kërkesave për rimbursim dhe për dërgimin e njoftimit sipas formatit nr. 2 të udhëzimit, "Njoftim për pranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së".

A.3.1.2. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin paraqiten në shumën 58,547 milionë lekë, me një mosrealizim kundrejt planit përfundimtar, të miratuar me aktin normativ nr. 11 datë 19.12.2025,

prej 1,840 milionë lekë. Në krahasim me vitin 2024, këto të ardhura janë realizuar 1,552 milionë lekë më shumë, ndërkohë që në krahasim me planin fillestar janë realizuar 7,202 milionë lekë më pak. Sipas raportimit të Ministrisë së Financave, me përjashtim të sektorit të prodhimit që ka një rënie prej 18% më pak se viti 2024, të gjithë sektorët e tjerë kanë rritje krahasuar me vitin 2024. Në raportimin e të ardhurave nga tatim fitimi janë konsoliduar edhe rimbursimet e kryera nga Drejtoritë Rajonale Tatimore në shumën -38.5 milionë lekë, ndërkohë që administrimi i llogarive të të ardhurave tatimore kryhet i qendërzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, në të njëjtën procedurë me një vit më parë, në të ardhurat e raportuara për vitin 2025 janë përfshirë parapagime të tatimit mbi fitimin në shumën 43,569 milionë lekë, për të cilat janë konstatuar mangësi në kryerjen e veprimeve rregulluese dhe sistemimin kontabël kundrejt detyrimeve tatimore përkatëse. Kjo problematikë, së bashku me tepricën e akumuluar në llogarinë 466, trajtohet në mënyrë të detajuar më poshtë lidhur me saktësinë e raportimit të të ardhurave tatimore.

A.3.1.3. Të ardhurat nga akciza paraqiten në shumën 69,599 milionë lekë, me një mosrealizim në shumën 1,362 milionë lekë kundrejt planit përfundimtar, të miratuar me aktin normativ nr. 11 datë 19.12.2025. Në krahasim me vitin 2024, këto të ardhura janë realizuar 6,162 milionë lekë më shumë, kryesisht si rezultat i rritjes së sasisë së karburanteve të hedhura për konsum me rreth +78 mijë ton më shumë, cigareve me +210 ton, kafes me +416 ton.

Në milionë lekë

NR. EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt Buxheti 2025	Buxheti 2025	Akti Normativ 3/2025	Akti Normativ 6/2025	Akti Normativ 10/2025	Akti Normativ 11/2025	Fakti 2025
Akcizat	**63,437**	**66,984**	**67,620**	**67,620**	**67,620**	**70,961**	**70,961**	**69,599**
a. Akciza e arkëtuar	63,525							69,625
b. Akciza e rimbursuar	88							26

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas treguesve fiskalë të konsoliduar, akciza e arkëtuar për vitin 2025 paraqitet në shumën 69,625 milionë lekë, ose 6,100 milionë lekë (9.6%) më shumë se në vitin 2024. Akciza e rimbursuar, edhe pse pa plan buxhetor në tabelën treguesve fiskal, paraqitet me realizimi faktik në shumën 26 milionë lekë, ose 62 milionë lekë (70.5%) më pak se në vitin 2024.

A.3.1.4. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale të mbledhura nga administrata tatimore, janë arkëtuar në shumën 82,532 milionë lekë, ose 1,680 milionë lekë (2%) më pak se plani përfundimtar prej 84,212 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, të ardhurat janë rritur me 16,391 milionë lekë (24.7%), por kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për realizimin e planit të rishikuar, i cili është realizuar në masën 98%. Referuar të dhënave të paraqitura nga Ministria e Financave, rritja lidhet kryesisht me rritjen e pagave në sektorin publik dhe privat, ku kanë ndikuar edhe:

- të ardhurat nga tatimi mbi Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave, me rritje rreth 415 milionë lekë, ose 23.3%;
- të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme, me rritje prej rreth 2 miliardë lekë, ose 36%;
- të ardhurat nga interesat bankare, me rritje prej 12.9%;
- të ardhurat nga qiratë, me rritje prej 8.5%.

Në të njëjtën procedurë me një vit më parë rezulton se në zërin e tatimit mbi të ardhurat personale janë raportuar si e ardhur parapagimet në llogaritë 466 në shumën 3,361.5 milionë lekë, duke e mbivlerësuar raportimin për këtë zë.

A.3.1.5. Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera janë realizuar në shumën 48,799 milionë lekë ose 1,692 milionë lekë më shumë se plani përfundimtar. Në krahasim me vitin 2024, këto të ardhura janë realizuar 1,381 milionë lekë më shumë. Sipas raportit të Ministrisë së Financave, zërat që kanë ndikuar në rritje përfshijnë taksën e qarkullimit me rritje 13.4%, taksën për automjetet e përdorura të transportit me rritje 9.5% si dhe taksën për ambalazhet plastike me rritje 9.6%. Përsa i përket rentës minerare të arkëtuar nga DPD konstatohet një rënie prej 880 milionë lekë në vitin 2025, në krahasim me një vit më parë, e ndikuar kryesisht nga ulja e të ardhurave nga renta e naftës bruto, e cila është kompensuar pjesërisht nga ecuria më pozitive e rentës së mineraleve të tjera.

A.3.1.6. Të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në shumën 9,486 milionë lekë, ose 780 milionë lekë më pak se plani përfundimtar. Në krahasim me vitin 2024, këto të ardhura janë realizuar 514 milionë lekë më shumë. Ndër faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e planit përfshihen ndryshimi i origjinës së disa produkteve të importuara gjatë vitit 2025, veçanërisht i cigareve, me efekt rreth -95 milionë lekë; ulja e sasisë së sheqerit të importuar, me efekt rreth -30 milionë lekë; si dhe ndryshimet në importin e ujit dhe lëngjeve të tjera, me efekt rreth -15 milionë lekë.

A.3.1.7. Saktësia e raportimit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat

Nga auditimi i raportimit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat, konstatohet se, njësoj si në vitin e mëparshëm, në treguesit fiskalë të konsoliduar përfshihen edhe arkëtimet e regjistruara në llogaritë e depozitimeve të përkohshme (466), të detajuara sipas llojit të tatimit. Kjo praktikë paraqet risk për saktësinë e raportimit në rastet kur arkëtimet nuk lidhen me detyrime tatimore të përcaktuara sipas legjislacionit përkatës, me përjashtim të parapagimeve të tatimit mbi fitimin të cilat janë parashikuar në legjislacionin mbi tatimin mbi fitimin. Për rrjedhojë, raportimi i parapagimeve të TVSH-së, tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributeve në zërin e të ardhurave tatimore, megjithëse jo material në raport me totalin e raportuar, krijon risk për mbivlerësimin e të ardhurave të raportuara, në masën që këto arkëtime nuk përmbushin kushtet për t'u njohur si të ardhura të periudhës. Shuma e identifikuar nga auditimi për këto parapagime është rreth 3,759 milionë lekë, sipas tabelës së mëposhtme.

Në milionë lekë

LLOGARIA	TATIMI	SHUMA
4665504	TVSH	**213**
4665502	TAP	**263**
4665514	TAP	**3,098**
4665510	Kontribute	**184**
TOTALI		**3,759**

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas praktikës aktuale të raportimit të tatimit mbi fitimin, konstatohet se parapagimet regjistrohen në llogarinë 466, ndërsa në fund të vitit raportohen si të ardhura të periudhës. Për vitin 2025, teprica e kësaj llogarie rezulton mbi 294 miliardë lekë, sipas raportit analitik të të ardhurave. Kjo tepricë kontabël e akumuluar ndër vite, evidenton mungesën e veprimeve rregulluese pas paraqitjes së deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, për sistemimin e parapagimeve kundrejt detyrimeve tatimore përkatëse dhe rakordimin e pozicionit financiar të shtetit kundrejt tatimpaguesve, duke mos pasqyruar saktë detyrimet reale të shtetit për depozitime të përkohshme të tatimpaguesve në lidhje me këtë tatim. Si rrjedhojë, sipas trajtimit aktual kontabël, kjo tepricë vijon të paraqitet në llogaritë e arkëtimeve të përkohshme, pa reflektuar sistemimin përkatës të parapagimeve.

Gjithashtu, në disa raste, konstatohet se në llogaritë analitike të të ardhurave janë kryer rimbursime të tatimit mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale dhe TVSH-së edhe nga drejtoritë rajonale tatimore, duke krijuar diferenca ndërmjet të dhënave të raportuara nga administrata tatimore qendrore dhe treguesve fiskalë të konsoliduar.

A.3.1.8. Administrimi dhe kontrolli i të ardhurave tatimore

KLSH ka audituar veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të drejtorive rajonale tatimore për vitin 2025, me fokus përputhshmërinë e procedurave të administrimit dhe mbledhjes së të ardhurave tatimore e kontributeve dhe kontrollit tatimor.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi në drejtimin metodologjik, planifikimin, monitorimin dhe efektivitetin e kontrolleve tatimore. Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk ka ushtruar asnjë kontroll metodologjik pranë drejtorive rajonale gjatë vitit 2025, ndërsa vonesat në shqyrtimin dhe miratimin e projekt-raporteve janë shoqëruar me një stok prej 793 kontrolle të papërfunduara. Një pjesë e konsiderueshme e kontrolleve të përzgjedhura nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut kanë rezultuar pa zbulime. Gjithashtu, nuk është dokumentuar qartë kohëzgjatja e kontrolleve ndaj individëve, bazuar në analizën e riskut. Në Drejtorinë e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren janë konstatuar mungesë e planeve të punës për tre tremujorët e fundit dhe e raporteve periodike të monitorimit, si dhe ulje e numrit të verifikimeve krahasuar me vitin 2024, ndërsa listat e tatimpaguesve të

përzgjedhur mbi bazë risku nuk janë kontrolluar plotësisht. Në Drejtorinë e Hetimit Tatimor janë konstatuar tejkalime të afateve procedurale, stok dosjesh të mbartura ndër vite dhe mungesë e analizave sistematike të performancës.

Nga auditimi në drejtoritë rajonale tatimore janë evidentuar efekte negative në mbledhjen e të ardhurave tatimore, si pasojë e mangësive në zbatimin e legjislacionit dhe në procedurat e kontrollit, kryesisht lidhur me:

- Kreditimin e padrejtë ose të pajustifikuar të TVSH-së, për automjete, karburant, qira financiare, blerje dhe investime pa dokumentacionin e kërkuar ligjor, përfshirë punime ndërtimore dhe instalime teknike pa provuar pajisjen me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh.
- Kreditimin e TVSH-së për shërbime ndërtimore dhe arkitekturore, përfshirë shërbimet e furnitorëve të huaj, projektimin, studimet sizmike, mbikëqyrjen dhe oponencën teknike, pa verifikuar destinacionin e investimit dhe lidhjen me furnizimet e tatueshme, veçanërisht për ndërtesat e përjashtuara nga TVSH.
- Mosaplikimin ose aplikimin e pasaktë të koeficientit të zbritjes së TVSH-së, për blerjet dhe shpenzimet e përbashkëta të subjekteve që ushtrojnë njëkohësisht aktivitet të tatueshëm dhe të përjashtuar.
- Trajtimin e parregullt të TVSH-së në aktivitetin e rindërtimit, përfshirë kreditimin për materiale të përdorura në furnizime të përjashtuara, kreditimin e plotë të blerjeve të përbashkëta në aktivitetin e përzier dhe aplikimin e përjashtimeve pa provuar kushtet ligjore e teknike.
- Kreditimin e TVSH-së për punime ndërtimore jashtë afateve të lejeve të ndërtimit, si dhe mospërputhjet ndërmjet periudhës faktike të punimeve, faturimit dhe fiskalizimit.
- Deklarimin e kostove të ndërtimit nën nivelet minimale referuese, pa dokumentacion teknik dhe ekonomik justifikues dhe pa rakordim të plotë të volumeve të punimeve, preventivave, situacioneve dhe kapaciteteve faktike.
- Shitjet sistematike nën kosto ose nën çmimet e tregut, pa argumentim ekonomik dhe vlerësim të efekteve në TVSH dhe Tatim Fitim, si dhe shitjet e pasurive të paluajtshme nën çmimet referuese, pa analizuar raportin ndërmjet çmimit të shitjes, kostos së ndërtimit dhe çmimit mesatar referues.
- Mangësitë në analizën tekniko-ekonomike të prodhimit, përfshirë aktivitetin blegtoral, mungesën e kartave teknologjike, analizave të inputeve ushqimore, shtesës në peshë, kapacitetit prodhues, normativave, firove dhe rendimenteve, pa përdorur metoda alternative vlerësimi mbi bazën e kostove standarde.
- Diferencat e parakorduara të inventarëve dhe deklarimeve, ndërmjet inventarit fizik, bilanceve materiale, pasqyrave financiare dhe sistemeve C@ts/CPCM, si dhe mospërputhjet në sasitë dhe çmimet e shitjeve, edhe kur të ardhurat totale rezultonin formalisht të rakorduara, pa trajtuar plotësisht transaksionet e padokumentuara.
- Njohjen e parregullt të shpenzimeve për qëllime fiskale, përfshirë amortizime mbi kufijtë e lejuar ose mbi baza të pasakta për aktivet me leasing, shpenzime pa lidhje të provuar me aktivitetin ekonomik dhe interesa përtej kufizimeve të zbritshmërisë.
- Njohjen e shpenzimeve financiare të pajustifikuara, përfshirë kostot e interesit për kredi bankare ndërkohë që subjektet kanë dhënë hua pa interes ndaj ortakëve ose subjekteve të tjera, si dhe mangësitë në verifikimin e origjinës, kushteve dhe substancës ekonomike të financimeve të ortakëve.
- Transaksionet me palët e lidhura dhe çmimet e transferimit, përfshirë transferimin e kuotave me vlerë nominale, pavarësisht ndryshimeve të konsiderueshme në vlerën ekonomike të shoqërive, pa analiza të mjaftueshme të efekteve fiskale.
- Mosdeklarimin ose deklarimin e pasaktë të parapagimeve nga klientët, pa lëshimin e faturave dhe llogaritjen e TVSH-së në momentin e lindjes së detyrimit, si dhe klasifikimin e papërshtatshëm të parapagimeve dhe të ardhurave.
- Nëndeklarimin e pagave dhe detyrimeve nga punësimi, përfshirë mosrespektimin e pagës minimale, mosdeklarimin ose mospagimin e orëve shtesë dhe pasqyrimin e pasaktë të detyrimeve ndaj punonjësve.

▸ Trajtimin fiskal të sektorit hidrokarbur, me mangësi në verifikimin e kostove hidrokarbure dhe çmimeve të eksportit të naftës bruto kundrejt referencave ndërkombëtare, si dhe efekteve në rentën minerare, Tatimin mbi Fitimin dhe detyrimet e tjera fiskale.

Në veprimtarinë e kontrollit nga zyra janë konstatuar mangësi në monitorimin dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve tatimore, kryesisht lidhur me:

▸Mungesën e analizave periodike dhe të gjurmës së auditimit, dokumentimin e pamjaftueshëm të kontrolleve të planifikuara e të realizuara, mosrespektimin e periudhave të programuara dhe mungesën e akteve justifikuese për penalitetet e regjistruara në sistem.

▸ Mosndjekjen e diferencave ndërmjet FDP-së, deklaratave të TVSH-së dhe Tatim Fitimit, pa analiza të plota të qarkullimit dhe të ardhurave dhe pa rivlerësim ose referim për kontroll të thelluar në vend, si dhe mospërputhjet ndërmjet të dhënave doganore për importet/eksportet dhe deklarimeve në C@ts.


▸ Mungesën e analizave për subjektet me humbje të mbartura ose të përsëritura dhe Tatim Fitim të shtyrë, duke mos vlerësuar plotësisht riskun fiskal dhe bazën e tatueshme të këtyre subjekteve.

▸ Monitorimin e pamjaftueshëm të tepricave kreditore të TVSH-së, të justifikuara me argumente të përgjithshme për investime, importe, inventarë, autongarkesë apo eksporte, pa verifikime të plota dokumentare, si dhe mungesën e analizave për shkallët e reduktuara të TVSH-së, rregullimet e TVSH-së së zbritshme dhe gjendjet kreditore me detyrime për të njëjtin tatim dhe periudhë.

▸ Mosidentifikimin në kohë të subjekteve që kanë tejkaluar kufijtë ligjorë të qarkullimit, pa kaluar në regjimin përkatës të Tatimit mbi Fitimin, me raste të qarkullimit të padeklaruar, si dhe mangësitë në llogaritjen, aplikimin dhe kontabilizimin e penaliteteve për pagesat me vonesë të kësteve.

▸ Mosndjekjen sistematike të tatimpaguesve mosdeklarues ose pa veprimtari.

A.3.1.9. Administrimi i borxhit tatimor



Stoku i detyrimeve tatimore të papaguara është rritur nga 162,535 milionë lekë në fillim të vitit 2025 në 194,432 milionë lekë në fund të vitit, pra me 31,897 milionë lekë ose 19.6%. Numri i subjekteve debitore është rritur nga 202,387 në 212,763. Rritja e stokut ka ndodhur edhe pse gjatë vitit janë arkëtuar 34,200 milionë lekë nga detyrimet tatimore të papaguara. Në proces gjyqësor rezultojnë 1,422 subjekte, me detyrime prej 13,150 milionë lekë. Një pjesë e konsiderueshme e stokut paraqet risk të lartë për mosarkëtim, duke marrë në konsideratë vjetërsinë e detyrimeve dhe statusin e subjekteve debitorë, ku:

▸ 60% e stokut janë detyrime më të vjetra se 5 vjet, 14% janë 2–5 vjeçare, 26% janë nga 0-2 vite;

▸ 65.6% e stokut, ose 127,700 milionë lekë, u përket 125,564 subjekteve pasive;

▸ 36% e stokut, ose 70,069 milionë lekë, janë gjoba, dhe 4.2% janë interesa.

Sipas llojit të tatimit, pjesën më të madhe të stokut e zënë tatimi mbi fitimin, me 68,966 milionë lekë (35.5%), dhe TVSH-ja, me 63,887 milionë lekë (32.9%). Pas tyre vijnë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, me 26,298 milionë lekë (13.5%), zëri "të tjera", me 32,319 milionë lekë (16.6%) dhe tatimi në burim, me 2,960 milionë lekë (1.6%). Rajoni Qendror zë 67% të stokut. Rreth 4.47% e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ose rreth 1,175 milionë lekë, janë krijuar nga ente publike dhe ndërmarrje shtetërore.


Nga auditimi konstatohet se masat shtrënguese të aplikuara nga administrata tatimore janë të kufizuara në raport me numrin e subjekteve debitore dhe nivelin e stokut të detyrimeve të papaguara. Në një pjesë të rasteve, nuk rezulton të jenë shfrytëzuar të gjitha masat shtrënguese të parashikuara nga legjislacioni tatimor.

A.3.1.10 Administrimi dhe kontrolli i të ardhurave doganore

KLSH ka kryer auditime për periudhën ushtrimore të vitit 2025, në drejtim të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe degëve doganore për dhënien e opinionit të

përputhshmërisë mbi mbledhjen e të ardhurave për buxhetin e shtetit, përmirësuar cilësinë e kontrolleve dhe ulur borxhin doganor.
Nga auditimi i praktikave të kontrollit të Drejtorisë së Antikontrabandës u konstatuan mangësi në përcaktimin e detyrimeve doganore, klasifikimin e shkeljeve dhe zbatimin e sanksioneve përkatëse. Për diferencat sasiore të konstatuara nuk janë rillogaritur detyrimet doganore dhe nuk është propozuar vendosja e gjobave në masën e dyfishit të detyrimeve të munguara. Gjithashtu, shkeljet nuk janë trajtuar si kundërvajtje doganore nga neglizhenca, në kundërshtim me përcaktimet e neneve 273–275 të Kodit Doganor. Në disa raste, riklasifikimi i shkeljeve nga kontrabandë në kundërvajtje administrative nuk është mbështetur me dokumentimin dhe argumentimin e fakteve që justifikojnë këtë ndryshim. Mangësi janë evidentuar edhe në përcaktimin e qartë të konfiskimit, identifikimin e autorit të kundërvajtjes dhe të debitorëve të borxhit doganor, si dhe në zbatimin e nenit 269, pika 1, të Kodit Doganor. Në disa vendime është konstatuar vendosja e gjobës në masën e trefishit të detyrimit të munguar, pa pasqyruar në dispozitiv detyrimin bazë të importit.
Nga auditimi i veprimeve administrative të Drejtorisë së Hetimit Doganor u konstatuan, në disa raste, intervale të gjata kohore ndërmjet veprimeve hetimore dhe zgjatje të pajustifikuara të procedurave. Gjithashtu, është evidentuar mungesa e një plani të dokumentuar dhe të miratuar të hetimit, si dhe i dokumentacionit që pasqyron vijimin e procedurave nga degët doganore. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës u konstatuan, në disa raste, mangësi në përgatitjen, dokumentimin dhe zbatimin e procedurave të kontrollit. Grupet e kontrollit nuk kanë administruar kopje të faturave të fundit tatimore të shitjes dhe të blerjes për lëndët e para dhe produktet e akcizës, ndërsa në raportet përfundimtare nuk është pasqyruar vlerësimi për përmbushjen e detyrave të lëna nga kontrollet e mëparshme. Mangësi procedurale janë evidentuar edhe në përfundimin e inventarizimit.
Nga auditimi i kryer në degët doganore, janë evidentuar efekte negative në mbledhjen e të ardhurave doganore si pasojë e mos respektimit të dispozitave të legjislacionit doganor, konkretisht:
▸ Shkeljet doganore në vendimet administrative nuk janë trajtuar dhe klasifikuar drejt, duke mos aplikuar sanksionet dhe penalitetet e duhura, në kundërshtim me nenet 251, 252, 256 dhe 257 të Kodit Doganor, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin. Në disa raste kontrabanda është zgjidhur administrativisht, por dosja nuk i është dërguar "për dijeni" prokurorisë, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 276 dhe pikën 2 të nenit 277 të Kodit Doganor.
▸ Në disa dosje nuk është respektuar afati për mbylljen e regjimeve RPA, ndërsa në disa raste subjektet kanë eksportuar/importuar sasi mbi kufijtë e miratuar në autorizim, çka përbën shkelje doganore sipas neneve 250, 252/c dhe 257/1/b të Kodit Doganor. Në disa raste nuk është kryer kontroll fizik për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv".
▸ Në sektorët e akcizës të degëve doganore janë konstatuar mangësi procedurale dhe administrative në planifikimin, dokumentimin dhe ushtrimin e kontrolleve.

A.3.1.11. Administrimi i borxhit doganor



Stoku i detyrimeve doganore të papaguara më 31.12.2025 ka rezultuar 61,833 milionë lekë, për 4,763 raste. Krahasuar me vitin 2024, stoku është rritur me 12,713 milionë lekë ose 25.9%, ndërsa numri i rasteve me 520 ose 12.3%. Pjesa më e madhe e rritjes, 9,491 milionë lekë ose 74.7%, vjen nga penalitetet sipas vendimeve të autoritetit doganor. Nga rritja neto e stokut, 3,191 milionë lekë ose 25.1% lidhen me detyrimet e reja të evidentuara gjatë vitit 2025, ndërsa 30 milionë lekë ose 0.2% me kamatëvonesat mbi borxhet e vjetra. Nga auditimi është konstatuar se administrata doganore nuk ka siguruar një proces efektiv mbledhjeje për detyrimet e mbartura nga vitet e

kaluara, duke rritur rrezikun e borxhit të pambledhshëm. Stoku përbëhet kryesisht nga detyrime me mundësi të ulët arkëtimi:

- 77% e stokut, ose 47,658 milionë lekë, janë detyrime të papaguara mbi 5 vjet;
- 58% e stokut, ose 35,944 milionë lekë, përbëhet nga penalitete; 16%, ose 9,669 milionë lekë, nga kamatëvonesa; ndërsa 26%, ose 16,220 milionë lekë, nga detyrime.

Për rikuperimin e detyrimeve janë konstatuar vonesa dhe mosndërmarrje e hapave proceduralë. Për 792 raste, me 14,485 milionë lekë, nuk janë nxjerrë vendime për rikuperimin me forcë të borxhit, ndërsa 2,035 raste, me 18,126 milionë lekë, janë pa urdhër ekzekutimi. Për 276 raste të krijuara gjatë tri viteve të fundit, me detyrime prej 140 milionë lekë, nuk janë ndërmarrë veprimet përkatëse për ndjekjen gjyqësore, dhe 62 raste nuk janë dërguar në zyrat përmbarimore. Në disa raste, degët doganore nuk kanë kërkuar në kohë pezullimin e aktivitetit ekonomik në DPT dhe bllokimin e veprimeve në ASYCUDA ŴORLD. Ka pasur gjithashtu vonesa në kërkesat për urdhër ekzekutimi dhe vendimet për rikuperimin me forcë nuk janë nxjerrë brenda afateve përkatëse.

A.3.2. Të ardhura nga pushteti vendor

Me ligjin fillestar të buxhetit për vitin 2025, të ardhurat e pushtetit vendor të përfshira në këtë zë të treguesve fiskalë janë planifikuar në shumën 40,774 milionë lekë, nga të cilat 32,163 milionë lekë nga taksat lokale dhe 8,611 milionë lekë nga taksat mbi pasurinë. Plani ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit, ndërsa realizimi ka arritur në 40,911 milionë lekë, ose 137 milionë lekë mbi planin, duke shënuar një rritje prej 580 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Ky tregues nuk përfshin të ardhurat jotatimore të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat raportohen veçmas në treguesit fiskalë dhe analizohen në vijim.

Në milionë lekë

EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt Buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Δ ndaj AN 11/2025	Δ ndaj Faktit 2024
TË ARDHURA NGA PUSHTETI VENDOR	40,331	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	40,911	▲ 137	▲ 580
Taksa lokale	32,564	32,163	32,163	32,163	32,163	32,163	32,163	32,731	▲ 568	▲ 167
Taksa mbi pasurinë	7,670	8,611	8,611	8,611	8,611	8,611	8,611	8,144	▼ 467	▲ 474
Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël	97	–	–	–	–	–	–	36	▲ 36	▼ 61

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH. Δ = fakti 2025 minus kolona e referuar; ▲ mbi plan / rritje ▼ nën plan / rënie.

Analiza e detajuar e realizimit kundrejt planit, sipas nënzërave të të ardhurave nga pushteti vendor trajtohen në vijim, për secilën kategori të të ardhurave.

A.3.2.1. Të ardhurat nga taksat lokale janë planifikuar në vlerën 32,163 milionë lekë, pra 401 milionë lekë ose 1.2% më pak se realizimi i vitit 2024. Ato janë realizuar në shumën 32,731 milionë lekë, ose 568 milionë lekë mbi plan, por vetëm 167 milionë lekë ose 0.5% më shumë se në vitin 2024. Të ardhurat, sipas llojit të taksave dhe tarifave vendore, paraqiten si në grafikun në vijim:

Në milionë lekë

ZËRI	SHUMA	PESHA
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	16,435	50.2%
Taksa të tjera	6,835	20.9%
Tarifa pastrimi dhe higjiene	5,929	18.1%
Tarifë vendore për zënien e hapësirave	1,153	3.5%
Taksë vendore e përkohshme	833	2.5%
Taksa e fjetjes në hotel	736	2.2%
Taksa vendore e gjelbërt	415	1.3%
Taksa e tabelës	396	1.2%
TAKSAT LOKALE GJITHSEJ	32,731	100%

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se peshën më të madhe në përbërjen e taksave lokale (50.2%) e zë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, e cila paraqitet në vlerën 16,435 milionë lekë, për të cilin rreth 40.2% e të ardhurave nga kjo taksë mblidhet nga Bashkia Tiranë.

Përtej treguesve të realizimit dhe strukturës së të ardhurave, nga auditimet e ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë evidentuar problematika në administrimin e taksave lokale, të lidhura me saktësinë e përllogaritjes së detyrimeve, evidentimin dhe kontabilizimin e të ardhurave, ushtrimin e kontrolleve dhe ndjekjen e procedurave për arkëtimin e plotë të tyre.

Në mënyrë të veçantë, në *administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje*, janë konstatuar raste të përllogaritjes së pasaktë të detyrimeve, moskontabilizimit të plotë të të ardhurave dhe mosarkëtimit të detyrimeve të krijuara. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në njoftimin e subjekteve debitore, në rakordimin periodik me Agjencinë

Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për evidentimin e objekteve të legalizuara dhe detyrimeve përkatëse, si dhe në marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve të papaguara.
Problematika janë evidentuar edhe në *administrimin e tarifës së ndriçimit dhe tarifës së pastrimit për kategorinë familjare*, ku në raste të caktuara detyrimet nuk janë përllogaritur në përputhje me kuadrin ligjor dhe paketat fiskale vendore në fuqi.
Gjithashtu, në *administrimin e taksës së fjetjes në hotel* janë konstatuar mangësi që lidhen me mbështetjen kryesisht në vetëdeklarimet e subjekteve, kryerjen e pamjaftueshme të kontrolleve në terren dhe mungesën e të dhënave të plota e të përditësuara mbi kapacitetet akomoduese dhe numrin e personave të akomoduar.

A. 3. 2.2. Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë, janë realizuar në vlerën 8,144 milionë lekë, kundrejt 8,611 milionë lekë të planifikuar, duke realizuar 94.6% të planit, me një mosrealizim prej 467 milionë lekë. Në krahasim me vitin e mëparshëm, ato janë rritur me 474 milionë lekë, ose 6.18% krahasuar me vitin 2024. Të ardhurat sipas llojit të taksave, paraqiten si në grafikun në vijim:

Në milionë lekë

ZËRI	SHUMA	PESHA
Taksa mbi ndërtesat	6,431	79.0%
Taksa mbi tokën bujqësore	732	9.0%
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuri të paluajtshme	648	8.0%
Taksa mbi truallin	333	4.1%
TAKSA MBI PASURINË GJITHSEJ	**8,144**	**100%**

Burimi: MF; përpunuar nga grupi i auditimit.

Konstatohet se peshën më të madhe në përbërjen e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e zë taksa mbi ndërtesat, e cila paraqitet në vlerën 6,431 milionë lekë dhe përbën 79% të totali të ardhurave nga taksa mbi pasurinë dhe 15.7% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Nga të ardhurat e realizuara prej taksës mbi ndërtesat, rreth 53.3% mblidhet nga Bashkia Tiranë.
Nga auditimet e ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë evidentuar problematika në administrimin e taksave mbi pasurinë, veçanërisht në drejtim të identifikimit të plotë të bazës së taksueshme, përditësimit të të dhënave të pasurive dhe taksapaguesve, si dhe llogaritjes dhe arkëtimit të detyrimeve. Mangësitë në administrimin e regjistrave, rakordimin e të dhënave me institucionet përkatëse dhe ndjekjen e procedurave të mbledhjes së detyrimeve kanë krijuar risk për mosidentifikimin e plotë të detyrimeve tatimore dhe mosrealizimin e të ardhurave.

A.3.2.3. Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël, për vitin 2025, janë realizuar në vlerën 36 milionë lekë, pavarësisht se nuk janë planifikuar në zërin e të ardhurave nga pushteti vendor, pasi me ligjin nr. 122/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm është zeruar. Të ardhurat për këtë zë janë realizuar nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura. Në krahasim me vitin e mëparshëm, të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël, janë ulur me 61 milionë lekë, ose me 63%.

A.3.2.4. Rakordimi i të dhënave të raportuara për të ardhurat vendore
Referuar bazës së të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore në Ministrinë e Financave, të ardhurat e pushtetit vendor nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar në vlerën 40,915 milionë lekë, kundrejt 40,911 milionë lekë të raportuar nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave, në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar, me diferencë prej 4 milionë lekë. Kjo diferencë vjen nga zëri “Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël”, i cili sipas të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore është 40 milionë lekë, ndërsa sipas të dhënave të Tabelës së Treguesve Fiskalë të Konsoliduar është 36 milionë lekë. Në tabelën e treguesve fiskalë në zërin “Të ardhura nga pushteti vendor/Biznes i vogël” përfshihen edhe të ardhurat e mbledhura nga tatimet të kontabilizuara në llogarinë ekonomike 7002300 “Tatim mbi të ardhurat personale te biznesit”.

A.3.2.5. Shpërndarja e të ardhurave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore
10 njësitë e vetëqeverisjes vendore që zënë peshën më të lartë në realizimin e të ardhurave paraqiten si në vijim:

Në milionë lekë

BASHKIA	Të ardhurat 2024	Të ardhurat 2025	TË ARDHURAT 2024	TË ARDHURAT 2025	PESHA 2025	NDRYSHIMI	NDR. %
Tiranë			23,671	**15,832**	38.7%	**-7,838**	**-33%**
Kamëz			2,346	**3,865**	9.4%	**+1,519**	**+65%**
Durrës			1,785	**3,292**	8.1%	**+1,506**	**+84%**
Vlorë			1,107	**3,074**	7.5%	**+1,967**	**+178%**
Himarë			573	**2,800**	6.8%	**+2,227**	**+389%**
Kavajë			965	**1,429**	3.5%	**+464**	**+48%**
Shkodër			887	**1,104**	2.7%	**+217**	**+25%**
Lezhë			903	**954**	2.3%	**+51**	**+6%**
Elbasan			975	**908**	2.2%	**-67**	**-7%**
Sarandë			682	**779**	1.9%	**+97**	**+14%**
10 NJËSITË GJITHSEJ			**35,569**	**34,038**	**83.2%**	**-1,531**	**-4.3%**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se 10 njësi të vetëqeverisjes vendore përbëjnë 83.2% të totalit të të ardhurave të realizuara. Bashkia me realizimin më të lartë të ardhurave rezulton Bashkia Tiranë, me realizimin në vlerën 15,832 milionë lekë ose 38.7% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Ndërsa bashkitë me realizimin më të ulët të të ardhurave rezultojnë: Bashkia Libohovë me realizim në vlerën 8.22 milionë lekë; Bashkia Këlcyrë me realizim në vlerën 5.43 milionë lekë dhe Bashkia Pustec me realizim në vlerën 4.07 milionë lekë. Pavarësisht se Bashkia Tiranë vijon të mbetet njësia me kontributin më të lartë në totalin e të ardhurave, të ardhurat e saj në krahasim me vitin 2024 janë ulur për vlerën 7,838 milionë lekë, ose 33.1% më pak. Ndërsa Bashkia Himarë ka regjistruar rritjen më të madhe në përqindje, ku krahasuar me vitin e mëparshëm të ardhurat janë rritur për vlerën 2,227 milionë lekë ose 389%.

Për sa i përket qarqeve, realizimi i të ardhurave rezulton në vlerën 31.71 milionë lekë ose 0.07% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor, nga të cilat, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar në vlerën 2.72 milionë lekë dhe të ardhurat jo tatimore janë realizuar në vlerën 28.99 milionë lekë. Qarku i Fierit përfaqëson 83.7% të totalit të ardhurave të realizuara nga qarqet, ku këto të ardhura janë realizuar për vlerën 26.54 milionë lekë në zërin e të ardhura jo tatimore.

A.3.2.6. Të ardhurat jotatimore të njësive të vetëqeverisjes vendore

Për vitin 2025, të ardhurat jo tatimore të realizuara nga njësitë e qeverisjes vendore rezultojnë në vlerën 3,935 milionë lekë. Të ardhurat jotatimore janë të ardhura që realizohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, por që, për qëllime të raportimit në Treguesit Fiskalë të Konsoliduar, pasqyrohen në zërin "Të ardhura jotatimore".

Nga auditimet e ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore janë evidentuar problematika në administrimin, monitorimin dhe arkëtimin e të ardhurave jotatimore, të cilat lidhen kryesisht me mangësitë në kontrollin e subjekteve, zbatimin e kushteve kontraktuale dhe ndjekjen e detyrimeve financiare.

Konkretisht, në administrimin e *tarifave për autorizimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre*, janë konstatuar raste të ushtrimit të aktivitetit pa autorizimin përkatës ose pa autorizim të vlefshëm, si dhe mospagim i tarifave përkatëse. Gjithashtu, edhe në rastet kur subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës, janë evidentuar mosshlyerje të detyrimeve financiare dhe mangësi në kryerjen e kontrolleve nga strukturat përgjegjëse.

Problematika janë evidentuar edhe në *administrimin e tarifës së parkimit,* veçanërisht në përcaktimin e kohëzgjatjes së vendparkimeve të rezervuara dhe llogaritjen e detyrimeve përkatëse. Në raste të caktuara, kontratat nuk kanë reflektuar kohëzgjatjen e përcaktuar në paketat fiskale ose natyrën e aktivitetit të subjekteve, ndërsa mungesa e kontrolleve periodike mbi përdorimin faktik të vendparkimeve ka ndikuar në arkëtimin jo të plotë të tarifave.

Një tjetër fushë ku janë konstatuar mangësi është *administrimi i të ardhurave nga dhënia me qira e pasurive vendore, përfshirë tokat bujqësore, pyjet dhe kullotat.* Nga auditimet janë evidentuar detyrime të prapambetura nga qiramarrësit, të cilat vijojnë të mbeten të paarkëtuara për periudha të gjata, si dhe mangësi në monitorimin e kontratave, ndjekjen e pagesave dhe marrjen në kohë të masave administrative e ligjore ndaj subjekteve debitore.

A.3.2.7. Të ardhurat totale dhe autonomia fiskale e njësive të vetëqeverisjes vendore

Autonomia fiskale e njësive të vetëqeverisjes vendore pasqyron shkallën në të cilën këto njësi mbështeten në të ardhurat e veta për financimin e veprimtarisë së tyre, kundrejt financimit

nëpërmjet transfertave nga buxheti i shtetit. Treguesi matet si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e veta përbëhen nga taksat dhe tarifat vendore (40,911 milionë lekë) dhe të ardhurat jo tatimore (3,935 milionë lekë), gjithsej 44,846 milionë lekë në vitin 2025. Të ardhurat totale, 91,983 milionë lekë, përfshijnë edhe grantet nga buxheti i shtetit (47,137 milionë lekë). Ecuria e treguesit për vitet 2024–2025 paraqitet në grafikun në vijim:

Në milionë lekë

VITI	Të ardhurat e veta vendore	Grante	TOTALI	AUTONOMIA FISKALE
2024	44,482 (52.4%)	40,436 (47.6%)	84,918	52.4%
2025	44,846 (48.8%)	47,137 (51.2%)	91,983	48.8%

Autonomia fiskale e njësive të vetëqeverisjes vendore, e matur si raport i të ardhurave të veta ndaj të ardhurave totale, ka rezultuar në nivelin 48.8% për vitin 2025, kundrejt 52.4% në vitin 2024, duke shënuar një ulje prej 3.6 pikësh përqindjeje. Kjo ecuri është ndikuar nga rritja më e shpejtë e transfertave nga buxheti i shtetit, të cilat janë rritur me 16.6%, kundrejt rritjes prej vetëm 0.8% të të ardhurave të veta vendore. Për rrjedhojë, pesha e transfertave në totalin e të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore është rritur nga 47.6% në 51.2%, duke tejkaluar peshën e burimeve të veta. Kjo ecuri evidenton rritjen e varësisë relative të financimit vendor nga transfertat e buxhetit të shtetit, pavarësisht rritjes nominale të të ardhurave të veta.

Në vijim paraqitet struktura dhe dinamika e të ardhurave totale të NJVV-ve për vitet 2024–2025, sipas burimeve të financimit:

Në milionë lekë

NR.	EMËRTIMI	Fakt 2024 / Fakt 2025	FAKT 2024	FAKT 2025	NDRYSHIMI	NDR. %
I.1	**Të ardhurat e veta vendore[1]**		44,482	**44,846**	**+364**	**+0.8%**
I.2	**Grante**		40,436	**47,137**	**+6,701**	**+16.6%**
a.	Transferta e pakushtëzuar		25,773	**27,482**	**+1,709**	**+6.6%**
b.	Transferta e pakushtëzuar sektoriale		12,615	**17,129**	**+4,514**	**+35.8%**
c.	Grante të huaja		570	**770**	**+200**	**+35.1%**
d.	Grante të tjera të brendshme (taksa të ndara)		1,478	**1,756**	**+278**	**+18.8%**
I.1 + I.2	**TË ARDHURAT E QEVERISJES VENDORE**		**84,918**	**91,983**	**+7,065**	**+8.3%**

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave.

[1] *Përfshihen edhe të ardhurat jo tatimore.*

A.3.2.8. Të ardhurat nga grantet

Të ardhurat e NJVV-ve nga grantet për vitin 2025 janë realizuar në shumën 47,137 milionë lekë, nga 40,436 milionë lekë që ishte fakti i vitit 2024, pra me një rritje prej 6,701 milionë lekë, ose 16.6%. Pesha e tyre në të ardhurat totale të NJVV-ve është rritur nga 47.6% në 51.2%. Rritja e granteve përbën rreth 95% të rritjes së të ardhurave totale të NJVV-ve, e cila është 7,065 milionë lekë. Grantet e vitit 2025 përbëhen nga transferta e pakushtëzuar (58.3%), transferta e pakushtëzuar sektoriale (36.3%) grantet e tjera të brendshme (3.7%) dhe grantet e huaja (1.6%).

a) Transferta e pakushtëzuar përfshin fonde që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore e nënligjore. Ajo është realizuar në shumën 27,482 milionë lekë, me rritje 1,709 milionë lekë, ose 6.6%, krahasuar me vitin 2024. Referuar aneksit nr. 1, “Formula e transfertës së pakushtëzuar”, bashkëlidhur ligjit fillestar të buxhetit për vitin 2025, fondi i planifikuar për shpërndarje sipas formulës ka qenë 24,555 milionë lekë[5], nga të cilat 23,815 milionë lekë për bashkitë dhe 740 milionë lekë për qarqet. Me Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, transferta e pakushtëzuar e përgjithshme është rritur me 75 milionë lekë për tetë bashki: Konispol, Pustec, Klos, Dibër, Dropull, Librazhd, Mirditë dhe Peqin. Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, është miratuar një shtesë tjetër prej 1,200 milionë lekë, e shpërndarë për të gjitha bashkitë, me përjashtim të Bashkisë Tiranë, me kusht përdorimin e saj për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Shpërndarja e shtesave të transfertës pa përfshirë të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore është në kundërshtim me nenin 24, pikat 1, 2, 3 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe nenin 15 të ligjit për buxhetin e vitit 2025. Gjithashtu, kushtëzimi i përdorimit të transfertës për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me përkufizimin e transfertës së pakushtëzuar, sipas nenit

[5] Në ligjin fillestar të buxhetit transferta e pakushtëzuar është planifikuar në vlerë 26,207 milionë lekë, por NJVV u janë shpërndarë me formulë fonde në vlerën 24,555 milionë lekë, pasi nga vlera e transfertës së pakushtëzuar është zbritur fondi rezervë në vlerë 100 milionë lekë, fondi për konviktet dhe qendrat e shërbimeve sociale në vlerën 650 milionë lekë, fondi për rrugët rurale nga qarqet te bashkitë në vlerën 575 milionë lekë dhe fondet për mbështetjen e reformës në financat e arsimit parashkollor në vlerën 327 milionë lekë.

3, pika 12, të ligjit nr. 68/2017. Në tabelën e mëposhtme paraqiten 20 bashkitë me shumat më të larta të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2025.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme · 2025 — Në milionë lekë

Nr.	Bashkitë	Shuma 2025	Nr.	Bashkitë	Shuma 2025
1	**Tiranë**	**3 917,68**	11	Pogradec	591,63
2	Durrës	1 432,34	12	Kavajë	525,99
3	Elbasan	1 037,42	13	Lezhë	520,91
4	Shkodër	965,57	14	Berat	506,00
5	Fier	921,49	15	Kukës	499,69
6	Kamëz	830,34	16	Krujë	440,43
7	Vlorë	828,18	17	Maliq	431,41
8	Korçë	644,66	18	Librazhd	420,39
9	Dibër	628,75	19	Malësi e Madhe	416,19
10	Lushnje	619,26	20	Bulqizë	380,87

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

b) Transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1 dhe 4, bashkëlidhur ligjit të buxhetit, dhe është realizuar në shumën 17,129 milionë lekë, me rritje 4,514 milionë lekë, ose 35.8%. Ky është zëri me rritjen më të madhe, si në vlerë ashtu edhe në përqindje. Ai përbën 67.4% të rritjes totale të granteve. Pesha e tij në totalin e granteve është rritur nga 31.2% në 36.3%, ndërsa në të ardhurat totale të NJVV-ve nga 14.9% në 18.6%.
c) Grantet e huaja janë realizuar në shumën 770 milionë lekë, me rritje 200 milionë lekë, ose 35.1%. Ato përbëjnë vetëm 1.6% të totalit të granteve dhe kanë ndikim të kufizuar në strukturën e financimit të NJVV-ve.
ç) Grantet e tjera të brendshme (taksat e ndara) janë realizuar në shumën 1,756 milionë lekë, me rritje 278 milionë lekë, ose 18.8%. Pesha e tyre në totalin e granteve ka mbetur e pandryshuar, në 3.7%.

A.3.2.9. Fondet e trashëguara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

Sipas përcaktimit të nenit 40 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Për vitin buxhetor 2025, fondet e papërdorura të trashëguara nga periudhat e mëparshme rezultojnë në shumën 49,385 milionë lekë, nga të cilat 48,684.7 milionë lekë u përkasin bashkive dhe 700.3 milionë lekë qarqeve. Në totalin e fondeve të trashëguara përfshihen 7,311 milionë lekë fonde të papërdorura për procesin e rindërtimit, të cilat përfaqësojnë rreth 14.8% të shumës së përgjithshme. Krahasuar me vitin 2024, fondet e papërdorura të trashëguara janë rritur me 12,951 milionë lekë, ose rreth 35.5%.
Nga auditimet e ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore është konstatuar se, në disa raste, fondet e papërdorura të trashëguara nga periudhat e mëparshme janë raportuar në pasqyrën e performancës financiare si të ardhura të periudhës ushtrimore.

A.3.3. Të ardhura nga Fondet Speciale

Të ardhurat nga fondet speciale me ligjin fillestar të buxhetit, janë planifikuar në shumën 169,893 milionë lekë. Krahasuar me realizimin faktik të vitit 2024, plani fillestar rezulton 8,113 milionë lekë ose 5% më i lartë. Gjatë vitit buxhetor, plani i të ardhurave nga fondet speciale është rritur me 7,814 milionë lekë me aktin normativ nr. 10/2025, duke arritur në planin përfundimtar prej 177,707 milionë lekë. Të ardhurat nga fondet speciale janë realizuar në shumën 179,147 milionë lekë, ose 100.8% të planit përfundimtar, duke e tejkaluar atë me 1,440 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, këto të ardhura janë rritur me 17,367 milionë lekë, ose 10.7%. Ecuria e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga fondet speciale, sipas përbërësve, paraqitet në tabelën në vijim.


Në milionë lekë

NR.	EMËRTIMI	FAKTI 2024	PROJEKT 2025	LIGJI 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	FAKTI 2025	FAKT-PLAN
II.3	**TË ARDHURAT NGA FONDET SPECIALE**	**161,780**	**169,893**	**169,893**	**169,893**	**169,893**	**177,707**	**177,707**	**179,147**	**+1,440**
	Sigurimi shoqëror	139,404	146,343	146,343	146,343	146,343	153,370	153,370	154,666	**+1,296**
	Sigurimi shëndetësor	21,543	22,645	22,645	22,645	22,645	23,431	23,431	23,543	**+112**
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	833	905	905	905	905	905	905	939	**+34**

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Në strukturën e të ardhurave nga fondet speciale, kontributin kryesor e japin të ardhurat nga sigurimet shoqërore, të cilat janë realizuar në shumën 154,666 milionë lekë. Ky zë përbën 86.3% të totalit të të ardhurave nga fondet speciale dhe është realizuar 1,296 milionë lekë mbi planin përfundimtar. Krahasuar me faktin e vitit 2024, të ardhurat nga sigurimet shoqërore janë rritur me 15,262 milionë lekë, ose 10.9%.
Të ardhurat nga sigurimet shëndetësore janë realizuar në shumën 23,543 milionë lekë, ose 112 milionë lekë mbi planin përfundimtar prej 23,431 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, ky zë është rritur me 2,000 milionë lekë, ose 9.3%.
Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve janë realizuar në shumën 939 milionë lekë (ose 0.5% të totalit të të ardhurave nga fondet speciale), kundrejt planit përfundimtar prej 905 milionë lekë, ose 34 milionë lekë mbi plan. Krahasuar me faktin e vitit 2024, këto të ardhura janë rritur me 106 milionë lekë, ose 12.7%.

Pjesa më e madhe e financimit të fondeve speciale vjen nga kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat mblidhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet listëpagesave të deklaruara nga subjektet. Pas arkëtimit, këto të ardhura transferohen përkatësisht në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH). Krahas kontributeve të detyrueshme, ISSH dhe FSDKSH realizojnë të ardhura nga kontributet vullnetare dhe nga burime të tjera të të ardhurave të veta.
Të ardhurat nga kontributet dhe të ardhurat e veta që kanë financuar fondet speciale të ISSH dhe FSDKSH paraqiten si më poshtë:




Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Të ardhurat e ISSH-së përbëhen në masën 96.2% nga kontributet dhe 3.8% nga të ardhurat e veta; dhe të ardhurat e FSDKSH-së përbëhen në masën 98.9% nga kontributet dhe 1.1% nga të ardhurat e veta. Arkëtimet e drejtpërdrejta nga institucionet dhe ato të administruara nga DPT trajtohen në vijim, sipas secilit fond.
Performanca pozitive e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore gjatë vitit 2025 është mbështetur kryesisht nga rritja e fondit të pagave dhe zgjerimi i bazës kontributive, e reflektuar në shtimin me 27,420 kontribuues (3.8%), regjistrimin e 20,919 bizneseve të reja dhe rritjen me 8,447 subjekte (6.3%) të numrit të bizneseve aktive, i të cilat kanë arritur në 142,769.

A.3.3.1 Të ardhurat e sigurimeve shoqërore dhe administrimi i kontributeve

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të sigurimeve shoqërore

Të ardhurat e sigurimeve shoqërore për vitin 2025, sipas raportimit të ISSH-së, janë realizuar në shumën 154,702 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 153,370 milionë lekë, me një nivel realizimi prej 100.9%. Krahasuar me vitin 2024, këto të ardhura janë rritur me 17,335 milionë lekë, ose 12.6%. Plani fillestar i të ardhurave nga kontributet dhe burimet e tjera është përcaktuar në shumën 146,343 milionë lekë dhe, pas rishikimeve gjatë vitit, është rritur me 7,027 milionë lekë, duke arritur në 153,370 milionë lekë. Realizimi ka tejkaluar planin përfundimtar me 1,332 milionë lekë.
Në strukturën e të ardhurave të realizuara, 148,789 milionë lekë, ose 96.2%, janë arkëtuar nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), ndërsa 5,912 milionë lekë, ose 3.8%, janë arkëtuar drejtpërdrejt nga ISSH. Struktura e këtyre të ardhurave, sipas institucionit arkëtues dhe kategorive kryesore të kontributeve, paraqitet në grafikun në vijim.



Burimi: ISSH dhe DPT; përpunuar nga grupi i auditimit.

Ecuria e të ardhurave paraqet ndryshime ndërmjet kategorive të kontribuuesve, të cilat analizohen në vijim.

Arkëtimet e realizuara nga DPT në vitin 2025 rezultojnë 148,789 milionë lekë, kundrejt planit prej 148,152 milionë lekë, me realizim prej 100.4%. Krahasuar me vitin 2024, arkëtimet janë rritur me 14,494 milionë lekë, ose 10.8%.

ARKËTIMET E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
të administruara nga DPT

Viti 2025 | Në milionë lekë

Kategoria	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Diferenca	Ndryshimi	F/P 2025
Sektori publik	50,778	—	56,557	+5,780	+11.4%	—
Buxhetore	42,868	—	47,973	+5,105	+11.9%	—
Jo buxhetore	7,909	—	8,584	+675	+8.5%	—
Sektori privat	80,582	—	89,206	+8,625	+10.7%	—
Biznes i madh privat	76,604	—	85,295	+8,691	+11.3%	—
Biznes i vogël	3,978	—	3,912	−67	−1.7%	—
Sigurim suplementar	2,296	—	2,438	+142	+6.2%	—
Të tjera DPT	640	—	587	−52	−8.2%	—
Gjithsej DPT	**134,295**	**148,152**	**148,789**	**+14,494**	**+10.8%**	**100.4%**

Burimi: ISSH dhe DPT; përpunuar nga KLSH.

Brenda arkëtimeve të administruara nga DPT, sektori privat përbën burimin kryesor, me 89,206 milionë lekë, ose 60% të totalit, ndërsa sektori publik ka realizuar 56,557 milionë lekë, ose 38%. Arkëtimet nga sektori privat janë rritur me 10.7%, ndërsa ato nga sektori publik me 11.4%, krahasuar me vitin 2024. Në sektorin privat evidentohet ecuri e ndryshme sipas madhësisë së subjekteve. Të ardhurat nga biznesi i madh privat janë rritur me 11.3%, duke arritur në 85,295 milionë lekë. Në të kundërt, të ardhurat nga biznesi i vogël janë ulur me 1.7%, duke zbritur në 3,912 milionë lekë. Sigurimet suplementare janë realizuar në shumën 2,438 milionë lekë, me rritje 6.2%, ndërsa zëri "Të tjera DPT" ka rënë me 8.2%, në 587 milionë lekë.

Arkëtimet e realizuara nga ISSH rezultojnë 5,912 milionë lekë, kundrejt planit prej 5,218 milionë lekë, me realizim prej 113.3%. Krahasuar me vitin 2024, këto arkëtime janë rritur me 770 milionë lekë, ose 15%.

ARKËTIMET E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
të administruara nga ISSH

Viti 2025 | Në milionë lekë

Kategoria	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	F/P 2025	Ndryshimi
Kontribute vullnetare	718	770	912	118.5%	+27.0%
Të vetëpunësuar në bujqësi	3,464	3,670	3,972	108.2%	+14.7%
Të ardhura të tjera, jo tatimore	959	778	1,026	131.9%	+7.1%
Derdhje në llogari sigurimi	1	—	2	—	+95.9%
Gjithsej ISSH	**5,142**	**5,218**	**5,912**	**113.3%**	**+15.0%**

Burimi: ISSH dhe DPT; përpunuar nga KLSH.

Kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi përbëjnë zërin kryesor të arkëtimeve të ISSH-së, në shumën 3,972 milionë lekë, ose 67.2% të totalit. Ky zë është realizuar në masën 108.2% të planit dhe është rritur me 14.7% krahasuar me vitin 2024. Kontributet vullnetare kanë arritur në 912 milionë lekë, me realizim 118.5% të planit dhe rritje 27% ndaj vitit 2024. Të ardhurat e tjera jotatimore janë realizuar në shumën 1,026 milionë lekë, ose 131.9% të planit, me rritje prej 7.1%.

Planifikimi dhe rakordimi i të ardhurave

Nga auditimi rezultoi se plani i të ardhurave i përcillet ISSH-së nga DPT pa detajim sipas kategorive të subjekteve, përfshirë sektorin buxhetor, sektorin jobuxhetor, biznesin e madh, biznesin e vogël dhe sigurimet suplementare. Mungesa e planifikimit të detajuar sipas kategorive kufizon mundësinë e ISSH-së për të ndjekur realizimin e të ardhurave sipas burimeve kryesore, për të analizuar devijimet nga plani dhe për të ndërmarrë masa të synuara ndaj kategorive që paraqesin ecuri negative, veçanërisht biznesit të vogël.

Nga krahasimi i të dhënave të ISSH-së me treguesit fiskalë të konsoliduar dhe llogaritë analitike për vitin 2025, u konstatua një diferencë prej rreth 36 milionë lekë ndërmjet të ardhurave të raportuara nga ISSH, në shumën 154,702 milionë lekë, dhe atyre të pasqyruara në treguesit fiskalë, në shumën

154,666 milionë lekë. Nga verifikimi i llogarive analitike, të cilat përfshijnë arkëtimet nga DPT, parapagimet dhe të ardhurat e veta të ISSH-së, rezultoi një total neto prej 154,665.9 milionë lekë, në përputhje me raportimin fiskal. Mungesa e një rakordimi të plotë dhe të dokumentuar ndërmjet të dhënave analitike të ISSH-së dhe treguesve fiskalë të konsoliduar krijon diferenca në raportimin e të ardhurave të fondit të sigurimeve shoqërore.

RAKORDIMI I TË ARDHURAVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE
sipas llogarive analitike të ISSH-së

Viti 2025 | Në milionë lekë

Përbërësi	Shuma neto
Të ardhura të arkëtuara nga DPT — llogaria 7000	148,576.53
Parapagime të përfshira në raportim — llogaria 4665510	184.27
Të ardhurat e veta të ISSH-së — llogaritë 7100, 7500 dhe 7600	5,905.11
Totali neto i llogarive analitike	**154,665.91**

Burimi: ISSH; përpunuar nga KLSH.

Detyrimet e prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore

Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përgjegjësi mbledhjeje nga DPT, rezultoi se stoku i detyrimeve, përfshirë gjobat dhe interesat, ka arritur në mbi 22,558 milionë lekë në fund të vitit 2025. Krahasuar me stokun prej 20,225 milionë lekë në fund të vitit 2024, detyrimet janë rritur me rreth 2,333 milionë lekë, ose 11.5%.



Subjektet aktive debitore përbëjnë 48,572 subjekte, ose 39.5% të numrit të përgjithshëm të subjekteve debitore, me detyrime në shumën 10,284 milionë lekë, ose 45.6% të stokut total. Brenda këtij grupi, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar përfaqësojnë 11,861 subjekte me detyrime mbi 5,201 milionë lekë. Detyrimet e subjekteve pasive kanë rezultuar në mbi 11,093 milionë lekë, ose rreth 49.2% të stokut total, të cilat dominohen nga biznesi i madh privat, me 62.2%, dhe biznesi i vogël, me 32.3%. Pjesa e mbetur e borxhit lidhet me subjekte në status kërkese për çregjistrim, të çregjistruara ose të falimentuara. Sipas formës juridike, peshën kryesore të stokut të detyrimeve e përbëjnë personat juridikë, me 55.2%, të ndjekur nga biznesi i vogël, me 37.7%.

Edhe pse DPT i transmeton ISSH-së listat e debitorëve çdo tre muaj, stoku i detyrimeve vijon të rritet. Rritja e stokut është shoqëruar edhe me shtimin e numrit të subjekteve debitore me 2,206 krahasuar me vitin 2024. Në sektorin publik buxhetor, numri i subjekteve debitore është rritur me 45 dhe detyrimet me 222 milionë lekë; në sektorin publik jobuxhetor, numri është rritur me 25 subjekte dhe detyrimet me 109 milionë lekë. Në sektorin privat, detyrimet janë rritur me 1,358 milionë lekë te biznesi i madh, me 1,164 subjekte debitore më shumë; dhe 646 milionë lekë te biznesi i vogël, me 972 subjekte debitore më shumë se në vitin 2024.

Deklarimi, pagesa dhe transmetimi i listëpagesave

Pavarësisht realizimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore, nga auditimi rezultoi se vijon problematika e mosdeklarimit të listëpagesave, si dhe e pagesave jo të plota ose të kryera me vonesë nga subjektet deklaruese. Nga auditimi u konstatuan mangësi në bashkëpunimin ndërmjet ISSH-së dhe DPT-së, si dhe pasaktësi procedurale në transmetimin dhe pasqyrimin e listëpagesave. Mangësitë lidhen me vendosjen e pasaktë të NIPT-ve, çështje të pambyllura që prej viteve 2013–2014, dublikime për periudha të ndryshme, mungesa në sistemin informatik për gjyqfituesit, transmetimin e të dhënave me rubrika të paplotësuara dhe mosreflektimin e pagesave të pjesshme. Për listëpagesat e periudhës 2006–2012, në fund të vitit 2025 rezultuan 1,469,581 listëpagesa të munguara, nga 1,475,774 në fund të vitit 2024, ku problematika rezulton pothuajse e pandryshuar.

Administrimi i rezultatit financiar pozitiv të ISSH-së

Për vitin 2025, rezultati financiar pozitiv i ISSH-së është miratuar në shumën 2,149 milionë lekë, me vendimin nr. 7, datë 15.05.2026, të Këshillit Administrativ, "Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2025". Sipas nenit 4, pika 5, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, rezultati financiar pozitiv i ISSH-së, pas miratimit të pasqyrave financiare,

duhet të derdhet në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, jo më vonë se muaji prill 2026. Nga rezultati financiar pozitiv i miratuar, shuma prej 1,787 milionë lekë është destinuar për shtesën e fondit rezervë, i cili është rritur nga 14,765 milionë lekë në 16,552 milionë lekë, ndërsa shuma prej 362 milionë lekë është miratuar në rezultatin e mbartur. Për përcaktimin e destinacionit përfundimtar të shumës prej 362 milionë lekë, ISSH-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 10834 prot., datë 15.06.2026, pa marrë përgjigje.

A. 3.3.2.Të ardhurat nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor

Skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë funksionon në bazë të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, administruar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH). Financimi i skemës sigurohet nga kontributet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, kontributet e sigurimit shëndetësor vullnetar dhe kontributet nga Buxheti i Shtetit për kategoritë e personave ekonomikisht joaktivë, sipas përcaktimeve ligjore.
Nëpërmjet kësaj skeme financohen shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor, shërbimet e ofruara nga institucionet publike dhe subjektet private të kontraktuara, si edhe barnat dhe produktet mjekësore të përfshira në Listën e Barnave të Rimbursueshme. Përfitues janë personat që paguajnë kontribute të sigurimit shëndetësor, si edhe kategoritë e personave për të cilët kontributet mbulohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të përcaktuara me ligj.
Të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për sigurimin shëndetësor paraqiten në shumën 23,278.5 milionë lekë. Ndërkohë, të ardhurat e arkëtuara drejtpërdrejt nga FSDKSH-ja, paraqiten në shumën 264 milionë lekë. Në total, të ardhurat e arkëtuara për sigurimin shëndetësor paraqiten në shumën 23,542.6 milionë lekë.

A. 3.3.3. Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve

Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve përfaqësojnë burime financimi për Fondin e Kompensimit të Pronave. Sipas nenit 10 të ligjit nr. 133/2015, burimet e këtij fondi përfshijnë: të ardhurat nga Buxheti i Shtetit; të ardhurat nga shitja në ankand e pasurive shtetërore pjesë e fondit të tokës; të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore në procesin e legalizimit; të ardhura të tjera që sipas ligjeve/akteve të veçanta kalojnë në fondin e kompensimit; si dhe të ardhura nga donatorët. Për vitin 2025 këto të ardhura janë realizuar në shumën 939 milionë lekë, ose 34 milionë lekë më shumë se plani i rishikuar dhe përfshijnë pagesat që lidhen me parcelat ndërtimore të objekteve të legalizuara që përdoren për kompensimin financiar të pronarëve të trojeve private të prekura nga ndërtimet e legalizuara. Ato janë transferuar në ATP nëpërmjet Thesarit nga ASHK sipas procedurave dhe parashikimeve të pikës 8 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", i ndryshuar.

A.4 Të ardhurat jo tatimore

Të ardhurat jo tatimore janë realizuar në shumën 30,941 milionë lekë sipas raportimit të Ministrisë së Financave, duke rezultuar 801 milionë lekë nën planin përfundimtar të miratuar me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura janë ulur me 12,753 milionë lekë. Tabela e mëposhtme paraqet zërat analitikë të të ardhurave jotatimore, sipas planifikimit dhe realizimit, si dhe krahasimin me vitin e mëparshëm:

Në milionë le

Nr.	EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt Buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca plan-fakt
III	**TË ARDHURA JOTATIMORE**	**43,694**	**25,800**	**25,800**	**26,800**	**26,800**	**31,743**	**31,743**	**30,941**	**▼ 802**
	Transferta e fitimit nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	0	0	–	0	0	**0**
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	14,983	13,300	13,300	13,300	13,300	17,673	17,673	15,458	**▼ 2,215**
	Dividenti	82	300	300	300	300	60	60	46	**▼ 14**
	Tarifat e shërbimeve	3,503	3,800	3,800	3,800	3,800	3,800	3,800	3,545	**▼ 255**
	Të tjera	9,210	8,400	8,400	9,400	9,400	10,210	10,210	11,893	**▲ 1,683**
	Rezultati financiar i ISSH-së	7,916	–	-	-	–	–	-	0	-
	Të ardhura nga shpronësimet	8,000	–	-	-	–	–	-	0	-

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH. Δ = Fakti 2025 minus Akti Normativ nr. 11/2025; ▲ mbi plan / mirë ▼ nën plan / rënie

Nga auditimi konstatohet se të ardhurat jo tatimore për vitin 2025 paraqesin një ulje të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, e ndikuar nga fakti se gjatë vitit 2024 në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë përfshirë edhe zëra jotipikë të të ardhurave, të lidhur me rezultatin

financiar të ISSH-së dhe të ardhurat nga shpronësimet, të cilat përfaqësonin lëvizje ndërmjet llogarive të buxhetit të shtetit.

A.4.1 Të ardhurat nga institucionet buxhetore përfshijnë tarifat dhe të ardhurat e tjera që realizojnë institucionet buxhetore për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Gjatë vitit 2025, plani i këtij zëri është rritur nga 13,300 milionë lekë në 17,673 milionë lekë, pra me 4,373 milionë lekë. Pavarësisht këtij rishikimi, realizimi përfundimtar ka rezultuar ndjeshëm nën planin e ndryshuar. Ato janë realizuar në shumën 15,458 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 17,673 milionë lekë, me mosrealizim prej 2,215 milionë lekë, ose realizim në masën 87.5%. Krahasuar me vitin 2024, kur këto të ardhura ishin 14,983 milionë lekë, rezulton një rritje prej 475 milionë lekë, ose 3.2%.

A.4.2 Të ardhurat nga dividendi përfshijnë shpërndarjet e dividendit nga shoqëritë aksionare në të cilat shteti zotëron pjesëmarrje, ndërsa realizimi i këtyre të ardhurave buxhetore varet nga fitimi i realizuar prej shoqërive dhe vendimmarrja për shpërndarjen e tij. Gjatë vitit, plani fillestar prej 300 milionë lekë është reduktuar në 60 milionë lekë, me një ulje prej 240 milionë lekë, ose 80%. Ato janë realizuar në shumën 46 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 60 milionë lekë, me mosrealizim prej 14 milionë lekë, ose realizim në masën 76.7%. Krahasuar me vitin 2024, kur këto të ardhura ishin 82 milionë lekë, rezulton një ulje prej 36 milionë lekë, ose 43.9%. Mosrealizimi i të ardhurave lidhet me vendimmarrjen e strukturave përgjegjëse për shpërndarjen dhe derdhjen e dividendëve nën nivelin e parashikuar, duke evidentuar mangësi në vlerësimin e rezultateve financiare të shoqërive me pjesëmarrje shtetërore, shpërndarjen e fitimit dhe arkëtimin e dividendëve që i takojnë shtetit.

A.4.3 Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve përfaqësojnë arkëtimet nga tarifat e aplikuara për ofrimin e shërbimeve publike. Ato janë realizuar në shumën 3,545 milionë lekë, kundrejt planit prej 3,800 milionë lekë, me mosrealizim prej 255 milionë lekë, ose realizim në masën 93.3%. Krahasuar me vitin 2024, kur këto të ardhura ishin 3,503 milionë lekë, rezulton një rritje prej 42 milionë lekë, ose 1.2%.

A.4.4 Të ardhurat tjera jotatimore përfshijnë të ardhura jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia, si dhe nga shërbimet administrative dhe të ardhurat dytësore, sipas llogarive analitike të klasifikimit të të ardhurave sipas natyrës ekonomike. Pavarësisht rishikimit në rritje të planit, realizimi ka rezultuar mbi parashikimin përfundimtar. Gjatë vitit, plani i këtij zëri është rritur nga 8,400 milionë lekë në 10,210 milionë lekë, me një shtesë prej 1,810 milionë lekë. Ato janë realizuar në shumën 11,893 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 10,210 milionë lekë, me tejkalim prej 1,683 milionë lekë, ose realizim në masën 116.5%. Krahasuar me vitin 2024, kur këto të ardhura ishin 9,210 milionë lekë, rezulton një rritje prej 2,683 milionë lekë, ose 29.1%.

A.4.5. Raportimi i transfertave të brendshme dhe i rezultatit financiar të ISSH-së

Në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar për vitin 2025 nuk rezultojnë të jenë kryer dhe raportuar transferta në hyrje të mjeteve monetare të klasifikuara si të ardhura të vitit për realizimin e buxhetit të shtetit, ndonëse dispozita përkatëse e ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, parashikon derdhjen e rezultatit financiar pozitiv të ISSH-së në të ardhurat e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare dhe jo më vonë se muaji prill 2026. Gjatë vitit 2024, në treguesit fiskalë të konsoliduar janë raportuar të ardhura jo tipike për rezultatin financiar të ISSH-së në shumën 7,916 milionë lekë dhe të ardhura nga shpronësimet në shumën 8,000 milionë lekë.

A.5 Problematikat e konstatuara nga auditimet në administrimin e të ardhurave publike

KLSH ka kryer auditime në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat janë evidentuar problematika në planifikimin, realizimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore, si më poshtë:

▸ Në 28 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u evidentua mosrealizimi i planit për zëra të veçantë të të ardhurave; në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore u

konstatuan mangësi në kontabilizimin e të ardhurave, në 9 njësi pasaktësi në përllogaritjen e tyre, ndërsa në 41 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 5 ente publike me kapital shtetëror mangësi në marrjen e masave për vjeljen e detyrimeve nga subjektet debitore.

▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore u konstatuan ndryshime të planit të të ardhurave pa analiza dhe argumentim të faktorëve të realizimit dhe risqeve përkatëse.

▸ Në administrimin e të ardhurave nga privatizimi dhe dhënia me qira e pasurive u evidentuan mangësi në përllogaritjen e detyrimeve në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror; mosarkëtim i detyrimeve kontraktuale në 23 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror, si dhe moskontabilizim i tyre në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror.

▸ Në administrimin e të ardhurave nga lejet, licencat dhe autorizimet u konstatuan mangësi në përllogaritjen e detyrimeve në 3 njësi të qeverisjes qendrore, ndërsa në 3 njësi të qeverisjes qendrore u evidentuan pasaktësi në përllogaritjen dhe klasifikimin e detyrimeve nga vendimet dhe sanksionet administrative.

▸ Në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatua moslidhja e kontratave me subjektet minerare për përdorimin e sipërfaqeve jashtë kufijve të lejeve minerare.

▸ Në administrimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (TNI) u evidentua mosarkëtimi i detyrimeve nga legalizimet në 9 njësi të vetëqeverisjes vendore, moskontabilizimi i tyre në 8 njësi, si dhe mosarkëtimi i detyrimeve nga kjo taksë në 34 njësi. Gjithashtu, në 11 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan pasaktësi në përllogaritjen e TNI-së ose mospërputhje ndërmjet akteve nënligjore dhe legjislacionit në fuqi.

▸ Për të ardhurat nga taksa e hidrokarbureve u konstatua mosarkëtimi i detyrimeve në 17 njësi të vetëqeverisjes vendore, moskontabilizimi i tyre në 8 njësi dhe mangësi në përllogaritjen e detyrimeve në 4 njësi.

▸ Në administrimin e taksave dhe tarifave vendore për familjet dhe bizneset u evidentua mosarkëtimi i detyrimeve në 41 njësi të vetëqeverisjes vendore, moskontabilizimi i tyre në 14 njësi dhe mangësi në përllogaritjen e detyrimeve në 10 njësi.

▸ Për të ardhurat nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe inspektorateve u konstatua mosarkëtimi i detyrimeve në 15 njësi të vetëqeverisjes vendore; në 6 njësi mangësi në ndjekjen e procedurave të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të IMTV-së [6]. Gjithashtu, në 4 njësi u evidentua moskontabilizimi i detyrimeve, në 6 njësi mangësi në përllogaritjen e tyre, ndërsa në 2 njësi u konstatuan pasaktësi në përllogaritjen e gjobave të IMTV-së. Në 14 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan pasaktësi në përllogaritjen e vlerës së gjobave.

▸ Në administrimin e të ardhurave nga lejet, licencat dhe autorizimet në nivel vendor u evidentua mosarkëtimi i detyrimeve në 21 njësi të vetëqeverisjes vendore, moskontabilizimi i tyre në 6 njësi dhe mangësi në përllogaritjen e detyrimeve në 4 njësi.

Mbi mangësitë administrative në lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit në njësitë e vetëqeverisjes vendore

▸ Në 21 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mangësi në dokumentacionin teknik, administrativ dhe shoqërues të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, ndërsa në 20 njësi u evidentuan mangësi në dokumentacionin pronësor. Gjithashtu, në 17 njësi u konstatuan vonesa në shqyrtimin e aplikimeve përtej afateve ligjore dhe në 8 njësi mosmarrja e mendimit të të gjitha autoriteteve përgjegjëse.

▸ Në 5 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan leje ndërtimi të miratuara në kundërshtim me dokumentet e planifikimit të territorit (PPV/PDV) ndërsa në 6 njësi u evidentua miratimi i objekteve në kundërshtim me kondicionet urbane. Gjithashtu, në 3 njësi nuk ishin respektuar detyrimet për kontributin në fondin publik të strehimit social për ndërtime banimi mbi 2,000 m².

[6] Në zbatim të ligjit nr. 127/2024 i cili parashikon shfuqizimin e masave administrative të papaguara, të vendosura nga 1 janari 2015 deri më 30 nëntor 2024, përfshirë gjobat e inspektorateve vendore dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), sipas kushteve ligjore, gjatë auditimeve të kryera për efekt të këtij raporti, nuk janë rekomanduar masa me efekte financiare për gjobat e paarkëtuara të kësaj periudhe.

▸ Në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan mangësi në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e dokumentuar të informacionit ndërmjet strukturave përgjegjëse për planifikimin dhe mbrojtjen e territorit.

Mbi veprimtarinë administrative të strukturave të mbrojtjes dhe inspektimit të territorit në njësitë e vetëqeverisjes vendore

▸ Në 11 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mangësi në kontrollin e ndërtimeve pa leje dhe objekteve me leje të miratuara, ndërsa në 7 njësi u evidentua përdorimi i objekteve pa certifikatë përdorimi dhe mangësi në kontrollin e procedurave të kolaudimit dhe inspektimit. Gjithashtu, në 8 njësi u konstatuan mangësi në plotësimin e strukturave inspektuese me numrin minimal të inspektorëve dhe personel me kualifikimin e kërkuar.

▸ Në 7 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan vendime për pezullimin e punimeve në kundërshtim me kriteret ligjore, ndërsa në 4 njësi mosrespektimi i afatit ligjor 10-ditor për nxjerrjen e vendimeve pas procesverbalit të konstatimit.

▸ Në 12 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk ishin nxjerrë urdhrat e ekzekutimit për prishjen e objekteve të kundërligjshme, ndërsa në 12 njësi nuk ishin referuar pranë organeve kompetente rastet me indicie për vepra penale.

▸ Në 8 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan mangësi në hartimin e planeve periodike të punës dhe raportimin pranë IKMT-së, ndërsa në 3 njësi relacionet individuale nuk përmbanin informacion të plotë.

▸ Në 6 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mangësi në dokumentimin e kundërvajtjeve dhe proceseve të prishjes së objekteve të kundërligjshme.

B. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I SHPENZIMEVE

B.1 Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore

B.1.1 Planifikimi fillestar dhe ndryshimet buxhetore gjatë vitit


Me ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", shpenzimet e buxhetit të shtetit janë planifikuar në shumën 825,088 milionë lekë, të përbëra nga shpenzimet korrente në shumën 656,014 milionë lekë, shpenzimet kapitale në shumën 162,374 milionë lekë dhe fondet e tjera të pashpërndara në shumën 6,700 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, plani fillestar rezulton 96,517 milionë lekë, ose rreth 13.2%, më i lartë. Gjatë vitit, plani i shpenzimeve është ndryshuar me aktet normative nr. 3/2025, nr. 6/2025, nr. 10/2025 dhe nr. 11/2025. Ecuria sipas kategorive kryesore paraqitet në tabelën në vijim.

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Projekt 2025	Ligji 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Δ ndaj ligjit
B	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**822,702**	**825,088**	**826,088**	**826,088**	**831,784**	**831,784**	**+6,696**
I.	Shpenzime korrente	654,964	656,014	656,014	660,521	662,246	669,356	+13,342
II.	Fonde të tjera të pashpërndara	5,900	6,700	6,700	6,700	5,400	5,400	−1,300
III.	Shpenzime kapitale	161,837	162,374	163,374	158,867	164,138	157,028	−5,346
IV.	Transfertë për Fondin e Pensioneve	—	—	—	—	—	—	—

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Me Aktin Normativ nr. 3/2025, plani i përgjithshëm i shpenzimeve është rritur me 1,000 milionë lekë, të reflektuara tërësisht në shpenzimet kapitale, ndërsa me Aktin Normativ nr. 6/2025 totali ka mbetur i pandryshuar, por shpenzimet korrente janë rritur me 4,507 milionë lekë dhe shpenzimet kapitale janë reduktuar me të njëjtën shumë. Rritja më e madhe e totalit është miratuar me Aktin Normativ nr. 10/2025, i cili e ka shtuar planin me 5,696 milionë lekë, duke e çuar në 831,784 milionë lekë. Kundrejt aktit paraardhës, shpenzimet korrente janë rritur me 1,725 milionë lekë dhe shpenzimet kapitale me 5,271 milionë lekë, ndërsa fondet e tjera të pashpërndara janë ulur me 1,300 milionë lekë. Në vijim, Akti Normativ nr. 11/2025 ka ruajtur të pandryshuar totalin, por ka rritur sërish shpenzimet korrente me 7,110 milionë lekë, duke reduktuar shpenzimet kapitale me të njëjtën shumë. Si rezultat, plani përfundimtar ka arritur në 831,784 milionë lekë, ose 6,696 milionë lekë dhe rreth 0.8% më shumë se plani fillestar. Ecuria e planit të përgjithshëm sipas akteve normative paraqitet në grafikun në vijim.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga analiza e ndryshimeve sipas kategorive kryesore konstatohet se rritja neto e planit është shoqëruar me ndryshime në strukturën e shpenzimeve të planifikuara. Kundrejt ligjit fillestar, shpenzimet korrente janë rritur me 13,342 milionë lekë, ose rreth 2%, ndërsa shpenzimet kapitale janë reduktuar me 5,346 milionë lekë, ose rreth 3.3%, dhe fondet e tjera të pashpërndara me 1,300 milionë lekë, ose rreth 19.4%. Në planin përfundimtar, shpenzimet korrente përbëjnë rreth 80.5% të totalit, shpenzimet kapitale 18.9% dhe fondet e tjera të pashpërndara 0.6%. Ndryshimet sipas kategorive, krahasuar me planin fillestar, paraqiten në grafikun në vijim.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

B.1.2 Realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve

Për vitin 2025, shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë raportuar në shumën 801,696 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 831,784 milionë lekë, me një nivel realizimi prej rreth 96.4%

dhe një diferencë të parealizuar prej 30,088 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet janë rritur me 73,125 milionë lekë, ose rreth 10%. Kundrejt planit fillestar, shpenzimet faktike rezultojnë 23,392 milionë lekë më të ulëta, çka tregon se, pavarësisht rritjes së planit gjatë vitit, realizimi faktik ka mbetur nën nivelin e planifikuar fillimisht. Realizimi sipas kategorive kryesore paraqitet në tabelën në vijim.

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2024	Ligji 2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Fakt – plan
B	**TOTALI I SHPENZIMEVE**	**728,571**	**825,088**	**831,784**	**801,696**	**−30,088**
I.	Shpenzime korrente	606,289	656,014	669,356	653,532	−15,824
II.	Fonde të tjera të pashpërndara	—	6,700	5,400	—	—
III.	Shpenzime kapitale	115,433	162,374	157,028	131,578	−25,450
IV.	Transfertë për Fondin e Pensioneve	6,300	—	—	16,587	—

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga analiza e shpenzimeve kundrejt planit përfundimtar, konstatohet se mosrealizimi është përqendruar kryesisht në shpenzimet kapitale, të cilat kanë arritur në 131,578 milionë lekë, ose 83.8% të planit, me një diferencë prej 25,450 milionë lekë. Krahasuar me planin fillestar, diferenca arrin në 30,796 milionë lekë, ose rreth 19%. Shpenzimet korrente janë realizuar në shumën 653,532 milionë lekë, duke realizuar rreth 97.6% të planit, me një diferencë të parealizuar prej 15,824 milionë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar se në totalin faktik është përfshirë edhe transferta për fondin e pensioneve prej 16,587 milionë lekë, e cila është kryer pa plan buxhetor. Duke përjashtuar këtë transfertë nga shpenzimet faktike të raportuara, realizimi rezulton 785,109 milionë lekë dhe diferenca kundrejt planit përfundimtar arrin në 46,675 milionë lekë.


Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet korrente janë rritur me 47,243 milionë lekë, ose rreth 7.8%, dhe shpenzimet kapitale me 16,145 milionë lekë, ose rreth 14%.

B.1.3 Shpenzimet sipas funksioneve

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve të buxhetit të shtetit sipas funksioneve, së bashku me peshën e secilit funksion në totalin e shpenzimeve, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Shpenzimet sipas funksioneve: planifikimi dhe realizimi 2025

Pesha në total — Fakti 2025



Vlerat në milionë lekë

Funksioni	Fakti 2024	Plani fillestar Ligji 2025	Plani fillestar i korrigjuar[1]	Fakti 2025	Δ vjetore 2025 – 2024	Δ fakt – plan i korrigjuar	Realizimi (%)
Shërbimet e përgjithshme publike	129,804	57,673	154,679	134,363	+4,559	-20,316	86.9%
Mbrojtja	21,467	37,167	37,474	27,011	+5,544	-10,463	72.1%
Rendi dhe siguria publike	48,330	50,304	54,676	51,760	+3,430	-2,916	94.7%
Çështjet ekonomike	89,499	78,820	102,386	112,153	+22,654	+9,767	109.5%
Mbrojtja e mjedisit	7,908	1,238	7,801	8,643	+735	+842	110.8%
Strehimi dhe komoditetet e komunitetit	46,636	36,432	54,759	53,018	+6,382	-1,741	96.8%
Shëndetësia	69,750	75,863	76,165	76,637	+6,887	+472	100.6%
Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare	12,334	6,394	11,842	13,215	+881	+1,373	111.6%
Arsimi	76,092	66,667	85,153	83,949	+7,857	-1,204	98.6%
Mbrojtja sociale	226,753	228,335	240,153	240,946	+14,193	+793	100.3%
Të paklasifikuara	—	186,195	—	—	—	—	—
TOTALI	**728,573**	**825,088**	**825,088**	**801,696**	**+73,123**	**-23,392**	**97.2%**

[1] Pas shpërndarjes së shpenzimeve të paklasifikuara; jo plani përfundimtar pas akteve normative.

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.


Në planin fillestar, shpenzimet e paklasifikuara ishin 186,195 milionë lekë, ose rreth 22.6% e totalit. Pas shpërndarjes së tyre në funksionet përkatëse, totali i planit ka mbetur i pandryshuar, ndërsa rritja më e madhe është reflektuar te shërbimet e përgjithshme publike, ku plani ka kaluar në 154,679 milionë lekë. Rritje të konsiderueshme janë reflektuar edhe te çështjet ekonomike, arsimi dhe strehimi e komoditetet e komunitetit.

Në realizimin faktik, peshën kryesore e zë mbrojtja sociale, me 30.1% të totalit, e ndjekur nga shërbimet e përgjithshme publike me 16.8%, çështjet ekonomike me 14%, arsimi me 10.5% dhe shëndetësia me 9.6%. Kundrejt planit fillestar të korrigjuar, diferencat më të mëdha të parealizuara evidentohen te shërbimet e përgjithshme publike, me 20,316 milionë lekë dhe realizim 86.9%, si dhe te mbrojtja, me 10,463 milionë lekë dhe realizim 72.1%. Nën plan rezultojnë edhe rendi dhe siguria publike, strehimi e komoditetet e komunitetit dhe arsimi, me realizim përkatësisht 94.7%, 96.8% dhe 98.6%. Nga ana tjetër, çështjet ekonomike rezultojnë 9,767 milionë lekë mbi plan, me realizim 109.5%. Mbi plan paraqiten edhe argëtimi, kultura dhe çështjet fetare, me realizim 111.6%, mbrojtja e mjedisit me 110.8%, shëndetësia me 100.6% dhe mbrojtja sociale me 100.3%. Krahasuar

me vitin 2024, shpenzimet janë rritur në të gjitha funksionet, kryesisht te çështjet ekonomike dhe mbrojtja sociale.

B.1.4 Shpërndarja mujore e shpenzimeve

Nga analiza e shpërndarjes mujore të shpenzimeve buxhetore konstatohet një përqendrim i konsiderueshëm i pagesave në fund të vitit. Në muajin dhjetor 2025 janë kryer shpenzime në shumën 162,544 milionë lekë, ose rreth 20.3% e totalit vjetor, të përbëra nga 92,547 milionë lekë shpenzime korrente, 53,410 milionë lekë shpenzime kapitale dhe 16,587 milionë lekë transfertë për fondin e pensioneve. Shpenzimet e dhjetorit rezultojnë rreth 2.8 herë më të larta se mesatarja mujore e periudhës janar–nëntor. Ecuria mujore sipas kategorive kryesore paraqitet në vijim.



Përqendrimi është më i theksuar në shpenzimet kapitale, ku vetëm në dhjetor është realizuar rreth 40.6% e investimeve vjetore, me një vlerë rreth 7.5 herë më të lartë se mesatarja mujore e periudhës janar–nëntor. Gjithashtu, shpenzimet korrente të dhjetorit rezultojnë rreth 1.8 herë më të larta se mesatarja mujore e së njëjtës periudhë. Në nivelin e shpenzimeve të raportuara në fund të vitit kanë ndikuar edhe transfertat në llogari speciale dhe pagesat për bonuse, të trajtuara në pjesët përkatëse të këtij raporti.

Nga analiza e pagesave konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e faturave të regjistruara me datë dhjetor 2025 i përkasin periudhës janar–nëntor 2025. Konkretisht, në dhjetor janë shlyer rreth 14,960 milionë lekë fatura për investime kapitale dhe rreth 8,902 milionë lekë për shpenzime operative, të lëshuara gjatë muajve të mëparshëm të vitit. Gjithashtu, janë shlyer rreth 955 milionë lekë fatura për investime kapitale që i përkasin vitit 2024 dhe viteve më të hershme. Përqendrimi i një vëllimi të lartë transaksionesh brenda një periudhe të shkurtër, rrit ekspozimin ndaj riskut të mangësive në kryerjen e kontrolleve përpara pagesës, si dhe krijon vështirësi në planifikimin dhe administrimin e likuiditetit.

B.2. Shpenzimet korrente

Shpenzimet korrente janë planifikuar me ligjin fillestar të buxhetit për vitin 2025 në shumën 656,014 milionë lekë. Gjatë vitit, plani është rritur nëpërmjet akteve normative, duke arritur në 669,356 milionë lekë, ose 13,342 milionë lekë dhe rreth 2% më shumë se plani fillestar. Akti Normativ nr. 3/2025 nuk ka ndryshuar këtë kategori, ndërsa me aktet normative nr. 6/2025, nr. 10/2025 dhe nr. 11/2025 janë miratuar rritje përkatësisht prej 4,507 milionë lekë, 1,725 milionë lekë dhe 7,110 milionë lekë.

Krahasuar me planin fillestar, rritjet janë përqendruar kryesisht te shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, me 10,303 milionë lekë, dhe shpenzimet për fondet speciale, me 8,931 milionë lekë. Rritje janë miratuar edhe për buxhetin vendor, me 1,000 milionë lekë, dhe shpenzimet e tjera, me 1,182 milionë lekë. Këto rritje janë kompensuar pjesërisht nga reduktimi i planit për interesat me 6,858 milionë lekë, për personelin me 1,050 milionë lekë dhe për subvencionet me 166 milionë lekë. Ecuria e planit dhe realizimi sipas zërave paraqiten në tabelën në vijim.

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2024	Projekt 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Δ Fakti 2025 – AN 11/2025
I.	**Shpenzime korrente**	**606,289**	**654,964**	**656,014**	**656,014**	**660,521**	**662,246**	**669,356**	**653,532**	**-15,824**
1	Personeli	112,699	127,651	127,929	127,929	128,985	128,747	126,879	125,694	-1,185
2	Interesat	54,459	68,552	68,552	68,552	68,552	61,694	61,694	54,692	-7,002
3	Shpenzime operative dhe mirëmbajtje	80,208	75,062	75,684	75,684	79,134	80,785	85,987	83,672	-2,315
4	Subvencionet	1,794	1,850	1,950	1,950	1,950	1,950	1,784	2,364	+580
5	Shpenzime për fondet speciale	251,791	263,838	263,838	263,838	263,838	271,009	272,769	270,271	-2,498
6	Shpenzime për buxhetin vendor	74,407	89,861	89,911	89,911	89,911	89,911	90,911	87,793	-3,118
7	Shpenzime të tjera	30,931	28,150	28,150	28,150	28,150	28,150	29,332	29,046	-286
	Transferime kapitale	550	—	—	—	—	—	—	—	—

Burimi: Ministria e Financave; përpunuar nga KLSH.

Në përfundim të vitit 2025, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën 653,532 milionë lekë, ose rreth 97.6% të planit përfundimtar, me një diferencë të parealizuar prej 15,824 milionë lekë. Kundrejt planit fillestar, realizimi rezulton 2,482 milionë lekë më i ulët, ndërsa krahasuar me shpenzimet faktike të vitit 2024, këto shpenzime janë rritur me 47,243 milionë lekë, ose rreth 7.8%. Analiza e detajuar e ndryshimeve të planit dhe realizimit trajtohet në vijim, sipas zërave përbërës të shpenzimeve korrente.

B.2.1 Shpenzimet e personelit në vitin 2025 kanë rezultuar në 125,694 milionë lekë, duke u rritur me 12,995 milionë lekë, ose 11.53%, krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje lidhet kryesisht me rritjen graduale të pagave. Peshën kryesore të shpenzimeve të personelit e zënë pagat me 107,361 milionë lekë, ose 85.41% të totalit, të ndjekura nga kontributet për sigurime shoqërore me 17,282 milionë lekë, ose 13.75%, dhe shpenzimet e arsimit të lartë nga të ardhurat e veta me 1,052 milionë lekë, ose 0.84%. Krahasuar me planin përfundimtar të miratuar me Aktin Normativ nr. 11/2025, shpenzimet faktike kanë rezultuar 1,185 milionë lekë më të ulëta, duke shënuar një realizim prej 99.07%. Mosrealizimi lidhet me mosplotësimin e strukturave organizative të institucioneve publike. Diferenca përqendrohet kryesisht te pagat dhe fondi i veçantë i pagave (i cili është raportuar i shpërndarë në realizim në zërin e pagave), ndërsa shpenzimet e arsimit të lartë nga të ardhurat e veta kanë tejkaluar planin me 52 milionë lekë.

Në milion lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Projekt buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca fakt-plan	Diferenca 2025-2024
Personeli	**112,699**	**127,651**	**127,929**	**127,929**	**128,985**	**128,747**	**126,879**	**125,694**	**-1,185**	**12,995**
Paga	96,235	109,026	109,275	109,275	110,049	109,518	108,047	107,361	-687	11,125
Kontributi për sigurime shoqërore	15,417	17,225	17,254	17,254	17,536	17,829	17,432	17,282	-150	1,864
Fondi i veçantë i pagave	0	400	400	400	400	400	400	0	-400	0
Politika të reja pagash	—	0	0	—	—	—	—	—	0	0
Indeksimi i pagave	—	—	—	—	—	—	—	—	0	0
Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	1,047	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,052	52	6

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit.

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” i ndryshuar, janë miratuar 86,314 punonjës buxhetorë, përfshirë 227 punonjës rezervë për institucionet qendrore. Pas ndryshimeve gjatë vitit, plani përfundimtar është përcaktuar në 84,897 punonjës, ndërsa numri faktik ka rezultuar 79,110, ose 5,787 punonjës më pak se plani. Mosrealizimi më i lartë konstatohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe në institucionet e tjera qeveritare.
Pas ndryshimeve me akte normative, rishpërndarjeve dhe shpërndarjes së fondit për rritjen e pagave, plani përfundimtar rezulton 108,406 milionë lekë, për pagat e financuara nga buxheti qendror, duke përfshirë edhe fondin e veçantë të pagave.

Nga auditimi konstatohet se në tabelën e treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar janë raportuar si shpenzime operative dhe mirëmbajtjeje 25,853 milionë lekë për paga dhe kontribute për sigurime, nga të cilat: 226 milionë lekë për Akademinë e Shkencave, 16,128 milionë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe 9,499 milionë lekë për Ministrinë e Arsimit. Këto fonde janë miratuar në grupin 604 “Të tjera transferta korrente të brendshme”, sipas tabelës nr. 5 të ligjit nr. 115/2024, dhe janë raportuar në zbatim të pikës 3 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 127, datë 19.12.2025, për mbylljen e llogarive të buxhetit. Raportimi i tyre si shpenzime operative dhe mirëmbajtjeje, ndonëse brenda shpenzimeve korrente, paraqet një

trajtim të ndryshëm nga ai i transfertave të tjera të grupit 604 dhe i shpenzimeve për paga të financuara nga të ardhurat e veta të arsimit të lartë.

Nga auditimet në institucionet e administratës publike janë evidentuar mangësi në planifikimin dhe realizimin e procedurave të rekrutimit, përfshirë mos hartimin e planeve vjetore të pranimit në shërbimin civil, përcjelljen jo të plotë të nevojave për personel dhe plotësimin e pjesshëm të pozicioneve të parashikuara për rekrutim. Këto mangësi kanë kontribuar në vijimin e vakancave dhe në mospërputhjen ndërmjet numrit të punonjësve të planifikuar dhe atij faktik, duke ndikuar në mosrealizimin e fondeve për paga dhe kontribute. Për rrjedhojë, diferencat e pashpenzuara që lidhen me vakancat nuk përfaqësojnë, në vetvete, ulje të nevojave të institucioneve për financimin e personelit. Gjithashtu, janë konstatuar raste të rinovimit të kontratave të punës me afat të caktuar për të njëjtët punonjës gjatë disa viteve radhazi, si dhe rritje e peshës së personelit të përkohshëm në raport me strukturat organike të miratuara. Përdorimi i përsëritur i këtyre kontratave për mbulimin e nevojave me karakter të vazhdueshëm evidenton mangësi në përcaktimin e nevojave afatmesme për personel dhe në harmonizimin e tyre me strukturat e miratuara dhe planifikimin e fondit të pagave. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave janë konstatuar 128 raste të transferimeve të përkohshme në tejkalim të afateve ligjore, nga të cilat 76 raste nga kategori më të ulëta në kategori më të larta. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, gjatë vitit 2025 janë evidentuar 59 urdhra për ngarkim të përkohshëm në detyrë, ndërsa në praktikat e shqyrtuara nuk është përcaktuar afati konkret i ushtrimit të funksioneve. Këto problematika përveç efekteve në mos realizim të shpenzimeve të personelit, japin impakt të drejtpërdrejtë në mirëfunksionimin e institucioneve përkatëse.

B.2.2 Shpenzimet e interesit në vitin 2025 kanë arritur në 54,692 milionë lekë dhe janë rritur me 233 milionë lekë, ose 0.43%, krahasuar me vitin 2024. Interesat e brendshme janë rritur me 2,068 milionë lekë, ndërsa interesat e huaja janë ulur me 1,835 milionë lekë, sipas diferencave të raportuara. Krahasuar me planin përfundimtar, shpenzimet e interesit kanë rezultuar 7,003 milionë lekë më të ulëta, me një nivel realizimi prej rreth 88.6%. Rreth 83.5% e mosrealizimit lidhet me mospërdorimin e kontingjencës për risqet e borxhit, të planifikuar në shumën 5,850 milionë lekë, e cila nuk është përdorur pasi nuk janë materializuar risqet për mbulimin e të cilave ishte parashikuar. Tabela e mëposhtme paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve të interesit sipas zërave analitikë.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Projekt buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca fakt−plan	Diferenca 2025-2024
Interesat	**54,459**	**68,552**	**68,552**	**68,552**	**68,552**	**61,694**	**61,694**	**54,692**	**−7,003**	**233**
Të brendshme	33,118	37,906	37,906	37,906	37,906	35,600	35,600	35,186	−414	2,068
Të huaja	21,341	24,866	24,866	24,866	24,866	20,244	20,244	19,505	−739	−1,835
Kontingjenca për risqet e borxhit	—	5,780	5,780	5,780	5,780	5,850	5,850	—	−5,850	0

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit.

B.2.3 Shpenzime operative mirëmbajtje në vitin 2025 kanë arritur në 83,672 milionë lekë dhe janë rritur me 3,463 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Krahasuar me planin përfundimtar, këto shpenzime janë realizuar 2,315 milionë lekë më pak, duke rezultuar në nivelin 97.3% të planit përfundimtar. Mungesa e detajimit të realizimit faktik sipas zërave dhe burimeve të financimit të përcaktuara në planin analitik të tabelës së treguesve fiskalë nuk mundëson identifikimin dhe krahasimin e veçantë të planit me realizimin për secilin burim financimi. Tabela e mëposhtme paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes sipas zërave analitikë.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Projekt buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca fakt−plan	Diferenca 2025-2024
Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes, nga të cilat:	**80,208**	**75,062**	**75,684**	**75,684**	**79,134**	**80,785**	**85,987**	**83,672**	**−2,315**	**3,463**
Të qeverisjes qendrore	—	71,262	71,884	71,884	75,385	77,036	82,237	—	—	—
Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	—	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	—	—	—
Të tjera jashtë limitit	—	2,800	2,800	2,800	2,750	2,750	2,750	—	—	—

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas bazës së të dhënave të pagesave për vitin 2025, zërat kryesorë të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes përfshijnë materiale e shërbime, furnizime mjekësore dhe ushqimore, mirëmbajtje,

transport, honorare dhe ekzekutim vendimesh gjyqësore. Tabela e mëposhtme paraqet realizimin e këtyre zërave dhe ndryshimin kundrejt vitit 2024:

Në milion lekë

Nr. llogarie	Përshkrimi i llogarisë	Realizimi 2024	Realizimi 2025	Ndryshimi 2025-2024
6029099	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	7,215	8,698	+1,483
6021099	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	7,107	8,485	+1,378
6021003	Ilaçe dhe materiale mjekësore	6,150	7,821	+1,671
6022099	Shërbime të tjera	3,481	5,874	+2,393
6021004	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mensat	5,072	5,776	+704
6022009	Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit	5,273	5,414	+141
6022001	Elektricitet	4,570	4,993	+423
6025800	Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave	4,871	4,007	-864
6023100	Karburant dhe vaj	3,954	3,676	-278
6025400	Shpenzime për mirëmbajtjen e rrugëve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohjes etj.	2,276	3,144	+868
6025300	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	2,693	2,554	-139
6021001	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	1,713	2,371	+658
6022008	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	2,198	2,256	+58
6024100	Udhëtim i brendshëm	1,847	1,936	+89
6029005	Shpenzime për honorarë	1,401	1,624	+223
6023900	Shpenzime të tjera transporti	1,335	1,290	-45
6022002	Ujë	1,051	1,092	+41
6027400	**Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna**	**1,367**	**1,053**	**-314**
6025500	Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës	1,023	1,023	0

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit.

Shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për largim nga puna rezultojnë 1,053 milionë lekë, 314 milionë lekë, ose 23%, më pak krahasuar me vitin 2024. Pavarësisht uljes, këto pagesa kanë vijuar të angazhojnë fonde buxhetore krahas shpenzimeve për personelin në detyrë. Nga auditimi është evidentuar mungesa e një baze të konsoliduar dhe të publikuar të të dhënave për këto vendime në sektorin publik, ndërsa planifikimi buxhetor nuk ka reflektuar plotësisht ekspozimin financiar që buron nga vendimet gjyqësore dhe çështjet gjyqësore në proces. Nga auditimet në institucionet publike janë konstatuar mangësi në funksionimin e komisioneve të posaçme për sistemimin e nëpunësve civilë gjyqfitues, mosrespektim i radhës së shlyerjes së detyrimeve, vonesa në përcjelljen e dokumentacionit dhe mangësi në hartimin e publikimin e grafikut të pagesave. Në raste të veçanta, edhe në kushtet e ekzistencës së pozicioneve vakante, nuk janë vlerësuar në kohë mundësitë e sistemimit të gjyqfituesve, duke sjellë vijimin e detyrimeve për paga dhe dëmshpërblime. Gjithashtu, vonesat në ekzekutimin e vendimeve janë shoqëruar me shpenzime përmbarimore dhe mbartje të detyrimeve të pashlyera në vitet pasardhëse.

Fondet për transferta drejt të tretëve: Nga analiza e ndryshimeve të fondeve për shpenzime operative gjatë vitit 2025 është konstatuar se, me Aktin Normativ nr. 11/2025, janë parashikuar transferta shtesë për përfitues jobuxhetorë në shumën 800 milionë lekë. Kjo shumë përfshin 280 milionë lekë për projektin "Ekipet Sportive në Shkolla" të KOKSH-it, 300 milionë lekë për Federatën Shqiptare të Futbollit për organizimin e Kampionatit Evropian UEFA U-17 dhe 220 milionë lekë për turneun ndërkombëtar "Cupra FIP Tour Platinum". Për projektin "Ekipet Sportive në Shkolla", i cili financohet në mënyrë të vazhdueshme që prej vitit 2022 dhe mbështetet çdo vit me vendime të Këshillit të Ministrave, nuk rezulton të jetë argumentuar nevoja për financim shtesë në fund të vitit 2025. Gjithashtu, për turneun "Cupra FIP Tour Platinum" nuk është argumentuar domosdoshmëria e alokimit të fondit në fund të vitit 2025, ndërkohë që aktiviteti është planifikuar të zhvillohet në vitin 2026, dhe nuk janë evidentuar arsyet e mosplanifikimit të financimit gjatë hartimit të buxhetit. Gjithashtu, ka vijuar problematika e evidentuar në vitin e kaluar, ku pas transferimit të fondeve në llogarinë 604 në favor të KOKSH-it dhe FSHF-së, përdorimi i mëtejshëm i tyre nuk regjistrohet dhe nuk ndiqet nëpërmjet SIFQ-së.

Fondet e ndryshuara për shpenzimet korrente me rishikimet me akte normative: Nga auditimi ka rezultuar se ndryshimet buxhetore për shpenzime operative janë shoqëruar me mangësi në argumentimin e kërkesave, ndryshime të destinacionit të fondeve dhe pasaktësi e vonesa në pasqyrimin e tyre në SIFQ. Konkretisht:

▸ Ministria e Arsimit ka kërkuar ndryshime të fondeve pa argumentimin e nevojshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 9936/2008. Gjithashtu, fondi prej 24 milionë lekë, i parashikuar për konkursin e projektimit të Kampusit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, është përfshirë në një projekt tjetër dhe është transferuar për rezidencat studentore dhe ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, pa u mbështetur në dokumentacionin përkatës justifikues dhe pa u pasqyruar ndryshimi në Aktin Normativ nr. 10/2025.

▸ Në rastin e AAPSK-së, fondi prej 1,000 milionë lekë është akorduar si transfertë kapitale për Korporatën e Investimeve Shqiptare, për pjesëmarrjen në "Thinking Machines Lab", ndërsa në planifikimin buxhetor nuk rezulton të jenë reflektuar nevojat për financimin e shpenzimeve operative të AAPSK-së, përfshirë pagat, sikundër përcaktonte vendimi i Komitetit Ndërinstitucional.

▸ Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fondi për skemën e investimeve me grant është pasqyruar në fund të vitit në shumën 683 milionë lekë, duke tejkaluar me 145.2 milionë lekë kufirin prej 537.8 milionë lekë të përcaktuar në Aktin Normativ nr. 6/2025. Ndryshimet janë reflektuar në SIFQ me rreth gjashtë muaj vonesë dhe janë konstatuar rishpërndarje ndërmjet skemave mbështetëse përtej nevojave.

B.2.4 Shpenzimet për subvencione përfshijnë subvencione për të rritur punësimin dhe ato për diferencë çmimi, apo të tjera për agjenci/ndërmarrje publike. Kryesisht ato kryhen nga buxheti për të mbështetur financiarisht veprimtarinë e ndërmarrjeve, prodhimin, ofrimin e shërbimeve ose mbajtjen në nivele të caktuara të çmimeve, në përputhje me politikat ekonomike dhe sociale të qeverisë. Në vitin 2025 ato kanë arritur në 2,364 milionë lekë, duke rezultuar 580 milionë lekë, ose rreth 32.5%, mbi planin përfundimtar prej 1,784 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, këto shpenzime janë rritur me 570 milionë lekë, kryesisht për shkak të rritjes së transfertave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare në projektin “Organizim eventesh dhe pritje përcjellje personalitetesh të vendit dhe të huaj”.

B.2.5 Shpenzime për fondet speciale në vitin 2025 kanë arritur në 270,271 milionë lekë dhe janë rritur me 18,480 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Rritja është reflektuar në shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ndërsa shpenzimet për kompensimin në vlerë të pronarëve janë ulur. Krahasuar me planin përfundimtar, shpenzimet janë realizuar 2,499 milionë lekë më pak, duke arritur në rreth 99.1% të planit përfundimtar prej 272,770 milionë lekë.Tabela e mëposhtme paraqet planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve sipas zërave analitikë.

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2024	Projekt-buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca fakt−plan	Diferenca 2025-2024
	Shpenzime për fondet speciale	**251,791**	**263,838**	**263,838**	**263,838**	**263,838**	**271,009**	**272,769**	**270,271**	**−2,499**	**18,480**
1	Sigurime shoqërore	188,626	192,338	192,338	192,338	192,338	194,038	194,038	204,060	+10,022	15,434
	Politika të reja pensionesh	—	1,618	1,618	1,618	1,618	1,140	1,140	—	—	—
	Bonusi i pensionistëve	—	3,750	3,750	3,750	3,750	9,700	9,700	—	—	—
2	Sigurime shëndetësore	58,771	63,132	63,132	63,132	63,132	63,132	64,892	63,927	−966	5,156
3	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	4,394	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	2,284	−716	−2,110

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga grupi i auditimit.
Shënim: Realizimi i politikave të reja të pensioneve dhe bonusit përfshihet në totalin e sigurimeve shoqërore.

B.2.5.1 Skema e sigurimeve shoqërore



Sistemi i sigurimeve shoqërore mbulon përfitimet për pleqërinë, invaliditetin, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, papunësinë dhe barrëlindjen. Ai përfshin sigurimin e detyrueshëm, sigurimin vullnetar, sigurimin suplementar dhe pensionet e veçanta, sipas kategorive dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Financimi i skemës mbështetet në të ardhurat nga kontributet e burimet e tjera, si dhe në transfertat nga buxheti i shtetit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve të skemës

Shpenzimet e skemës së sigurimeve detyrueshme për vitin 2025 janë realizuar në shumën 204,060 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 204,878 milionë lekë, me një nivel realizimi prej 99.6%. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet janë rritur me 15,434 milionë lekë, ose 8.2%.

Në strukturën e shpenzimeve, peshën kryesore e zënë shpenzimet për përfitime, në shumën 170,869 milionë lekë, ose 83.7% të totalit. Programet e veçanta janë realizuar në shumën 21,182 milionë lekë, skemat suplementare në 8,403 milionë lekë dhe shpenzimet administrative në 3,607 milionë lekë.

Në milionë lekë

Shpenzimet	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Diferenca fakt-plan	Realizimi	Ndryshimi 2025/2024
Përfitime	159,332	170,975	**170,869**	-106	99.9%	7.2%
Programe të veçanta	18,371	21,474	**21,182**	-292	98.6%	15.3%
Skema suplementare	7,546	8,422	**8,403**	-19	99.8%	11.4%
Shpenzime administrative	3,378	4,006	**3,607**	-399	90.0%	6.8%
Total	**188,626**	**204,878**	**204,060**	**-818**	**99.6%**	**8.2%**

Burimi: ISSH, përpunuar nga KLSH.

Mosrealizimi është përqendruar kryesisht në shpenzimet administrative, të cilat janë realizuar në masën 90% të planit, me një diferencë prej 399 milionë lekë. Programet e veçanta janë realizuar 292 milionë lekë më pak se plani, ndërsa përfitimet dhe skemat suplementare kanë shënuar diferenca më të kufizuara. Në krahasim me vitin 2024, rritjen më të lartë e kanë shënuar programet e veçanta, me 15.3%, të ndjekura nga skemat suplementare me 11.4%, ndërsa shpenzimet për përfitime janë rritur me 7.2%.

Shpenzimet për përfitime sipas degëve të sigurimeve shoqërore

Shpenzimet për përfitime kanë arritur në 170,869 milionë lekë dhe janë rritur me 11,537 milionë lekë, ose 7.2%, krahasuar me vitin 2024.

Në milionë lekë

Përfitimi	Fakti 2024	Fakti 2025	Ndryshimi 2025-2024	Ndryshimi 2025/2024 (%)	Pesha 2025
Pensione	152,907	**163,870**	10,963	7.2%	95.9%
Barrëlindje	5,627	**6,034**	407	7.2%	3.5%
Sëmundje	765	**923**	158	20.6%	0.5%
Aksidente	33	**42**	9	27%	0.02%
Total	**159,332**	**170,869**	**11,537**	**7.2%**	**100%**


Burimi: ISSH, përpunuar nga KLSH.

Ritja është mbështetur kryesisht te pensionet, të cilat kanë përbërë 95.9% të shpenzimeve për përfitime dhe kanë kontribuar në rreth 95% të rritjes vjetore. Shpenzimet për barrëlindje janë rritur me 407 milionë lekë, ose 7.2%. Përfitimet për sëmundje dhe aksidente kanë shënuar rritje më të larta, përkatësisht 20.6% dhe 27%.

Financimi dhe mbulimi i shpenzimeve të skemës

Financimi i shpenzimeve të skemës së sigurimeve shoqërore gjatë vitit 2025 është mbështetur në të ardhurat nga kontributet dhe burimet e tjera në shumën 154,702 milionë lekë, si dhe në transfertat nga buxheti i shtetit, në shumën 51,508 milionë lekë. Në raport me shpenzimet e realizuara prej 204,060 milionë lekë, të ardhurat nga kontributet dhe burimet e tjera kanë mbuluar 75.8% të tyre. Diferenca ndërmjet këtyre të ardhurave dhe shpenzimeve ka rezultuar 49,358 milionë lekë, duke evidentuar nevojën për financim nga buxheti i shtetit.

Transfertat buxhetore prej 51,508 milionë lekë kanë tejkaluar nevojën e përllogaritur për mbulimin e shpenzimeve me 2,150 milionë lekë. Për rrjedhojë, skema ka rezultuar me bilanc financiar pozitiv pas përfshirjes së financimit buxhetor. Megjithatë, ky rezultat nuk përfaqëson një suficit të krijuar nga të ardhurat kontributive, pasi këto të fundit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar tërësisht shpenzimet.



Burimi: ISSH, përpunuar nga KLSH.

Rezultati i skemës së pensioneve

Për vlerësimin e mbulimit të shpenzimeve të pensioneve nga të ardhurat përkatëse, është analizuar veçmas rezultati financiar i skemës së pensioneve. Ky tregues ndryshon nga rezultati financiar i përgjithshëm i ISSH-së, pasi evidenton diferencën ndërmjet të ardhurave kontributive të skemës dhe shpenzimeve përkatëse, pa përfshirë financimin plotësues nga buxheti i shtetit.

Në milionë lekë, përveç raporteve

Treguesi	2024	2025	Δ 2025-2024
Të ardhura nga kontributet	144,513	159,101	14,588
Shpenzimet e skemës	162,237	173,943	11,706
Deficiti	17,724	14,842	-2,882
Deficiti / PBB	0.71%	0.56%	-0.15 p.p.
Mbulimi nga kontributet	89.1%	91.5%	+2.39 p.p.

Burimi: ISSH, përpunuar nga KLSH.

Deficiti i skemës së pensioneve për vitin 2025 ka arritur në 14,842 milionë lekë, duke u ulur me 2,882 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave nga kontributet me 14,588 milionë lekë, ose 10.1%, e cila ka tejkaluar rritjen e shpenzimeve prej 11,706 milionë lekë, ose 7.2%. Si rezultat, niveli i mbulimit të shpenzimeve të skemës së pensioneve nga kontributet është rritur nga 89.1% në vitin 2024 në 91.5% në vitin 2025, ndërsa raporti i deficitit ndaj PBB-së është ulur nga 0.71% në 0.56%. Pavarësisht përmirësimit të këtyre treguesve, skema e pensioneve ka vijuar të rezultojë me deficit, duke ruajtur nevojën për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit.

Analiza e deficitit të skemës së pensioneve sipas qytetit dhe fshatit

Në milionë lekë

Zërat	Qytet			Fshat		
	2024	2025	Δ 25-24	2024	2025	Δ 25-24
Kontribute	134,702	147,941	13,239	9,811	11,160	1,349
Shpenzime	148,756	160,764	12,008	13,481	13,179	-302
Deficiti	14,054	12,823	-1,231	3,670	2,019	-1,651

Burimi: ISSH, përpunuar nga KLSH.

Në skemën e qytetit, të ardhurat nga kontributet janë rritur me 13,239 milionë lekë, duke tejkaluar rritjen e shpenzimeve prej 12,008 milionë lekë. Për rrjedhojë, deficiti është ulur me 1,231 milionë lekë, duke arritur në 12,823 milionë lekë. Në skemën e fshatit, të ardhurat nga kontributet janë rritur me 1,349 milionë lekë, ndërsa shpenzimet janë ulur me 302 milionë lekë. Këto ndryshime kanë sjellë uljen e deficitit me 1,651 milionë lekë, duke e çuar atë në 2,019 milionë lekë. Skema e fshatit ka kontribuar në rreth 57.3% të uljes së deficitit të përgjithshëm të pensioneve, ndërsa pjesa kryesore e deficitit të mbetur ka vijuar të përqendrohet në skemën e qytetit.

Indeksimi dhe bonusi

Përllogaritja e indeksimit të pensioneve- Nga auditimi rezultoi se për indeksimin e pensioneve është përzgjedhur muaji korrik 2025 si bazë për përllogaritjen e indeksimit në masën 2.5%. Krahasuar me vitin 2024, kur indeksimi ka qenë 4.1%, kjo masë është ulur me 1.6 pikë përqindjeje. Indeksimi i pensioneve në masën 2.5% për vitin 2025, ka sjellë një efekt financiar të parashikuar prej 1.14 miliardë lekë.

Planifikimi i indeksimit dhe bonusit- Sipas nenit 4, pika 3, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", janë parashikuar 1,618 milionë lekë për indeksimin dhe 3,750 milionë lekë për bonusin e pensionistëve, në total 5,368 milionë lekë. Me Aktin Normativ nr. 10/2025, fondi për indeksimin është ulur me 478 milionë lekë, ndërsa fondi për bonusin është rritur me 5,950 milionë lekë.

Në milionë lekë

Zëri	Ligji nr. 115/2024 Plani fillestar	AN nr. 10/2025 Plani i rishikuar	Ndryshimi
Indeksimi	1,618	1,140	-478
Bonusi i pensionistëve	3,750	9,700	5,950
Total	**5,368**	**10,840**	**5,472**

Burimi: Të dhënat e paraqitura në materialin e auditimit.

Me VKM-në nr. 711, datë 26.11.2025, "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2025", është miratuar shpërblimi me efekt financiar rreth 10,405 milionë lekë. Financimi është përcaktuar nga fondi buxhetor për bonusin, në shumën 9,700 milionë lekë, dhe nga buxheti i planifikuar i sigurimeve shoqërore, në shumën 704.52 milionë lekë. Nga auditimi ka rezultuar se, përpara miratimit të vendimit, nuk është dokumentuar analiza nga ISSH-ja që të justifikonte se rialokimi i 704.52 milionë lekëve nuk do të cenonte përmbushjen e detyrimeve të planifikuara të skemës. Nëpërmjet këtij rishikimi, rezulton se fondet janë orientuar drejt rritjes së bonusit të pensionistëve, si përfitim i njëhershëm dhe i përkohshëm, ndërkohë që është pakësuar fondi për indeksimin, i cili ndikon në mënyrë të përhershme në masën e pensioneve. Në zbatim të VKM-së, fondi është siguruar nëpërmjet pakësimit të zërit 6060 "Shpenzime për pensione".

Raportimi i transfertave në llogarinë speciale të Fondit të Pensioneve
Nga auditimi është konstatuar se në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar për vitin 2025 është raportuar një transfertë prej 16,587 milionë lekë në llogarinë speciale të Fondit të Pensioneve në Bankën e Shqipërisë, e cila është raportuar si e realizuar në treguesit fiskalë të konsoliduar, ndërsa në shpenzimet faktike të ISSH-së nuk është pasqyruar shpenzim përkatës. Kjo diferencë në raportim nuk mundëson identifikimin e pjesës së fondit të përdorur dhe të gjendjes së mbetur në llogarinë speciale. E njëjta situatë konstatohet edhe për transfertën prej 6,300 milionë lekë, të raportuar në Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të vitit 2024 dhe të transferuar gjatë vitit 2025 në llogarinë speciale për bonusin e pensionistëve, e cila nuk është pasqyruar në shpenzimet faktike të ISSH-së për vitin 2025. Për rrjedhojë, raportimi financiar vjetor i ISSH-së nuk pasqyron në mënyrë të njëjtë me treguesit fiskalë të konsoliduar transfertat e fondeve të kaluara në llogarinë speciale të pensioneve.

Problematika të konstatuara nga auditimi pranë ISSH-së
Caktimi, administrimi dhe pagesa e përfitimeve: Procedurat për pensionet afatgjata dhe përfitimet afatshkurtra vijojnë të mbështeten në rregullore të miratuara përkatësisht në vitet 2004 dhe 2008, të bazuara në administrimin fizik të aplikimeve dhe dokumentacionit, ndërsa prej vitit 2022 aplikimet dhe një pjesë e administrimit realizohen elektronikisht nëpërmjet platformës e-Albania. Këto mospërputhje përfshijnë edhe procedurën e pagesës së përfitimeve afatshkurtra nëpërmjet punëdhënësit dhe rimbursimit nga ISSH-ja, e cila nuk zbatohet prej vitesh. Nga testimi i dosjeve janë evidentuar pasaktësi në llogaritjen e përfitimeve, ku:
▸Në 14 nga 70 dosjet e pensioneve të pleqërisë janë konstatuar pasaktësi në përllogaritjen e masës së pensionit, të cilat kanë ndikuar në vlerën e përfitimit të caktuar.
▸Në administrimin e pensioneve familjare janë evidentuar raste të mosreflektimit të shtesave kreditore, vonesa në ndërprerjen e pensioneve, mungesë e dokumentacionit justifikues për sistemimin e tepricave debitore dhe kreditore, si dhe pasaktësi në përcaktimin e bazës së vlerësuar.
▸ Në 15% të dosjeve të pensioneve të invaliditetit janë konstatuar pasaktësi në përcaktimin e bazës së vlerësuar dhe të elementeve përbërëse që ndikojnë në masën e përfitimit.
Nga auditimi i administrimit të shtesave kreditore janë konstatuar raste të mosreflektimit të plotë të veprimeve në regjistrat elektronikë, kryerjes së korrigjimeve manuale dhe ndryshimit të masës së përfitimeve pas certifikimit, pa iu nënshtruar një procesi të ri certifikimi. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në njoftimin e përfituesve për ndryshimet e kryera. Për shtesat kreditore që kanë buruar nga vendimet gjyqësore, janë konstatuar raste të kryerjes së pagesave përpara përfundimit të procesit të certifikimit.

Planifikimi dhe mbulimi i kontrolleve: Kontrollet e kryera nga ISSH nuk kanë siguruar një mbulim të vazhdueshëm të periudhave të administrimit të përfitimeve, si dhe një shpërndarje të njëtrajtshme ndërmjet drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore. Kontrollet kanë përfshirë kryesisht përfitimet e viteve 2020–2023, duke lënë jashtë verifikimit periudha të mëvonshme të administrimit të pensioneve. Kontrollet për pensionet e pleqërisë kanë mbuluar 42% të DRSSH-ve; pensionet e invaliditetit, familjare dhe sociale 66% të DRSSH-ve dhe pensionet suplementare dhe trajtimet e veçanta, 91.6% të DRSSH-ve. Shtrirja territoriale e kontrolleve nuk ka qenë në përpjesëtim me volumin e përfitimeve të administruara dhe ekspozimin ndaj riskut. Pavarësisht rritjes së volumit të përfitimeve, disa drejtori rajonale me numër të konsiderueshëm përfituesish kanë mbetur tërësisht ose pjesërisht jashtë kontrolleve.

B.2.5.2. Skema e sigurimeve shëndetësore



Shpenzimet e FSDKSH-së për vitin 2025 janë realizuar në shumën 63,927 milionë lekë, ose në masën 98.5% të planit vjetor, me një mosrealizim prej 965 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet janë rritur me rreth 8.8%, kryesisht nga rritja e financimit të shërbimit spitalor dhe kujdesit parësor. Në strukturën e shpenzimeve faktike, peshën më të madhe

e zënë shpenzimet për shërbimin spitalor, me rreth 57.27%, të ndjekura nga shpenzimet për kujdesin parësor, me 21.51%, dhe për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve, me 19.53%.

Programi	Fakt 2024	Plan 2025	Fakt 2025	25/24	Plan − Fakt	Realizimi	Pesha
Spitale	33,225	36,857	36,610	110.2%	247	99.3%	57.268%
Kujdes parësor	12,352	13,892	13,748	111.3%	144	99.0%	21.506%
Barna/pajisje	12,136	12,850	12,484	102.9%	366	97.1%	19.528%
Administratë	1,057	1,183	1,083	102.5%	100	91.5%	1.694%
Investime	10.7	110	2.5	23.4%	107.5	2.3%	0.004%
Total	**58,781**	**64,892**	**63,927**	**108.8%**	**965**	**98.5%**	**100.000%**

Burimi: FSDKSH, përpunuar nga KLSH. Njësia: milionë lekë.

Shpenzimet për rimbursimin e barnave dhe pajisjeve janë rritur me rreth 2.9% krahasuar me vitin 2024, por realizimi i tyre ka arritur në 97.1% të planit vjetor, duke rezultuar me fonde të pashfrytëzuara në shumën 366 milionë lekë. Ndërkohë, në financimin e shërbimit spitalor është konstatuar një mosrealizim prej 247 milionë lekë. Niveli më i ulët i realizimit të shpenzimeve është evidentuar në kategorinë e investimeve, ku nga fondi i planifikuar prej 110 milionë lekë janë realizuar vetëm 2.5 milionë lekë, ose rreth 2.3% e planit.

Mbi problematikat e konstatuara në auditimin e kryer pranë FSDKSH

Nga auditimi i procesit të administrimit dhe përditësimit të Listës së Barnave të Rimbursuara janë konstatuar mangësi në verifikimin dhe dokumentimin e disponueshmërisë së barnave të përfshira në listë. Konkretisht, për 373 barna pa konsum të raportuar, nga të cilat 77 alternativa të para, nuk rezultojnë të dokumentuara analiza apo verifikime mbi shkaqet e mungesës së konsumit, përfshirë disponueshmërinë e tyre në treg. Gjithashtu, u evidentuan 28 barna pa çmime CIF/EẂ, shoqëruar me mangësi në mbulimin kontraktual të barnave, ku nga verifikimi i barnave të përfshira në listat e rimbursimit janë evidentuar 200 barna pa kontratë, nga të cilat 64 barna në LBR II rezultojnë me konsum të raportuar dhe me pagesa rimbursimi. Për alternativat e vetme dhe të para të rimbursuara në mungesë të kontratave përkatëse, vlera e rimbursimit ka arritur në rreth 10.13 milionë lekë. Për 24 barna, mungesa e kontraktimit të alternativave të para është shoqëruar me përdorimin e alternativave të dyta, duke sjellë, sipas përllogaritjeve të auditimit, një kosto financiare shtesë për pacientët prej rreth 11.3 milionë lekë. Nga auditimi është konstatuar se planifikimi i veprimtarisë kontrolluese nuk është mbështetur në një analizë të dokumentuar të riskut, ndërsa kontrollet e realizuara nuk kanë siguruar verifikimin e plotë të problematikave të evidentuara në disponueshmërinë dhe furnizimin me barna. Pavarësisht mungesave të raportuara, janë realizuar vetëm 3 kontrolle tematike. Gjithashtu, mangësitë në koordinimin institucional dhe në ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale janë shoqëruar me mosaplikimin e penaliteteve të përllogaritura në shumën 42 milionë lekë. Nga auditimi i të dhënave të administruara në sistemin “e-Depo” janë evidentuar dalje të barnave të regjistruara me vlerë zero, në një volum prej 9,251,637 njësish, nga të cilat 283,052 njësi rezultonin në prag të skadencës. Gjithashtu, janë konstatuar dalje të barnave të destinuara për përdorim spitalor drejt rrjetit të hapur, pa u dokumentuar verifikime të plota mbi destinacionin përfundimtar, përdorimin dhe përputhshmërinë e këtyre lëvizjeve me procedurat përkatëse të administrimit të barnave. Kontrollet e FSDKSH nuk kanë përfshirë të gjithë mjekët që rezultonin me tejkalim të pragut të përcaktuar të rimbursimit, duke evidentuar mangësi në identifikimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve me risk në përdorimin e fondeve të skemës. Në organizimin dhe funksionimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor janë evidentuar 151 pozicione vakante për mjekë, të përqendruara kryesisht në zonat rurale. Në administrimin e rimbursimeve të barnave për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është konstatuar vijimi i përdorimit të procedurave “off-line”, si dhe raste të rimbursimit të barnave pa kontratë.


Nga shqyrtimi i zbatimit të kontratave koncesionare në shëndetësi u evidentuan kosto buxhetore të lidhura me trajtimin e shërbimeve me TVSH dhe pagesat sipas sasive minimale të garantuara, pavarësisht realizimit faktik të tyre. Nga auditimi i zbatimit të kontratave koncesionare për Kontrollin Mjekësor Bazë dhe sterilizimin e instrumenteve kirurgjikale janë evidentuar problematika në trajtimin fiskal të shërbimeve të financuara nga buxheti i shtetit. Konkretisht, gjatë viti 2025 aplikimi i TVSH-së mbi shërbimet përkatëse ka sjellë një kosto shtesë buxhetore prej 146.02 milionë lekë për Kontrollin Mjekësor Bazë dhe 316.66 milionë lekë për sterilizimin e instrumenteve kirurgjikale. Për koncesionin e dializës, pagesat sipas projeksioneve minimale kontraktuale kanë

tejkaluar shërbimin e realizuar, me pagesa për 8,398 seanca të pakryera, me vlerë rreth 94.08 milionë lekë; si dhe për koncesionin e kontrollit mjekësor bazë janë kryer pagesa për 19,147 raste kontrolli të pakryera, me kosto në shumën 35.32 milionë lekë. Për kontratën koncesionare të shërbimeve laboratorike, shpenzimet e vitit 2025 janë realizuar në shumën 1,893.58 milionë lekë, ose rreth 99.7% të planit vjetor prej 1,900 milionë lekë.

B.2.5.3 Kompensimi në vlerë i pronarëve

Financimi i kompensimit në vlerë të pronarëve mbështetet kryesisht në fondet e buxhetit të shtetit, si dhe në të ardhurat e transferuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), të krijuara nga transferimi i pronësisë së parcelave ndërtimore. Për vitin 2025, fondi i planifikuar për shpenzimet e kompensimit ishte 3,000 milionë lekë.

Gjatë vitit 2025, ASHK-ja ka mbledhur 938.37 milionë lekë të ardhura për transferim në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), ndërsa transfertat e realizuara kanë arritur në 951.54 milionë lekë. Duke marrë në konsideratë gjendjen e mbartur prej 709.78 milionë lekë në fillim të vitit, në fund të vitit 2025 kanë mbetur të patransferuara në ATP të ardhura në shumën 696.61 milionë lekë.



Sa i përket realizimit të shpenzimeve për kompensimin e pronarëve, nga fondi i planifikuar prej 3,000 milionë lekë janë shpenzuar 2,284 milionë lekë, ose 76.1% e planit, duke mbetur të pashfrytëzuara 716 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, kur shpenzimet kanë arritur në 4,394 milionë lekë, pagesat e kompensimit janë ulur me 2,110 milionë lekë (48%).

Nga auditimi ka rezultuar se, krahas mosrealizimit të plotë të fondit të planifikuar për kompensimin e pronarëve, në fund të vitit 2025 kanë mbetur të patransferuara nga ASHK-ja në ATP të ardhura në shumën 696.61 milionë lekë. Kjo situatë, në kushtet e ekzistencës së detyrimeve të njohura dhe të papaguara ndaj pronarëve, mbart riskun e zgjatjes së periudhës së shlyerjes së tyre dhe të rritjes së nevojave për financim në vitet pasardhëse.

B.2.6 Shpenzimet për buxhetin vendor

Shpenzimet për buxhetin vendor në vitin 2025 janë realizuar në shumën 87,793 milionë lekë, me një rritje prej 13,386 milionë lekë, ose 18%, krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, rritja e nivelit të shpenzimeve nuk është shoqëruar me realizimin e plotë të fondeve të planifikuara, duke evidentuar diferenca ndërmjet programimit buxhetor dhe ekzekutimit faktik.

Me ligjin fillestar të buxhetit, shpenzimet janë planifikuar në shumën 89,911 milionë lekë, nga të cilat 43,137 milionë lekë, ose 48%, përfaqësonin transfertat nga buxheti i shtetit. Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, plani i shpenzimeve për buxhetin vendor është rritur në 90,911 milionë lekë, nga të cilat 44,611 milionë lekë, ose 49.1%, përfaqësojnë transfertat e planifikuara nga buxheti i shtetit. Megjithëse planifikimi i buxhetit vendor paraqitet i detajuar sipas burimeve të financimit, në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar shpenzimet faktike raportohen vetëm në nivel total.

Në milionë lekë


Nr.	Emërtimi	Fakti 2024	Projekt-buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Diferenca fakt-plan	Diferenca 2025-2024
	Shpenzime për buxhetin vendor	**74,407**	**89,861**	**89,911**	**89,911**	**89,911**	**89,911**	**90,911**	**87,793**	**-3,118**	**13,386**
1	Transfertat nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	—	43,087	43,137	43,137	43,137	43,137	44,611	—	—	—
1.1	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme	—	26,207	26,207	26,207	26,207	26,207	27,482	—	—	—
1.2	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant specifik)	—	13,180	13,230	13,230	13,230	13,230	13,429	—	—	—
1.3	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant performance)	—	200	200	200	200	200	200	—	—	—
1.4	Transfertë sektoriale për pagat	—	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500	—	—	—
2	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	—	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	40,774	—	—	—
3	Taksa të ndara	—	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	1,756	—	—	—
4	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)	—	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	—	—	—
5	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	—	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	770	—	—	—
6	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Nga rakordimi i të dhënave të planifikimit buxhetor rezulton se plani i paraqitur sipas Aktit Normativ nr. 11/2025, në shumën 90,911 milionë lekë, nuk pasqyron të gjitha ndryshimet e kryera gjatë vitit nëpërmjet vendimeve dhe rialokimeve të fondeve. Pas përfshirjes së këtyre ndryshimeve, plani përfundimtar rezulton në shumën 92,492 milionë lekë, ose 1,581 milionë lekë më shumë se niveli i paraqitur sipas aktit normativ. Kundrejt planit prej 90,911 milionë lekë, të miratuar me Aktin Normativ nr. 11/2025, shpenzimet faktike prej 87,793 milionë lekë përfaqësojnë një realizim prej 96.6%, me diferencë të parealizuar prej 3,118 milionë lekë. Ndërsa kundrejt planit përfundimtar së bashku me ndryshimet e tjera gjatë vitit prej 92,492 milionë lekë, niveli i realizimit zbret në 94.9%, me fonde të parealizuara prej 4,699 milionë lekë.

Nga auditimi rezultoi se, sipas të dhënave të Drejtorisë së Financave Vendore, shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025 janë 92,422 milionë lekë, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar raportohen 87,793 milionë lekë, me një diferencë prej 4,629 milionë lekë, e lidhur, me trajtimin e shpenzimeve për borxhin dhe eliminimet e tjera për qëllime të kontabilizimit dhe raportimit.

Në strukturën e shpenzimeve të raportuara nga Drejtoria e Financave Vendore, shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, në shumën 92,422 milionë lekë, përbëhen nga shpenzimet korrente prej 69,211 milionë lekë, ose 74.9% të totalit, dhe shpenzimet kapitale prej 23,211 milionë lekë, ose 25.1%. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet korrente janë rritur me 8,124 milionë lekë, ose 13.3%, ndërsa shpenzimet kapitale me 8,650 milionë lekë, ose 59.4%, duke evidentuar një rritje më të shpejtë të shpenzimeve për investime.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave.

Për vitin 2025, peshën më të madhe të shpenzimeve vendore, e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime në vlerën 40,077 milionë lekë ose 43.4% e totalit të shpenzimeve.

Nga analiza e shpërndarjes së shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore rezulton se 20 bashkitë e paraqitura në tabelë kanë realizuar së bashku rreth 75.8% të shpenzimeve totale të raportuara për vitin 2025. Bashkia Tiranë përfaqëson njësinë me nivelin më të lartë të shpenzimeve, në shumën 33,069 milionë lekë, ose 35.78% të totalit, e ndjekur nga bashkitë Durrës, Kamëz, Elbasan dhe Shkodër. Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet dhe peshën e këtyre bashkive në total për vitet 2024 dhe 2025.

Në milionë lekë

Nr.	Bashkia	2024	2025	Δ 25-24	Rritja (%)	Pesha 2025
1	**Tiranë**	**25,193**	**33,069**	**+7,876**	**+31.3%**	**35.78%**
2	Durrës	3,829	4,624	+795	+20.8%	5.00%
3	Kamëz	3,191	4,022	+831	+26.0%	4.35%
4	Elbasan	2,821	2,977	+156	+5.5%	3.22%
5	Shkodër	2,202	2,770	+568	+25.8%	3.00%
6	Vlorë	2,397	2,667	+270	+11.3%	2.89%
7	Fier	2,009	2,319	+310	+15.4%	2.51%
8	Korçë	1,970	2,011	+41	+2.1%	2.18%
9	Lezhë	1,684	1,784	+100	+5.9%	1.93%
10	Kavajë	1,347	1,525	+178	+13.2%	1.65%

Nr.	Bashkia	2024	2025	Δ 25-24	Rritja (%)	Pesha 2025
11	Berat	1,338	1,464	+126	+9.4%	1.58%
12	Pogradec	1,291	1,451	+160	+12.4%	1.57%
13	Lushnjë	1,344	1,435	+91	+6.8%	1.55%
14	Dibër	1,198	1,268	+70	+5.8%	1.37%
15	Sarandë	982	1,258	+276	+28.1%	1.36%
16	Himarë	498	1,159	+661	+132.7%	1.25%
17	Vorë	909	1,135	+226	+24.9%	1.23%
18	Kukës	881	1,056	+175	+19.9%	1.14%
19	Krujë	776	1,041	+265	+34.1%	1.13%
20	Gjirokastër	805	980	+175	+21.7%	1.06%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH
Ndryshimet janë llogaritur mbi vlerat e rrumbullakosura të paraqitura në tabelë.

Krahasuar me vitin 2024, të 20 bashkitë e analizuara kanë regjistruar rritje të shpenzimeve. Rritja më e madhe në vlerë absolute rezulton në Bashkinë Tiranë, me 7,876 milionë lekë, ose 31.3%, ndërsa rritja më e lartë relative rezulton në Bashkinë Himarë, me 132.8%, ose 661 milionë lekë.

B.2.7 Shpenzime të tjera

Gjatë vitit 2025, shpenzimet e kategorisë “Shpenzime të tjera” janë realizuar në shumën 29,046 milionë lekë, me një ulje prej 1,885 milionë lekë (6.1%) krahasuar me vitin 2024. Kjo ecuri është ndikuar kryesisht nga reduktimi i shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar, si dhe për bonusin e lindjeve, ndërsa shpenzimet për kompensimin financiar të ish-të përndjekurve politikë kanë shënuar rritje.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Plan fillestar	Plan final	Fakti 2025	Fakt – Plan	2025 – 2024
Pagesa e papunësisë	832	800	765	692	−72	−139
Ndihma ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar	26,841	23,700	24,918	25,471	+554	−1,369
Kompensimi për ish-të përndjekurit politikë	1,059	1,400	1,400	1,399	−1	341
Bonusi i lindjeve	2,200	2,250	2,250	1,482	−768	−718
Total	**30,931**	**28,150**	**29,332**	**29,046**	**−287**	**−1,885**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Peshën kryesore në këtë kategori e zë “Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia”, me një realizim prej 25,471.4 milionë lekë, ose 87.7% të totalit, duke tejkaluar planin përfundimtar me 554 milionë lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2024 rezulton një ulje prej 1,369 milionë lekë. Nga kjo shumë, 5,309.3 milionë lekë i përkasin skemës së ndihmës ekonomike dhe 18,603.9 milionë lekë skemës së pagesave të aftësisë së kufizuar, ndërsa 1,558.2 milionë lekë përfaqësojnë shpenzime të tjera të mbështetjes sociale.

Në milionë lekë

Skema	Fakti 2024	Plani 2025	Fakti 2025	Fakt – Plan	Realizimi	2025 – 2024
Ndihma ekonomike	5,763.98	5,392.22	5,309.27	−82.95	98.46%	−454.72
Pagesat e aftësisë së kufizuar	19,612.35	18,696.95	18,603.92	−93.02	99.50%	−1,008.43

SHSSH, përpunuar nga KLSH

Shpenzimet për *ndihmën ekonomike* janë realizuar në masën 98.46% të planit, me një ulje prej 454.72 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Numri i përfituesve është reduktuar nga 53,599 në 50,631, ose me 5.5%, duke rezultuar 11,369 përfitues më pak se treguesi i planifikuar.

Për *skemën e pagesave të aftësisë së kufizuar*, realizimi ka arritur në 99.5% të planit, me një ulje prej 1,008.43 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Numri i raportuar i përfituesve ka kaluar nga 164,104 në vitin 2024 në 76,586 në vitin 2025, por këta tregues nuk janë drejtpërdrejt të krahasueshëm, për shkak të transferimit pranë ISSH-së të kategorisë së invalidëve të punës dhe ndryshimeve në klasifikimin e kujdestarëve dhe ndihmësve personalë.

Gjatë vitit 2025 është akorduar gjithashtu *mbështetje financiare e fundvitit*, sipas VKM-së nr. 835, datë 30.12.2025, në shumën 2,227.50 milionë lekë, përkatësisht 738.26 milionë lekë për 49,217 përfitues të ndihmës ekonomike dhe 1,489.25 milionë lekë për 99,283 përfitues të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe kategorive të lidhura, në formën e një pagese të njëhershme prej 15,000 lekë.

Për zërat e tjerë, *bonusi i lindjeve* është realizuar në shumën 1,482 milionë lekë, ose 768 milionë lekë (34.1%) nën plan, me një ulje prej 718 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Ndërkohë, *kompensimi financiar i ish-të përndjekurve politikë* ka arritur në 1,399 milionë lekë, ose 99.9% të planit, duke shënuar një rritje prej 341 milionë lekë.

Përbërja dhe raportimi i zërit “Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia”

Nga auditimi ka rezultuar se, në shumën prej 25,471.4 milionë lekë të raportuar në treguesit fiskalë për zërin “Ndihma Ekonomike dhe Paaftësia”, përfshihen edhe 1,558.2 milionë lekë shpenzime që nuk përfaqësojnë pagesa të drejtpërdrejta të dy skemave. Konkretisht, këto përfshijnë 829.4 milionë lekë për mbështetjen e grave të papuna, 347.4 milionë lekë për Fondin Social, 380.1 milionë lekë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të MSHMS-së për PAK dhe 1.4 milionë lekë për transfertat ndaj individëve që dalin në pension.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti
Ndihma ekonomike	5 309,27
Personat me aftësi të kufizuara	18 603,92
Totali I	**23 913,19**
Gratë e papuna	829,35
Fondi Social	347,40
Vendime gjyqësore të MSHMS-së për PAK	380,10
Transferta për individë – SHSSH (punonjës që dalin në pension)	1,38
Totali II	**1 558,24**
Totali I + II	**25 471,43**

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, përpunuar nga KLSH.

Problematikat e konstatuara në Shërbimin Social Shtetëror

Nga auditimi i administrimit të fondeve nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) kanë rezultuar mangësi në planifikimin dhe administrimin e skemave të ndihmës ekonomike (NE) dhe pagesave të aftësisë së kufizuar (PAK). Konkretisht, udhëzimet dhe procedurat e planifikimit nuk ishin përditësuar plotësisht në përputhje me ndryshimet rregullatore dhe kategoritë e përfituesve, ndërsa mospërputhjet kohore ndërmjet përditësimit të të dhënave, përllogaritjes së nevojave dhe çeljes së fondeve kanë ndikuar në saktësinë e planifikimit financiar.

Moszbatimi i mekanizmit të indeksimit të ndihmës ekonomike. Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës 2023–2025 mbështetja financiare shtesë është realizuar kryesisht nëpërmjet pagesave

të njëhershme, pa rezultuar zbatimi i mekanizmit të indeksimit të parashikuar në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019. Ndryshe nga indeksimi i përfitimit mujor, këto pagesa nuk sigurojnë rritje të qëndrueshme të mbështetjes financiare, duke krijuar risk për uljen e vlerës reale të ndihmës ekonomike në kushtet e rritjes së çmimeve.
Në administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, janë konstatuar mangësi në kontrollin e përmbushjes dhe vijueshmërisë së kritereve ligjore të përfitimit, verifikimin e tërheqjes së pagesave, dhe respektimin e afateve të penalizimit për deklarime të rreme.
Në administrimin e skemave të aftësisë së kufizuar, janë konstatuar mangësi në monitorimin e komisioneve të vlerësimit, tejkalime të afateve të shqyrtimit të kërkesave dhe ankimeve, si dhe mangësi në kuadrin nënligjor dhe mekanizmat referues, të cilat kanë ndikuar në aksesin në kohë të individëve në përfitimet përkatëse.
Në shërbimet e kujdesit shoqëror, janë evidentuar mangësi në monitorimin dhe respektimin e standardeve të shërbimit, përfshirë mungesën e metodologjisë së monitorimit, funksionimin pa licencë të 12 nga 29 institucioneve në varësi ose bashkëvarësi të SHSSH-së, si dhe praninë e rezidentëve mbi moshën e përcaktuar në Qendrat e Zhvillimit.

Transferime kapitale të cilat për vitin 2024 ishin raportuar si zë më vete në shumën 550 milionë lekë, nuk janë paraqitur në të njëjtën mënyrë në raportimin për vitin 2025, por janë përfshirë në kategorinë e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm. Nga auditimi rezultoi se ndryshimi i grupeve të raportimit të shpenzimeve nuk mundëson krahasimin e informacionit financiar të publikuar dhe nuk ruan konsistencën në treguesit e realizimit të buxhetit.

B.3. Fonde të tjera të pashpërndara

Fondet e tjera të pashpërndara në buxhetin e vitit 2025 përfshijnë fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, rezervën për përballimin e shpenzimeve të zgjedhjeve dhe fondin e parashikuar për financimin e reformave dhe masave të Planit të Rritjes me Bashkimin Evropian. Plani përfundimtar i kësaj kategorie rezulton në shumën 5,400 milionë lekë, nga të cilat 2,900 milionë lekë për fondin rezervë dhe 2,500 milionë lekë për rezervën për zgjedhjet. Fondi për reformat dhe masat e Planit të Rritjes me BE është riklasifikuar gjatë vitit në kategorinë e shpenzimeve kapitale, duke ndryshuar strukturën e planit të fondeve të pashpërndara krahasuar me buxhetin fillestar. Ecuria e planit të këtyre fondeve, nga projektbuxheti deri në ndryshimin e fundit buxhetor, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Emërtimi	Projektbuxheti	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025
Fond rezervë	2,700	3,000	4,200	4,200	2,900	2,900
Rezervë për zgjedhjet	2,000	2,500	2,500	2,500	2,500	2,500
Rezervë për reformat/masat e Planit të Rritjes me BE	1,200	1,200	-	-	-	-
Total	**5,900**	**6,700**	**6,700**	**6,700**	**5,400**	**5,400**

Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

B.3.1 Fondi rezervë

Nga auditimi rezultoi se, nga plani përfundimtar prej 2,900 milionë lekë, është miratuar përdorimi i 2,430 milionë lekëve nëpërmjet 12 vendimeve të Këshillit të Ministrave, ose 83.8% e planit. Sipas natyrës së shpenzimeve, 2,005 milionë lekë, ose 82.5% e shumës së miratuar, janë akorduar për shpenzime operative dhe transferta të brendshme, 326.4 milionë lekë për shpenzime personeli dhe 98.6 milionë lekë për shpenzime kapitale.
Nga auditimi i përdorimit të fondit rezervë gjatë vitit 2025 janë evidentuar raste të financimit të veprimtarive dhe detyrimeve, natyra dhe koha e realizimit të të cilave tregojnë se nevojat përkatëse mund të ishin identifikuar gjatë procesit të planifikimit buxhetor. Në këto raste, përdorimi i fondit rezervë nuk rezulton të jetë mbështetur në dokumentimin e plotë të kushtit të paparashikueshmërisë dhe të kritereve të përcaktuara në nenin 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si më poshtë:
▸ 50 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet VKM-së nr. 821, datë 30.12.2025 *"Për një shtesë në vendimin nr. 684, datë 06.11.2024, të Këshillit të*

Ministrave "Për krijimin e shoqërisë aksionare Enti Kombëtar i Operimit Rrugor sh.a" në artikullin 232 në projektin "Rritje të kapitalit të EKORR sh.a për mbulimin e veprimtarisë operacionale".

‣ 400 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve nëpërmjet VKM nr. 147, datë 06.03.2025 *"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për financimin e këstit të dytë të kontratës për realizimin e tre tureve të para të Giro D'Italia 2025 në RSH.*

‣ 150 milionë lekë janë akorduar për Ministrinë e Drejtësisë nëpërmjet VKM nr. 66, datë 29.01.2025 *"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për organizimin e Kongresit të së Drejtës 2027, në Tiranë".*

‣ 31.75 milionë lekë janë akorduar me VKM nr. 556, datë 01.10.2025 *"Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Forumit të Investimeve midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 13-14 tetor 2025"*.

‣ 150 milionë lekë janë akorduar për subjektet zgjedhore pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend nëpërmjet VKM-së nr. 199, datë 04.04.2025 *"Për një shtesë fondi në programin "mbështetje për partitë politikë", për financimin e fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrës në zgjedhjet për kuvend të datës 11 maj 2025".*

Financimi nëpërmjet fondit rezervë kufizon funksionin e tij si instrument për përballimin e shpenzimeve të paparashikuara gjatë vitit buxhetor.

B.3.2 Fondi rezervë "Për zgjedhjet"

Nga auditimi i planifikimit dhe përdorimit të fondeve për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 rezultoi se, në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr. 115, datë 03.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025", është parashikuar një fond i posaçëm prej 2,500 milionë lekë për përballimin e shpenzimeve zgjedhore, si dhe mundësia e financimit të kostove shtesë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Parashikimi në ligjin vjetor të buxhetit për mbulimin e kostove shtesë të zgjedhjeve nga fondi rezervë nuk rezulton në përputhje me kriteret e përdorimit të këtij fondi, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Nevojat financiare për organizimin e tyre duhej të ishin objekt i një planifikimi të plotë dhe të argumentuar. Me VKM-në nr. 47, datë 22.01.2025, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej 2,500 milionë lekë. Gjithashtu, me VKM-në nr. 152, datë 06.03.2025, është miratuar një financim shtesë prej 927.2 milionë lekë nga fondi rezervë, duke e çuar shumën e përgjithshme të fondeve të akorduara në 3,427.2 milionë lekë, ose 37.1% mbi nivelin e planifikuar fillimisht.

B.3.3 Fondi rezerve për reformat/masat e Planit të Rritjes me BE

Nga auditimi i planifikimit dhe administrimit të fondeve të parashikuara për reformat dhe masat e Planit të Rritjes me Bashkimin Evropian rezultoi se në buxhetin fillestar të vitit 2025, ishte parashikuar një fond rezervë prej 1,200 milionë lekë, i destinuar për mbulimin e kontributit të shtetit shqiptar në financimin e projekteve të investimit në kuadër të këtij plani. Gjatë vitit buxhetor, fondi është riklasifikuar në kategorinë e shpenzimeve kapitale, por rezultoi se nuk është vijuar me detajimin e tij në projekte konkrete investimi dhe, për rrjedhojë, fondet përkatëse nuk kanë pasur realizim gjatë vitit 2025.

B.4. Shpenzime kapitale

Shpenzimet kapitale për vitin 2025 janë realizuar në shumën 131,578 milionë lekë, me një rritje prej 16,145 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Kundrejt planit përfundimtar prej 157,028 milionë lekë, realizimi është 83.8%, duke rezultuar 25,450 milionë lekë nën nivelin e planifikuar.Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e planit dhe realizimin e shpenzimeve kapitale sipas zërave përbërës, si dhe diferencat ndaj planit përfundimtar dhe realizimit të vitit 2024.

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2024	Projekt-buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Fakt – plan	2025 – 2024
	Shpenzime kapitale	**115,433**	**161,837**	**162,374**	**163,374**	**158,867**	**164,138**	**157,028**	**131,578**	**−25,450**	**16,145**
1	Financimi i brendshëm	88,903	112,274	112,811	113,811	109,304	117,274	114,206	107,258	−6,948	18,356
1.1	Transferta kapitale të tjera	—	—	—	—	—	—	—	1,169	+1,169	1,169
1.2	Transfertë kapitale për AIC	—	—	—	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	0	1,000
1.3	Transfertë kapitale për Albcontrol	—	—	—	—	—	3,000	7,000	7,000	0	7,000
2	Investime nga të ardhurat e arsimit të lartë	832	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000	865	−135	33
3	Financimi i huaj	17,427	43,563	43,563	43,563	43,563	38,100	36,122	20,297	−15,825	2,871
3.1	Nga të cilat: energjia	—	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	—	−2,000	—
3.2	Nga të cilat: Plani I Rritjes me BE	—	4,463	4,463	4,463	4,463	—	—	—	—	—
4	Plani I Rritjes me BE	—	—	—	—	—	2,764	700	—	−700	—
5	Fondi i rindërtimit	8,271	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	3,157	−1,843	−5,115


Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Në planin përfundimtar të shpenzimeve kapitale janë parashikuar 114,206 milionë lekë (1,932 milionë lekë më shumë se plani fillestar në projektbuxhet) investime me burim financimi të brendshëm, 1,000 milionë lekë investime nga të ardhurat e arsimit të lartë dhe 36,122 milionë lekë (7,441 milionë lekë më pak se plani fillestar) investime me burim financimi të huaj. Në zërin e investimeve është përfshirë gjithashtu plani i rritjes me BE në shumën 700 milionë lekë dhe fondi i rindërtimit në shumën 5,000 milionë lekë (pa ndryshuar nga plani fillestar). Në treguesin e investimeve me financim të brendshëm janë përfshirë edhe transferta kapitale për agjenci dhe ndërmarrje publike me kapital shtetëror në shumën 9,169 milionë lekë, nga të cilat 7,000 milionë lekë për Albcontrol, 1,000 milionë lekë për Korporatën e Investimeve Shqiptare (AIC) dhe 1,169 milionë lekë transferta të tjera kapitale. Krahasuar me vitin 2024, kur këto transferta janë raportuar në shumën 550 milionë lekë, rezulton një rritje prej 8,619 milionë lekë, ose rreth 16.7 herë. Përfshirja e këtyre transfertave në treguesin e investimeve me financim të brendshëm ndikon në krahasueshmërinë ndërmjet viteve dhe mbivlerëson investimet e raportuara si të tilla, duke qenë se fondet nuk përfaqësojnë drejtpërdrejt krijimin e aktiveve kapitale nga njësitë buxhetore.

Këto transferta të kryera në pjesën më të madhe në agjenci dhe ndërmarrje publike me kapital shtetëror mbartin problematika edhe mbi plotësinë e raportimit fiskal, për shkak të operimit të tyre jashtë strukturës tradicionale të njësive buxhetore, duke mos siguruar informacion të plotë mbi përdorimin përfundimtar të fondeve, aktivet e krijuara dhe angazhimet financiare të ndërmarra nga subjektet përfituese.

Plani i shpenzimeve kapitale është rishikuar disa herë gjatë vitit. Me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025, ai është ulur nga 164,138 milionë lekë në 157,028 milionë lekë. Megjithëse ky rishikim është kryer pranë mbylljes së vitit buxhetor, realizimi ka mbetur 25,450 milionë lekë nën planin përfundimtar. Diferenca ndaj planit përfundimtar është përqendruar kryesisht te financimi i huaj, me 15,825 milionë lekë, ose rreth 62.2% të mosrealizimit të përgjithshëm, dhe te financimi i brendshëm, me 6,948 milionë lekë. Diferencat e tjera lidhen me fondin e rindërtimit, me 1,843 milionë lekë, Planin e Rritjes me BE, me 700 milionë lekë, dhe investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë, me rreth 135 milionë lekë.

B.4.1 Investimet me financim të brendshëm




Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për vitin 2025 janë realizuar në shumën 107,258 milionë lekë, ose 93.9% të planit përfundimtar prej 114,206 milionë lekë, duke rezultuar 6,948 milionë lekë nën nivelin e planifikuar. Krahasuar me vitin 2024, realizimi është rritur me 18,356 milionë lekë.


Planifikimi dhe ndryshimet buxhetore

Me ligjin nr. 115/2024, datë 03.12.2024, "Për buxhetin e vitit 2025", financimi i brendshëm i shpenzimeve kapitale është miratuar në shumën 112,811 milionë lekë, ose rreth 537 milionë lekë mbi projektbuxhetin. Pas miratimit të buxhetit, Ministria e Financave, mbi bazën e kërkesave të institucioneve, ka kryer detajimin e fondeve për investime, i cili ka vijuar deri në muajin mars 2025.


Me aktin normativ nr. 3, datë 29.04.2025, është parashikuar financimi i projektit me kod 24AD901 “Machine Thinking Lab”, në shumën 1,000 milionë lekë. Me aktin normativ nr. 6, datë 11.06.2025, janë kryer rialokime të fondeve në ulje në shumën rreth 4,507 milionë lekë. Këto rialokime përfshijnë shtesa dhe pakësime bruto ndërmjet projekteve të ndryshme në programe të ndryshme të buxhetit të miratuar për ministritë e linjës. Shtesat kryesore paraqiten në figurën në vijim.



Me aktin normativ nr. 10, datë 08.10.2025, plani është rritur me 7,970 milionë lekë, duke arritur në 117,274 milionë lekë. Institucionet dhe projektet me shtesat më të mëdha paraqiten:



Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, plani i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm është ulur me 3,068 milionë lekë, në nivelin përfundimtar prej 114,206 milionë lekë. Megjithëse rishikimi është kryer pranë mbylljes së vitit, realizimi paraqitet 107,258 milionë lekë, ose 93.9% të planit, duke lënë 6,948 milionë lekë të parealizuara. Lista e institucioneve për të cilat kanë ndryshuar fondet për financimin e brendshëm në muajin dhjetor paraqitet në tabelën e mëposhtme:



Mangësitë në planifikimin dhe detajimin e investimeve: Nga auditimi është konstatuar se 32 kontrata në vazhdim nga vitet e mëparshme nuk kanë pasur fonde të çelura me buxhetin fillestar, por janë financuar nëpërmjet rishikimeve buxhetore gjatë vitit, në mos përputhje me pikën 26 të Udhëzimit nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”.

Në muajin janar janë çelur tre kode investimi, me vlerë të përgjithshme 5,256.2 milionë lekë, të cilat nuk janë shoqëruar me detajimin në projekte konkrete:

- M170203 “Fondi i ngrirë”, me 2,309.43 milionë lekë;

▸ M560009 “Projekte investimi”, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me 1,446.77 milionë lekë;
▸ 18AZ901 “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara”, në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes, me 1,500 milionë lekë.
Fondet janë planifikuar dhe administruar përmes kodeve me karakter të përgjithshëm, pa identifikuar projektet individuale, duke kufizuar mundësinë për të identifikuar investimet konkrete që do të financohen dhe lidhjen e tyre me objektivat e programeve buxhetore.

Nga auditimi janë konstatuar mangësi në përfshirjen e projekteve në planifikimin afatmesëm, detajimin e fondeve gjatë vitit, prokurimeve dhe angazhimeve, si dhe financimin me ecurinë e zbatimit, sipas tipologjive:

2025 | Në milionë lekë

Fusha	Problematika	Raste / projekte	Vlera
Planifikimi	Jashtë PBA-së 2025–2027	**17**	**2,445**
Rishikimet	Projekte të mbyllura në dhjetor	**368**	**36,331**
	Projekte pa realizim në fundvit	**188**	**3,588**
	Detajime për herë të parë në shtator–dhjetor	**69**	**6,855**
Angazhimet	Prokurime mbi financimin në dispozicion	**44**	**16,835**
	Angazhime pa fonde buxhetore	**39**	**4,281**
	Planifikim i papërputhur me koston dhe afatet	**39**	**6,461**
	Mosrespektim i shpërndarjes 20%–30%–30%	**5**	**10,694**
	Reduktim fondesh për prokurimet e shtator–dhjetorit	**8**	**3,400**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Projekte jashtë planifikimit afatmesëm dhe ciklit të investimeve

▸ Janë evidentuar 17 projekte, me vlerë kontratash 2,445 milionë lekë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e PBA-së 2025–2027, por janë detajuar gjatë vitit me akte normative, pa ndjekjen e plotë të procedurave të menaxhimit të investimeve publike dhe pa dokumentacion ose përshkrim të plotë të projektit.
▸ Me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, i janë shtuar 520 milionë lekë për blerjen e selisë së misionit diplomatik të Shqipërisë në Londër, pa ndjekur ciklin e përcaktuar në aneksin nr. 1 të VKM nr. 887, datë 27.12.2022, të ndryshuar.

Rishikimet/rialokimet e fondeve buxhetore

▸ Në muajin dhjetor janë mbyllur 368[7] projekte, me vlerë 36,331 milionë lekë, të detajuara gjatë periudhës janar–tetor. Në 9 raste, me vlerë 541 milionë lekë, projektet kanë qëndruar të hapura për një deri në tre muaj.
▸ Në fund të vitit janë evidentuar 188 projekte, me fonde të planifikuara në shumën 3,588 milionë lekë, për të cilat nuk rezultojnë shpenzime të kryera, duke evidentuar mangësi në përshtatjen e planit përfundimtar me mundësitë faktike të realizimit të projekteve deri në mbyllje të vitit buxhetor.
▸ Në periudhën shtator–dhjetor 2025 janë detajuar për herë të parë 69 projekte investimi, me fonde në shumën 6,855 milionë lekë. Për një pjesë të tyre, vlera e fondeve të detajuara ka qenë e barabartë me realizimin e raportuar. Nga këto, me aktin normativ nr. 11 janë detajuar për herë të parë 16 projekte, me fonde në shumën 839 milionë lekë, për të cilat është raportuar realizim prej 679 milionë lekë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga vitet e mëparshme.

Angazhimet dhe planifikimi i financimit shumëvjecar

▸ Nga krahasimi i fondeve në dispozicion me fondet limit të procedurave të prokurimit janë evidentuar 44 raste me vlerë të kontraktuar 16,835 milionë lekë, në të cilat autoritetet kontraktore kanë iniciuar procedura për vlera më të larta se financimi në dispozicion sipas shpërndarjes trevjeçare të buxhetit të miratuar.
▸ Gjithashtu, për 39 projekte janë marrë angazhime më pak se fondet në dispozicion në shumën 4,281 milionë lekë, në mos përputhje me nenin 50 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
▸ Në 39 raste është konstatuar mospërputhje ndërmjet planifikimit buxhetor, kostos totale dhe periudhës së zbatimit të projekteve. Fondet e përfshira në buxhetin fillestar të vitit 2025 rezultonin

[7] Plani buxhetor është zeruar

më të ulëta se kostoja totale e projekteve të paraqitur në dokumentacionin e projektbuxhetit, ndërsa shpërndarja e financimit sipas viteve nuk ishte harmonizuar me afatet e planifikuara të fillimit dhe përfundimit të tyre.

▸ Në 5 raste, me vlerë të kontraktuar 10,694 milionë lekë, është konstatuar se shpërndarja e financimit sipas viteve nuk ishte kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM-në nr. 887, datë 27.12.2022, të ndryshuar, lidhur me planifikimin e fondeve në raport me koston totale të projekteve. Mospërputhjet janë evidentuar që në fazën e përfshirjes së projekteve në listën e investimeve publike të projektbuxhetit dhe në detajimin fillestar të fondeve.

▸ Në 4 raste me vlerë të kontraktuar 10,374 milionë lekë, pas lidhjes së kontratave, fondet e planifikuara për këto projekte janë pakësuar dhe rialokuar për financimin e projekteve të tjera, duke ndryshuar mbulimin buxhetor mbi të cilin ishin marrë angazhimet kontraktuale. Kjo ka cenuar vazhdimësinë e financimit të parashikuar. Detajimi fillestar në masën 20%, i ndjekur nga pakësimi pas kontraktimit, rezulton si planifikim i orientuar drejt lidhjes së kontratës dhe jo sigurimit të financimit gjatë zbatimit.

▸ Në 8 raste, me vlerë kontratash 3,400 milionë lekë, në të cilat fondet e planifikuara janë reduktuar me akt normativ, ndërkohë që procedurat e prokurimit për projektet përkatëse janë zhvilluar gjatë periudhës shtator–dhjetor 2025.

▸ Gjithashtu janë evidentuar edhe 343 raste të projekteve në vlerën 13,524 milionë lekë, ku kontrata për investime është nënshkruar përtej afatit ligjor për marrjen e angazhimeve. Hapja e projekteve dhe zhvillimi i prokurimeve pranë mbylljes së vitit kanë kufizuar mundësinë e realizimit të financimit të parashikuar për vitin e parë dhe kanë mbartur nevoja për financim në vitet pasuese.

Institucionet më problematike për këto gjetje përfshijnë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Bujqësisë.

Afatet e marrjes së angazhimeve buxhetore: Kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullon marrjen e angazhimeve buxhetore dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, nuk rezulton i harmonizuar në raport me kufizimet e përcaktuara në ligjin organik të buxhetit, ku përcaktohet se angazhimet e reja buxhetore mund të ndërmerren jo më vonë se data 15 tetor, dhe ky angazhim përkufizohet si marrja përsipër të detyrimeve financiare, në formë të shkruar, nëpërmjet hyrjes në marrëdhënie kontraktuale. Aktet nënligjore parashikojnë mundësinë e fillimit ose vijimit të procedurave të prokurimit pas datës 15 tetor për projekte të përfshira në buxhetin trevjeçar, duke kushtëzuar lidhjen e kontratës me vënien në dispozicion të fondeve në buxhetin e vitit pasardhës, ndërkohë, neni 11, pika 4, i ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, parashikon mundësinë e fillimit të procedurave të prokurimit që në muajin shtator të vitit korrent, për fondet e akorduara/regjistruara në sistemin e thesarit për vitin 2026 e në vijim, duke përcaktuar si kusht që kontrata të bëhet efektive vetëm pas miratimit të ligjit të buxhetit përkatës. Në këtë kuadër, megjithëse fillimi apo vijimi i procedurave të prokurimit nuk përbën në vetvete marrjen e një angazhimi buxhetor, lidhja e kontratës mund të shoqërohet me marrjen përsipër të detyrimeve financiare, jo në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin organik.

Klasifikimi dhe raportimi i shpenzimeve: Në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 6210 “Programe zhvillimi”, sipas të dhënave të SIFQ-së, është raportuar si investim i realizuar 1,076 milionë lekë kosto lokale e menaxhimit të projekteve. Këto fonde përdoren nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit përmes llogarive bankare të nivelit të dytë për mbulimin e shpenzimeve korrente të institucionit për menaxhimin e projekteve.

Në AZHBR, në programin 4250 “Zhvillimi rural”, janë raportuar investime kapitale në shumën 202 milionë lekë për projektin 18AL301 “Përfitues nga Programi IPARD II nga masa 1”, në kapitullin 3 “Kosto lokale”.Nga shqyrtimi i natyrës së financimit rezulton se këto fonde përfaqësojnë kontributin e bashkëfinancimit kombëtar, në kuadër të mbështetjes së ofruar së bashku me fondet e Bashkimit Evropian për investime të realizuara nga përfituesit e programit, përfshirë fermerë dhe subjekte të agroturizmit.

Dokumentimi dhe miratimi i parapagimeve: Nga auditimi i dokumentacionit të administruar për parapagimet e kryera në kuadër të projekteve të investimit me kod 18AZ231 “Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore”, 18AZ238 “Blerje dronësh” dhe 18AZ239 “Ndërtimi i sistemit

antidron", në shumën e përgjithshme prej 1,154 milionë lekë, u konstatua se nuk është evidentuar dokumentacioni justifikues dhe argumentimi për trajtimin e këtyre parapagimeve si raste me rëndësi të veçantë, në përputhje me kërkesat e pikave 160 dhe 161 të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ndryshuar. Gjithashtu, për parapagimet në shumën 841.7 milionë lekë, të kryera për projektet "Blerje dronësh" dhe "Ndërtimi i sistemit antidron", në dokumentacionin e administruar nuk është evidentuar miratimi paraprak nga Ministri i Financave, sikurse në rastin e parapagimit të kryer për projektin "Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore" (i cili megjithatë konstatohet se është dhënë pas lidhjes së kontratës). Nga ana tjetër, këto parapagime të kryera pa miratimin e Ministrit të Financave rezultojnë të jenë dhënë në masën 20% të vlerës së kontratës, në kundërshtim me kufirin maksimal prej 10% të vendosur sipas Udhëzimit Standard të Zbatimit të Buxhetit. Procesimi I transaksioneve në sistemin e thesarit nuk është kryer nëpërmjet ngurtësimit në llogari, por duke përdorur fondet e shpenzimeve kapitale dhe është raportuar si investim kapital, ndërkohë që nuk përmbushen kushtet për regjistrimin si shpenzim. Administrimi i fondeve buxhetore në fushën e mbrojtjes paraqitet me problematika edhe në drejtim të disponueshmërisë së fondeve përpara marrjes së angazhimeve buxhetore si dhe procesimit të pagesës pa regjistruar kontratën në Sistemin Informatik Financar të Qeverisë. Konkretisht, për investimin me kod 18AZ230 "Ngritja e shkollës së aviacionit Vlorë" konstatohet se nuk ka kontratë të regjistruar në SIFQ, në kundërshtim me nenin 157 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të Udhëzimit të Buxhetit", për të cilin është kryer pagesa e shumës 9.2 milionë Euro në kundravleftën 901.6 milionë lekë me urdhërues Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Nga auditimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon kryerjen e shpenzimeve buxhetore, u evidentuan problematika në lidhje me lejimin e paradhënieve dhe njohjen e shpenzimeve, pasi kryerja e pagesës për paradhënie nuk vërteton në vetvete realizimin e punimeve apo përmbushjen e detyrimeve kontraktore përkatëse dhe dokumentacioni që justifikon kryerjen e paradhënies është i ndryshëm nga ai që vërteton realizimin faktik të punimeve, çka kërkon një trajtim të dallueshëm të pagesës paraprake nga shpenzimi i njohur mbi bazën e realizimit të detyrimit kontraktor. Neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton verifikimin e shpenzimeve mbi bazën e dokumentacionit të plotë që vërteton kryerjen e tyre, ndërsa neni 61 parashikon njohjen e shpenzimeve në çastin e ndodhjes, pavarësisht datës së pagesës. Ndërkohë, pika 161 e udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, lejon kryerjen e parapagimeve, deri në masën 10% të vlerës së kontratës, vetëm në rastet kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor ose nënligjor përkatës.

Në tërësi, auditimi i planifikimit dhe realizimit të investimeve publike me financim të brendshëm evidentoi mangësi në përfshirjen e projekteve në planifikimin buxhetor afatmesëm, në detajimin dhe rialokimin e fondeve gjatë vitit, në respektimin e kufijve të angazhimeve dhe në sigurimin e përputhshmërisë ndërmjet financimit shumëvjeçar dhe detyrimeve kontraktuale. Në veçanti, inicimi i procedurave të prokurimit përtej financimit të miratuar, marrja e angazhimeve pa mbulim buxhetor, pakësimi i fondeve pas lidhjes së kontratave dhe përfshirja e projekteve të reja në periudhën e fundit të vitit evidentojnë dobësi në koordinimin ndërmjet planifikimit, prokurimit dhe zbatimit të investimeve. Këto praktika kanë kufizuar parashikueshmërinë e financimit të projekteve dhe kanë rritur riskun e shtyrjes së pagesave dhe krijimit të detyrimeve të papaguara. Gjithashtu, nuk janë në përputhje me kufijtë e miratuar për shpenzimet dhe angazhimet dhe me kërkesat përkatëse të neneve 40–51 të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

B.4.2 Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë

Në treguesit e shpenzimeve kapitale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2025 janë përfshirë edhe investimet e financuara nga të ardhurat e veta të institucioneve të arsimit të lartë. Për këtë kategori shpenzimesh, plani fillestar është përcaktuar në shumën 1,000 milionë lekë dhe ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit, pavarësisht ndryshimeve të buxhetit me akte normative. Ky nivel planifikimi rezulton rreth 20% më i lartë se realizimi i vitit 2024. Sipas treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, shpenzimet faktike për vitin 2025 rezultuan 865 milionë lekë, ose 86.5% e planit, duke evidentuar një mosrealizim prej 135 milionë lekë, ekuivalent me 13.5% të fondeve të planifikuara.

B.4.3 Investimet me financim të huaj

Shpenzimet kapitale me financim të huaj për vitin 2025 janë realizuar në shumën 20,297 milionë lekë, duke rezultuar 15,825 milionë lekë nën planin buxhetor përfundimtar prej 36,122 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, realizimi është rritur me 2,870 milionë lekë. Në planifikimin e shpenzimeve kapitale me financim të huaj është përfshirë edhe financimi i energjisë në shumën 2,000 milionë lekë (pa ndryshuar nga plani fillestar) dhe planit të rritjes me BE në shumën 4,463 milionë lekë sipas planit të ndryshuar me aktin normativ nr.6/2025. Në tabelën e treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar, financimi i Planit të Rritjes me BE është paraqitur si zë i veçantë brenda shpenzimeve kapitale, i ndarë nga investimet me financim të huaj. Plani përfundimtar për këtë zë është përcaktuar në shumën 700 milionë lekë, pas rishikimeve në ulje të parashikimeve fillestare, ndërsa gjatë vitit 2025 nuk rezultojnë shpenzime të realizuara, për shkak të mungesës së disbursimeve për projekte investimi në kuadër të këtij plani. Ndërkohë, shpenzimet kapitale për sektorin e energjisë me financim të huaj janë përfshirë në totalin e investimeve me financim të huaj, pa u paraqitur veçmas si nënkomponent i tyre.

Për 25 projekte me financim të huaj është raportuar realizim në shumën 150 milionë lekë pa plan buxhetor, edhe pas ndryshimeve të miratuara me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025. Gjithashtu, për 67 projekte, realizimi ka tejkaluar planin e miratuar me 1,070 milionë lekë. Realizimi i shpenzimeve pa plan buxhetor ose në tejkalim të tij, si dhe mosmarrja e masave për sistemimin e këtyre diferencave nëpërmjet rialokimeve ose rishikimeve buxhetore gjatë vitit, është vlerësuar si jo në përputhje me pikën 31 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”.

Klasifikimi dhe regjistrimi i shpenzimeve: Nga auditimi rezultoi se 677 milionë lekë janë klasifikuar si shpenzime kapitale me financim të huaj, ndonëse për nga natyra përfaqësojnë shpenzime korrente për paga, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe shpenzime operative. Nga kjo shumë, 615 milionë lekë janë financuar nga grantet dhe 62 milionë lekë nga kreditë. Ky klasifikim ka sjellë mbivlerësimin e shpenzimeve kapitale dhe nënvlerësimin e atyre korrente.

Rakordimi i të dhënave të financimit të huaj: Nga auditimi rezultuan diferenca prej 394 milionë lekë ndërmjet të dhënave të strukturës përgjegjëse për borxhin dhe atyre të thesarit për investimet me financim të huaj. Megjithëse është kryer akt-rakordimi ndërmjet dy strukturave, ai është realizuar në monedhën origjinale, pa siguruar përputhjen e vlerave të raportuara në lekë. Diferencat lidhen me përdorimin e kurseve të ndryshme të këmbimit dhe trajtimin e komisioneve të disbursimit.

Në auditimet e zhvilluara nga KLSH në njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar problematika në administrimin e financimeve të huaja dhe donacioneve:

Nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në dokumentimin e marrjes në dorëzim, regjistrimin kontabël, administrimin dhe përdorimin e aktiveve të përfituara nga financimet e huaja dhe donacionet, si dhe në ndjekjen e detyrimeve financiare dhe realizimin e projekteve të financuara nga burime të jashtme. Mungesa e informacionit të konsoliduar në nivel të administratës shtetërore mbi donacionet, si dhe e një pasqyrimi të plotë të aktiveve të përfituara në raportimin financiar të konsoliduar, kufizon mundësinë e evidentimit dhe ndjekjes së tyre gjatë gjithë ciklit të administrimit, nga marrja në dorëzim dhe regjistrimi kontabël, deri te ruajtja, mirëmbajtja dhe vënia në funksion sipas qëllimit për të cilin janë përfituar. Kjo situatë ndikon edhe në cilësinë e planifikimit të nevojave dhe alokimit të fondeve publike, pasi mungesa e informacionit mbi llojin, sasinë, gjendjen dhe shpërndarjen e këtyre aktiveve ndërmjet institucioneve kufizon mundësinë e vlerësimit të kapaciteteve ekzistuese përpara planifikimit të investimeve dhe prokurimeve të reja. Për rrjedhojë, krijohet risku i angazhimit të fondeve publike për sigurimin e aktiveve të reja, pa u shqyrtuar paraprakisht mundësia e shfrytëzimit ose rishpërndarjes së atyre që disponohen nga institucione të tjera.

Konkretisht, *sistemi elektronik “Doculive*”, i zhvilluar me mbështetjen e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) për administrimin dhe trajtimin e ankesave, ishte vënë në përdorim pa përfunduar marrjen në dorëzim, pa dokumentacionin për përcaktimin e vlerës financiare dhe pa u regjistruar si aktiv në pasqyrat financiare të vitit 2025. Ndërkohë, për mirëmbajtjen e tij ishin angazhuar fonde buxhetore. Mangësi janë evidentuar edhe në

administrimin e një sistemi elektronik për menaxhimin e rasteve të ankesave, të përfituar nëpërmjet një donacioni me vlerë 1.2 milionë USD, për të cilin regjistrimi i hyrjes së aktivit në magazinë ishte kryer me mbi pesë muaj vonesë, ndërsa dokumentacioni për instalimin, testimin, kolaudimin dhe shërbimet e mirëmbajtjes rezultonte i paplotë.
Në *strukturat e shërbimeve terapeutike dhe rehabilituese për fëmijët* është konstatuar se një pajisje për depistimin dhe diagnostikimin e hershëm të dëgjimit, e siguruar nëpërmjet një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian, kishte qëndruar e magazinuar për rreth gjashtë vite pa u vënë në funksion, ndërkohë që nuk ishte regjistruar në kohë në inventar dhe mungonin aktet e marrjes në administrim, dorëzimit në përdorim dhe caktimit të personit përgjegjës.
Problematika janë konstatuar edhe në administrimin e detyrimeve nga financimet e huaja, ku për dy kredi të marra nga Banka Evropiane e Investimeve dhe KfW, me vlerë fillestare gjithsej 29.5 milionë euro, nuk ishte shlyer asnjë këst i principalit dhe interesave. Deri më 30.09.2025, interesat dhe principali i akumuluar dhe i papaguar rezultonte 4.47 milionë euro, nga të cilat 1.28 milionë euro i përkisnin periudhës 2023–2025, ndërsa pagesat ishin përballuar nga Ministria e Financave. Gjithashtu, në kuadër të programit INTERREG IPA CBC 2021–2027 Shqipëri–Greqi, ishin miratuar bashkëfinancime për dy projekte në vlerën 20.55 milionë lekë, pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

B.4.4 Plani i Rritjes me BE

Në kuadër të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Shqipërinë është parashikuar një financim prej 228.47 milionë euro për financim projektesh, për të cilin nuk janë realizuar disbursime, për shkak të mosfinalizimit të marrëveshjeve të kontributit me menaxherët e fondeve, Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD).

B.4.5 Fondi i rindërtimit

Shpenzimet e fondit të rindërtimit për vitin 2025 janë realizuar në shumën 3,157 milionë lekë, ose 63.1% të planit përfundimtar, duke rezultuar 1,843 milionë lekë (36.9%) nën nivelin e parashikuar dhe 5,114 milionë lekë më pak krahasuar me vitin 2024. Pavarësisht këtij niveli realizimi, plani i fondit të rindërtimit ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit, nga miratimi i buxhetit fillestar deri në miratimin e aktit normativ nr. 11/2025.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Projekt-buxheti	Ligji fillestar	AN 3	AN 6	AN 10	AN 11	Fakti 2025	Diferenca fakt-plan
Fondi i Rindërtimit	8,271	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	**3,157**	**−1,843**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Shpërndarja dhe realizimi i fondeve: Gjatë vitit 2025, fondi i rindërtimit me kod “94920AA” është çelur në shumën 5,000 milionë lekë. Nëpërmjet 18 vendimeve të Këshillit të Ministrave janë shpërndarë 1,733.5 milionë lekë, ose 34.7% e fondit të çelur, nga të cilat 1,544 milionë lekë për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 189.5 milionë lekë për njësitë e qeverisjes qendrore. Në përfundim të vitit kanë mbetur të pashpërndara 3,266.5 milionë lekë.
Nga auditimi është konstatuar se të 18 vendimet janë miratuar gjatë muajit dhjetor 2025. Prej tyre, shtatë vendime, me vlerë të përgjithshme 763.37 milionë lekë, janë miratuar më 30.12.2025. Kjo shumë përfaqëson rreth 44% të fondeve të shpërndara gjatë vitit dhe 15.3% të fondit të çelur, duke lënë një periudhë shumë të kufizuar për realizimin e shpenzimeve brenda vitit buxhetor.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 115/2024, nuk i është dhënë përparësi financimit të projekteve të miratuara në vitet e mëparshme, duke miratuar projekte të reja.
Njësitë e vetëqeverisjes vendore, përveç fondeve prej 1,544 milionë lekë të alokuara gjatë vitit 2025, kanë pasur në dispozicion edhe 7,311 milionë lekë të trashëguara nga vitet e mëparshme, duke arritur në një total prej 8,855 milionë lekë. Realizimi për këto njësi ka rezultuar 3,131 milionë lekë, ose rreth 35.4% e fondeve në dispozicion. Për njësitë e qeverisjes qendrore, kundrejt fondeve të alokuara prej 189.5 milionë lekë, janë realizuar 26 milionë lekë, ose rreth 13.7%. Realizimi sipas burimit të fondeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Burimi	Disponibël 2025	Fakti 2025
Fonde të alokuara nëpërmjet VKM në vitin 2025, nga këto:	**1,734**	**1,031**
Njësi të qeverisjes vendore	*1,544*	*1,005*
Njësi të qeverisjes qendrore	*190*	*26*
Fonde të trashëguara nga vitet e mëparshme, nga këto:	**7,311**	**2,126**
Njësi të qeverisjes vendore	*7,311*	*2,126*
Total	**9,045**	**3,157**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Realizimi prej 3,157 milionë lekë përfaqëson 63.1% të planit vjetor prej 5,000 milionë lekë, por vetëm rreth 34.9% të fondeve të alokuara dhe të trashëguara në dispozicion. Niveli i ulët i realizimit është evidentuar edhe në analizën sipas bashkive, ku, sipas të dhënave të auditimit, ai varion nga 12% në Bashkinë Lezhë deri në 57% në Bashkinë Vorë. Shpërndarja e fondeve në fundvit, së bashku me mbartjen e fondeve të pashfrytëzuara, evidenton dobësi në lidhjen ndërmjet planifikimit, alokimit dhe ecurisë faktike të projekteve, duke rritur riskun e shtyrjes së afateve të përfundimit.

Regjistrimi dhe klasifikimi i shpenzimeve: Nga auditimi është konstatuar se fondet e rindërtimit janë regjistruar dhe raportuar në llogari të ndryshme dhe se për projekte të ndryshme është përdorur i njëjti kod projekti/produkti, pa identifikuar veçmas investimin përkatës.
Gjithashtu, shpenzimet operative dhe transferta për të tretë, të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në shumën 1,286 milionë lekë, janë raportuar në treguesit fiskalë si shpenzime kapitale. Kjo shumë përfaqëson rreth 40.7% të realizimit të përgjithshëm të fondit të rindërtimit për vitin 2025 dhe rezulton si e klasifikuar jo në përputhje me natyrën e shpenzimit.

Planifikimi shumëvjeçar dhe financimet e parealizuara: Nga auditimi i planifikimit shumëvjeçar ka rezultuar se fondi i rindërtimit është parashikuar në shumën 5,000 milionë lekë për vitin 2025, ndërsa në tabelën nr. 4 “Treguesit fiskalë të konsoliduar” është parashikuar financim prej 5,000 milionë lekë për vitin 2026 dhe zero për vitin 2027. Ky planifikim nuk pasqyron plotësisht nevojat financiare të projekteve të miratuara më parë dhe detyrimet që shtrihen në periudhat pasuese. Vlera e fondeve të shpërndara me VKM gjatë periudhës 2020–2025 arrin në 123,936 milionë lekë, ndërsa realizimi faktik për të njëjtën periudhë është 103,187 milionë lekë. Diferenca prej 20,749 milionë lekë përfaqëson pjesën e financimeve të miratuara që nuk rezulton e realizuar deri në fund të vitit 2025.

Transferta për fondin e pensioneve

Në vitin 2025, transferta për llogarinë e fondit të pensioneve në Bankën e Shqipërisë është raportuar në shpenzime në shumën 16,587 milionë lekë, me një rritje prej 10,287 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Ndryshe nga viti paraardhës, për vitin 2025 kjo transfertë nuk ka pasur një plan të miratuar në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar. Transferta është kryer në mbështetje të pikës 11 të nenit 11 të ligjit nr. 115/2024. Raportimi i saj si shpenzim në momentin e transferimit të mjeteve monetare ndërmjet llogarive nuk është në përputhje me përcaktimet e pikës 17 të nenit 3 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Transferimi i likuiditeteve në një llogari për ruajtje të përkohshme nuk përbën kryerje të shpenzimit përfundimtar dhe nuk justifikon njohjen e tij si të tillë. Vlera prej 16,587 milionë lekë është përcaktuar në relacionin shoqërues të urdhrit të ministrit, të miratuar pas aktit normativ nr. 11, datë 19.12.2025, pa u pasqyruar në planin buxhetor të miratuar sipas treguesve fiskal të konsoliduar. Në aspektin kontabël, nga auditimi është konstatuar se regjistrimi i transfertës si shpenzim dhe njëkohësisht si mjete në ruajtje në llogarinë 466 nuk është mbështetur në përcaktimet e nenit 61 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, të ndryshuar, dhe në procedurat e Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, të ndryshuar. Gjithashtu, planifikimi dhe raportimi i kësaj shume në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar nuk është vlerësuar në përputhje me pikën 265 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ndryshuar. Për rrjedhojë, ka ndikuar në paraqitjen dhe krahasueshmërinë e treguesve fiskalë.

B.5. Problematikat e konstatuara nga auditimet në administrimin dhe përdorimin e fondeve publike

Në auditimet e zhvilluara nga KLSH në njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë konstatuar problematika në procesin e realizimit të shpenzimeve dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, në

hartimin e preventivave, përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike që konsitojnë në:

▸ Në 25 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u evidentua mosshlyerje e detyrimeve të prapambetura; në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në kontabilizimin e tyre, ndërsa në 5 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan diferenca ndërmjet detyrimeve të raportuara në Ministrinë e Financave.

▸ Për detyrimet nga vendimet gjyqësore u evidentuan mangësi në kontabilizimin e këtyre detyrimeve në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror.

▸ Për detyrimet nga investimet në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në kontabilizimin e tyre.

▸ Në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 5 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 6 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan parregullsi në hartimin e preventivave dhe përllogaritjen e fondit limit, për shkak të përfshirjes së zërave të pajustifikuar dhe përdorimit të çmimeve në mospërputhje me manualet përkatëse.

▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan afate të papërshtatshme për lëvrimin e mallrave, shërbimeve ose punimeve; në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror mungonte angazhimi i anëtarëve të komisioneve për hartimin e specifikimeve teknike, ndërsa në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror kërkesat për mallra nuk ishin argumentuar në raport me gjendjen e inventarit.

▸ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 1 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u konstatuan procedura prokurimi me copëzim të fondit; në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 9 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror mungonte dokumentacioni për përllogaritjen e fondit limit, ndërsa në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 1 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror grupet e punës për specifikimet teknike, vlerësimin e ofertave ose zbatimin e kontratave nuk përfshinin specialistë të fushës.

▸ Në 10 njësi të qeverisjes qendrore, 20 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 12 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan kritere dhe specifikime teknike të paargumentuara. Në 4 njësi të qeverisjes qendrore dhe 4 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mangësi në raportet përmbledhëse të prokurimit, ndërsa në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 23 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 10 ente publike me kapital shtetëror u evidentua shpallja fituese e operatorëve ekonomikë pa verifikimin e plotë të përmbushjes së kritereve të kualifikimit dhe dokumentacionit përkatës.

▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan vonesa në marrjen në dorëzim të mallrave dhe mangësi në përllogaritjen e penaliteteve, ndërsa në 2 njësi të qeverisjes qendrore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin kryer të gjitha shërbimet e përcaktuara në kontratë.

▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 21 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 10 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan diferenca ndërmjet punimeve faktike dhe atyre të raportuara në situacionet përfundimtare.

▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan parregullsi në akordimin e shpërblimeve, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentuan pasaktësi në përllogaritjen e shtesës së vështirësisë.

▸ Në 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u konstatua mungesa e oponencës teknike, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 3 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentua tejkalimi i afateve të vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO).

Përtej parregullsive të konstatuara në planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore, të lidhura me hartimin e preventivave, përllogaritjen e fondit limit, përcaktimin e kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, vlerësimin e ofertave, zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave, marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punimeve, si dhe likuidimin e detyrimeve kontraktuale, auditimet e KLSH-së kanë evidentuar problematika edhe në administrimin e fondeve dhe pasurive publike, menaxhimin e financimeve të huaja dhe donacioneve, vënien në

funksion të investimeve të realizuara dhe shfrytëzimin e aktiveve, veçanërisht në sektorë me rëndësi për ofrimin e shërbimeve publike, si shëndetësia, arsimi, kultura, infrastruktura, etj.

▸*Administrimi dhe përdorimi i fondeve publike për shërbimet e kujdesit, zhvillimit dhe arsimit*

Nga auditimi në *sistemin e çerdheve dhe kopshteve të Bashkisë Tiranë,* janë konstatuar tejkalime të kapaciteteve të miratuara në disa institucione, ndërsa në të tjera kapacitetet nuk janë shfrytëzuar plotësisht, njëkohësisht me ekzistencën e listave të pritjes. Gjithashtu, janë evidentuar mosrespektim i raporteve edukator/fëmijë, mbulim i pamjaftueshëm me mësues ndihmës dhe mangësi në organizimin e shërbimeve mbështetëse. Në administrimin financiar janë konstatuar detyrime debitore nga tarifat e ditëngrënies. Nga auditimi janë evidentuar mangësi në mirëmbajtjen periodike të pajisjeve diagnostikuese. Gjithashtu, projekti për evidentimin e prevalencës së çrregullimeve të neurozhvillimit dhe aftësisë së kufizuar në kopshte dhe shkolla nëntëvjeçare, i financuar nga buxheti i shtetit, nuk ka filluar zbatimin deri në fund të vitit 2025, megjithëse fondet janë lëvruar në muajin gusht.

Në *sistemin parauniversitar* nga auditimi janë konstatuar 284 mësues të palicencuar dhe 64 raste të punësimit jashtë profilit të diplomimit, përfshirë angazhimin e mësuesve ndihmës pa specializimin përkatës për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në administrimin e fondeve për transportin e nxënësve dhe punonjësve arsimorë janë evidentuar pagesa në kundërshtim me kriteret e përfitimit dhe mangësi në sigurimin e shërbimit të financuar.

Nga auditimet e kryera në *shoqëritë publike përgjegjëse për akomodimin dhe trajtimin e studentëve* janë konstatuar mangësi në planifikimin, shpërndarjen dhe administrimin e subvencioneve buxhetore, të cilat në disa raste janë akorduar kryesisht për mbulimin e shpenzimeve të pagave dhe sigurimeve, pa u mbështetur plotësisht në nevojat financiare të dokumentuara të shoqërive, kapacitetet akomoduese të shfrytëzuara dhe koston e shërbimit. Gjithashtu, janë evidentuar rënie e numrit të studentëve të akomoduar, reduktim i të ardhurave të veta dhe rritje e varësisë nga financimi buxhetor, humbje financiare dhe vështirësi në mbulimin e shpenzimeve operative, si dhe problematika në mirëmbajtjen e godinave dhe shfrytëzimin e kapaciteteve akomoduese, ku për shkak të amortizimit të infrastrukturës dhe pajisjeve.

▸*Risqet për financat publike nga administrimi i burimeve natyrore dhe mjedisore*

Nga auditimet e kryera nga KLSH në institucionet përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore e mjedisore janë evidentuar mangësi në arkëtimin e gjobave, zbatimin e sanksioneve administrative dhe kontraktuale dhe monitorimin e veprimtarive me ndikim në mjedis. Këto mangësi mbartin riskun e mosrealizimit të të ardhurave përkatëse dhe risk të shtuar për krijimin e nevojave të paparashikuara për financimin e ndërhyrjeve rehabilituese.

Nga auditimet e kryera nga KLSH në strukturat përgjegjëse për *mbrojtjen e mjedisit* dhe *administrimin e territorit bregdetar* janë konstatuar mangësi në vendosjen, zbatimin dhe arkëtimin e sanksioneve administrative dhe kontraktuale, përfshirë gjoba të paarkëtuara, raste të shfuqizimit të pajustifikuar të tyre, mosvendosje të penaliteteve dhe mosaplikim të sanksioneve për mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në monitorimin e veprimtarive me ndikim në mjedis, gjurmueshmërinë e mbetjeve, kryerjen dhe ndjekjen e inspektimeve e riinspektimeve. Këto mangësi kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave si dhe kanë evidentuar dobësi në kontrollin dhe monitorimin e veprimtarive me ndikim në mjedis, në parandalimin e dëmeve mjedisore dhe në sigurimin e përmbushjes së detyrimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e territorit nga subjektet përgjegjëse. Nga auditimet e kryera në *institucionet përgjegjëse për monitorimin e kontratave koncesionare në sektorin hidroenergjetik, si dhe në shoqëritë publike që administrojnë dhe shfrytëzojnë hidrocentrale*t, janë konstatuar mangësi në mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale dhe mjedisore, mirëmbajtjen e veprave hidroenergjetike, planifikimin e investimeve dhe administrimin e aktiveve. Konkretisht, janë evidentuar dëmtime të strukturave hidroenergjetike, me pasoja në mjedis, pronat private dhe infrastrukturën e zonës, si dhe mangësi në vlerësimin e gjendjes teknike dhe jetëgjatësisë së makinerive e pajisjeve. Gjithashtu, janë konstatuar studime dhe projekte të hartuara për mbrojtjen e sistemeve, zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara dhe rehabilitimin e infrastrukturës hidroenergjetike, të cilat nuk janë vënë në zbatim për shkak të mosplanifikimit të fondeve përkatëse. Këto mangësi kanë evidentuar nevoja për përmirësimin e mirëmbajtjes dhe rehabilitimin

e infrastrukturës hidroenergjetike, ndërsa dëmet e shkaktuara në mjedis, pronat private dhe infrastrukturën e zonës krijojnë ekspozim të mundshëm financiar për buxhetin e shtetit.

Problematika në planifikimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës janë evidentuar edhe në strukturat përgjegjëse për administrimin e sistemeve të ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytjet.
Janë konstatuar mangësi në planifikimin e ndërhyrjeve të mirëmbajtjes, kontrollin teknik të projekteve, dokumentimin e inspektimeve dhe respektimin e kërkesave teknike e mjedisore gjatë përgatitjes së investimeve për mbrojtjen nga erozioni. Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në administrimin e regjistrave të infrastrukturës, monitorimin e gjendjes së veprave ujitëse dhe kulluese, si dhe organizimin dhe sigurimin teknik të funksionimit të hidrovorëve. Këto mangësi kanë kufizuar vlerësimin në kohë të gjendjes së infrastrukturës dhe planifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e saj, duke shtuar ekspozimin ndaj dëmtimeve, përmbytjeve dhe erozionit, si dhe mundësinë e krijimit të nevojave shtesë për financimin e ndërhyrjeve rehabilituese dhe emergjente.

Në fushën e administrimit dhe shfrytëzimit të burimeve minerare dhe fondit pyjor e kullosor janë konstatuar mangësi në kontrollin e respektimit të kushteve të lejeve të shfrytëzimit, përmbushjen e kërkesave mjedisore dhe monitorimin e veprimtarive minerare. Konkretisht, janë evidentuar raste të shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore jashtë kufijve të lejeve të miratuara. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi në kryerjen e monitorimeve periodike, ndalimin e ndërhyrjeve të paligjshme, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në pasurinë publike dhe dokumentimin e procedurave për mbylljen e veprimtarive minerare dhe rehabilitimin e zonave të shfrytëzuara.

▸ *Administrimi i fondeve për projektet e artit dhe kulturës.*
Nga auditimet e kryera janë evidentuar mungesë e kritereve të formalizuara për përcaktimin e masës së financimit të projekteve të artit dhe kulturës, dokumentacion i pamjaftueshëm dhe mangësi në gjurmën e auditimit gjatë përzgjedhjes, miratimit dhe zbatimit të tyre. Këto mangësi kanë kufizuar verifikimin e bazës së përcaktimit të shumave të miratuara dhe përdorimit të fondeve sipas destinacionit. Gjithashtu, janë konstatuar raste të financimit të projekteve në favor të individëve pa verifikimin e plotë të përmbushjes së kritereve ligjore, si dhe përdorimi i mekanizmit të financimit të projekteve kulturore për mbulimin e veprimtarive institucionale, pa ndjekur procedurat përkatëse sipas natyrës së shpenzimeve. Gjithashtu, janë konstatuar tejkalime të shpenzimeve operative dhe mosrikuperim në afat i fondeve të dhëna për projekte kulturore, duke kufizuar disponueshmërinë e burimeve financiare për zhvillimin e veprimtarisë dhe ruajtjen, restaurimin e promovimin e trashëgimisë filmike kombëtare.

▸ *Mangësi në vënien në funksion dhe shfrytëzimin e investimeve të realizuara*
Nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në vënien në funksion dhe shfrytëzimin e investimeve të realizuara, përfshirë pajisje teknologjike, laboratorë mësimorë dhe infrastrukturë të furnizimit me ujë, për të cilat, megjithëse janë kryer shpenzimet përkatëse, nuk është siguruar përdorimi i plotë sipas qëllimit të financimit.

Në *sektorin e ujësjellës-kanalizimeve* është konstatuar se investimi për ndërtimin e rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën e Frutikulturës, Valias i Vjetër, me vlerë kontrate 595.1 milionë lekë me TVSH, kishte përfunduar në shtator 2025 dhe ishte marrë në dorëzim përkohësisht në dhjetor 2025. Megjithëse punimet kishin përfunduar, investimi nuk ishte vënë në funksionim të plotë, për shkak të mosrealizimit të lidhjeve të rrjetit me familjarët për furnizimin e tyre me ujë, duke kufizuar përfitimin e shërbimit për të cilin ishin alokuar fondet publike.

▸ *Mangësi në administrimin e fondeve, materialeve mjekësore, pajisjeve dhe infrastrukturës spitalore*
Nga auditimet e kryera në *strukturat spitalore* janë konstatuar mangësi në administrimin dhe kontrollin e konsumit të barnave dhe materialeve mjekësore, dokumentimin e furnizimeve,

mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve mjekësore, si dhe në ndjekjen e investimeve dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Konkretisht, në 12 shërbime dhe pavione, mosregjistrimi i daljeve të barnave dhe materialeve mjekësore në sistemin elektronik SIIS kishte sjellë mbivlerësimin e gjendjes së inventarit në sistem me rreth 288.2 milionë lekë. Gjithashtu, janë konstatuar transferime të materialeve mjekësore ndërmjet institucioneve, të kryera pa marrëveshje dhe pa mekanizma të formalizuar kompensimi financiar, me diferencë prej rreth 39.8 milionë lekë ndërmjet daljeve dhe hyrjeve. Mangësi janë evidentuar edhe në marrjen në dorëzim të furnizimeve me oksigjen mjekësor, ku sasitë ishin pranuar pa matës ligjorë të instaluar në hyrje dhe dalje të tankerëve, duke u mbështetur në dokumentacionin e peshimit jashtë strukturës spitalore, pa nënshkrimin e përfaqësuesit të komisionit të marrjes në dorëzim, ndërsa certifikatat e analizave nuk mundësonin identifikimin e qartë të furnizimeve përkatëse. Në administrimin e furnizimeve ushqimore janë konstatuar mangësi në dokumentimin e furnizimeve dhe mospërputhje ndërmjet sasive të artikujve të dalë nga magazina dhe atyre të përcaktuara sipas dietave dhe numrit të pacientëve, duke kufizuar verifikimin e përdorimit të fondeve sipas destinacionit dhe nevojave të përllogaritura.

Problematika janë konstatuar edhe në *administrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore*, ku janë evidentuar 24 pajisje jashtë funksionit, me vlerë fillestare 483.59 milionë lekë, përfshirë një CT Skaner me vlerë fillestare 388.98 milionë lekë dhe vlerë të mbetur 84.82 milionë lekë, për të cilin ishte konfirmuar pamundësia e riparimit për shkak të përfundimit të mbështetjes nga prodhuesi dhe mungesës së pjesëve të këmbimit. Për pajisjet e tjera jofunksionale nuk ishin marrë masa për riparimin ose nxjerrjen e tyre nga përdorimi, ndërsa në administrimin e kontratës së mirëmbajtjes "Full-Risk" të CT Skanerit janë konstatuar penalitete të paaplikuara për 214 ditë mosfunksionim.

Gjithashtu, janë evidentuar mangësi në *ndjekjen e investimeve për rikonstruksionin e infrastrukturës spitalore.* Në një investim për rikonstruksionin e një poliklinike specialitetesh, me vlerë kontrate 79.36 milionë lekë, gjatë vitit 2025 janë konstatuar defekte të pariparuara brenda periudhës së garancisë.

Nga auditimet e performancës janë evidentuar mangësi në planifikimin, realizimin dhe përdorimin e fondeve publike, si më poshtë:

▸ *"Fuqizimi i grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse":* Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk është konsoliduar në të gjitha bashkitë e audituara, ndërsa mungesa e burimeve të dedikuara, treguesve financiarë dhe monitorimit të shpenzimeve sipas ndikimit gjinor ka kufizuar efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e masave për fuqizimin e grave në *vendimmarrje.*


▸ *"Kontrolli i cilësisë, magazinimi dhe importimi i drithërave (me fokus miellin)":* Fondet e akorduara për AKU-në kanë mbuluar vetëm një pjesë të nevojave të planifikuara, në disa vite rreth 18% të kërkesave, duke kufizuar kapacitetet për ushtrimin efektiv të kontrollit, veçanërisht në drejtim të laboratorëve, pajisjeve dhe infrastrukturës rajonale.

▸ *"Kujdesi Shëndetësor në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale":* Planifikimi i furnizimit me barna nuk është mbështetur në konsumin faktik dhe nevojat reale, ndërsa pajisjet stomatologjike kanë rezultuar jofunksionale. Furnizimi paralel me të njëjtat barna nga DPB-ja dhe skema e rimbursimit ka evidentuar mungesë koordinimi dhe shpenzime joekonomike.

▸ "*Qarkullimi Rrugor në Bashkinë e Tiranës*": Procesi i rimbursimit të linjave të transportit urban është kryer bazuar në një set dokumentacioni të përgatitur individualisht nga operatorët ekonomikë, të paverifikuara nga Bashkia Tiranë. Llogaritja e kilometrave të përshkruar nga secili mjet është kryer në mënyrë të njëanshme nga kompania e cila operon linjën. Operatorët e Sektorit të Sistemeve, nuk kanë kryer verifikime të dokumentuara të GPS-it të autobusëve urbanë të linjave të licencuara apo verifikime e monitorim të vazhdueshme. Fondi i rimbursimit të linjave të transportit rezulton se është menaxhuar në mënyrë jo efektive nga Bashkia Tiranë ku efektet financiare për vitin 2025 paraqiten në vlerën 308 milionë lekë. Vonesat në disbursimin e huasë, për projektin Bus Rapid Transit (BRT) prodhojnë kosto financiare për buxhetin e Bashkisë Tiranë. Kostot e vonesave rriten në mënyrë progresive për çdo periudhë gjashtë-mujore dhe për vitin 2025 llogariten në vlerën rreth 4,603 mijë lekë[8], vlerë e cila përbën menaxhim joefektiv të fondeve.

[8] Llogaritur me kursin e publikuar nga Banka e Shqipërisë datë 31.12.2025 1Euro = 96.77 lekë

B.6. Risqet fiskale dhe impakti buxhetor



Risqet fiskale përfaqësojnë faktorë ose ngjarje të pasigurta, materializimi i të cilave mund të shkaktojë devijime të rezultateve fiskale nga parashikimet bazë, duke ndikuar në të ardhurat, shpenzimet, deficitin, nevojat për financim dhe pozicionin fiskal të qeverisjes së përgjithshme. Këto risqe mund të burojnë nga zhvillime makroekonomike të ndryshme nga ato të parashikuara, nga detyrimet kontingjente, veprimtaria financiare e ndërmarrjeve publike, kontratat koncesionare/PPP, detyrimet e prapambetura, proceset gjyqësore, si dhe nga faktorë të tjerë që mund të krijojnë efekte të paparashikuara mbi financat publike.

Përgjatë vitit 2025, monitorimi i ekspozimeve fiskale është përqendruar në disa prej burimeve kryesore që mund të ndikojnë në financat publike. Në veçanti, janë marrë në konsideratë rezultatet dhe pozicioni financiar i ndërmarrjeve shtetërore, detyrimet që lidhen me kontratat koncesionare dhe projektet PPP të financuara ose të mbështetura nga buxheti, detyrimet e akumuluara të qeverisjes së përgjithshme, si dhe rreziqet që mund të lindin nga proceset gjyqësore në nivel ndërkombëtar.


Në lidhje me raportimin e këtyre risqeve, Ministria e Financave ka dërguar pranë Këshillit të Ministrave, për informacion, *"Deklaratën e Risqeve Fiskale për vitin 2024",* të shoqëruar me raportin që pasqyron zbatimin e buxhetit dhe zhvillimet makroekonomike e fiskale gjatë vitit 2025.

KLSH vlerëson se paraqitja gjatë vitit 2025 e Deklaratës së Risqeve Fiskale për vitin 2024 ka kufizuar rolin e saj në mbështetjen e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit në vijim. Vlerësimi i risqeve fiskale merr rëndësi për vendimmarrjen buxhetore kur siguron informacion në kohë mbi ndikimin e mundshëm të tyre dhe mundëson marrjen e masave për kufizimin e pasojave në financat publike. Në këtë kuptim, raportimi për periudhën e kaluar, i pashoqëruar me një vlerësim të përditësuar për vitin në vijim, kufizon funksionin parandalues të monitorimit të risqeve fiskale.

B.6.1 Risqet fiskale nga sektori energjetik, ujësjellës kanalizime, dhe të tjerë

Në raportin e Ministrisë së Financave "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2025", stoku i raportuar i detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet shoqërive me kapital shtetëror në sektorin energjetik, ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe detyrimeve përkatëse të tyre ndaj buxhetit të shtetit rezulton në 175.42 miliardë lekë, nga 171.24 miliardë lekë në fund të vitit 2024, me një rritje prej 4.18 miliardë lekë, ose 2.4%.

Nga analiza e ecurisë së detyrimeve rezulton se rritja është përqendruar kryesisht në detyrimet e KESH-it ndaj Ministrisë së Financave, me 4.98 miliardë lekë, ndërsa detyrimet e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve ndaj OSHEE-së dhe Ministrisë së Financave janë rritur në total me 1.79 miliardë lekë. Kjo ecuri evidenton se masat e ndërmarra për reduktimin e detyrimeve të prapambetura nuk kanë siguruar uljen e qëndrueshme të stokut, në kuadër të objektivave të përcaktuara në Urdhrin e përbashkët nr. 304, datë 17.12.2020, dhe Urdhrin nr. 379, datë 30.09.2021, për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Gjithashtu, nga auditimi janë evidentuar mangësi në rakordimin e detyrimeve ndërmjet subjekteve, të cilat kufizojnë besueshmërinë e informacionit të raportuar, vlerësimin e gjendjes reale financiare të ndërmarrjeve publike dhe identifikimin e ekspozimit të mundshëm të buxhetit të shtetit ndaj këtyre detyrimeve. Gjatë vitit 2025, sektori energjetik ka përfituar mbështetje buxhetore prej 5.28 miliardë lekë. Pavarësisht kësaj mbështetjeje, stoku i detyrimeve të ndërsjellta ka vijuar të rritet, duke evidentuar vështirësi në shlyerjen e detyrimeve dhe riskun e krijimit të nevojave të mëtejshme për financim nga buxheti i shtetit.

Sektori energjetik

Nga auditimet e kryera në sektorin energjetik janë evidentuar problematika të vazhdueshme në administrimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndërmjet shoqërive publike. Detyrimet e prapambetura të OSHEE-së ndaj KESH-it dhe OST-së, pavarësisht marrëveshjeve të lidhura për shlyerjen e tyre, vijojnë të ndikojnë në administrimin e likuiditetit dhe në aftësinë e shoqërive për të përmbushur angazhimet financiare, përballuar shpenzimet operative dhe realizuar investimet e planifikuara. Gjithashtu, detyrimet e papaguara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve për furnizimin me energji elektrike kanë kufizuar arkëtimet e operatorëve të sektorit, ndërkohë që vijimi i krijimit të detyrimeve të reja, krahas stokut të mbartur, ka rritur vështirësitë për reduktimin e tyre. Nga auditimi në OSHEE është konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e procedurave përmbarimore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura lidhet me ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve. Gjithashtu, janë evidentuar mospërputhje ndërmjet sistemeve të faturimit dhe evidencave kontabël, mangësi në rakordimin e të drejtave dhe detyrimeve, si dhe në evidentimin dhe trajtimin e kamatëvonesave.

Problematika të evidentuara nga auditimet në sektorin energjetik, me ndikim në performancën financiare

Qëndrueshmëria financiare e sektorit energjetik vijon të përfaqësojë një element të rëndësishëm në vlerësimin e risqeve fiskale, për shkak të nivelit të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet shoqërive publike, kostove të aktivitetit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe mbështetjes financiare të akorduar nga buxheti i shtetit. Nga auditimi i ndërmarrjeve të sektorit energjetik (OSHEE Group sh.a. së bashku me Drejtori Rajonale), janë evidentuar problematika në administrimin e veprimtarisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, menaxhimin dhe reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike, arkëtimin e detyrimeve nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes, administrimin e shpenzimeve dhe detyrimeve financiare, si dhe planifikimin dhe monitorimin ekonomik e financiar të shoqërisë. Nga auditimi u konstatua se për periudhën Janar-Korrik 2025, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. ka futur në rrjetin e shpërndarjes 4,817,363,000 kWh energji elektrike, nga të cilat janë faturuar 4,002,834,000 kWh, ndërsa humbjet rezultuan në 814,530,000 kWh, ose 16.91% të energjisë së futur në rrjet. OSSH sh.a. ka blerë energji elektrike për mbulimin e humbjeve teknike dhe joteknike në rrjetin e shpërndarjes për periudhën Janar - Korrik 2025 në vlerën 7,853.62 milionë lekë. Në kushtet e akumulimit të detyrimeve të ndërsjellta dhe të nevojave për investime në rrjet, niveli i lartë i kostove për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe mangësitë në kontrollin e humbjeve teknike dhe joteknike mund të rrisin ekspozimin e sektorit energjetik ndaj nevojave për financim. Nga auditimi i veprimtarisë së strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe rikuperimin e humbjeve të energjisë elektrike janë evidentuar mangësi në planifikimin dhe orientimin e kontrolleve drejt zonave dhe kategorive të konsumatorëve me risk më të lartë, si dhe në arkëtimin e vlerave të faturuara për dëmet ekonomike

të konstatuara nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes. Për periudhën Janar -Korrik 2025, nga 188 raste të evidentuara të ndërhyrjeve të paligjshme, vetëm 31 raste u përkisnin subjekteve private, të cilat përfaqësonin rreth 90.2% të dëmit ekonomik të konstatuar. Për këto subjekte u evidentuan 4,006,000 kWh energji elektrike nga ndërhyrjet e paligjshme, me vlerë të përllogaritur 73.51 milionë lekë, ndërkohë që arkëtimet rezultuan vetëm 0.34 milionë lekë. OSSH sh.a. ka konstatuar ndërhyrje të paligjshme që përfaqësojnë 4,439,520 kWh energji elektrike, me vlerë të faturuar rreth 1.55 milionë lekë, ndërsa niveli i arkëtimit rezultoi rreth 1.9% e vlerës së faturuar. Strukturat përgjegjëse të OSSH sh.a. nuk kanë hartuar analiza dhe plane masash të mjaftueshme për parandalimin dhe reduktimin e humbjeve joteknike, veçanërisht në zonat industriale dhe në ato me nivel të lartë humbjesh. Po kështu, u konstatuan mangësi në planifikimin e projekteve dhe ndërhyrjeve për përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit dhe reduktimin e humbjeve teknike.
Nga auditimi u konstatua mungesë e verifikimeve dhe kontrolleve të mjaftueshme mbi shërbimin e realizimit të printimit dhe shpërndarjen e faturave të energjisë elektrike tek klientët fundorë. Nga strukturat përgjegjëse nuk janë kryer kontrolle të dokumentuara mbi vërtetësinë e treguesve të shpërndarjes së faturave dhe nuk është analizuar efektiviteti dhe eficienca e marrëveshjes përkatëse duke rezultuar në pagesa 212.86 milionë lekë.

Sektori i Ujësjellës Kanalizimeve

Sektori i ujësjellës-kanalizimeve vijon të përballet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare, arkëtimin e të ardhurave dhe mbulimin e kostove të veprimtarisë. Për mbështetjen e këtij sektori, në buxhetin e vitit 2025 është parashikuar një subvencion prej 350 milionë lekë, në strukturën buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Sipas të dhënave të raportuara nga OSHEE Group sh.a., detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve për energjinë elektrike kanë arritur në rreth 33.8 miliardë lekë në fund të vitit 2025, nga rreth 32.6 miliardë lekë në fund të vitit 2024, me një rritje prej rreth 1.2 miliardë lekë, ose 3.7%. Nga ky stok, rreth 14.1 miliardë lekë, ose 41.7%, përfaqësojnë detyrime të faturuara për energjinë elektrike, ndërsa rreth 19.7 miliardë lekë, ose 58.3%, përfaqësojnë kamatëvonesa. Pesha e lartë e kamatëvonesave evidenton koston financiare të krijuar nga mosshlyerja në afat e detyrimeve. Vetëm UK Durrës sh.a. rezulton me detyrime për energjinë elektrike, pa përfshirë kamatëvonesat, në vlerën rreth 5.75 miliardë lekë, nga 5.62 miliardë lekë në fund të vitit 2024. Akumulimi i detyrimeve të këtyre ndërmarrjeve ndaj sektorit energjetik ndikon njëkohësisht në gjendjen financiare të operatorëve të ujësjellës-kanalizimeve dhe në aftësinë e OSHEE-së për të arkëtuar të ardhurat dhe për të përmbushur angazhimet financiare. Në këto kushte, mosreduktimi i stokut të detyrimeve dhe krijimi i detyrimeve të reja rrisin ekspozimin ndaj nevojave për mbështetje financiare nga fondet publike.

Problematika të evidentuara nga auditimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, me ndikim në performancën financiare

Nga auditimet e kryera në shoqëritë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a., Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a. dhe Ujësjellës Kanalizime Lushnjë sh.a. u konstatuan problematika në administrimin e detyrimeve financiare, përmbushjen e angazhimeve të kreditimit, arkëtimin e të ardhurave, reduktimin e humbjeve të ujit dhe menaxhimin ekonomik e financiar të shoqërive. Nga auditimet rezultoi se shoqëritë rajonale të ujësjellës kanalizime vijojnë të mbartin detyrime të konsiderueshme ndaj furnizuesve të energjisë elektrike, institucioneve financiare dhe shoqërive të tjera publike, ndërkohë që mosshlyerja në kohë ka sjellë krijimin e kamatëvonesave dhe kostove shtesë. Problematika të përbashkëta për këto shoqëri rajonale u konstatuan edhe në administrimin e humbjeve të ujit dhe arkëtimin e të ardhurave. Në UK Kamëz sh.a, pavarësisht përmirësimit të treguesit, humbjet e ujit vijuan të mbeteshin në nivelin 60% për vitin 2025. Ndërsa në UK Korçë sh.a, detyrimet e klientëve ndaj shoqërisë rezultuan 422.07 milionë lekë në datën 30.09.2025, me një rritje prej 9% gjatë periudhës së audituar. Këto problematika kanë kufizuar aftësinë e shoqërive për të gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e kostove operative, shlyerjen e detyrimeve dhe financimin e investimeve. Nga auditimi i praktikave të miratimit të tarifave në Entin Rregullator të Ujit u konstatua se nivelet e larta të treguesit “Uji Pa të Ardhura” nuk janë shoqëruar në mënyrë të mjaftueshme me vendosjen e kushteve detyruese dhe të verifikueshme për

reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e performancës së operatorëve. Konkretisht, në shoqëritë rajonale UK Lezhë, UK Fier dhe UK Shkodër, ky tregues rezultoi përkatësisht në nivelet 74.14%, 69.59% dhe 67.01%, ndërkohë që vendimmarrjet tarifore nuk janë shoqëruar me mekanizma të mjaftueshëm për garantimin e zbatimit të masave korrigjuese. Nga auditimi i UK Korçë sh.a. rezultoi se shoqëria kishte detyrime të pashlyera nga katër kredi në vlerën 36.29 milionë euro. Gjithashtu, në UK Lushnjë sh.a. u evidentuan detyrime ndaj institucioneve të kreditit dhe kreditorëve të tjerë në vlerën 400.76 milionë lekë. Nga auditimet u evidentuan edhe mangësi në planifikimin dhe administrimin e burimeve financiare, përfshirë subvencionin prej 30 milionë lekë për investime, pavarësisht ekzistencës së detyrimeve të prapambetura që duhej të shlyheshin me përparësi në UK Korçë, si dhe diferenca në rakordimin e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet UK Kamëz sh.a. dhe UK Tiranë sh.a. në vlerën 18.16 milionë lekë.

Sektorë të tjerë

Nga auditimi janë evidentuar risqe fiskale që burojnë nga detyrimet e pashlyera të subjekteve përfituese ndaj buxhetit të shtetit, në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë dhe garancive shtetërore, edhe në sektorë të tjerë përveç energjisë dhe ujësjellës-kanalizimeve. Në drejtim të nënhuave, pavarësisht reduktimit të detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe sektorit hekurudhor, detyrimet e Albcontrol janë rritur me 1,108 milionë lekë, duke arritur në 1,170 milionë lekë në fund të vitit 2025, ndërsa detyrimet nga mikrokreditë kanë shënuar një rritje prej 4.96 milionë lekë. Për sa u përket garancive shtetërore, janë evidentuar rritje të detyrimeve për Hekurudhën Durrës me 12.63 milionë lekë dhe për financimin e ndihmës në mallra, të evidentuar pranë Ministrisë së Financave, me 25.4 milionë lekë, ndërkohë që detyrimet e RTSH-së janë reduktuar me 24.89 milionë lekë. Vijimësia e këtyre detyrimeve dhe rritja e tyre për këto entitete evidentojnë risqe për arkëtimin e të drejtave të buxhetit të shtetit dhe për krijimin e kostove shtesë financiare. Gjithashtu, kjo situatë merr një rëndësi të vecantë për monitorim të aftësisë shlyerëse të subjekteve përfituese dhe të ekspozimit fiskal, veçanërisht në rastet kur këto subjekte mbështeten njëkohësisht me transferta kapitale nga buxheti i shtetit.


B.6.2 Kontratat koncesionare dhe Partneritetet Publike-Private (PPP)

Për vitin 2025 raportohen 11 kontrata koncesionare dhe të Partneritetit Publik-Privat (PPP) me mbështetje buxhetore, për 10 prej të cilave janë realizuar pagesa. Për kontratën koncesionare/PPP *“Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e "Portit të Integruar" në Triport Vlorë”*, nuk rezultojnë fonde të planifikuara dhe pagesa gjatë vitit, pasi referuar modelit financiar të kësaj kontrate, pagesat nga Autoriteti Kontraktor do të kryhen jo më parë se tre vite nga data efektive e kontratës, pasi të jenë kryer 100% të volumit të punimeve.

Plani përfundimtar për kontratat koncesionare/PPP rezultoi në 13,682.9 milionë lekë, ndërsa pagesat e raportuara në 13,359 milionë lekë, me nivel realizimi 97.6%. Krahasuar me vitin 2024, kur pagesat faktike rezultuan rreth 13,293.6 milionë lekë, pagesat e raportuara për vitin 2025 paraqesin një rritje neto prej rreth 65.4 milionë lekë, ose 0.5%.

Pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, në shumën prej 13,359 milionë lekë përbëjnë 2.03% e totalit të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2024, prej rreth 598,662 milionë lekë, duke qenë brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike.

Nga analiza e pagesave sipas kontratave evidentohet realizim pranë nivelit 100% të planit, ndërsa kontrata për landfillin/inceneratorin e Tiranës paraqet nivelin më të ulët të realizimit të raportuar, prej 77.4%. Verifikimi i pagesave në SIFQ ka evidentuar gjithashtu diferenca ndërmjet pagesave të raportuara nga Ministria e Financave dhe pagesave të evidentuara në sistem për këtë kontratë. Sipas raportit të buxhetit faktik 2025, të detajuara sipas kontratave respektive plani dhe pagesat për secilën kontratë koncesionare/PPP paraqitet si në vijim:



Në analizën e pagesave të kryera gjatë vitit 2025 u evidentua se një pjesë e tyre lidhen me detyrime të krijuara në periudhat e mëparshme ku përmendet projekti *"Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1 dhe për 4 objektet arsimore në zonën Tirana 4"* në vlerën 101 milionë lekë.

Nga verifikimi i pagesave për kontratën koncesionare "*Ndërtimi i landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese në Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike*", rezultoi se gjatë vitit 2025 financimi i kësaj kontrate nuk është kryer nëpërmjet transfertave buxhetore nga programi 06220 "Menaxhimi i mbetjeve urbane", sikurse është vepruar në vitet e para të zbatimit të saj, por është përballuar nga të ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, njësoj si gjatë vitit 2024. Nga verifikimi i pagesave për këtë kontratë rezultoi se në raportimin e Ministrisë së Financave për vitin 2025 janë pasqyruar pagesa në vlerën 913.1 milionë lekë, të kryera nga Bashkia Tiranë. Ndërkohë, nga databaza e pagesave në SIFQ rezultojnë pagesa totale të lidhura me këtë kontratë në vlerën 1,437.6 milionë lekë, ose rreth 524.5 milionë lekë më shumë se vlera e raportuar. Diferenca lidhet me pagesa të kryera edhe nga bashkitë Kamëz, Kavajë, Vorë dhe Durrës. Për rrjedhojë, raportimi i pagesave faktike për këtë kontratë nuk pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha pagesat e evidentuara në SIFQ gjatë vitit 2025. Në pagesat e bashkisë Vorë përfshihet edhe 2.8 milionë lekë detyrim i prapambetur i vitit 2024. Rezulton se, pavarësisht kësaj diference të pa raportuar, pagesat vjetore faktike nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për kontratat koncesionare apo PPP, mbeten brenda kufirit të pagesave prej 5% të të ardhurave tatimore faktike.

Nga auditimi rezultuan 4 kontrata koncesionare/PPP që paraqiten me rritje të pagesave prej 301.9 milionë lekë krahasuar me vitin 2024, konkretisht: *kontrata "Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë"; kontrata "Koncesioni/PPP Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale"; kontrata "Ofrimi i shërbimit të dializës"; kontrata "Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore".* Rritja faktike e pagesave vjen si rezultat i rritjes së shërbimit, referuar modelit të pagesës së këtyre kontratave "pagesë sipas nivelit të përdorimit".

KLSH ka kryer auditimin e dy kontratave koncesionare në sektorin e shëndetësisë, të cilat ndodhen në vitin e fundit të zbatimit, duke vlerësuar ndër të tjera përmbushjen e detyrimeve kontraktuale përgjatë gjithë periudhës së zbatimit, kostot dhe efektet financiare për buxhetin e shtetit, si dhe masat për garantimin e vijimësisë së shërbimeve pas përfundimit të kontratave, ku ka rezultuar si më poshtë:

Kontrata koncesionare për ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit të seteve kirurgjikale, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale

Nga auditimi u konstatua se mbështetja financiare buxhetore për periudhën 2016-2025 ka arritur në vlerën 15,110.95 milionë lekë me TVSH, kundrejt vlerës maksimale të planifikuar prej 11,588.40 milionë lekë, duke e tejkaluar këtë të fundit me 3,522.55 milionë lekë, ose 30.4%, ku vetëm për vitin 2025 vlera paraqitet në 1,885.30 milionë lekë me TVSH. Mbështetja buxhetore e planifikuar për të gjithë periudhën dhjetëvjeçare të kontratës është ezauruar pothuajse dy vite përpara përfundimit të saj, ndërkohë që tavani vjetor prej 1.6 miliardë lekë, i përcaktuar në amendimin e vitit 2020, nuk

është respektuar në katër vite. Për periudhën 2016-2025 janë kryer dhe paguar gjithsej 564,718 ndërhyrje kirurgjikale duke tejkaluar me rreth 13% numrin e ndërhyrjeve të parashikuara sipas planit të biznesit, ndërkohë që mbështetja buxhetore ka rezultuar mbi 30% më i lartë se parashikimi fillestar, ku vetëm për vitin 2025 janë kryer 67,126 ndërhyrje kirurgjikale, duke tejkaluar me 17,126 ndërhyrje (34.3%) numrin prej 50,000 ndërhyrjesh të parashikuara sipas planit të biznesit. Rritja e kostos së shërbimit është ndikuar nga ndryshimet në strukturën e kompleksitetit të ndërhyrjeve, ku janë rritur ndërhyrjet me kompleksitet të lartë dhe të mesëm, ndërsa janë ulur ato me kompleksitet të ulët dhe këto ndryshime nuk janë shoqëruar me verifikime dhe analiza periodike nga Autoriteti Kontraktor mbi ndikimin e tyre në koston e shërbimit. Nga auditimi u konstatua gjithashtu se financimi i këtij shërbimi rezulton më i lartë se vlera e faturuar nga koncesionari, pasi nga institucionet publike janë përballuar edhe shpenzimet për energjinë elektrike dhe ujin, si dhe janë vënë në dispozicion pa shpërblim ambiente spitalore, me një ndikim shtesë të vlerësuar në rreth 4% të kostos së kontratës. Këto elemente nuk janë reflektuar plotësisht në analizën fillestare financiare dhe në studimin e fizibilitetit duke kufizuar vlerësimin e kostos së plotë të ofrimit të shërbimit. Janë konstatuar mangësi edhe në monitorimin e investimeve të realizuara nga koncesionari dhe në verifikimin e aseteve që duhet t'i transferohen autoritetit publik në përfundim të kontratës. Nga auditimi u konstatua se çmimet e shërbimit ishin përcaktuar pa TVSH, ndërsa faturimi nga koncesionari është kryer duke aplikuar TVSH mbi çmimin neto. Për periudhën 2016-2025, FSDKSH ka financuar elementin e TVSH-së në vlerën 2,518.49 milionë lekë jo në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit të TVSH-së. Gjithashtu, kjo kosto nuk ishte reflektuar plotësisht në analizën fillestare financiare dhe në studimin e fizibilitetit, duke ndikuar në vlerësimin e kostos reale dhe në krahasimin ekonomik me modelin publik të ofrimit të shërbimit. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatuan vonesa në fillimin dhe shtrirjen e shërbimit në institucionet spitalore, në kundërshtim me afatet e përcaktuara në kontratë dhe në projektin teknik. U konstatuan mangësi në raportimin periodik të shërbimeve, në realizimin e trajnimeve të vazhdueshme për personelin spitalor, në dokumentimin teknik të produkteve dhe në funksionimin e sistemit elektronik për raportimin dhe gjurmueshmërinë në kohë reale të shërbimeve. Nga auditimi u evidentua gjithashtu se qendra e trajtimit të mbetjeve spitalore është vendosur në pronë private dhe transporti i mbetjeve realizohet nga palë të treta duke krijuar problematika dhe risqe për transferimin e aseteve dhe vijimësinë e shërbimit pas përfundimit të kontratës. Gjatë periudhës 2016-2021 nuk janë kryer monitorime dhe kontrolle të zbatimit të kontratës nga strukturat përgjegjëse, ndërsa monitorimet e filluara gjatë vitit 2022 dhe të kryera në vijim kanë paraqitur mangësi në mbulimin e detyrimeve kontraktuale, respektimin e afateve dhe ndjekjen e rekomandimeve. Nuk rezulton të jetë emëruar përfaqësuesi përgjegjës për administrimin e kontratës, si dhe nuk janë ushtruar në mënyrë të plotë të drejtat e Autoritetit Kontrator për inspektimin e llogarive dhe regjistrave të koncesionarit, verifikimin e vlefshmërisë së garancive kontraktuale, kontrollin e investimeve dhe certifikimeve të cilësisë.

Kontrata koncesionare për kontrollin mjekësor bazë

KLSH ka audituar zbatimin e kontratës koncesionare të kontrollit mjekësor bazë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si Autoritet Kontraktor dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor si autoritet financues, ku janë konstatuar devijime materiale dhe të përhapura nga kudri ligjor dhe rregullator. Nga auditimi i koncesionit të kontrollit mjekësor bazë rezultoi se, gjatë periudhës 2015–2025, volumi i projektuar prej 475,000 kontrollesh në vit është arritur dhe tejkaluar vetëm në vitin 2019, ndërsa në asnjë vit nuk është arritur ky projeksion për efekt pagesash. Deri më 31.12.2025, pagesat totale ndaj koncesionarit kanë arritur në 8,053 milionë lekë me TVSH, për 4,366,140 kontrolle të financuara, nga të cilat 3,877,008 kontrolle të realizuara dhe 489,132 kontrolle të pakryera. Pavarësisht volumit faktik të shërbimit, pagesat janë kryer mbi bazën e volumit minimal të garantuar prej 475,000 kontrollesh në vit, duke rezultuar në pagesa prej rreth 902 milionë lekë me TVSH për kontrolle të pakryera. Mekanizmi financiar i kontratës nuk ka krijuar një shpërndarje të balancuar të riskut kontraktual, pasi risku i mosrealizimit të volumit të projektuar të kontrolleve është përballuar nga Autoriteti Kontraktor. Si rrjedhojë, pagesa minimale e garantuar nuk ka funksionuar si një mekanizëm financimi i bazuar në rezultatet dhe performancën faktike të shërbimit, por si një mekanizëm që garanton mbulimin financiar të projektimit,

pavarësisht nivelit të realizimit të tij. Kjo nuk është shoqëruar me një analizë të treguesve financiarë të kontratës në krahasim me parashikimet sipas procedurës për lidhjen e saj me efekt në kryerje pagese për shërbim të pakryer. Nga auditimi i kontratës koncesionare, u konstatua se ky shërbim është trajtuar me TVSH, ndërkohë që ai duhet të trajtohet si furnizim i përjashtuar. Përfshirja e këtij shërbimi në fushën e zbatimit të TVSH-së i ka sjellë buxhetit të shtetit kosto shtesë në vlerën 1,342 milionë lekë. Gjithashtu janë konstatuar devijime nga kuadri i raportimit financiar, si për koncesiondhënësin dhe operatorin privat dhe problematika në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin tatimor, përsa i përket aktiveve të infrastrukturës së koncesionit. Nga auditimi i kontratës koncesionare u konstatua se nga ana e MSHMS-së në cilësinë e Autoriteti Kontraktor nuk është kryer asnjë monitorimi i zbatimit të kontratës koncesionare përgjatë viteve 2015-2022 si dhe monitorimi i kryer për periudhën 2022-2025 paraqet problematika. Nuk është ngritur Bordi i Administrimit të Projektit (BAP), sipas pikës 15 dhe aneksit 5 të kontratës koncesionare që në fazat e hershme të fillimit të zbatimit të kontratës koncesionare, pasi ky bord për herë të parë është ngritur në vitin 2022 me Urdhrin nr. 358 datë 03.10.2022. Sa i përket rezultateve të kontrollit mjekësor bazë për gjithë periudhën e zbatimit të konesionit, u konstatuan 491,621 raste ku megjithëse janë kryer dhe paguar kontrolle mjekësore bazë nga ana e pacientëve, nuk janë të regjistruara/hedhura në sistemin e KMB përgjigjet e plotësuara nga mjekët për këto analiza. U konstatua mospërputhje ndërmjet parashikimeve kontraktuale që rregullojnë vlerën e investimit fillestar dhe të riinvestimit, si dhe mangësi në monitorimin e përmbushjes së këtyre detyrimeve nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht, pika 1.5 e kontratës koncesionare përcakton se, në rast mospërputhjeje ndërmjet anekseve të kontratës, përparësi kanë Aneksi nr. 2 “Propozimi i Koncesionarit” dhe Aneksi nr. 3, sipas të cilëve investimi fillestar është përcaktuar në vlerën 476,881,820 lekë. Ndërkohë, Aneksi nr. 7 “Çështjet financiare” parashikon investim fillestar në vlerën 172,020,000 lekë, duke krijuar mospërputhje ndërmjet dokumenteve kontraktuale lidhur me vlerën e investimit. Nga auditimi i kontratës koncesionare dhe dokumentacionit të administruar nga Autoriteti Kontraktor u konstatua se nuk rezultoi të dokumentohej realizimi i investimit në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet kontraktuale përsa i përket vlerës së investimit dhe riinvestimit. Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të koncesionarit dhe zërave analitikë të aktiveve për vitet 2015, 2016 dhe 2017 rezultoi se, sipas pasqyrave financiare të koncesionarit, në fund të vitit 2015 janë pasqyruar investime në shumën 369,884,520 lekë. Faturimi i shërbimit ka filluar sipas çmimit të përcaktuar në kontratë, ndërkohë që nuk rezulton të jetë dokumentuar përmbushja e plotë e investimit fillestar sipas detyrimeve kontraktuale. Mospërputhjet ndërmjet dokumenteve kontraktuale dhe mungesa e monitorimit të realizimit të investimit fillestar dhe riinvestimeve nuk kanë mundësuar një vlerësim të plotë të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga koncesionari, duke krijuar mangësi në administrimin e kontratës dhe në procesin e vlerësimit përfundimtar të zbatimit të saj. Nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi kontraktual për ngritjen dhe funksionimin e 20 laboratorëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mosrealizimi i këtij komponenti të investimit ka sjellë devijim nga modeli dhe shpërndarja territoriale e shërbimit, mbi të cilin është bazuar oferta fituese dhe vlerësimi ekonomik i kontratës koncesionare. Mosrealizimi i këtyre investimeve dhe reduktimi i kostove operacionale nuk rezulton të jetë reflektuar në uljen e çmimit të shërbimit të Kontrollit Mjekësor Bazë, ndërkohë që nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk rezulton të jenë marrë masa për vlerësimin e ndikimit të këtyre devijimeve në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet palëve. Një pjesë e shërbimit të parashikuar për tu ofruar nga koncesionari është nënkontraktuar drejt palëve të treta, ku mënyra e realizimit të nënkontraktimit nuk është në përputhje me kërkesat e DST-së, nenit 19 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar, nenit 34 të kontratës koncesionare dhe ofertës fituese të koncesionarit. Megjithëse në nenin 52 “Administrimi i daljes” dhe në Aneksin 1 të kontratës koncesionare parashikohet detyrimi për hartimin dhe dakordësimin e një plani daljeje ndërmjet palëve, nga Autoriteti Kontraktor nuk rezulton të jetë hartuar dhe miratuar një plan i tillë.


Nga ana e Ministrisë së Financave nuk është finalizuar dhe nuk është publikuar *raporti i Performancës së Kontratave të Koncesionit dhe të Partneritetit Publik Privat për vitin 2025,* për të dytin vit radhazi, raport i cili përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të ecurisë dhe performancës financiare dhe jo financiare të kontratave të koncesionit/PPP dhe synon të sigurojë

që risqet kryesore fiskale nga kontratat e koncesionit/PPP janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike, në kundërshtim me pikën 4 dhe 7 të nenit 10 të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar ku përcaktohet detyrimi për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe raportimin e rregullt mbi ecurinë dhe ndikimet fiskale të kontratave koncesionare dhe PPP.

B.6.3 Detyrimet e prapambetura

Në fund të vitit 2025, stoku i detyrimeve të prapambetura rezultoi rreth 5.9 miliardë lekë, nga 7.32 miliardë lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar ulje me rreth 1.42 miliardë lekë, ose 19.4%. Pavarësisht kësaj ecurie, niveli i detyrimeve të prapambetura mbetet i konsiderueshëm, ndërkohë që gjatë vitit ka vijuar krijimi i detyrimeve të reja nga institucione të ndryshme publike.

Në strukturën e stokut të vitit 2025, detyrimet e qeverisë vendore zënë peshën kryesore, me rreth 2.93 miliardë lekë ose 49.7% të totalit, të ndjekura nga detyrimet e qeverisë qendrore me rreth 1.56 miliardë lekë ose 26.4%, dhe detyrimet për rimbursimin e TVSH-së me rreth 1.41 miliardë lekë ose 23.9%.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor: Në fund të vitit 2025, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore ka arritur në 2,933 milionë lekë, nga të cilat 2,886 milionë lekë për bashkitë dhe 47 milionë lekë për qarqet. Krahasuar me vitin 2024, stoku është ulur me 326 milionë lekë, ose 10%.

Nga analiza e shpërndarjes së detyrimeve të prapambetura rezulton një përqendrim i konsiderueshëm i tyre në një numër të kufizuar njësish të vetëqeverisjes vendore. Stokun më të lartë e ka Bashkia Kavajë, me 755.16 milionë lekë, ose 25.9% të totalit, e ndjekur nga Bashkia Pogradec, me 220.18 milionë lekë, ose 7.5%, dhe Bashkia Vorë, me 184.8 milionë lekë, ose 6.3%.

Saktësia e raportimit: Nga auditimi i saktësisë dhe plotësisë së raportimit të detyrimeve të prapambetura janë evidentuar mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet stokut të raportuar në fund të vitit 2024 dhe pagesave të kryera gjatë vitit 2025 për detyrime të periudhave të mëparshme. Konkretisht, për 23 bashki, pagesat e kryera gjatë vitit 2025 për detyrime të krijuara përpara muajit tetor 2024 kanë tejkaluar me 2,548 milionë lekë stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuar në fund të vitit 2024. Kjo mospërputhje evidenton mangësi të mundshme në identifikimin, regjistrimin dhe raportimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, duke cenuar besueshmërinë e të dhënave mbi gjendjen financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Nga auditimet janë evidentuar problematika në administrimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të lidhura me faturat e palikuiduara ndaj operatorëve ekonomikë dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Është konstatuar mungesa e një plani ose grafiku të qartë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke vështirësuar ndjekjen sistematike të tyre dhe menaxhimin e angazhimeve financiare të njësive vendore.

Mbi statusin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore: Referuar raportit mbi statusin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025, nga 61 bashki, 56 janë klasifikuar në kategorinë pa probleme financiare, 4 në kategorinë me probleme financiare dhe 1 në kategorinë në vështirësi financiare. Në kategorinë me probleme financiare përfshihen bashkitë Pogradec, Vorë, Dimal dhe Rrogozhinë, ndërsa Bashkia Kavajë vijon të klasifikohet në vështirësi financiare.


56 Pa probleme financiare	4 Me probleme financiare	1 Në vështirësi financiare

Statusi financiar	Bashkia	Detyrime dhjetor 2025	Detyrime / shpenzime faktike 2025
Me probleme financiare	Pogradec	220	15.17%
	Vorë	185	16.28%
	Dimal	141	18.17%
	Rrogozhinë	141	25.02%
Në vështirësi financiare	Kavajë	755	49.51%

Njësia: milionë lekë. Për 56 bashkitë e tjera nuk paraqiten vlera individuale të detyrimeve.
Burimi: Raporti "Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, 2025".

Krahasuar me vitin 2024, 5 bashki kanë përmirësuar statusin financiar, konkretisht bashkia Peqin, Konispol dhe Cërrik kanë kaluar nga kategoria me probleme financiare në atë pa probleme financiare, ndërsa Rrogozhina dhe Dimali kanë kaluar nga vështirësia financiare në kategorinë me probleme financiare. Situata më e rënduar mbetet në Bashkinë Kavajë, ku detyrimet e prapambetura përfaqësojnë 49.51% të shpenzimeve faktike vjetore.

Detyrimet e prapambetura në raport me të ardhurat e veta: Nga analiza e stokut të raportuar të detyrimeve të prapambetura në raport me të ardhurat e veta faktike të njësive të vetëqeverisjes vendore rezulton se, për vitin 2025, ky tregues ka arritur në 5.9%, kundrejt 7.3% në vitin 2024, duke shënuar një ulje prej 1.4 pikësh përqindjeje. Megjithatë, përmirësimi i treguesit në nivel të përgjithshëm nuk pasqyron në mënyrë të njëtrajtshme situatën financiare të të gjitha njësive, pasi evidentohen diferenca të konsiderueshme në raportin ndërmjet detyrimeve të prapambetura dhe kapacitetit të tyre për të gjeneruar të ardhura. Bashkia Peqin paraqet një nivel të detyrimeve të prapambetura që tejkalon të ardhurat e veta faktike vjetore, ndërsa në bashkitë Rrogozhinë, Memaliaj dhe Dimal stoku i detyrimeve i afrohet nivelit të këtyre të ardhurave. Kjo situatë evidenton një ekspozim të shtuar të këtyre njësive ndaj riskut të likuiditetit dhe vështirësive për shlyerjen e detyrimeve të akumuluara nëpërmjet burimeve të veta financiare. Raporti sipas bashkive paraqitet në grafikun në vijim.



Burimi i figurës: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave.

Përsa u përket njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohet se 14 bashki (në totalin bashki/qarqe) përbëjnë rreth 77% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore ku peshën kryesore e zënë Bashkia Kavajë me rreth 755.2 milionë lekë ose rreth 25.8% e totalit të detyrimeve, Bashkia Pogradec me 220.2 milionë lekë ose 7.5%, Bashkia Vorë me 184.8 milionë lekë ose 6.3%, Bashkia Rrogozhinë me 140.7 milionë lekë ose 4.8%, Bashkia Tiranë me 132.8 milionë lekë ose 4.5% etj.




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore: Në fund të vitit 2025, stoku i detyrimeve të prapambetura për njësitë e qeverisjes qendrore ka arritur në 1, 558 milionë lekë. Krahasuar me vitin 2024, stoku është ulur me 1,099 milionë lekë, ose 41.36%. Stokun më të lartë e ka Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me 366.5 milionë lekë, ose 23.52% të

totalit, e ndjekur nga Ministria e Shëndetësisë, me 260.2 milionë lekë, ose 16.7%, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me 256 milionë lekë, ose 16.43%, dhe Ministria e Mbrojtjes me 244.7 milionë lekë ose 15.71%


Përveç përqendrimit të stokut në një numër të kufizuar NJVQV-sh, ndryshime evidentohen edhe në strukturën e detyrimeve sipas natyrës së tyre. Rezulton se detyrimet për investime kanë pësuar një rritje nga 28.6% në vitin 2024 në 32% në vitin 2025. Nga ana tjetër, detyrimet e prapambetura të tjera janë ulur ndjeshëm, nga 32% në 25%. Rritje të ndjeshme ka shënuar edhe zëri shërbime, nga 11.3% në 16.2%, si dhe vendimet gjyqësore, nga 16.2% në 20%, çka tregon një rritje të peshës së detyrimeve që lidhen me kontrata shërbimi dhe vendime të gjykatave.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Konstatohet se 7 Ministri (*përkatësisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit)* përbëjnë rreth 86% të totalit të stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të qeverisjes qendrore, ku peshën kryesore e zë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 332.3 milionë lekë ose 21.3%, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me 260.2 milionë lekë ose 16.7%, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me 256 milionë lekë ose 16.4%, Ministria e Mbrojtjes me 244.7 milionë lekë ose 15.7% etj. Përveç përqendrimit të stokut në një numër të kufizuar të njësive qendrore, ndryshime evidentohen edhe në strukturën e detyrimeve sipas natyrës së tyre.

Nga sa më sipër, për njësitë e qeverisjes së përgjithshme qendrore rezulton se detyrimet për investime kanë pësuar rritje të ndjeshme, nga 41.2% në vitin 2024 në 46% në vitin 2025, duke u bërë zëri me peshën më të madhe në total. Vendimet gjyqësore, edhe pse mbeten një kategori me ndikim të lartë, kanë rënë nga 34.3% në 26%.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Për sa i përket saktësisë dhe plotësisë së të dhënave të raportuara për pagesat e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2025, si dhe për stokun në datën 31 dhjetor 2025, u evidentua se ky raportim nuk rezulton i plotë dhe i saktë. Sipas të dhënave të audituara nga sistemi SIFQ, rezulton se vlera faktike e pagesave të kryera për detyrime të prapambetura gjatë vitit 2025 (duke përfshirë edhe ato detyrime të vitit 2025 mbi 60 ditë) është rreth 1,793 milionë lekë më e lartë sesa ajo e raportuar. Kjo diferencë tregon se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve kanë kryer pagesa për detyrime të prapambetura pa i regjistruar ato përmes skemës së përcaktuar të kontabilizimit, pra pa përdorur llogarinë 486, me efekt në pasaktësi të vlerës së raportuar të pagesave të detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2025, duke nënvlerësuar detyrimet e prapambetura të periudhës së mëparshme dhe periudhës objekt auditimi 31.12.2025.

Nga analizat e kryera mbi 1,164 institucione/njësi të testuara, për 373 prej tyre u konstatuan mospërputhje ndërmjet pagesave faktike të evidentuara në sistemin SIFQ dhe pagesave të raportuara për detyrimet e prapambetura.

▸ Konkretisht, në 193 institucione pagesat e raportuara rezultojnë më të ulëta se pagesat faktike të evidentuara në SIFQ, me një diferencë kumulative prej 4,467 milionë lekë. Në këtë kategori përfshihen, ndër të tjera, AKSHI, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, ARRSH, FSHZH, Bashkia Kavajë, etj.
▸ Në 87 institucione, pagesat e raportuara rezultojnë më të larta se ato të evidentuara në SIFQ, me një diferencë kumulative prej 2,709 milionë lekë. Ndër institucionet me mospërputhje të kësaj natyre përfshihen Bashkia Tiranë, INUK, Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Bashkia Kurbin, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, etj.
▸ Gjithashtu, për 43 institucione, të cilat nuk rezultojnë të përfshira në databazën e raportimeve për detyrimet e prapambetura për vitin 2025, nga sistemi SIFQ u evidentuan pagesa në vlerën totale rreth 101 milionë lekë. Në këtë grup përfshihen, ndër të tjera, Bashkia Bulqizë, Zyra Arsimore Malësia e Madhe dhe Agjencia Kombëtare e Duhanit. Në kahun tjetër, 50 institucione kanë raportuar pagesa për detyrime të prapambetura, ndërkohë që në sistemin SIFQ nuk rezultojnë pagesa të tilla, me një diferencë totale rreth 66 milionë lekë.

Në drejtim të dinamikës së stokut të detyrimeve, institucionet me rritjen më të lartë gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024, rezultojnë Autoriteti Rrugor Shqiptar me 6,471 milionë lekë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me 4,569 milionë lekë, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" me 3,606 milionë lekë, Bashkia Tiranë me 3,202 milionë lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve me 1,634 milionë lekë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit me 1,407 milionë lekë.

Këto devijime tregojnë se procesi i raportimit të detyrimeve të prapambetura nuk është monitoruar në mënyrë të plotë dhe nuk ka garantuar saktësinë dhe plotësinë e vlerave të raportuara në përputhje me të dhënat faktike të pagesave, sipas kritereve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të Qeverisjes së Përgjithshme". Sa i takon, skemës së kontabilizimit të faturave të prapambetura si "shpenzime të periudhave të ardhshme", ajo ka mbetur e pandryshuar dhe në kundërshtim me pikën 36 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, sipas të cilit shpenzimi duhet të njihet në momentin kur ndodh ose kryhet, duke sjellë devijime të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskalë.

B.6.4 Detyrimet kontigjente nga çështjet gjyqësore ndërkombëtare

Në detyrimet kontigjente përfshihen detyrimet që kanë lindur apo mund të lindin nga Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), përfshirë çështjet që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe nga vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar për mosmarrëveshjet dy- dhe shumëpalëshe.



a) Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)

Gjatë vitit 2025, Këshilli i Ministrave ka miratuar 4 vendime për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, me vlerë totale 56,500 euro (rreth 5.56 milionë lekë), të përballuara nga Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit, si në vijim:

▸VKM 547/2025 "Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 16.07.2024 për çështjen Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V kundër Shqipërisë", në vlerën 17,200 Euro.

▸VKM 592/2025 “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 10.12.2024 për çështjen Ramaj kundër Shqipërisë”, në vlerën 14,000 Euro.
▸VKM 724/2025 “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 14.01.2025 për çështjen Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 12,800 Euro.
▸VKM 652/2025 “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ datë 27.05.2025 për çështjen ARB, sh.p.k dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 12,500 Euro.
Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave ka ekzekutuar gjithashtu 13 vendime të GJEDNJ-së, me vlerë totale 55,905 euro (rreth 5.57 milionë lekë). Në fund të vitit 2025, detyrimet faktike dhe kontingjente të raportuara për vendimet e GJEDNJ-së rezultojnë në vlerën 19.95 milionë euro, që lidhen me 9 vendime në tejkalim të afatit tremujor të ekzekutimit. Moslikuidimi brenda afatit ka sjellë vijimin e përllogaritjes së interesave për pagesë të vonuar, ku pothuajse gjithë pesha i atribuohet 3 vendimeve, me vlerë totale të interesave të përllogaritura, në rreth 4.59 milionë euro në fund të vitit 2025 nga rreth 4 milionë euro në fund të vitit 2024 (rreth 56.7 milionë lekë).

b) Çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar
Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me vendimet e formës së prerë për zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy/shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, me efekte të konsiderueshme financiare dhe për pasojë me risk të lartë për buxhetin e shtetit. Në fund të vitit 2025, detyrimet faktike dhe kontingjente të raportuara për çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar rezultojnë në 179.95 milionë euro, në të njëjtin nivel me fundin e vitit 2024. Kostot e përballuara nga buxheti gjatë vitit 2025, për çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar, përfshirë shpenzimet ligjore, të mbrojtjes dhe shpenzime të tjera të lidhura me procedurat, rezultuan në rreth 147.5 milionë lekë (rreth 1.51 milionë Euro), nga të cilat 145.6 milionë lekë, ose rreth 99%, janë përballuar nga Ministria e Financave.
Për sa i përket raportimit të bërë nga Avokatura e Shtetit në lidhje me çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar që janë fituar nga RSH dhe janë njohur nga Gjykata e Apelit deri në datën 31.12.2025 rezulton se janë 2 vendime të fituara nga RSH dhe të njohura nga Gjykata e Apelit, konkretisht vendimi ICC Case no. 22919/GR (ICC 2 (2017)) dhe vendimi ICC Case 21349/GR (2015) . Nga këto dy vendime, vetëm vendimi ICC Case no. 22919/GR (ICC 2 (2017)) përmban detyrim financiar në favor të RSH-së, në shumën prej 731,280 euro, si dhe 1,795.60 GBP (në total rreth 0.73 milionë euro) për kosto ligjore dhe të arbitrazhit. Këto vlera nuk rezultojnë të jenë arkëtuar deri në përfundim të mbylljes së auditimit në terren.


Detyrimet e GJEDNJ-së, Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe mosekzekutimi i tyre në kohë përbëjnë ekspozim fiskal potencial dhe, në rast të materializimit dhe financimit të tyre nga buxheti, mund të krijojnë nevoja shtesë financimi dhe presion mbi deficitin, likuiditetin dhe, në varësi të mënyrës së financimit, mbi borxhin publik.

B.6.5 Risqet fiskale nga dëmtimi i burimeve natyrore, fatkeqësitë dhe nevojat për rehabilitim
Nga auditimet e kryera nga KLSH në sektorët e mjedisit, energjisë, administrimit të burimeve minerare e pyjore, ujitjes dhe kullimit, si dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, janë evidentuar mangësi në parandalimin dhe monitorimin e dëmeve, mirëmbajtjen e infrastrukturës, zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe mjedisore, monitorimin nga strukturat përgjegjëse, si dhe vlerësimin e kostove të rehabilitimit. Këto problematika krijojnë ekspozim të mundshëm financiar për buxhetin e shtetit, si pasojë e nevojave për ndërhyrje rehabilituese dhe emergjente, dëmeve ndaj pasurisë publike e private dhe detyrimeve të mundshme që mund të lindin nga përgjegjësitë e institucioneve publike. Ky ekspozim shoqërohet me nevoja shtesë për financim nga buxheti i shtetit në periudhat pasardhëse, duke ndikuar në parashikueshmërinë e shpenzimeve dhe qëndrueshmërinë e planifikimit buxhetor.
Në këtë kuadër, ligji nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon mekanizma buxhetorë për përballimin e shpenzimeve të paparashikuara. Megjithatë, është konstatuar mungesa e analizave nga institucionet përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, detyrimet e mundshme dhe kostot e ndërhyrjeve rehabilituese, shoqëruar me mos kryerjen e identifikimit të risqeve fiskale, dhe rrjedhimisht mos marrjen e masave për adresimin e tyre.


C. DEFICITI BUXHETOR

C.1 Ecuria e deficitit buxhetor

Deficiti buxhetor për vitin 2025 ka rezultuar në shumën 47,089 milionë lekë, me një rritje prej 29,105 milionë lekë, ose 161.8%, krahasuar me vitin 2024, kur ishte 17,984 milionë lekë. Plani fillestar i deficitit prej 68,052 milionë lekë ka mbetur i pandryshuar deri në Aktin Normativ nr. 6, ndërsa me Aktin Normativ nr. 10 është ulur në 61,644 milionë lekë, pa pësuar ndryshime të mëtejshme deri në fund të vitit. Deficiti faktik ka përfaqësuar 76.4% të planit përfundimtar, duke rezultuar 14,555 milionë lekë më i ulët se ky plan dhe 20,963 milionë lekë më i ulët se parashikimi fillestar. Pavarësisht rritjes së ndjeshme krahasuar me vitin 2024, deficiti ka mbetur brenda kufirit të miratuar për vitin 2025.



Faktorët që kanë ndikuar në deficitin buxhetor



Rritja e deficitit buxhetor në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, lidhet me rritjen më të madhe të shpenzimeve kundrejt të ardhurave buxhetore. Të ardhurat totale janë rritur nga 710,587 milionë lekë në vitin 2024 në 754,608 milionë lekë në vitin 2025, me një shtesë prej 44,021 milionë lekë. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet totale janë rritur nga 728,571 milionë lekë në 801,696 milionë lekë, me një shtesë prej 73,125 milionë lekë. Diferenca ndërmjet këtyre dy shtesave, prej rreth 29.1 miliardë lekë, shpjegon zgjerimin e deficitit buxhetor nga 17,984 milionë lekë në vitin 2024 në 47,089 milionë lekë në vitin 2025.

C.2 Financimi i deficitit buxhetor

Në milionë lekë

EMËRTIMI	Fakti 2024	Projekt Buxheti 2025	Buxheti 2025	AN 3/2025	AN 6/2025	AN 10/2025	AN 11/2025	Fakti 2025	Δ ndaj AN 11/2025	Δ ndaj Faktit 2024
DEFICITI	**-17,984**	**-68,052**	**-68,052**	**-68,052**	**-68,052**	**-61,644**	**-61,644**	**-47,089**	**▲ 14,555**	**▼ 29,105**
FINANCIMI I DEFICITIT	**17,984**	**68,052**	**68,052**	**68,052**	**68,052**	**61,644**	**61,644**	**47,089**	**▼ 14,555**	**▲ 29,105**
Financimi i brendshëm	**33,360**	**59,828**	**59,828**	**59,828**	**59,828**	**52,734**	**52,734**	**38,847**	**▼ 13,887**	**▲ 5,487**
Të ardhura nga privatizimi	27							**301**	—	**▲ 274**
Huamarrje e brendshme	49,718	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	**49,338**	**▼ 662**	**▼ 380**
Të tjera	-16,385	9,828	9,828	9,828	9,828	2,734	2,734	**-10,791**	**▼ 13,525**	**▲ 5,594**
Financimi i huaj	**-15,376**	**8,224**	**8,224**	**8,224**	**8,224**	**8,910**	**8,910**	**8,242**	**▼ 668**	**▲ 23,618**
Hua afatgjatë (e marrë)	12,968	92,848	92,848	92,848	92,848	88,520	88,520	**78,818**	**▼ 9,702**	**▲ 65,850**
Ndryshimi i gjendjes së arkës	-256							**-575**	—	**▼ 319**
Ripagesat	-40,453	-103,120	-103,120	-103,120	-103,120	-93,753	-93,753	**-90,336**	**▲ 3,417**	**▼ 49,883**
Mbështetje buxhetore	12,366	18,496	18,496	18,496	18,496	14,142	14,142	**20,335**	**▲ 6,193**	**▲ 7,969**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH. Δ = Fakti 2025 minus kolona e referuar; ▲ rritje ▼ ulje

Për financimin e deficitit faktik prej 47,089 milionë lekë, gjatë vitit 2025 janë përdorur burime të brendshme dhe të huaja. Financimi i brendshëm neto rezultoi në shumën 38,847 milionë lekë, ndërsa financimi i huaj neto në shumën 8,242 milionë lekë, duke rakorduar në total me nivelin e deficitit buxhetor të raportuar. Burimet e brendshme kanë përfaqësuar rreth 82.5% të financimit total të deficitit, ndërsa burimet e huaja rreth 17.5%.

Krahasuar me planin përfundimtar prej 61,644 milionë lekë, financimi total rezultoi 14,555 milionë lekë më i ulët, në përputhje me nivelin më të ulët të deficitit faktik kundrejt deficitit të planifikuar.

C.2.1 Financimi i brendshëm


Financimi i brendshëm neto është raportuar në shumën 38,847 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 52,734 milionë lekë, me një diferencë prej 13,887 milionë lekë nën plan. Në përbërje të tij, huamarrja e brendshme është raportuar në shumën 49,338 milionë lekë, kundrejt 50,000 milionë lekëve të planifikuara, ose në masën 98.7% të planit. Të ardhurat nga privatizimi janë raportuar në shumën 301 milionë lekë, ndërsa zëri "Të tjera" në vlerën −10,791 milionë lekë.
Diferenca e financimit të brendshëm neto kundrejt planit përfundimtar është ndikuar kryesisht nga zëri "Të tjera", i cili ka rezultuar 13,525 milionë lekë nën plan, ndërsa huamarrja e brendshme ka qenë 662 milionë lekë më e ulët se niveli i parashikuar. Këto diferenca janë kompensuar pjesërisht nga të ardhurat prej 301 milionë lekë nga privatizimet, të paparashikuara në planin përfundimtar.
Zëri "Të tjera", i cili përfshin lëvizjet e mjeteve monetare në Llogarinë e Vetme të Thesarit (TSA), në katër monedhat, si dhe në llogaritë e tjera buxhetore të raportuara nën vijën e deficitit, është rishikuar gjatë vitit nga 9,828 milionë lekë në planin fillestar në 2,734 milionë lekë në planin përfundimtar.

C.2.2 Financimi i huaj

Financimi i huaj neto ka rezultuar në shumën 8,242 milionë lekë, kundrejt planit përfundimtar prej 8,910 milionë lekë, ose 668 milionë lekë nën plan. Huamarrjet afatgjata të marra gjatë vitit janë raportuar në shumën 78,818 milionë lekë, kundrejt 88,520 milionë lekëve të planifikuara, me një diferencë prej 9,702 milionë lekë nën plan. Ripagesat e principalit janë raportuar në shumën 90,336 milionë lekë, kundrejt 93,753 milionë lekëve të planifikuara, ose 3,417 milionë lekë më pak.
Huamarrjet afatgjata të marra gjatë vitit kanë qenë 11,518 milionë lekë më të ulëta se ripagesat e principalit. Megjithatë, financimi i huaj neto ka rezultuar pozitiv, pasi kjo diferencë është mbuluar nga mbështetja buxhetore prej 20,335 milionë lekë, duke marrë parasysh edhe ndryshimin e gjendjes së arkës prej −575 milionë lekë. Mbështetja buxhetore ka tejkaluar planin përfundimtar me 6,193 milionë lekë, duke kompensuar pjesërisht nivelin më të ulët të huamarrjeve afatgjata kundrejt planit. Sipas evidencave analitike të shqyrtuara, transaksioni i Eurobondit të realizuar gjatë vitit 2025 është përfshirë në zërin "Hua afatgjatë e marrë".


C.3 Ecuria mujore e deficitit dhe përqëndrimi i shpenzimeve në fund të vitit

Nga analiza e ecurisë mujore të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore konstatohet një përqendrim i ndjeshëm i shpenzimeve në muajin dhjetor 2025, i cili ka ndikuar në ndryshimin e pozicionit fiskal të akumuluar deri në fund të muajit nëntor.
Deri në fund të muajit nëntor 2025, diferenca kumulative ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve ka rezultuar në një suficit buxhetor prej rreth 49,118 milionë lekë. Gjatë muajit dhjetor, të ardhurat buxhetore rezultuan në shumën 66,337 milionë lekë, ndërsa shpenzimet arritën në 162,544 milionë lekë, duke krijuar për këtë muaj një diferencë negative prej rreth 96,207 milionë lekë. Si rezultat, suficiti i akumuluar gjatë periudhës janar–nëntor u përthith tërësisht nga niveli i shpenzimeve të realizuara në muajin dhjetor dhe viti 2025 u mbyll me një deficit buxhetor prej 47,089 milionë lekë.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Grafiku i mëposhtëm paraqet situatën e treguesve të të ardhurave, shpenzime dhe deficitit/suficitit progresiv sipas muajve:



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Shpenzimet e realizuara gjatë muajit dhjetor 2025, në shumën 162,544 milionë lekë, përfaqësojnë rreth 20.3% të shpenzimeve vjetore prej 801,696 milionë lekë. Përqendrimi ka qenë më i theksuar në shpenzimet kapitale, të cilat gjatë këtij muaji janë realizuar në shumën 53,410 milionë lekë, ose rreth 40.6% të totalit vjetor prej 131,578 milionë lekë. Gjithashtu, në dhjetor është regjistruar transferta prej 16,587 milionë lekë për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në Bankën e Shqipërisë, duke kontribuar në nivelin e shpenzimeve të raportuara për këtë muaj. Kjo transfertë ka përfaqësuar rreth 10.2% të shpenzimeve të raportuara për muajin dhjetor.

Kjo ecuri evidenton një shpërndarje jo të njëtrajtshme të shpenzimeve gjatë vitit, me përqendrim të theksuar në muajin dhjetor, veçanërisht për investimet publike. Krahas kësaj, auditimi ka evidentuar problematika në detajimin dhe rialokimin e fondeve në pjesën e fundit të vitit, si dhe në regjistrimin e transaksioneve me vlerë materiale në mbyllje të periudhës buxhetore. Në këtë kontekst, përqendrimi i shpenzimeve në fund të vitit, së bashku me problematikat e evidentuara në detajimin dhe rialokimin e fondeve gjatë kësaj periudhe, evidenton se realizimi i treguesve vjetorë nuk pasqyron, më vete, ecurinë e ekzekutimit të buxhetit gjatë vitit dhe përputhshmërinë e pagesave me planifikimin kohor, nevojat për likuiditet dhe progresin faktik të projekteve e veprimtarive të financuara.

C.4 Saktësia e raportimit të deficitit buxhetor

Deficiti buxhetor i raportuar për vitin 2025 nuk ka tejkaluar nivelin e parashikuar në buxhetin përfundimtar. Megjithatë, nga auditimi janë evidentuar pasaktësi në njohjen, klasifikimin dhe raportimin e disa zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat krijojnë risk për saktësinë e treguesve fiskalë dhe mund të ndikojnë në deficitin e raportuar, në varësi të natyrës së transaksioneve dhe bazës së raportimit. Këto çështje janë trajtuar hollësisht në pjesët përkatëse të këtij raporti dhe përmblidhen si më poshtë:

▸ *Mbivlerësimi i të ardhurave tatimore:* Në të ardhurat e raportuara nga DPT-ja janë përfshirë 3,759 milionë lekë nga llogaritë e parapagimeve, të cilat, nuk përmbushin kushtet për njohjen si të ardhura buxhetore sipas Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

▸ *Mbivlerësim i shpenzimeve për ndryshimin neto të detyrimeve të prapambetura*: Në shpenzimet e buxhetit të vitit 2025 janë përfshirë pagesa prej 9,462.18 milionë lekë për detyrime të viteve të kaluara. Ndërkohë, në përllogaritjen e paraqitur nga auditimi është përfshirë edhe shuma −4,701 milionë lekë që përbën stokun e detyrimeve të prapambetura në 31.12.2025, të cilat nuk janë njohur si shpenzim i vitit 2025. Për shkak të parregullsive të evidentuara në regjistrimin, njohjen dhe raportimin e këtyre detyrimeve në SIFQ, përllogaritja e ndikimit të tyre neto mbi shpenzimet dhe deficitin paraqitet me rezerva.

▸ *Mbivlerësimi i shpenzimeve nga transferta për Fondin e Pensioneve:* Në shpenzimet buxhetore është përfshirë shuma 16,587 milionë lekë për transfertën në Llogarinë e Fondit të Pensioneve në Bankën e Shqipërisë. Referuar natyrës së këtij transaksioni, përfshirja e tij si shpenzim buxhetor ka ndikuar në mbivlerësimin e shpenzimeve.


▸ *Nënvlerësimi i shpenzimeve për vendimet e GJEDNJ-së:* Në shpenzimet e vitit 2025 nuk janë përfshirë interesat e akumuluara gjatë këtij viti për vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të

Njeriut, në shumën 585,503 euro, të vlerësuara në 56.7 milionë lekë. Mosnjohja e kësaj shume ndikon në nënvlerësimin e shpenzimeve dhe të deficitit të raportuar. Kjo përllogaritje nuk përfshin detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore ndërkombëtare të viteve të mëparshme, për të cilat nuk disponohet informacion i plotë mbi vlerën dhe statusin e shlyerjes, ndërkohë që vonesat në ekzekutimin e tyre gjenerojnë kosto shtesë.

▸ *Mangësi në evidentimin e detyrimeve të tjera financiare:* Nga auditimi janë evidentuar mangësi në dokumentimin dhe raportimin e detyrimeve financiare që lidhen me procesin e njohjes dhe kompensimit të pronës së ish-pronarëve, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë, si dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare. Mungesa e evidencave të plota dhe të rakorduara për detyrimet e krijuara gjatë vitit, krahas stokut të akumuluar, ka kufizuar mundësinë e vlerësimit të plotë të këtyre detyrimeve dhe të ndikimit të tyre në raportimin buxhetor dhe financiar.

Problematikat e evidentuara lidhen me mangësi në zbatimin e rregullave për njohjen, klasifikimin dhe raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Këto elemente ndikojnë në drejtime të ndryshme në nivelin e deficitit të raportuar, ndërsa mangësitë në evidentimin, dokumentimin dhe rakordimin e detyrimeve financiare, përfshirë detyrimet e prapambetura, ato që lidhen me njohjen dhe kompensimin e pronës së ish-pronarëve, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kufizojnë mundësinë e përcaktimit të plotë dhe të saktë të treguesve fiskal. Në veçanti, mungesa e informacionit të konsoliduar mbi detyrimet e krijuara gjatë vitit dhe stokun e akumuluar vështirëson vlerësimin e ekspozimit financiar të shtetit dhe të nevojave për financim në periudhat pasardhëse.

D. Borxhi Publik: Menaxhimi dhe Raportimi



D.1 Ecuria, struktura dhe financimi i borxhit publik

Gjatë vitit 2025, stoku i borxhit publik ka shënuar rritje në terma nominalë, ndërsa raporti i tij ndaj PBB-së është ulur, si rezultat i rritjes më të shpejtë të PBB-së nominale. Në përbërje të stokut, borxhi i brendshëm është rritur me 43,517 milionë lekë, ndërsa borxhi i jashtëm është ulur me 6,989 milionë lekë, duke reflektuar ecuri të ndryshme të dy komponentëve kryesorë të borxhit publik.

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit të jashtëm të qeverisjes qendrore ka rezultuar në rreth 548,200 milionë lekë, kundrejt 555,189 milionë lekëve në fund të vitit 2024. Ulja prej 6,989 milionë lekë është ndikuar nga pakësimi i borxhit të jashtëm shtetëror me 8,075 milionë lekë, i kompensuar pjesërisht nga rritja e borxhit të jashtëm të garantuar nga shteti me 1,086 milionë lekë. Ky i fundit ka arritur në 20,509 milionë lekë, nga 19,423 milionë lekë në vitin 2024, me një rritje prej 5.6%.

Në ecurinë e stokut të borxhit publik, krahas huamarrjeve dhe shlyerjeve të principalit, kanë ndikuar edhe luhatjet e kursit të këmbimit. Konkretisht, rivlerësimi valutor ka sjellë një efekt në ulje prej 19,275.83 milionë lekë në stokun e përgjithshëm të borxhit të shprehur në monedhën kombëtare.

Sa i përket financimit të jashtëm, gjatë vitit 2025, në sistemin e menaxhimit të borxhit janë regjistruar disbursime për 34 kredi dhe financime, në vlerën totale prej 105,267 milionë lekë, nga të cilat 6,501 milionë lekë për 4 kredi të garantuara dhe 98,766 milionë lekë për 30 kredi dhe financime të tjera. Analiza e detajuar e stokut, strukturës dhe financimit të borxhit publik, përfshirë marrëveshjet e reja të huasë, emetimin e Eurobondit dhe financimet në kuadër të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian, paraqitet në nënseksionet në vijim.

D.1.1 Ecuria e stokut të borxhit publik dhe raporti ndaj PBB-së

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit publik është raportuar në shumën 1,401,519 milionë lekë, kundrejt 1,365,007 milionë lekëve në fund të vitit 2024, duke shënuar një rritje nominale prej 36,512 milionë lekë, ose 2.7%. Në të njëjtën periudhë, PBB-ja nominale është rritur nga 2,517,820 milionë lekë në 2,650,990 milionë lekë, me një shtesë prej 133,170 milionë lekë, ose 5.3%. Si rezultat i rritjes së PBB-së nominale me ritme më të larta se stoku i borxhit publik, raporti borxh/PBB është ulur nga 54.21% në vitin 2024 në 52.87% në vitin 2025, me një diferencë prej 1.34 pikë përqindjeje. Ecuria e treguesve kryesorë të borxhit publik për periudhën 2017–2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë, përveç raporteve në %

EMËRTIMI	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025*	Δ 2025/2024
Borxhi publik	**1,088,169**	**1,107,285**	**1,112,626**	**1,224,470**	**1,382,940**	**1,378,626**	**1,362,828**	**1,365,007**	**1,401,519**	**▲ 36,512**
Borxhi i qeverisë qendrore	1,087,342	1,106,569	1,112,044	1,224,038	1,382,625	1,378,421	1,362,727	1,364,983	**1,401,509**	**▲ 36,526**
Borxhi i pushtetit vendor	827	716	582	432	315	204	101	24	**10**	**▼ 14**
PBB[1]	1,579,056	1,660,820	1,712,037	1,655,984	1,866,672	2,149,742	2,364,276	2,517,820	**2,650,990**	**▲ 133,170**
Stoku i borxhit / PBB (%)	**68.91%**	**66.67%**	**64.99%**	**73.94%**	**74.09%**	**64.13%**	**57.64%**	**54.21%**	**52.87%**	**▼ 1.34 pp**
Borxhi i qeverisë qendrore / PBB (%)	68.86%	66.63%	64.95%	73.92%	74.07%	64.12%	57.64%	54.21%	**52.87%**	**▼ 1.34 pp**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH. Δ = 2025 minus 2024; ▲ rritje ▼ ulje; pp = pikë përqindjeje.

Ulja e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së gjatë vitit 2025 nuk është shoqëruar me reduktim të stokut në vlerë absolute. Stoku nominal është rritur me rreth 36.5 miliardë lekë, ndërsa PBB-ja nominale është rritur me rreth 133.2 miliardë lekë, me ritëm më të lartë se borxhi. Në uljen e raportit ka ndikuar edhe rivlerësimi i borxhit në valutë si pasojë e ndryshimeve të kursit të këmbimit,

me efekt në ulje prej 19,275.83 milionë lekë mbi vlerën e stokut të shprehur në lekë, ekuivalente me rreth 0.73% të PBB-së së vitit 2025. Ky efekt përfaqëson rreth 54.5% të reduktimit prej 1.34 pikë përqindjeje të raportit borxh/PBB, duke evidentuar ndikimin e konsiderueshëm të kursit të këmbimit në ecurinë e këtij treguesi.

D.1.2 Huamarrja për financimin e deficitit

Deficiti buxhetor për vitin 2025 rezultoi në shumën 47,089 milionë lekë, i financuar nga burime të brendshme në shumën 38,847 milionë lekë dhe burime të huaja në shumën 8,242 milionë lekë. Sipas treguesve fiskalë të konsoliduar, financimi i brendshëm nëpërmjet instrumenteve të borxhit, përkatësisht bonove të thesarit dhe obligacioneve, rezultoi në shumën 49,338 milionë lekë, ose 662 milionë lekë më pak se plani prej 50,000 milionë lekë. Ndërkohë, zëri "Të tjera", që përfshin lëvizjet në gjendjet e llogarive dhe mjetet në ruajtje, rezultoi në shumën -10,791 milionë lekë dhe 301 milionë lekë të ardhura nga privatizimi kanë shërbyer për financimin e deficitit të brendshëm. Sa i përket financimit të huaj, huamarrja e re afatgjatë rezultoi në shumën 78,818 milionë lekë, kundrejt 88,520 milionë lekëve të planifikuara, ose 9,702 milionë lekë më pak se plani. Ndërkohë, mbështetja buxhetore rezultoi në shumën 20,335 milionë lekë, kundrejt 14,142 milionë lekëve të planifikuara, duke shënuar një tejkalim prej 6,193 milionë lekë. Ripagesat e principalit të borxhit të jashtëm arritën në 90,336 milionë lekë, kundrejt 93,753 milionë lekëve të planifikuara, ose 3,417 milionë lekë më pak. Pjesa tjetër prej 575 milionë lekë në financimin e jashtëm të deficitit përfshin ndryshimin e gjendjes së arkës sipas raportimit në treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar. Të dhënat mbi financimin e deficitit buxhetor për vitin 2025, sipas burimeve të financimit dhe në krahasim me planin e ndryshuar, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Emërtimi	Fakti 2024	Buxheti 2025	A.N. 3	A.N. 6	A.N. 10	A.N. 11	Fakti 2025	Δ Fakti 2025 - A.N. 11	Ndryshimi (%)
Deficiti	**-17,984**	**-68,052**	**-68,052**	**-68,052**	**-61,644**	**-61,644**	**-47,089**	**▲ 14,555**	**+23.61%**
Financimi i deficitit	**17,984**	**68,052**	**68,052**	**68,052**	**61,644**	**61,644**	**47,089**	**▼ 14,555**	**-23.61%**
Financimi i brendshëm	**33,360**	**59,828**	**59,828**	**59,828**	**52,734**	**52,734**	**38,847**	**▼ 13,887**	**-26.33%**
Të ardhura nga privatizimi	27	—	—	—	—	—	**301**	**▲ 301**	**—**
Huamarrje e brendshme	49,718	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	**49,338**	**▼ 662**	**-1.32%**
Të tjera	-16,385	9,828	9,828	9,828	2,734	2,734	**-10,791**	**▼ 13,525**	**-494.70%**
Financimi i huaj	**-15,376**	**8,224**	**8,224**	**8,224**	**8,910**	**8,910**	**8,242**	**▼ 668**	**-7.50%**
Hua afatgjata (të marra)	12,968	92,848	92,848	92,848	88,520	88,520	**78,818**	**▼ 9,702**	**-10.96%**
Ndryshimi i gjendjes së arkës	-256	—	—	—	—	—	**-575**	**▼ 575**	**—**
Ripagesat	-40,453	-103,120	-103,120	-103,120	-93,737	-93,737	**-90,336**	**▲ 3,417**	**+3.64%**
Mbështetje buxhetore	12,366	18,496	18,496	18,496	14,142	14,142	**20,335**	**▲ 6,193**	**+43.79%**

Δ = Fakti 2025 − A.N. 11; përqindja ndaj A.N. 11. Në deficit, ulja e vlerës negative tregon përmirësim.
Për llogaritjen e Δ, qelizat bosh të A.N. 11 trajtohen si zero; përqindja nuk llogaritet kur baza është zero.

Nga krahasimi i të dhënave të raportuara në treguesit fiskalë të konsoliduar me ato të Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave, u konstatua një mospërputhje prej 387 milionë lekë në vlerën e huamarrjes së jashtme afatgjatë. Konkretisht, në treguesit fiskalë kjo huamarrje është raportuar në shumën 78,818 milionë lekë, ndërsa sipas të dhënave të sistemit të borxhit rezulton në shumën 78,431 milionë lekë. Nga auditimi rezultoi se disbursimet e projekteve me financim të huaj janë rakorduar në fund të vitit 2025 ndërmjet strukturave përgjegjëse të Thesarit dhe Borxhit në monedhën origjinale të disbursimit, pa evidentuar diferenca në këto vlera. Megjithatë, mospërputhja prej 387 milionë lekë në raportimin e tyre në monedhën vendase lidhet me trajtimin e ndryshëm të komisioneve të disbursimit dhe përdorimin e kurseve të ndryshme të këmbimit gjatë regjistrimit të transaksioneve, duke evidentuar mangësitë në unifikimin e praktikave të trajtimit kontabël dhe të metodologjisë së konvertimit të disbursimeve në monedhën vendase.

Në përfundim, nga auditimi rezultoi se kufiri ligjor i huamarrjes së brendshme për vitin 2025 është respektuar. Megjithatë, financimi i deficitit është karakterizuar nga nënrealizimi i huamarrjes së jashtme afatgjatë, krahas tejkalimit të planit të mbështetjes buxhetore.

D.1.3 Struktura dhe ecuria e stokut të borxhit të qeverisjes qendrore

Gjatë vitit 2025, stoku i borxhit të qeverisjes qendrore ka shënuar rritje, ndikuar nga shtimi i borxhit të brendshëm dhe pakësimi i borxhit të jashtëm. Struktura e stokut të borxhit dhe ndryshimet sipas komponentëve përkatës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në milionë lekë

EMËRTIMI	2024	2025*	Δ 2025/2024	Ndryshimi (%)
Stoku i borxhit të brendshëm	**788,360**	**831,877**	**▲ 43,517**	**+5.52%**
Borxhi i brendshëm shtetëror*	774,197	**823,298**	**▲ 49,101**	**+6.34%**
Borxhi i brendshëm i garantuar	14,163	**8,579**	**▼ 5,584**	**-39.43%**
Stoku i borxhit të jashtëm	**576,621**	**569,632**	**▼ 6,989**	**-1.21%**
Borxhi i jashtëm shtetëror	557,198	**549,123**	**▼ 8,075**	**-1.45%**
Borxhi i jashtëm i garantuar	19,423	**20,509**	**▲ 1,086**	**+5.59%**
Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore	**1,364,981**	**1,401,509**	**▲ 36,528**	**+2.68%**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH. Δ = 2025 minus 2024; ▲ rritje ▼ ulje.

Krahasuar me vitin 2024, stoku i borxhit të brendshëm është rritur me 43,517 milionë lekë, ndërsa ai i jashtëm është ulur me 6,989 milionë lekë dhe stoku u borxhit të njësive të vetëqeverisjes vendore është ulur me rreth 14 milionë lekë. Rritja e borxhit të brendshëm ka ardhur nga shtimi i borxhit shtetëror me 49,101 milionë lekë, i shoqëruar me pakësimin e borxhit të garantuar me 5,584 milionë lekë. Ndërkohë, ulja e borxhit të jashtëm ka reflektuar pakësimin e borxhit shtetëror me 8,075 milionë lekë, të kompensuar pjesërisht nga rritja e borxhit të garantuar me 1,086 milionë lekë.

Në milionë lekë

FAKTORËT	VLERA
Stoku i borxhit më 31.12.2024	**1,365,007**
Huamarrja e re gjatë vitit	**+148,491**
E brendshme	49,338
E jashtme	99,153
Shlyerjet e principalit	−90,336
Efekti i kursit të këmbimit	−19,276
Rregullime të tjera	−2,367
Stoku i borxhit më 31.12.2025	**1,401,519**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Instrumentet e tregtueshme, si bonot e thesarit, obligacionet dhe eurobondet, vijojnë të zënë mbi 60% të stokut. Kjo strukturë pasqyron mbizotërimin e financimit nëpërmjet instrumenteve të emetuara në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga huatë e kontraktuara me kreditorë vendas dhe të huaj.

D.1.3.1. Borxhi i brendshëm

Gjatë vitit 2025, në tregun e brendshëm janë emetuar tituj shtetërorë me vlerë të përgjithshme prej 355.2 miliardë lekë, të raportuar me çmim blerjeje/të pastër, nga të cilët 186.1 miliardë lekë në bono thesari dhe 169.1 miliardë lekë obligacione. Të gjithë titujt e emetuar gjatë vitit në tregun e brendshëm janë në monedhën kombëtare, pa emetime në valutë të huaj.

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit të brendshëm shtetëror ka arritur në 823,298 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 49,101 milionë lekë, ose rreth 6.34%, krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje ka ardhur nga shtimi i stokut të obligacioneve me 59,664 milionë lekë, të kompensuar pjesërisht nga pakësimi i stokut të bonove të thesarit me 10,564 milionë lekë. Struktura dhe ndryshimet e stokut sipas instrumenteve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Instrumenti	2024	2025	Ndryshimi	Ndryshimi (%)
Bono thesari	192,987	182,423	−10,564	−5.50%
Obligacione	581,211	640,875	+59,664	+10.30%
Totali	**774,197**	**823,298**	**+49,101**	**+6.34%**

Burimi: Ministria e Financave.

Në strukturën e borxhit të brendshëm shtetëror, pesha e obligacioneve është rritur nga 75.1% në fund të vitit 2024 në 77.8% në fund të vitit 2025, me një stok prej 640,875 milionë lekë. Në të kundërt, pesha e bonove të thesarit është ulur nga 24.9% në 22.2%, me një stok prej 182,423 milionë lekë.

Brenda portofolit të bonove të thesarit, ulja e stokut është përqendruar te bonot 12-mujore, të cilat janë pakësuar me 11,310 milionë lekë, nga 192,745 milionë lekë në 181,435 milionë lekë. Ndërkohë, stoku i bonove 6-mujore është rritur me 746 milionë lekë, duke arritur në 988 milionë lekë. Pavarësisht këtij ndryshimi, bonot 12-mujore vijojnë të përfaqësojnë pjesën mbizotëruese të stokut të bonove të thesarit. Ndryshimet në stokun e obligacioneve sipas afatit të maturimit paraqiten si më poshtë:

Në milionë lekë

Afati i maturimit	2024	2025	Ndryshimi
2-vjeçare	107,720	106,190	**−1,530**
3-vjeçare	74,874	87,587	**+12,713**
5-vjeçare	136,405	156,941	**+20,536**
7-vjeçare	115,124	128,631	**+13,507**
10-vjeçare	127,763	128,420	**+657**
15-vjeçare	19,325	27,150	**+7,825**
20-vjeçare	—	5,956	**+5,956**

Burimi: Ministria e Financave.

Rritja e stokut të obligacioneve është përqendruar kryesisht në instrumentet 5-vjeçare dhe 7-vjeçare, përkatësisht me 20,536 milionë lekë dhe 13,507 milionë lekë, të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 57.1% të rritjes neto. Ritje është shënuar edhe në obligacionet 3-vjeçare, me 12,713 milionë lekë, dhe ato 15-vjeçare, me 7,825 milionë lekë. Në fund të vitit 2025, stoku i obligacioneve 20-vjeçare rezulton në 5,956 milionë lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 nuk raportohej stok për këtë kategori. Ndërkohë, obligacionet 10-vjeçare janë rritur me 657 milionë lekë, ndërsa ato 2-vjeçare janë pakësuar me 1,530 milionë lekë. Në tërësi, ecuria e borxhit të brendshëm gjatë vitit 2025 evidenton rritjen e peshës së obligacioneve në strukturën e stokut, me shtim të vlerës së tyre në disa kategori me maturitet më të gjatë, krahas reduktimit të stokut të bonove të thesarit.

D.1.3.2. Borxhi i jashtëm

Huamarrja e jashtme dhe disbursimet

Gjatë vitit 2025, në sistemin e brendshëm të menaxhimit të borxhit janë regjistruar transaksione disbursimi për 34 kredi/financime të jashtme, me vlerë të përgjithshme prej 105,267 milionë lekë, të shprehur në monedhën kombëtare. Nga kjo shumë, 6,501 milionë lekë u përkasin 4 kredive të garantuara, ndërsa 98,766 milionë lekë u përkasin 30 kredive dhe financimeve të tjera.



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Brenda grupit prej 30 kredish/financimesh, disbursimet e lidhura me 5 prej tyre, në shumën 20,335 milionë lekë, janë regjistruar si mbështetje buxhetore. Këto fonde janë transferuar drejtpërdrejt në llogarinë e unifikuar të Thesarit në monedhë të huaj, në dallim nga financimet e projekteve, të cilat disbursohen në llogaritë përkatëse speciale pranë Bankës së Shqipërisë. Financimet dhe vlerat përkatëse, të shprehura në euro dhe në milionë lekë, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Kreditori	MF Loan ID	Emërtimi	Shuma në euro	Shuma në milionë lekë
25/03/EU	25/03/EU	Lehtësia e Reformës dhe Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor	76,238,776.49	7,441.54
IBRD	22/05/IBRD	Modernizimi i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve	8,652,400.00	841.81
IBRD	23/01/IBRD	Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike nëpërmjet Gov.Tech	2,800,000.00	272.02
IBRD	25/04/IBRD	Financim shtesë: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike nëpërmjet Gov.Tech	8,500,000.00	821.27
IBRD	25/06/IBRD	Aftësia ripërtëritëse dhe zhvillimi i gjelbër – Hua e dytë për politikat e zhvillimit	113,600,000.00	10,957.90
TOTALI			**209,791,176.49**	**20,334.55**

Burimi: Ministria e Financave.

Pjesa tjetër e financimit të jashtëm, prej 78,431 milionë lekë, lidhet me 27 kredi dhe instrumente financimi, nga të cilat dy përfshijnë si disbursime për mbështetje buxhetore, ashtu edhe disbursime për projekte. Në këtë shumë përfshihet edhe Eurobondi i emetuar gjatë vitit 2025, në vlerën 63,063 milionë lekë, i cili përfaqëson rreth 80.4% të financimit të jashtëm afatgjatë të raportuar, ndërsa pjesa e mbetur, prej 15,368 milionë lekë, lidhet me financimet e tjera.

Financimet e reja të jashtme

Gjatë vitit 2025 janë evidentuar 11 financime të jashtme, që përfshijnë marrëveshje huaje dhe emetimin e Eurobondit, të destinuara për financimin e projekteve të investimit dhe mbështetjen e

buxhetit. Të dhënat mbi kreditorët, vlerat e financimit, monedhat përkatëse, stokun e raportuar dhe institucionet zbatuese paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Loan ID	Kreditori	Projekti	Shuma	Monedha	Stoku	Njësia zbatuese
25/01/ABUDHABI[1]	AbuDhabi	Mbështetje e përgjithshme buxhetore për përpjekjet për zhvillim	20,000,000.00	USD	—	Ministria e Financave
25/02/ABUDHABI[1]	AbuDhabi	Sistemi i kamerave nën administrimin e Policisë së Shtetit - Smart City	118,500,000.00	USD	—	Ministria e Brendshme
EUR10Y/25/2035	EuroBond	Mbështetje për buxhetin	650,000,000.00	EUR	650,000,000.00	Ministria e Financave
25/03/EU	Këshilli i Europës	Lehtësia e reformës dhe zgjerimit për Ballkanin Perëndimor	657,458,743.67	EUR	76,238,776.49	Ministria e Financave, SASPAC
25/04/IBRD	IBRD	Financim shtesë: Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike nëpërmjet Gov.Tech	76,900,000.00	EUR	9,092,250.00	Ministria e Financave dhe AKSHI
25/05/EIB[1]	EIB	Infrastruktura hekurudhore e Korridorit VIII – Faza 1, Shqipëri	30,000,000.00	EUR	—	Hekurudha Shqiptare
25/06/IBRD	IBRD	Aftësia ripërtëritëse dhe zhvillimi i gjelbër - Hua e dytë për politikat e zhvillimit	113,600,000.00	EUR	113,600,000.00	Ministria e Financave
25/09/EBRD[1]	EBRD	Korridori hekurudhor VIII – Faza I, Durrës-Rrogozhinë	30,000,000.00	EUR	—	Hekurudha Shqiptare
25/11/KFÊ[2]	KfÊ	Programi i infrastrukturës bashkiake V – Faza II	47,000,000.00	EUR	—	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKUK)
25/12/KFÊ[2]	KfÊ	Rehabilitimi i HEC Fierzë	40,000,000.00	EUR	—	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (KLSH)
25/13/ITALY[2]	Cassa Depositi & Prestiti	Përmirësimi i rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipërinë Veriore pas tërmetit 2019	35,000,000.00	EUR	—	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (OSHEE)

Burimi: Ministria e Financave.

Financimet e paraqitura përfshijnë projekte në sektorët e infrastrukturës hekurudhore, energjetike dhe bashkiake, modernizimin e shërbimeve publike nëpërmjet Gov.Tech, sigurinë publike, si dhe financime për mbështetje buxhetore dhe politika zhvillimi. Nga pikëpamja e monedhës, 9 financime janë në euro dhe 2 në dollarë amerikanë. Ndër financimet në euro, vlerat më të larta të paraqitura janë ato të Lehtësisë së Reformës dhe Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor, prej 657.5 milionë euro, dhe të Eurobondit, prej 650 milionë euro. Financimet në dollarë amerikanë përfshijnë mbështetjen e përgjithshme buxhetore, prej 20 milionë dollarë dhe projektin Smart City, prej 118.5 milionë dollarë.

Eurobondi

Për vlerësimin e propozimeve për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (Lead Manager) për transaksionet e Eurobondit janë përzgjedhur katër banka pjesëmarrëse, pavarësisht renditjes së tyre individuale sipas pikëve të përfituara. Propozimi është miratuar nga Ministri i Financave, ndërsa tarifa e shërbimit për bankat e përzgjedhura është përcaktuar duke iu referuar ofertës së bankës së renditur të parën. Nga auditimi është konstatuar se, megjithëse bankat pjesëmarrëse janë vlerësuar dhe renditur individualisht, përzgjedhja përfundimtare ka përfshirë të katër pjesëmarrësit në procedurë, pa u dokumentuar angazhimin i tyre i përbashkët. Nga emetimi i Eurobondit gjatë vitit 2025, me vlerë nominale prej 650 milionë euro, në llogarinë e unifikuar të Thesarit janë arkëtuar 636.61 milionë euro, sipas dokumentacionit të autorizimit nr. 3257/1, datë 14.02.2025. Diferenca prej 13.39 milionë euro, ose rreth 2.06% e vlerës nominale të emetimit, përfshin zbritjen në çmimin e emetimit dhe kostot e ndërmjetësimit financiar, të detajuara në tabelën e mëposhtme.

EUROBONDI · Rakordimi i vlerës nominale me arkëtimin neto	Afati: 10 vjet
Vlera nominale	€ 650,000,000
Çmimi i ofruar	98.070%
Arkëtuar bruto	€ 637,455,000
Tarifa bankare (13 bps)	−€ 845,000
Arkëtuar neto (pas zbritjes së tarifave)	**€ 636,610,000**

Diferenca nominale–neto: € 13,390,000

Zbritje në emetim: € 12,545,000 + tarifë bankare: € 845,000

Diferenca ndërmjet vlerës nominale të Eurobondit dhe shumës neto të arkëtuar përfshin dy komponentë me natyrë të ndryshme financiare: zbritjen në çmimin e emetimit, e cila lidhet me kushtet e emetimit në treg, dhe kostot e ndërmjetësimit, që lidhen me shërbimet e bankave të angazhuara në transaksion. Këto të fundit përbëjnë koston e drejtpërdrejtë të shërbimeve të ndërmjetësimit financiar dhe lidhen me procesin e përzgjedhjes së bankave të trajtuar më sipër.

Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian

Në kuadër të Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, me ligjin nr. 18/2025, datë 13.03.2025, është ratifikuar Marrëveshja e Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarrës, Bankës së Shqipërisë, si agjent i huamarrësit, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni Evropian, si huadhënës, për "Lehtësinë e Reformës dhe Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor" (Reform and Growth Facility – RGF). Marrëveshja parashikon një financim maksimal në formën e huasë prej 657,458,743.67 euro, disbursimi i të cilit kushtëzohet nga përmbushja e


masave cilësore dhe sasiore të Axhendës së Reformës, si dhe e kushteve të tjera të përcaktuara në kuadrin rregullator përkatës të Bashkimit Evropian.

Financimi i përgjithshëm i parashikuar për Shqipërinë në kuadër të Planit të Rritjes arrin në 922,085,888 euro dhe përfshin grante për projekte dhe hua. Komponenti i huasë ndahet në financim për mbështetje buxhetore dhe financim projektesh nëpërmjet Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Përbërja e financimit sipas komponentëve paraqitet në figurën e mëposhtme.



Institucionet buxhetore sipas fushës së përgjegjësisë janë përgjegjëse për përmbushjen e reformave të cilat përbëjnë kushte të vendosura në fusha të caktuara nga Bashkimi Evropian për lëvrimin e fondeve buxhetore. Institucionet qeveritare raportojnë në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës mbi përbushjen e reformave. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës është përgjegjëse për koordinimin e procesit me institucionet shqiptare dhe Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave sipas marrëveshjes së ratifikuar, dërgojnë kërkesën për pagesë drejt huadhënësit dhe pas vlerësimit nga ky i fundit të përmbushjes së kushteve merret Vendimi I KE për disbursimin e fondeve. Pas disbursimit të fondeve, Ministria e Financave regjistron disbursimet në regjistrin e borxhit.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Huasë, deri më 31.12.2025 janë disbursuar në formën e mbështetjes buxhetore 76,238,776.49 euro, nga të cilat 30,029,428.12 euro si parafinancim dhe 46,209,348.37 euro si transh pasues. Në maj 2026 është disbursuar edhe një transh prej 22,779,256.24 euro, i lidhur me periudhën e raportimit deri në dhjetor 2025, duke e çuar shumën e përgjithshme të mbështetjes buxhetore të arkëtuar në 99,018,032.73 euro. Megjithatë, për qëllime të vlerësimit të realizimit të huamarrjes gjatë vitit buxhetor 2025, konsiderohet vetëm shuma prej 76,238,776.49 euro, ndërsa disbursimi i majit 2026 paraqitet si zhvillim i mëvonshëm. Këto vlera përfaqësojnë financime të transferuara në favor të buxhetit të shtetit dhe jo shpenzime të realizuara nga institucionet zbatuese.



Disbursimi i financimit, me përjashtim të parafinancimit, kushtëzohet nga përmbushja e masave dhe objektivave të përcaktuara në Axhendën e Reformës, të cilat i nënshtrohen vlerësimit të Komisionit Evropian mbi bazën e kërkesave për pagesë të paraqitura nga autoritetet shqiptare. Për masat që lidhen me vitin 2025 janë paraqitur katër kërkesa për pagesë, nga të cilat dy gjatë vitit 2025, përkatësisht kërkesa nr. 10905, datë 14.07.2025, në shumën 94,994,047.37 euro, dhe kërkesa nr. 10904, datë 14.07.2025, në shumën 50,590,699.56 euro. Dy kërkesa të tjera janë paraqitur në janar 2026, në shumat 22,529,893.87 euro dhe 42,304,333.04 euro, për masa që i përkasin periudhës së raportimit të vitit 2025. Në total, financimi i kërkuar nëpërmjet këtyre katër kërkesave arrin në 210,418,973.84 euro. Paraqitja e kërkesave nuk nënkupton miratimin automatik të shumave përkatëse, pasi financimi që mund të disbursohet përcaktohet pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve nga Komisioni Evropian. Ecuria e shqyrtimit të kërkesave, shumat e miratuara dhe statusi i masave përkatëse paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në euro (€)

Kërkesa për pagesë	Data e paraqitjes	Shuma e kërkuar	Kredia e miratuar	Shuma e disbursuar	Shuma e pezulluar / pamiratuar	Statusi i kërkesës dhe masave
Nr. 10905	14.07.2025	94,994,047	70,818,925	46,209,348	99,375,399	Në proces
Nr. 10904	14.07.2025	50,590,700				
Nr. 681	14.01.2026	22,529,894	34,910,738	22,779,256	42,054,971	Në proces
Nr. 681/1	14.01.2026	42,304,333				
Totali		**210,418,974**	**105,729,662**	**68,988,605**	**141,430,369**	

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë auditimit, përfshirë anekset e vendimeve të Komisionit Evropian për miratimin e disbursimit të dytë dhe të tretë në kuadër të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor (RGF), rezulton se kërkesat për pagesë të paraqitura nga Shqipëria nuk janë miratuar në vlerën e plotë të kërkuar, për shkak të mospërmbushjes së një pjese të masave të përcaktuara në Axhendën e Reformave. Mospërmbushjet e evidentuara lidhen kryesisht me qeverisjen e ndërmarrjeve shtetërore, lehtësimin e procedurave administrative dhe reformimin e sistemit të inspektimeve për bizneset, digjitalizimin dhe lehtësimin e transportit dhe tregtisë, integrimin e tregut të energjisë elektrike, përafrimin e legjislacionit për burimet e rinovueshme dhe eficiencën energjetike, forcimin e sigurisë kibernetike, përmirësimin e transparencës dhe eficiencës së sistemit gjyqësor, si dhe transparencën e financave publike.

Për sa i përket komponentit të huasë për financimin e projekteve nëpërmjet WBIF, me vlerë të parashikuar prej 228,466,913.43 euro, nga auditimi rezulton se deri në përfundim të tij nuk është realizuar asnjë disbursim. Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, marrëveshjet e kontributit me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), si institucione përgjegjëse për menaxhimin e fondeve, nuk janë finalizuar ende.

D.2. Shërbimi dhe kostoja e borxhit

D.2.1. Pagesat e Principalit

Gjatë vitit 2025, në sistemin e menaxhimit të borxhit janë regjistruar shlyerje principali për kreditë shtetërore dhe kreditë e garantuara nga shteti, në shumën 93,064.07 milionë lekë. Nga kjo vlerë, 90,341.56 milionë lekë janë paguar nga Buxheti i Shtetit, ndërsa 2,722.51 milionë lekë nga njësitë përfituese të garancive dhe nënhuamarrësit. Shlyerjet sipas kategorisë së borxhit dhe subjektit pagues paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Kategoria	Buxheti i Shtetit	Njësitë përfituese	Totali
Kredi shtetërore	87,957.13	10.75	**87,967.88**
Garanci shtetërore	2,384.43	2,711.76	**5,096.19**
Totali	**90,341.56**	**2,722.51**	**93,064.07**


Burimi: Ministria e Financave.

Nga totali i shlyerjeve, 87,967.88 milionë lekë u përkasin kredive shtetërore dhe 5,096.19 milionë lekë kredive të garantuara. Për kreditë shtetërore, pothuajse e gjithë vlera e principalit, prej 87,957.13 milionë lekë, është shlyer nga Buxheti i Shtetit, ndërsa 10.75 milionë lekë janë paguar nga nënhuamarrësit. Ndërkohë, për kreditë e garantuara, pagesat e principalit janë ndarë ndërmjet Buxhetit të Shtetit dhe njësive përfituese, përkatësisht në shumat 2,384.43 milionë lekë dhe 2,711.76 milionë lekë. Nga krahasimi i të dhënave për pagesat e principalit të borxhit të jashtëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në shumën 90,342 milionë lekë me ato të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit, në shumën 90,336 milionë lekë, rezulton një diferencë prej rreth 6 milionë lekë. Sipas shpjegimeve të strukturës së borxhit, kjo diferencë lidhet me transaksione të klasifikuara si “principal in kind”, të cilat janë regjistruar si pakësim i detyrimit të principalit, pa u shoqëruar me dalje monetare nga llogaritë e thesarit.

D.2.2 Pagesat për garancitë shtetërore

Gjatë vitit 2025, nga buxheti i shtetit janë kryer pagesa për shërbimin e kredive të garantuara në shumën 2,817.29 milionë lekë, nga të cilat 2,384.43 milionë lekë për principalin dhe 432.86 milionë lekë për interesat, për detyrime të papërmbushura nga njësitë përfituese të garancive. Pjesa tjetër, prej 2,902.59 milionë lekë, është paguar drejtpërdrejt nga njësitë përfituese, nga të cilat 2,711.76

milionë lekë për principalin dhe 190.83 milionë lekë për interesat. Ndarja e pagesave sipas paguesit dhe natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.



Nga sa më sipër rezulton se Buxheti i Shtetit ka përballuar rreth 49.3% të shërbimit total të kredive të garantuara gjatë vitit 2025, si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të pagesës nga njësitë përfituese të garancive. Kjo situatë evidenton rëndësinë e monitorimit të aftësisë paguese të përfituesve të garancive dhe të ekspozimit të buxhetit ndaj detyrimeve që mund të lindin nga këto financime.

Për të evidentuar përqendrimin e pagesave të principalit, në tabelën e mëposhtme paraqiten dhjetë kreditë shtetërore dhe të garantuara me vlerat më të larta të principalit të paguar nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2025, të cilat së bashku arrijnë në 69,527.31 milionë lekë.

Loan ID	Përshkrimi i kredisë/garancisë shtetërore	Subjekti përfitues	Garanci/Kredi	Vlera në milionë lekë
EUR7Y/18/01	Mbështetje për buxhetin	Ministria e Financave	Kredi	35,475.14
15/06/DB	Garancia e bazuar në politika	Ministria e Financave	Kredi	19,494.00
20/03/IMF	Instrument i financimit të shpejtë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kredi	4,219.92
14/03/IMF	Extended Arrangement	Ministria e Financave	Kredi	4,181.69
16/02/EBRD	Plani i ristrukturimit të KESH	Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH)	Garanci	1,702.77
11/02/IDB	Rruga Tiranë-Elbasan	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ARRSH)	Kredi	1,357.62
21/04/KFÉ	Reforma në sektorin e energjisë	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Kredi	1,027.26
21/01/IBRD	Politikat e zhvillimit të qëndrueshmërisë fiskale dhe rritjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kredi	803.21
11/10/EBRD	Bypass Fier-Vlorë	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ARRSH)	Kredi	691.41
13/03/IDB	Rruga Qukës-Qafë Plloçë	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ARRSH)	Kredi	574.30
Totali				**69,527.31**

Burimi: Ministria e Financave.

Pagesat më të larta të principalit janë regjistruar për financimin “Mbështetje për buxhetin”, në shumën 35,475.14 milionë lekë, dhe për financimin “Garancia e bazuar në politika”, në shumën 19,494 milionë lekë. Së bashku, këto dy financime përfaqësojnë rreth 79.1% të principalit të shlyer për dhjetë financimet e paraqitura në tabelë. Ndër kreditë e garantuara, për financimin “Plani i ristrukturimit të KESH” është regjistruar një pagesë principali prej 1,702.77 milionë lekë.

D.2.3. Shpenzimet për interesa

Gjatë vitit 2025, shpenzimet për interesa të borxhit arritën në 54,692 milionë lekë, kundrejt 54,459.09 milionë lekëve në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 232.91 milionë lekë, ose rreth 0.43%. Ecuria e këtyre shpenzimeve gjatë periudhës 2019–2025, sipas ndarjes në borxh të brendshëm dhe të jashtëm, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Shpenzimet e interesit	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Δ 2025/2024	Ndryshimi (%)
Borxhi i brendshëm	22,837.89	22,350.91	23,470.40	24,210.32	29,030.33	33,118.49	**35,186**	▲ 2,067.51	+6.24%
Borxhi i jashtëm	12,304.93	12,042.49	12,907.66	15,610.05	18,560.58	21,340.59	**19,505**	▼ 1,835.59	-8.60%
Interesat gjithsej	**35,142.82**	**34,393.40**	**36,378.05**	**39,820.37**	**47,590.91**	**54,459.09**	**54,692**	▲ 232.91	+0.43%

Burimi: Ministria e Financave. Δ = 2025 − 2024.

Rritja e kufizuar e shpenzimeve totale për interesa ka rezultuar nga ecuria e kundërt e dy komponentëve të borxhit. Konkretisht, shpenzimet për interesa të borxhit të brendshëm janë rritur me 2,067.51 milionë lekë, ose 6.24%, duke arritur në 35,186 milionë lekë, për shkak të ndryshimeve në rritje të normave të interesit që përbëjnë kostot e huamarrjes dhe rritjes së peshës së borxhit të brendshëm ndaj totalit, ndërsa ato të borxhit të jashtëm janë ulur me 1,835.59 milionë lekë, ose 8.60%, duke arritur në 19,505 milionë lekë si pasojë e uljes së peshës së borxhit të jashtëm ndaj totalit. Për rrjedhojë, ulja e shpenzimeve për interesa të borxhit të jashtëm ka kompensuar pjesën më të madhe të rritjes së interesave të borxhit të brendshëm, duke mbajtur pothuajse të pandryshuar nivelin e përgjithshëm të këtyre shpenzimeve krahasuar me vitin e mëparshëm.

D.3. Garancitë shtetërore dhe ekspozimi fiskal

D.3.1. Stoku i borxhit të garantuar nga shteti

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit të garantuar nga shteti ka arritur në 29,088 milionë lekë, kundrejt 33,586 milionë lekëve në fund të vitit 2024, duke shënuar një ulje prej 4,498 milionë lekë,

ose rreth 13.4%. Ndarja e stokut në borxh të brendshëm dhe të jashtëm të garantuar, së bashku me ndryshimet vjetore, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Treguesi	2024	2025	Δ 2025/2024	Ndryshimi (%)
Borxh i brendshëm i garantuar	14,163	**8,579**	▼ 5,584	-39.43%
Borxh i jashtëm i garantuar	19,423	**20,509**	▲ 1,086	+5.59%
Totali i garantuar	**33,586**	**29,088**	▼ 4,498	-13.39%

Burimi: Ministria e Financave. Δ = 2025 − 2024.

Reduktimi i stokut është ndikuar nga pakësimi i borxhit të brendshëm të garantuar me 5,584 milionë lekë, i kompensuar pjesërisht nga rritja e borxhit të jashtëm të garantuar me 1,086 milionë lekë. Këto ndryshime kanë sjellë edhe një zhvendosje në përbërjen e stokut, me rritjen e peshës së borxhit të jashtëm të garantuar në fund të vitit 2025.

Pavarësisht uljes së stokut të borxhit të garantuar, gjatë vitit 2025 Buxheti i Shtetit ka përballuar pagesa për detyrimet e kredive të garantuara që nuk janë shlyer nga njësitë përfituese. Konkretisht, pagesat nga buxheti për principalin dhe interesat e këtyre kredive kanë arritur në 2,817.29 milionë lekë, duke evidentuar se mospërmbushja e detyrimeve nga njësitë përfituese ka vijuar të krijojë kosto financiare për Buxhetin e Shtetit, pavarësisht reduktimit të stokut të përgjithshëm të garancive. Në vijim, analiza fokusohet në ecurinë e borxhit të garantuar, njësitë përfituese dhe detyrimet e përballuara nga buxheti.

D.3.2. Garancitë e brendshme

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit të brendshëm të garantuar ka arritur në 8,579 milionë lekë, kundrejt 14,163 milionë lekëve në fund të vitit 2024, duke shënuar një ulje prej 5,584 milionë lekë. Ky stok përfshin kreditë e garantuara nga shteti për shoqëritë e sektorit energjetik, si dhe garancitë sovrane të lëshuara në kuadër të masave mbështetëse të ndërmarra nga qeveria për përballimin e situatave të veçanta ekonomike. Ndarja sipas huamarrësve, huadhënësve dhe monedhës, së bashku me ndryshimet vjetore, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Huamarrësi	Huadhënësi	2024		2025		Δ 2025/2024 Milionë lekë
		Milionë euro	Milionë lekë	Milionë euro	Milionë lekë	
FSHU / OSHEE, FTL, OSSH	Raiffeisen Bank	14.30	1,403	14.95	1,446	▲ 43
OSSH / OSHEE, FTL, FSHU	Raiffeisen Bank	16.45	1,615	0.70	68	▼ 1,547
FSHU / OSHEE	OTP	19.92	1,955	—		▼ 1,955
FSHU / OSHEE	Intesa Sanpaolo Bank / Tirana Bank	20.00	1,963	20.00	1,935	▼ 27
FSHU / OSHEE	ABI	9.99	980			▼ 980
KESH	IntesaSanPaolo1	6.55	643	5.62	543	▼ 100
KESH	Raiffeisen Bank		500		500	0
KESH	Raiffeisen Bank	19.61	1,925	19.61	1,898	▼ 27
GS1	Sektori bankar		18		18	0
GS2*	Sektori bankar		2,919		1,690	▼ 1,228
GS3*	BKT / OTP / Credins / RZB		214		73	▼ 141
GS4**	Sektori bankar		28		41	▲ 13
GS5***	Sektori bankar				367	▲ 367
Totali në milionë lekë			**14,163**		**8,579**	▼ 5,584

Burimi: Ministria e Financave. Δ ruan diferencat e tabelës burimore; qelizat pa vlerë janë lënë bosh.

Nga auditimi konstatohet se reduktimi i stokut të garancive të brendshme është ndikuar nga shlyerjet e kredive të garantuara për shoqëritë e sektorit energjetik, pakësimi i stokut të garancisë sovrane nr. 2, si dhe nga ndryshimet e kursit të këmbimit për kreditë e denominuara në monedhë të huaj. Uljet më të konsiderueshme janë regjistruar për kreditë e FSHU/OSHEE, në shumat 1,955 milionë lekë dhe 980 milionë lekë, si dhe për kredinë e OSSH/OSHEE, FTL dhe FSHU, në shumën 1,547 milionë lekë. Ndikimi i kursit të këmbimit evidentohet edhe në rastet kur stoku i kredive në euro ka mbetur i pandryshuar, ndërsa kundërvlera e tij në lekë është reduktuar. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2025 është regjistruar një rritje prej 13 milionë lekë e stokut të garancisë sovrane nr. 4, ndërsa për garancinë e re sovrane nr. 5 stoku në fund të vitit rezulton 367 milionë lekë. Gjithashtu, kredia e garantuar për FSHU/OSHEE, FTL dhe OSSH ka shënuar një rritje prej 43 milionë lekë. Këto ndryshime kanë kompensuar pjesërisht reduktimin e stokut të garancive të tjera.

D.3.3. Garancitë e jashtme

Në fund të vitit 2025, stoku i borxhit të jashtëm të garantuar ka arritur në 20,509 milionë lekë, nga 19,423 milionë lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar një rritje prej 1,086 milionë lekë, ose rreth 5.6%. Kjo rritje ka ndërprerë tendencën rënëse të regjistruar gjatë viteve 2023–2024, megjithëse

stoku në fund të vitit 2025 mbetet nën nivelin e vitit 2019. Ecuria e stokut gjatë periudhës 2019–2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Treguesi	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Δ 2025/2024	Ndryshimi (%)
Stoku i jashtëm i garantuar	26,698	35,516	31,521	32,346	24,958	19,423	**20,509**	**▲ 1,086**	**+5.59%**

Burimi: Ministria e Financave. Δ = 2025 − 2024.

Nga auditimi konstatohet se në ndryshimin e stokut të borxhit të jashtëm të garantuar ka ndikuar kredia me ID 25/07/EBRD, për projektin "Qëndrueshmëria e OSHEE", e nënshkruar më 10.03.2025 me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), në vlerën 45,750,000 euro, me përfitues OSHEE-në, e cila rezulton e disbursuar plotësisht. Kjo garanci është miratuar në kuadër të ristrukturimit të financimit, përmes zëvendësimit të borxhit të brendshëm të garantuar me borxh të jashtëm të garantuar, me kushte interesi më të favorshme. Megjithatë, nga auditimi rezulton se OSHEE është ndër subjektet përfituese të garancive shtetërore që kanë detyrime të pashlyera ndaj Buxhetit të Shtetit. Në këto kushte, miratimi i një garancie të re, ndonëse në kuadër të ristrukturimit të borxhit me kushte financimi më të favorshme, është kryer në një situatë kur subjekti nuk kishte përmbushur detyrimet ekzistuese ndaj buxhetit. Kjo situatë evidenton vijimin e mbështetjes së subjektit përmes garancive shtetërore, pavarësisht detyrimeve të pashlyera, duke ruajtur ekspozimin e Buxhetit të Shtetit ndaj riskut të mospërmbushjes së detyrimeve të financimit të ri.
Nga ana tjetër, për kredinë me ID 25/08/EBRD, me përfitues Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), në vlerën e nënshkruar prej 30,000,000 euro, nga auditimi janë konstatuar mangësi në vlerësimin ekonomiko-financiar që duhet të paraprijë vendimmarrjen për dhënien e garancisë shtetërore. Konkretisht, miratimi i garancisë është kryer në kushtet kur KESH rezultonte me detyrime debitore ndaj Buxhetit të Shtetit, të krijuara nga marrëdhëniet e nënhuasë dhe të garancive shtetërore, pa u evidentuar një vlerësim i mjaftueshëm i ndikimit të këtyre detyrimeve në aftësinë e subjektit për të përmbushur angazhimet e reja financiare. Këto mangësi në procesin e vlerësimit përpara miratimit të garancisë nuk sigurojnë dokumentimin e mjaftueshëm të përmbushjes së kërkesave të neneve 36–38 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, i ndryshuar, lidhur me kushtet dhe vlerësimin për dhënien e garancive shtetërore. Miratimi i garancisë në këto kushte rrit riskun që detyrimet e financimit të ri të përballohen nga Buxheti i Shtetit, në rast të mospërmbushjes së tyre nga KESH-i.

D.3.4. Materializimi i riskut të garancive shtetërore

Gjatë vitit 2025, Buxheti i Shtetit ka kryer pagesa në shumën 2,817.29 milionë lekë për detyrimet e kredive të garantuara, të papërmbushura nga subjektet përfituese. Nga kjo shumë, 2,384.43 milionë lekë përfaqësojnë pagesa të principalit dhe 432.86 milionë lekë pagesa të interesave. Këto pagesa evidentojnë materializimin e riskut të garancive shtetërore në pagesa faktike nga Buxheti i Shtetit. Ndarja e pagesave sipas financimeve dhe subjekteve përfituese paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Paguesi	Principal	Interesa	Totali
Buxheti i Shtetit	2,384.43	432.86	**2,817.29**
Njësitë përfituese	2,711.76	190.83	**2,902.59**
Totali	**5,096.19**	**623.69**	**5,719.88**

Burimi: Ministria e Financave.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht uljes së stokut të përgjithshëm të borxhit të garantuar gjatë vitit 2025, mospërmbushja e detyrimeve nga subjektet përfituese ka vijuar të sjellë pagesa të drejtpërdrejta nga Buxheti i Shtetit. Kjo situatë evidenton se garancitë shtetërore nuk kanë mbetur vetëm angazhime financiare të kushtëzuara, por kanë sjellë detyrime konkrete për buxhetin, ndërkohë që disa prej subjekteve përfituese kanë vijuar të mbështeten me garanci të reja, pavarësisht detyrimeve të pashlyera nga financimet e mëparshme.

D.4. Nënhuatë dhe të drejtat e paarkëtuara ndaj Buxhetit të Shtetit

D.4.1. Marrëveshjet e nënhuasë dhe detyrimet e subjekteve përfituese

Në kuadër të financimit të projekteve publike, shteti shqiptar ka lidhur ndër vite marrëveshje huaje të jashtme, fondet e të cilave u janë kaluar në formën e nënhuasë subjekteve përfituese, kryesisht

në sektorin energjetik, atë të ujësjellësve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Paralelisht, shteti ka garantuar shlyerjen e kredive të marra nga subjekte të treta, në përputhje me kuadrin ligjor për huamarrjen shtetërore. Nga auditimi konstatohet se një pjesë e subjekteve përfituese nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuasë dhe të garancive shtetërore, pavarësisht realizimit ose vijimit të projekteve të financuara. Mospërmbushja e këtyre detyrimeve ka sjellë përballimin e pagesave nga Buxheti i Shtetit dhe akumulimin e detyrimeve të pashlyera nga subjektet përfituese, në kundërshtim me detyrimet e tyre kontraktuale dhe kërkesat përkatëse të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Në fund të vitit 2025, detyrimet e subjekteve ndaj Buxhetit të Shtetit kanë arritur në 51,078.68 milionë lekë, nga 51,766.47 milionë lekë në fund të vitit 2024, duke shënuar një reduktim prej 687.79 milionë lekë, ose rreth 1.3%. Megjithatë, kjo ulje është ndikuar kryesisht nga reduktimi i detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, ndërkohë që në sektorin energjetik, sektorin e ujësjellësve dhe për Albcontrol janë regjistruar rritje të detyrimeve. Ecuria sipas sektorëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



Në sektorin energjetik, detyrimet janë rritur me 2,396.75 milionë lekë, duke arritur në 37,430.84 milionë lekë në fund të vitit 2025. Rritja është përqendruar kryesisht te KESH-i, detyrimet e të cilit janë shtuar me 3,261.78 milionë lekë, duke arritur në 27,198.33 milionë lekë. Ndërkohë, detyrimet e OSHEE-së janë rritur me 47.48 milionë lekë, ndërsa ato të OST-së janë reduktuar me 912.51 milionë lekë. Në fund të vitit 2025, sektori energjetik përfaqëson rreth 73.3% të totalit të detyrimeve të raportuara, nga të cilat vetëm KESH-i zë rreth 53.2% të totalit.
Në sektorin e ujësjellësve, detyrimet kanë arritur në 9,109.39 milionë lekë, me një rritje prej 247.04 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Rritja më e konsiderueshme është regjistruar te Ujësjellësi Korçë, me 219.96 milionë lekë, si dhe te Ujësjellësi Vlorë dhe ujësjellësit e tjerë, përkatësisht me 49.82 milionë lekë dhe 12.64 milionë lekë. Në të kundërt, detyrimet e Ujësjellësit Durrës janë reduktuar me 35.38 milionë lekë.
Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, detyrimet janë reduktuar me 4,261.31 milionë lekë, duke arritur në 3,144.08 milionë lekë në fund të vitit 2025. Ky ndryshim është përcaktuar kryesisht nga ulja e detyrimeve të Bashkisë Tiranë, nga 7,365.39 milionë lekë në 3,098.87 milionë lekë, ndërsa detyrimet e bashkive të tjera kanë shënuar një rritje të lehtë.
Rritje e konsiderueshme është regjistruar edhe për Albcontrol, detyrimet e të cilit janë shtuar me 1,107.96 milionë lekë, duke arritur në 1,169.94 milionë lekë. Ndërkohë, ndryshime më të kufizuara janë evidentuar për Unionin e Kursimit të Kredisë dhe ARMO-n, me rritje përkatësisht prej 4.96 milionë lekë dhe 0.79 milionë lekë, ndërsa detyrimet e Hekurudhës Shqiptare janë reduktuar me 183.98 milionë lekë, duke arritur në 58.27 milionë lekë.

Ecuria e detyrimeve sipas sektorëve dhe subjekteve për periudhën 2020–2025, së bashku me ndryshimet vjetore, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Detyrimet sipas sektorëve dhe institucioneve

Në milionë lekë

Sektori / Institucioni	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Δ 2025/2024
Energjia	22,772.17	27,128.73	28,778.86	31,063.45	35,034.09	37,430.84	+2,396.75
KESH	12,887.27	15,286.93	17,429.28	20,196.88	23,936.55	27,198.33	+3,261.78
OSHEE	2,593.80	2,640.45	2,687.24	2,734.32	2,781.73	2,829.21	+47.48
OST	7,291.11	9,201.36	8,662.34	8,132.26	8,315.82	7,403.30	-912.51
Ujësjellës	7,177.08	7,991.84	8,599.81	8,542.08	8,862.36	9,109.39	+247.04
Ujësjellësi Durrës	1,467.63	1,686.42	1,824.32	1,722.36	1,904.91	1,869.52	-35.38
Ujësjellësi Korçë	1,634.77	1,907.69	2,119.22	2,217.67	2,348.12	2,568.08	+219.96
Ujësjellësi Vlorë	2,052.37	2,055.07	1,998.20	1,912.72	1,903.78	1,953.59	+49.82
Ujësjellës të tjerë	2,022.30	2,342.67	2,658.06	2,689.33	2,705.56	2,718.20	+12.64
Bashki	5,050.19	6,372.07	7,499.71	7,729.05	7,405.39	3,144.08	-4,261.31
Bashkia Tiranë	4,994.60	6,314.17	7,418.30	7,644.23	7,365.39	3,098.87	-4,266.52
Bashki të tjera	55.59	57.90	81.41	84.82	40.01	45.21	+5.20
Mikrokredi	87.03	104.08	121.43	139.09	150.51	155.46	+4.96
FAF/Agrocredit	—	—	—	—	—	—	—
Unioni Kursim Kredi	87.03	104.08	121.43	139.09	150.51	155.46	+4.96
ARMO	7.74	8.71	9.34	9.48	9.90	10.69	+0.79
Hekurudha Shqiptare	—	—	—	—	242.24	58.27	-183.98
Albcontrol	—	—	—	—	61.98	1,169.94	+1,107.96
TOTALI	35,094.20	41,605.44	45,009.15	47,483.15	51,766.47	51,078.68	-687.80

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht reduktimit të lehtë të stokut të përgjithshëm gjatë vitit 2025, detyrimet e pashlyera ndaj Buxhetit të Shtetit vijojnë të mbeten në nivele të konsiderueshme dhe të përqendruara kryesisht në sektorin energjetik. Rritja e mëtejshme e detyrimeve të KESH-it dhe Albcontrol, krahas detyrimeve të akumuluara nga subjektet e tjera, evidenton vijimin e mospërmbushjes së angazhimeve financiare ndaj buxhetit. Kjo situatë ka sjellë mbartjen dhe shtimin e të drejtave të paarkëtuara të shtetit, ndërkohë që për disa prej subjekteve përfituese Buxheti i Shtetit ka vijuar të përballojë pagesat e financimeve përkatëse.

D.4.2. Detyrimet nga garancitë shtetërore ndaj buxhetit të shtetit

Në fund të vitit 2025, detyrimet e subjekteve përfituese të garancive shtetërore ndaj Buxhetit të Shtetit kanë arritur në 21,927.23 milionë lekë, kundrejt 19,891.89 milionë lekëve në fund të vitit 2024, duke shënuar një rritje prej 2,035.34 milionë lekë, ose rreth 10.2%. Këto detyrime përfaqësojnë shumat e akumuluara që subjektet përfituese i detyrohen buxhetit si pasojë e pagesave të kryera prej tij në përmbushje të garancive shtetërore. Ndarja sipas institucioneve dhe ndryshimi vjetor paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Në milionë lekë

Kategoria	2024	2025	Δ 2025/2024
KESH/OST - sektori energjetik	15,922.61	17,613.03	+1,690.42
UKT	1,613.31	1,942.29	+328.98
Hekurudha Durrës	295.36	307.99	+12.63
MF - ndihmë në mallra	219.39	244.78	+25.40
UK Krujë	71.08	73.89	+2.81
RTSH	1,770.15	1,745.26	−24.89
Totali	**19,891.89**	**21,927.23**	**+2,035.34**

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi konstatohet se detyrimet janë përqendruar kryesisht në sektorin energjetik, me një stok prej 17,613.03 milionë lekë në fund të vitit 2025, ose rreth 80.3% të totalit, dhe një rritje vjetore prej 1,690.42 milionë lekë. Brenda këtij sektori, rritja më e konsiderueshme është regjistruar për projektin “Plani i ristrukturimit të KESH”, detyrimet e të cilit janë shtuar me 1,898.23 milionë lekë, duke arritur në 5,929.80 milionë lekë. Kjo rritje, prej rreth 47.1%, ka tejkaluar rritjen neto të detyrimeve të sektorit energjetik, si rezultat i reduktimit të detyrimeve në projekte të tjera.

Për projektet me përfitues Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UKT), detyrimet ndaj Buxhetit të Shtetit kanë arritur në 1,942.29 milionë lekë, duke u rritur me 328.98 milionë lekë krahasuar me vitin 2024. Rritja është përqendruar kryesisht në projektin “Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës”, për të cilin detyrimet janë shtuar nga 6.68 milionë lekë në 279.12 milionë lekë. Kjo situatë evidenton vijimin e akumulimit të detyrimeve ndaj buxhetit për financimet e garantuara të UKT-së, si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve përkatëse nga subjekti përfitues.

Për subjektet e tjera janë regjistruar rritje të detyrimeve prej 12.63 milionë lekë për Hekurudhën Durrës, 25.40 milionë lekë për financimin e ndihmës në mallra të evidentuar pranë Ministrisë së Financave dhe 2.81 milionë lekë për Ujësjellës-Kanalizime Krujë. Në të kundërt, detyrimet e Radio Televizionit Shqiptar janë reduktuar me 24.89 milionë lekë, duke arritur në 1,745.26 milionë lekë në fund të vitit 2025.

Ecuria e detyrimeve sipas institucioneve dhe projekteve për periudhën 2020–2025, së bashku me ndryshimet vjetore, paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Detyrimet si pasojë e pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit

Ecuria në fund të vitit, 2020–2025

Në milionë lekë

Institucioni / Projekti	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Δ 2025/2024
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (KESH, OST)	12,968.27	14,040.95	15,982.04	15,348.53	15,922.61	17,613.03	+1,690.42
Elektrifikimi i zonave rurale	1,002.65	1,141.75	1,243.41	1,199.68	1,171.41	1,152.09	-19.32
Linja 400 kV Tiranë–Podgoricë I	52.91	63.83	69.86	75.67	81.20	89.67	+8.47
Linja 400 kV Tiranë–Podgoricë II	976.02	952.83	901.30	819.64	774.43	763.54	-10.89
TEC-i Vlorë	5,879.70	6,277.09	6,305.17	5,835.22	5,560.47	5,482.29	-78.18
Transmetim, shpërndarje e energjisë	2,818.32	3,119.62	3,123.96	2,957.86	2,919.72	2,870.48	-49.23
Hidrocentrali mbi lumin Drin	560.47	616.46	614.23	560.94	560.74	513.66	-47.08
Nënstacioni i transmetimit të energjisë	1,037.35	1,012.69	957.93	871.14	823.08	811.51	-11.57
Plani i ristrukturimit të KESH-it	640.85	625.62	2,766.18	3,028.40	4,031.57	5,929.80	+1,898.23
Projekti i eficiencës në energji	—	231.06	—	—	—	—	—
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës / UKT	1,536.39	1,621.14	1,648.20	1,603.18	1,613.31	1,942.29	+328.98
Furnizimi me ujë i Tiranës II	941.29	995.14	1,013.43	987.18	994.68	1,041.78	+47.10
Ujësjellësi i Tiranës I	586.68	617.78	626.98	608.92	611.94	621.39	+9.44
Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës	8.42	8.22	7.78	7.07	6.68	279.12	+272.43
Hekurudha Durrës	284.29	299.31	303.53	294.40	295.36	307.99	+12.63
Rehabilitimi i Hekurudhës së Durrësit	284.29	299.31	303.53	294.40	295.36	307.99	+12.63
Ministria e Financave (ndihmë në mallra)	185.70	218.48	230.06	229.62	219.39	244.78	+25.40
Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Krujë	69.78	73.01	73.64	71.12	71.08	73.89	+2.81
Radio Televizioni Shqiptar	840.64	1,161.74	1,416.64	1,584.75	1,770.15	1,745.26	-24.89
TOTALI	15,885.06	17,414.64	19,654.11	19,131.59	19,891.89	21,927.23	+2,035.34

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Nga auditimi konstatohet se detyrimet e subjekteve përfituese të garancive shtetërore ndaj Buxhetit të Shtetit kanë vijuar të rriten gjatë vitit 2025, duke arritur në 21,927.23 milionë lekë. Përqendrimi i tyre në sektorin energjetik, veçanërisht te projekti “Plani i ristrukturimit të KESH”, si dhe rritja e detyrimeve të UKT-së, evidentojnë vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve financiare nga subjektet përfituese.

D.4.3. Detyrime të tjera ndaj buxhetit të shtetit

Nga auditimi konstatohet se për kredinë me numër identifikimi 88, ndërmjet Medio Credito Centrale (kreditori) dhe Qeverisë Shqiptare (huamarrësi) është nënshkruar me 06.07.1998, të regjistruar si kredi shtetërore, rezultojnë detyrime të subjekteve të ndryshme përfituese, si në marrëdhëniet e nënhuasë, ashtu edhe të garancisë. Në datën 31.12.2025, këto detyrime kanë arritur në 427.60 milionë lekë, me një rritje prej 25 milionë lekë krahasuar me fundin e vitit 2024.

Në konkluzion, deri në fund të vitit 2025, të drejtat e paarkëtuara të Buxhetit të Shtetit për garancitë dhe nënhuatë kanë arritur në 73,433.51 milionë lekë, nga të cilat 51,078.68 milionë lekë nga marrëdhëniet e nënhuasë, 21,927.23 milionë lekë nga garancitë shtetërore dhe 427.60 milionë lekë nga detyrime të tjera, me një rritje prej 1,372 milionë lekë, krahasuar me 2024. Nga auditimi konstatohet se niveli i konsiderueshëm i këtyre detyrimeve, i përqendruar kryesisht në subjektet e sektorit energjetik, evidenton vijimin e mospërmbushjes së detyrimeve financiare ndaj shtetit dhe mbartjen e shumave të paarkëtuara ndër vite. Kjo situatë ka kufizuar arkëtimin e fondeve që i takojnë buxhetit të shtetit, ndërkohë që ky i fundit ka vijuar të përballojë detyrimet e financimeve përkatëse.

Nga auditimi ka rezultuar se, ashtu si në vitin paraardhës, edhe gjatë vitit 2025 ka vijuar rritja e detyrimeve të subjekteve përfituese të garancive shtetërore ndaj buxhetit të shtetit, me 2,035.34 milionë lekë (10.2%), duke arritur në 21,927.23 milionë lekë në fund të vitit. Pavarësisht funksionimit të Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera (AMGKP), përgjegjëse për administrimin dhe ndjekjen e këtyre detyrimeve, si dhe rolit të Ministrisë së Financave në cilësinë e institucionit autorizues dhe vendimmarrës, vijimi i rritjes së stokut të detyrimeve të papaguara evidenton problematika të vazhdueshme në rikuperimin e shumave të paguara nga buxheti i shtetit për llogari të subjekteve përfituese.

E. KONTABILITETI I SEKTORIT PUBLIK, MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI, SI DHE AUDITIMI I BRENDSHËM

E.1 Raportimi financiar i njësive të qeverisjes së përgjithshme

Në zbatim të nenit 63 të ligjit nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka detyrimin të shqyrtojë dhe certifikojë pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, në kuadër të raportimit në Kuvend mbi zbatimin e buxhetit të vitit të mëparshëm fiskal. Nga auditimi konstatohet se Ministria e Financave vijon të mos hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara të sektorit publik, të cilat, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë as në raportin vjetor të zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2025. Mungesa e këtyre pasqyrave nuk ka mundësuar shprehjen e një opinioni auditimi mbi pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31.12.2025.

Nga auditimi i ecurisë së reformës së kontabilitetit publik rezulton se, gjatë vitit 2025, aktivitetet për zhvillimin e kuadrit ligjor dhe metodologjik kanë vijuar kryesisht në fazën përgatitore, pa u finalizuar me miratimin e akteve përkatëse. Projektligji "Për kontabilitetin në sektorin publik" dhe projektudhëzimi "Mbi politikat kontabël, procedurat kontabël dhe raportimin financiar në njësitë e sektorit publik" nuk kanë përfunduar procesin e miratimit, ndërsa kuadri metodologjik dhe standardet e kontabilitetit publik të harmonizuara me IPSAS nuk rezultojnë të miratuara dhe të zbatuara.

Nga auditimi ka rezultuar se 38 institucione nuk kanë dorëzuar ose kanë dorëzuar me vonesë pasqyrat financiare vjetore individuale, në kundërshtim me kërkesat e nenit 62 të ligjit nr. 9936/2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, të cilat përcaktojnë detyrimet për përgatitjen dhe paraqitjen e këtyre pasqyrave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave. Mangësi u evidentuan edhe në raportimin financiar të konsoliduar nga institucionet me njësi varësie, ku 5 institucione, përkatësisht një ministri linje dhe katër bashki, nuk kishin dorëzuar pasqyrat financiare të konsoliduara.

Nga auditimi janë evidentuar gjithashtu mangësi në procesin e shqyrtimit, rakordimit dhe konsolidimit të pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Pas dorëzimit të pasqyrave financiare nga institucionet, nuk rezulton të kryhet një proces i plotë shqyrtimi dhe konfirmimi nga strukturat e Thesarit për të verifikuar eliminimin e transaksioneve të ndërsjella ndërmjet njësive dhe institucioneve të varësisë. Gjithashtu, vijojnë të evidentohen mospërputhje ndërmjet pasqyrave financiare të dorëzuara nga institucionet dhe atyre të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), kryesisht në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, si pasojë e trajtimit të ndryshëm të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara kundrejt arkëtimeve dhe pagesave të realizuara. Mangësi evidentohen edhe në konsolidimin e informacionit financiar të ndërmarrjeve publike ku shteti zotëron pjesëmarrje në kapital.

Nga auditimet e kryera në kuadër të hartimit të këtij raporti, u konstatuan mospërputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mangësi në proceset e përgatitjes, regjistrimit dhe raportimit të informacionit financiar. Mangësitë e konstatuara lidhen me saktësinë, plotësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar, si dhe me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke krijuar risk për paraqitjen e drejtë të gjendjes financiare dhe të rezultateve të veprimtarisë së njësive publike. Problematikat kryesore të konstatuara paraqiten:

- Në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 35 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 9 ente publike me kapital shtetëror u evidentua mungesa e sistemeve të integruara të menaxhimit financiar dhe kontabël, me përdorim të skedarëve Excel dhe regjistrave paralelë jashtë sistemeve zyrtare.
- Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 6 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në regjistrimin e detyrimeve të prapambetura dhe rakordimin me furnitorët dhe Thesarin. Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatua nënvlerësimi i të drejtave për arkëtim, ndërsa në 2 njësi të qeverisjes qendrore nuk ishin njohur në kohë detyrimet nga vendimet gjyqësore dhe në 2 njësi të qeverisjes qendrore u evidentuan detyrime të paarkëtuara nga debitorët.


▸ Në 6 njësi të qeverisjes qendrore, 12 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 11 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në përllogaritjen dhe regjistrimin e amortizimit të aktiveve.
▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 14 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 6 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan pasaktësi në regjistrimin e vlerës së ndërtesave dhe rikonstruksioneve, mospërputhje me inventarin e pronave shtetërore dhe mungesë e dokumentacionit teknik e ligjor, përfshirë aktet e kolaudimit, procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe titujt e pronësisë. Gjithashtu, në 6 ente publike me kapital shtetëror mungonin certifikatat e pronësisë për pasuritë në disponim.
▸ Në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u konstatuan mospërputhje ndërmjet bilancit të mbylljes dhe atij të çeljes.
▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror nuk ishte përfunduar inventarizimi i aktiveve për hartimin e pasqyrave financiare. Në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 24 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan inventarizime të paplota dhe mangësi në vlerësimin e gjendjes, kushtet e ruajtjes dhe trajtimin e diferencave, ndërsa në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 6 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan parregullsi në asgjësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 29 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 10 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në informacionin analitik të zërave të pasqyrave financiare dhe raste të trajtimit të pasaktë kontabël të investimeve në proces. Gjithashtu, në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 25 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan pasaktësi në dallimin kontabël ndërmjet investimeve në proces dhe atyre të përfunduara.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 33 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u konstatua mosrealizimi i transferimit të aktiveve sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 2 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk ishte realizuar transferimi i sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit pranë strukturave përgjegjëse.
▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentua klasifikim i pasaktë i të ardhurave dhe shpenzimeve. Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në regjistrimin e granteve, donacioneve dhe fondeve të huaja, ndërsa në 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror të ardhurat nuk ishin njohur në kohë sipas parimit të të drejtës së konstatuar.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 14 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 5 ente publike me kapital shtetëror u konstatua moskryerja e rivlerësimit të aktiveve për përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut.
▸ Në 4 njësi të qeverisjes qendrore, 13 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror mungonin analizat shpjeguese të zërave të pasqyrave financiare. Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në argumentimin e transaksioneve dhe ngjarjeve në shënimet shpjeguese, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore nuk ishte respektuar formati standard i Ministrisë së Financave.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore dhe 6 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mosrakordime ndërmjet llogarive të Thesarit dhe transaksioneve të pasqyruara në pasqyrat financiare. Në 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mosrakordime ndërinstitucionale për pasqyrat e konsoliduara, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u konstatuan regjistrime kontabël pa dokumentacion justifikues të plotë dhe të verifikueshëm.
▸ Nga auditimet e kryera nga KLSH, janë konstatuar mangësi në proceset e inventarizimit, certifikimit, vlerësimit dhe kontabilizimit të pronave publike. Analiza e të dhënave sipas bashkive evidenton diferenca të konsiderueshme ndërmjet proceseve të administrimit të pronës, ku niveli i inventarizimit nuk shoqërohet në të njëjtën masë me certifikimin dhe vlerësimin e tyre. Këto mangësi evidentojnë dobësi në administrimin e pasurive publike dhe krijojnë risqe për plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit financiar, si dhe për identifikimin, mbrojtjen dhe administrimin efektiv të aktiveve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

E.2 Auditimi i brendshëm në sektorin publik

Në zbatim të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, sipas së cilës të gjitha njësitë publike të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit duhet të sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas formave të përcaktuara prej tij, KLSH ka audituar funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Në këtë kuadër, auditimi ka përfshirë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave, si dhe vlerësimin e funksionit të auditimit të brendshëm në kuadër të auditimeve individuale të institucioneve publike, rezultatet e të cilave janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Gjatë vitit 2025, sistemi i auditimit të brendshëm në sektorin publik ka përfshirë 135 NJAB, të cilat mbulojnë veprimtarinë audituese në kuadër të 1,783 njësive shpenzuese. Nga këto, 44 struktura funksiononin në institucionet qendrore, 41 në institucionet ekstra-buxhetore dhe 50 në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për këto struktura ishin planifikuar 533 audites, ndërsa në fund të vitit rezultonin 465 audites faktikë, ose 87.2% e kapacitetit të planifikuar.

Nga auditimi i organizimit dhe shtrirjes së funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik rezultoi se, pavarësisht strukturave të ngritura, mbulimi institucional me këtë shërbim vijon të paraqesë mangësi. Konkretisht, 45 njësi publike rezultojnë të pambuluara me shërbim auditimi të brendshëm, nga të cilat 18 institucione qendrore, 1 institucion i grupit 87, 7 bashki, 11 këshilla qarku dhe 8 shoqëri aksionare. Gjithashtu, nga 135 NJAB me strukturë të miratuar, 5 prej tyre kishin parashikuar më pak se 3 punonjës, duke mos përmbushur kriterin minimal të organizimit të përcaktuar në VKM-në nr. 83, datë 03.02.2016, të ndryshuar. Krahas këtyre problematikave, në nivel sistemi rezultonin 68 pozicione vakante, ose 12.8% e numrit të përgjithshëm të pozicioneve të miratuara.




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Në drejtim të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, nga auditimi u konstatua se edhe gjatë vitit 2025 Ministria e Financave zhvilluar procesin e certifikimit, duke e çuar në tre vite radhazi (2023–2025) periudhën gjatë së cilës ky proces nuk është realizuar. Konkretisht, vetëm në fund të vitit 2025, me Urdhrin nr. 159, datë 22.12.2025, është miratuar hapja e procesit të certifikimit për sezonin 2026. Kjo situatë është shoqëruar edhe me vonesa në ngritjen dhe plotësimin e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, i cili është krijuar fillimisht me vetëm 3 nga 5 anëtarët e kërkuar dhe ka funksionuar me përbërje të paplotë gjatë gjithë vitit 2025. Sipas raportimit të Ministrisë së Financave, nga 465 audites të brendshëm në detyrë gjatë vitit 2025, 313 janë raportuar të certifikuar, 37 të pacertifikuar dhe 115 "në proces certifikimi". Megjithatë, nga auditimi rezultoi se lista e kandidatëve të pranuar në procesin e certifikimit është shpallur vetëm më datë 23.02.2026, çka tregon se deri më 31.12.2025, 115 audituesit e klasifikuar "në proces certifikimi" nuk e kishin fituar ende këtë status. Për rrjedhojë, klasifikimi i tyre në raportimin vjetor nuk pasqyron gjendjen faktike në fund të periudhës raportuese. Nga rillogaritja e kryer gjatë auditimit rezultoi se, nga 465 audites në detyrë, 313 audites, ose 67.3%, ishin të certifikuar, ndërsa 152 audites, ose 32.7%, rezultonin të pacertifikuar.

Problematika në drejtim të përmbushjes së kritereve të certifikimit evidentohet edhe në nivel të njësive të auditimit të brendshëm. Referuar pikës 3 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016, sipas së cilës në strukturën e një NJAB-je mund të punësohen deri në 1/3 audites të pacertifikuar, nga rillogaritja e kryer gjatë auditimit rezultoi se 81 nga 135 NJAB, ose 60% e tyre, kishin në përbërje më shumë se

1/3 auditues të pacertifikuar, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në aktin nënligjor. Kjo situatë evidenton një nivel të konsiderueshëm të mospërmbushjes së kërkesave për përbërjen profesionale të njësive të auditimit të brendshëm, si dhe nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe të masave për certifikimin e audituesve në nivel sistemi.

Të dhëna mbi njësitë e AB, 2021–2025




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Mangësi u konstatuan gjithashtu në procesin e planifikimit strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm. Nga 135 NJAB, 3 nuk kishin depozituar planet strategjike për periudhën 2026–2028 dhe planet vjetore për vitin 2026, ndërsa 6 njësi i kishin paraqitur ato jashtë afatit të përcaktuar. Në raste të tjera u evidentuan mangësi në dokumentimin e miratimit të planeve nga titullarët e institucioneve dhe në plotësimin e informacionit mbi nevojat për trajnim. Këto mangësi kanë ndikuar në plotësinë dhe cilësinë e informacionit të administruar për hartimin e Planit Strategjik 2026–2028 dhe Planit Vjetor të Konsoliduar 2026, duke kufizuar pasqyrimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të planifikimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në nivel sistemi.

Realizimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm, 2025

963 / 1 043 angazhime | Realizimi i planit: 92,33%



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Gjatë vitit 2025, NJAB-të kanë realizuar 963 angazhime auditimi nga 1,043 të planifikuara, duke arritur një nivel realizimi prej 92.3% të planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me vitin 2024, kur ishin realizuar 958 angazhime nga 1,042 të planifikuara, volumi i përgjithshëm i veprimtarisë audituese paraqitet relativisht i qëndrueshëm. Megjithatë, analiza sipas tipologjisë së angazhimeve evidenton ndryshime të ndjeshme kundrejt strukturës së planifikuar. Auditimet e përputhshmërisë, financiare, të performancës dhe të teknologjisë së informacionit janë realizuar mbi nivelin e planifikuar, ndërsa auditimet e kombinuara janë realizuar në masën 52.3% të planit. Gjithashtu, gjatë vitit janë realizuar 29 angazhime me kërkesë të titullarëve, të cilat nuk kanë qenë pjesë e planifikimit fillestar dhe kanë ndikuar në rishikimin e planeve vjetore në nivel njësie. Për rrjedhojë, realizimi i përgjithshëm i planit është shoqëruar me një ndryshim të strukturës së veprimtarisë audituese sipas tipologjisë së angazhimeve. Në drejtim të rezultateve të auditimit, gjatë vitit 2025 janë evidentuar problematika me efekt financiar negativ në shumën 675,8 milionë lekë, kundrejt 192,5 milionë lekëve në vitin 2024, ndërkohë që numri i përgjithshëm i gjetjeve është ulur nga 7,256 në 6,702. Sipas fushave të auditimit, efekti financiar negativ më i lartë është konstatuar në fushën e “Të ardhurave”, në shumën 398 milionë lekë, ose 59% të totalit, e ndjekur nga fusha e “Sistemeve specifike operacionale të subjektit”, me 144.5 milionë lekë lekë, ose 21%. Për sa i përket shpërndarjes së gjetjeve, numri më i lartë është evidentuar në fushën e “Qeverisjes dhe Administrimit”, me 1,509 gjetje, ose 23% të totalit, e ndjekur nga fusha e “Sistemeve specifike operacionale të subjektit”, me 1,332 gjetje, ose 20%.

Në drejtim të ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2025 janë dhënë gjithsej 7,156 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 7,095, ose 99.1%. Megjithatë, nga rekomandimet e pranuara, vetëm 4,143, ose 58.4%, rezultojnë të zbatuara, ndërsa 2,173, ose 30.6%, janë në proces zbatimi dhe 779, ose 11%, mbeten të pazbatuara.

Gjatë vitit 2025 nga Ministria e Financave nuk është zhvilluar Programi i miratuar i Trajnimit të Vijueshëm Profesional. Gjatë vitit janë njohur 5,195 orë trajnimi për 235 pjesëmarrës, të realizuara nga institucione dhe organizata të tjera profesionale, por këto nuk zëvendësojnë zbatimin e plotë dhe të unifikuar të programit vjetor të miratuar. Gjithashtu, u konstatua mungesa e një regjistri të plotë dhe të përditësuar për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve individuale për trajnim, ndërkohë që nga evidencat e administruara rezultuan 120 raste me më pak se 80 orë trajnim gjatë periudhës 2024–2025.

Nga 135 njësi që kanë raportuar veprimtarinë gjatë vitit 2025, 10 nuk kishin paraqitur Pyetësorin e Vetëvlerësimit. Gjithashtu, megjithëse Ministria e Financave kishte kryer vlerësimin e të pesë treguesve të performancës së funksionit të auditimit të brendshëm, rezultatet e këtij vlerësimi nuk janë pasqyruar në mënyrë të plotë në Raportin mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik për vitin 2025. Konkretisht, mungon paraqitja e rezultateve sipas institucioneve, analiza e konsoliduar, krahasimi ndërmjet institucioneve dhe renditja e performancës së njësive. Nga shqyrtimi i rezultateve të vlerësimit të administruara gjatë auditimit evidentohen diferenca të konsiderueshme në nivelin e performancës ndërmjet institucioneve. Në disa institucione rezultatet arrijnë në mbi 90% të pikëve maksimale, ndërsa në institucione të tjera rezultojnë nivele dukshëm më të ulëta, veçanërisht në treguesit që lidhen me zbatimin dhe pranimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm, planifikimin e auditimeve bazuar në risk, zbatimin e standardeve profesionale dhe procedurave të auditimit, dokumentimin e veprimtarisë audituese, si dhe cilësinë e raportimit vjetor.

Në drejtim të sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë së auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2025 janë realizuar 18 nga 20 vlerësime të jashtme të cilësisë të planifikuara. Dy vlerësimet e parealizuara i përkasin Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë, për shkak të mungesës së funksionit të auditimit të brendshëm, dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për shkak të kufizimeve të aksesit në dokumentacionin e klasifikuar. Nga 18 njësitë e vlerësuara, vetëm 6 kanë rezultuar në përputhje të plotë me standardet profesionale, ndërsa 12 të tjerat kanë paraqitur nivele të ndryshme mospërputhjeje dhe nevoja për përmirësim. Problematikat kryesore lidhen me mangësitë në burimet njerëzore, planifikimin e angazhimeve bazuar në risk, zbatimin e programeve të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, si dhe dokumentimin e kontrolleve të brendshme dhe monitorimin e rekomandimeve.

Në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (RGF), i trajtuar më sipër në drejtim të planifikimit fiskal, financimit dhe përmbushjes së angazhimeve të reformave, nga auditimi u evidentuan problematika edhe në organizimin dhe planifikimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Megjithëse financimi dhe objektivat e Instrumentit RGF ishin përfshirë më herët në kuadrin e planifikimit fiskal, mekanizmat institucionalë për kontrollin, auditimin dhe siguridhënien mbi zbatimin e tij janë përcaktuar gjatë vitit 2025, nëpërmjet ligjit nr. 19/2025, VKM-së nr. 252, datë 02.05.2025, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 21, datë 14.07.2025. Ky kuadër ka përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve zbatuese për monitorimin dhe verifikimin e përmbushjes së objektivave dhe treguesve të reformave, si dhe rolin e auditimit të brendshëm në vlerësimin e pavarur të funksionimit të sistemeve të kontrollit, ligjshmërisë dhe rregullsisë së përdorimit të fondeve, identifikimit të parregullsive dhe risqeve të mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe financimit të dyfishtë. Rezultatet e këtyre angazhimeve përbëjnë pjesë të mekanizmit të siguridhënies që mbështet Deklaratën e Sigurisë dhe dokumentacionin për kërkesat e disbursimit të fondeve pranë Komisionit Evropian. Në zbatim të këtij kuadri, Ministria e Financave, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, ka përgatitur për herë të parë Raportin Përmbledhës mbi Angazhimet e Auditimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, duke konsoliduar raportimet e njësive të auditimit të brendshëm të Kryeministrisë dhe gjashtë ministrive të linjës: Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,

Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Megjithatë, miratimi i kuadrit rregullator gjatë vitit 2025 nuk ishte shoqëruar me përfshirjen e angazhimeve specifike për Instrumentin RGF në planet vjetore të auditimit të atij viti. Për rrjedhojë, raportimi përmbledhës, ndonëse përmbushte detyrimin procedurial të raportimit, mbështetej në rezultatet e auditimeve të zakonshme të institucioneve dhe nuk përmbante evidenca auditimi të dedikuara për zbatimin e masave dhe përdorimin e fondeve të këtij instrumenti.

Për rrjedhojë, në mungesë të angazhimeve të posaçme, mbetet i kufizuar kontributi i auditimit të brendshëm në sigurimin e vlerësimeve të pavarura dhe të dokumentuara mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit, rregullsinë e përdorimit të fondeve dhe proceset e monitorimit e verifikimit të përmbushjes së angazhimeve të reformave. Kjo merr rëndësi të veçantë në kontekstin e Instrumentit RGF, ku disbursimi i financimit kushtëzohet nga realizimi i objektivave dhe treguesve të Axhendës së Reformës, ndërsa rezultatet e auditimit të brendshëm përbëjnë një element mbështetës të mekanizmit të siguridhënies dhe të besueshmërisë së informacionit që shoqëron raportimin institucional dhe kërkesat për financim pranë Bashkimit Evropian.

Në kuadër të auditimeve të kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, KLSH ka vlerësuar edhe organizimin, funksionimin dhe efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Nga këto auditime janë evidentuar problematika, të cilat, të grupuara sipas natyrës së tyre, paraqiten si më poshtë:

- Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 19 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u evidentua mosplotësimi i kritereve ligjore për rekrutimin dhe ushtrimin e funksionit të audituesit të brendshëm, lidhur me arsimin, përvojën, certifikimin dhe zhvillimin profesional. Gjithashtu, në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 34 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror nuk ishte ngritur Komiteti i Auditimit të Brendshëm.
- Në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 21 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në planifikimin, realizimin dhe raportimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm. Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 6 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin realizuar angazhimet për ndjekjen e rekomandimeve, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 27 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në vlerësimin e riskut dhe përfshirjen në planifikim të fushave me rëndësi.
- Në 2 njësi të qeverisjes qendrore dhe 2 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan ndryshime të shpeshta të planeve vjetore të auditimit, pa analiza të dokumentuara të riskut dhe argumentim të mjaftueshëm për rishikimin e tyre.
- Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 16 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në dokumentimin e angazhimeve, administrimin e dosjeve, inventarizimin e dokumentacionit dhe hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu, në 17 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatuan mangësi në kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së auditimit.
- Në 2 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në plotësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm.


E.3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në sektorin publik

Në kuadër të auditimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në sektorin publik, KLSH ka përfshirë në auditim veprimtarinë e Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) pranë Ministrisë së Financave, si strukturë përgjegjëse për harmonizimin, monitorimin dhe zhvillimin e sistemit, si dhe funksionimin e MFK-së në kuadër të auditimeve individuale të institucioneve publike, rezultatet e të cilave janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

Gjatë vitit 2025, janë realizuar 19 nga 20 vlerësime të planifikuara të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, ose 95% të planit. Megjithatë, ky nivel mbulimi nuk siguron respektimin e ciklit pesëvjeçar të parashikuar në metodologji, pasi për mbulimin e 205 njësive të qeverisjes së

përgjithshme nevojiten mesatarisht 41 vlerësime në vit, kundrejt 19 të realizuara, duke e zgjatur ciklin e vlerësimit në rreth 11 vjet.

Nga auditimi u evidentua mungesa e një evidencë të plotë dhe të konsoliduar të institucioneve subjekt vlerësimi dhe të historikut të vlerësimeve të kryera, ku nga 199 njësi të raportuara, vetëm 127 janë përfshirë në listën e administruar dhe për 66 prej tyre mungojnë të dhënat mbi vlerësimet e mëparshme. Nga vlerësimet e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të kryera gjatë vitit 2025, rezultoi se vetëm 4 nga 19 institucionet e vlerësuara kishin një sistem efektiv kontrolli, ndërsa në 9 institucione sistemi u vlerësua pjesërisht efektiv dhe në 6 institucione joefektiv. Problematikat kryesore lidhen me dobësitë në identifikimin dhe administrimin e risqeve, dokumentimin e proceseve administrative dhe financiare, zbatimin e procedurave të kontrollit dhe monitorimin e masave korrigjuese.



Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve, gjatë vitit 2025 DH/MFKK ka realizuar trajnime dhe asistenca teknike kryesisht mbi bazën e kërkesave të institucioneve, por nuk ka hartuar dhe miratuar një program vjetor të strukturuar trajnimesh, të mbështetur në analizën e nevojave dhe me përcaktimin e temave, afateve, institucioneve dhe grupeve të synuara dhe rezultateve të pritshme. Megjithëse asistenca teknike është realizuar, nuk janë përcaktuar objektiva të matshëm dhe rezultate të pritshme, ndërsa mungesa e raportimit nga institucionet përfituese nuk është ndjekur me masa të mëtejshme për vlerësimin e progresit. Për rrjedhojë, nuk është siguruar një vlerësim i dokumentuar i ndikimit të asistencës në zbatimin e instrumenteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në drejtim të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Pyetësori i Vetëvlerësimit i është shpërndarë 220 njësive publike, nga të cilat 204 janë përgjigjur dhe 16 njësi nuk kanë raportuar. Nga përgjigjet e pyetësorit të vetëvlerësimit, si dhe nga vlerësimi i kryer nga DH/MFKK për treguesit 13–19, janë evidentuar rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë:

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik

Treguesit 13–19 dhe 17 parimet e kontrollit të brendshëm, 2024 dhe 2025

Treguesi / Parimi	2025	2024
PLANIFIKIMI DHE RAPORTIMI I MFK		
T13 Hartimi me cilësi i Planit të Veprimit të MFK-së	Plotëson kriteret, nevojë përmirësimi	Plotëson kriteret, nevojë përmirësimi (2.90)
T14 Gjithëpërfshirja dhe rregullsia e raportimit vjetor	Plotëson kriteret, nevojë përmirësimi	Plotëson kriteret, nevojë përmirësimi (3.06)
MJEDISI I KONTROLLIT · T15		
P1 Angazhim për integritet dhe vlera etike	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P2 Pavarësi dhe përgjegjshmëri të mbikëqyrjes	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P3 Struktura organizative, linja raportimi, autoritete	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P4 Angazhim në realizimin e kompetencave	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P5 Përputhje me përgjegjshmëritë menaxheriale	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
MENAXHIMI I RISKUT · T16		
P6 Objektivat si bazë për vlerësimin e risqeve	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P7 Identifikimi dhe analiza e risqeve	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P8 Vlerësimi i riskut të mashtrimit	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P9 Identifikimi i ndryshimeve të rëndësishme	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
AKTIVITETET E KONTROLLIT · T17		
P10 Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit	Plotëson pjesërisht kriteret ▼	Efektiv
P11 Kontrolle të përgjithshme mbi teknologjinë	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P12 Kontrolle përmes politikave dhe procedurave	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI · T18		
P13 Informacion i përshtatshëm dhe cilësor	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P14 Komunikimi i brendshëm	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P15 Komunikimi i jashtëm	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
MONITORIMI · T19		
P16 Vlerësime të vazhdueshme dhe/ose të veçanta	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
P17 Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv
VLERËSIMI TOTAL	Plotëson pjesërisht kriteret	Pjesërisht efektiv

▼ P10 ka rënë nga "Efektiv" (2024) në "Plotëson pjesërisht kriteret" (2025).
* Pikët për 2025 nuk janë raportuar. P = Parim; T = Tregues.

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH.

Nga analiza e rezultateve të vetëvlerësimit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për vitin 2025, evidentohet se dobësitë më të theksuara lidhen me menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin e funksionimit të sistemit. Në veçanti, vetëm 45.5% e njësive

përcaktojnë mënyrën e trajtimit të risqeve, 47.5% raportojnë dhe monitorojnë ekspozimin ndaj mashtrimit, ndërsa 39.4% disponojnë sisteme rezervë dhe plane rikuperimi të testuara në praktikë. Gjithashtu, rezultatet evidentojnë se megjithëse 92.9% e institucioneve deklarojnë se kryejnë rregullisht vetëvlerësimin e sistemit të MFK-së, vetëm 51.5% disponojnë rregulla të miratuara për monitorimin e tij.

Në analizën sipas pesë komponentëve të kontrollit të brendshëm, mjedisi i kontrollit, i vlerësuar në nivelin 74.3%, paraqet dobësi në delegimin e kompetencave, qartësinë e përgjegjësive dhe zbatimin e parimit të përgjegjshmërisë menaxheriale. Menaxhimi i riskut, me vlerësim 61.2%, përfaqëson komponentin me performancën më të ulët, duke reflektuar mangësi në identifikimin, analizimin dhe trajtimin e risqeve, përfshirë vlerësimin e ekspozimit ndaj mashtrimit dhe ndikimin e risqeve në realizimin e objektivave. Aktivitetet e kontrollit, të vlerësuara në nivelin 69.8%, evidentojnë mangësi në dokumentimin e proceseve administrative dhe financiare, ndarjen e detyrave dhe funksionimin e kontrolleve mbi sistemet e teknologjisë së informacionit. Informimi dhe komunikimi, me vlerësim 70.7%, paraqet kufizime në funksionimin e sistemeve të raportimit dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e performancës dhe mbështetjen e vendimmarrjes menaxheriale. Monitorimi, i vlerësuar në nivelin 67.5%, karakterizohet nga dobësi në formalizimin e procedurave të mbikëqyrjes së vazhdueshme, analizën e shkaqeve të mosrealizimit të objektivave dhe ndjekjen e masave korrigjuese.

Në tërësi, këto rezultate evidentojnë se dobësitë në identifikimin dhe trajtimin e risqeve, zbatimin e aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimin e tyre vijojnë të jenë të pranishme në institucionet publike. Problematikat e evidentuara nga procesi i vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar gjejnë mbështetje edhe në konstatimet e KLSH-së nga auditimet e kryera në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe shoqëritë aksionare me kapital shtetëror, ku problematikat kryesore, të grupuara sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, paraqiten si më poshtë:

Mjedisi i kontrollit

▸ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 18 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u konstatua mungesa e prioriteteve, vizionit, misionit dhe Planit Strategjik të Zhvillimit Afatmesëm; në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 5 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror mungonte Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit, ndërsa në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 6 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin ngritur Grupet e Menaxhimit Strategjik.

▸ Në 9 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror u evidentua mungesa e miratimit ose publikimit të Kodit të Etikës dhe Standardeve të Sjelljes, si dhe e procedurave për raportimin e shkeljeve etike. Gjithashtu, në 13 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin vendosur mekanizmat antikorrupsion përmes njësive përgjegjëse për sinjalizimin e brendshëm.

▸ Në 15 njësi të qeverisjes qendrore, 22 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 8 ente publike me kapital shtetëror nuk ishte dokumentuar vendimmarrja e Grupeve të Menaxhimit Strategjik (GMS); në 6 njësi të qeverisjes qendrore, 21 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror mungonin Planet Vjetore të Veprimtarisë, ndërsa në 13 njësi të qeverisjes qendrore, 18 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror nuk ishte miratuar Plani i Veprimit për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm.

▸ Në 7 njësi të qeverisjes qendrore dhe 13 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk ishin hartuar manualet e proceseve të punës, ndërsa në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 21 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonte hartëzimi i proceseve sipas strukturave organizative. Gjithashtu, në 16 njësi të qeverisjes qendrore, 26 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 7 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin hartuar ose përditësuar gjurmët standarde të auditimit.

▸ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonte rregullorja për mirëadministrimin e aktiveve. Në 1 njësi të qeverisjes qendrore

dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në zbatimin e kuadrit rregullator për protokoll-arkivën dhe ruajtjen e informacionit, përfshirë rregullat e aksesit.
▸ Në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin zhvilluar trajnime mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm.
▸ Në 8 njësi të qeverisjes qendrore, 21 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror ndryshimet e strukturës organizative nuk ishin reflektuar në rregulloret e brendshme, ndërsa në 1 njësi të qeverisjes qendrore dhe 6 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan parregullsi në procedurat e delegimit të kompetencave.

Menaxhimi i riskut
▸ Në 14 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në identifikimin e nevojave, planifikimin dhe ndjekjen e trajnimeve të personelit përgjegjës për menaxhimin e riskut.
▸ Në 14 njësi të qeverisjes qendrore, 17 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 6 ente publike me kapital shtetëror mungonin mekanizmat për administrimin e riskut, përfshirë aktin e ngritjes së Grupit të Menaxhimit të Riskut dhe rregulloren për përcaktimin e përgjegjësive, vendimmarrjes dhe monitorimit. Gjithashtu, në 6 njësi të qeverisjes qendrore, 9 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin caktuar Koordinatori i Riskut dhe MFK-së dhe Koordinatori i Deleguar i Riskut.
▸ Në 8 njësi të qeverisjes qendrore, 22 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në identifikimin dhe analizimin e risqeve, përcaktimin e përgjegjësve, dokumentimin e kontrolleve për minimizimin e tyre dhe hartimin e Regjistrit e Matricës së Riskut, përpara dhe pas aplikimit të kontrolleve.
▸ Në 16 njësi të qeverisjes qendrore, 16 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror nuk ishte kryer përditësimi i Regjistrit të Riskut 2 herë në vit, ndërsa në 9 njësi të qeverisjes qendrore, 23 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror mungonte Strategjia e miratuar e Menaxhimit të Riskut.
▸ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore dhe 3 njësi të vetëqeverisjes vendore mungonin procedurat e posaçme për mbledhjen, dokumentimin dhe analizimin e gabimeve dhe ankesave.

Aktivitetet e kontrollit
▸ Në 10 njësi të qeverisjes qendrore, 3 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 7 ente publike me kapital shtetëror mungonin rregullat e qarta për rekrutimin e personelit; në 5 njësi të qeverisjes qendrore, 7 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u evidentuan mangësi në plotësimin e vendeve vakante, ndërsa në 10 njësi të vetëqeverisjes vendore u konstatua mosplotësimi i vendeve vakante sipas kërkesave për kualifikim dhe përvojë. Gjithashtu, në 3 njësi të qeverisjes qendrore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonte personeli drejtues në pozicione kyçe.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 9 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror mungonin përshkrimet e punës, treguesit e matshëm të performancës dhe miratimi i dokumentacionit përkatës. Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror nuk ishin kryer vlerësimet 6-mujore të performancës, ndërsa në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 16 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit.

Informimi dhe komunikimi
▸ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 13 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 4 ente publike me kapital shtetëror u konstatua mungesa e procedurave për raportimin periodik, përfshirë përcaktimin e llojeve të raporteve, afateve dhe përgjegjësive për raportimin e veprimtarisë institucionale. Gjithashtu, në 2 njësi të vetëqeverisjes vendore mungonin rregullat e shkruara për komunikimet zyrtare shkresore dhe elektronike, si dhe trajtimin e informacionit të klasifikuar.
▸ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore dhe 12 njësi të vetëqeverisjes vendore u evidentuan mangësi në mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, përfshirë regjistrat elektronikë, digjitalizimin e proceseve dhe ofrimin e shërbimeve. Në 21 njësi të vetëqeverisjes

vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonin sistemet rezervë (back-up) dhe procedurat për rikuperimin e të dhënave në rast cenimi ose humbjeje.
‣ Në 8 njësi të qeverisjes qendrore, 8 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në funksionimin e faqeve zyrtare dhe publikimin e informacionit për publikun, përfshirë buxhetet, pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit të jashtëm. Gjithashtu, në 4 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk ishte caktuar Koordinatori për të Drejtën e Informimit ose mungonte Programi i Transparencës.

Monitorimi
‣ Në 1 njësi të qeverisjes qendrore, 4 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 2 ente publike me kapital shtetëror u konstatuan mangësi në përbërjen, organizimin dhe funksionimin e organeve mbikëqyrëse.
‣ Në 11 njësi të qeverisjes qendrore, 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 3 ente publike me kapital shtetëror mungonin procedurat për monitorimin dhe analizimin periodik të veprimtarisë institucionale dhe efektivitetit të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK), ndërsa në 10 njësi të qeverisjes qendrore dhe 4 njësi të vetëqeverisjes vendore nuk ishin miratuar rregullat e brendshme për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
‣ Në 3 njësi të qeverisjes qendrore, 11 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror mungonin raportet e monitorimit të kontrollit të brendshëm.
‣ Në 2 njësi të qeverisjes qendrore, 5 njësi të vetëqeverisjes vendore dhe 1 ent publik me kapital shtetëror gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm nuk ishin përfshirë në Raportin Vjetor të Veprimtarisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe në planet përkatëse të veprimit.

Nga **auditimet e performancës** kanë rezultuar problematika në funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, kryesisht në drejtim të menaxhimit të riskut, përcaktimit dhe ndarjes së përgjegjësive, zbatimit të mekanizmave të kontrollit, administrimit të informacionit dhe monitorimit të rezultateve, si më poshtë:
► *"Ndotja e mjedisit në Bashkinë e Elbasanit dhe Krujës":* Institucionet përgjegjëse nuk kanë hartuar plan veprimi për trajtimin e mbi 1.5 milionë tonëve mbetje industriale, metale të rënda (Ferrokrom dhe ferronikel) në territorin e Bashkisë Elbasan, në zonën e ish-metalurgjikut, ndërsa Bashkia Krujë nuk ka disponuar strategji lokale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe ka grumbulluar rreth 23 mijë tonë mbetje në vit në pika pa leje mjedisore. AKM-ja nuk ka vlerësuar riskun për planifikimin e inspektimeve, ndërsa marrëveshja me AMBU-në nuk është zbatuar plotësisht për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e kontrolleve.
► *"Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim*": Portali i ngritur nuk pasqyron të dhëna mbi arritjet dhe treguesit kryesorë të performancës së programit të Garancisë Rinore. Modeli i "Universitetit të Moshës së Tretë" nuk është ngritur dhe dhjetë kurrikulat e planifikuara nuk janë miratuar, ndërsa fushatat sensibilizuese kanë pasur shtrirje të kufizuar dhe pjesëmarrja e personave mbi 65 vjeç në kurse ka qenë 100 nga 1,000 të synuar.
► *"Fuqizimi i grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse":* Koordinimi institucional dhe mekanizmat për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave gjinore nuk kanë rezultuar të standardizuara dhe të orientuara mjaftueshëm drejt rezultateve, ndërsa KQZ-ja nuk ka disponuar strukturë të dedikuar për analizimin e përfaqësimit gjinor dhe të dhëna mbi shpërndarjen e fondeve zgjedhore ndërmjet kandidatëve burra dhe gra. Bashkitë e audituara nuk kanë siguruar mekanizma të konsoliduar për identifikimin, trajnimin, mentorimin, promovimin dhe ndjekjen e grave drejt pozicioneve drejtuese.
► *"Kujdesi Shëndetësor në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale":* Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka garantuar në mënyrë efektive aksesin, cilësinë dhe vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor në IEVP. Dobësitë kryesore lidhen me koordinimin dhe monitorimin e pamjaftueshëm ndërmjet sistemit penitenciar dhe atij shëndetësor, mungesën e personelit, shpërndarjen e pabalancuar të mjekëve specialistë dhe mangësitë infrastrukturore e

diagnostikuese. Pajisjet diagnostikuese jashtë funksionit dhe mosimplementimi i recetës elektronike (eRx) kanë kufizuar integrimin me sistemin publik shëndetësor.

► *"Kontrolli i cilësisë, magazinimi dhe importimi i drithërave (me fokus miellin)":* Kuadri rregullator nuk është përditësuar, ndërsa planifikimi i inspektimeve nuk ka siguruar lidhje të plotë me riskun, duke lënë të painspektuar 38 nga 56 operatorë të licencuar. Laboratorët rajonalë nuk kanë rezultuar të akredituar, sistemi LIMS nuk ka funksionuar dhe monitorimi nuk ka përfshirë plotësisht disa kontaminues kritikë, ndër ta mikotoksinat T-2 dhe HT-2 dhe nikeli, ndërsa në pikat kufitare kanë munguar baza elektronike e integruar, verifikimet e standardizuara dhe dokumentimi sistematik.

► *"Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar":* Kuadri ligjor nuk ka përcaktuar kohëzgjatjen dhe periodicitetin e monitorimit pasbirësues, ndërsa organizimi i KSHB-së nuk ka garantuar ndarjen e funksioneve dhe paanshmërinë. KSHB-ja nuk ka siguruar ndjekjen sistematike të raporteve për birësimet ndërvendase dhe verifikimin e plotë të dokumentacionit e të subjekteve të autorizuara, ndërsa nuk ka zbatuar plan të integruar për sigurinë dhe digjitalizimin e dosjeve.

► *"Efektiviteti i komisioneve rajonale të KEMP-it në trajtimin e dosjeve mjekësore":* Kriteret mjekësore nuk janë miratuar me akt nënligjor dhe nuk kanë qenë të aksesueshme publikisht, procedurat ndërmjet skemave kontributive dhe jokontributive nuk janë harmonizuar, ndërsa komisionimi nëpërmjet kanaleve digjitale nuk është mbështetur me procedurë administrative dhe teknike të miratuar. Në 38 komisione rajonale, 68 anëtarë kanë ushtruar funksionet përtej afatit të përcaktuar dhe janë evidentuar raste të mbivendosjes së rolit të mjekut kurues me atë të anëtarit vlerësues.

▸ "*Qarkullimi Rrugor në Bashkinë e Tiranës*": Verifikimi joefektiv i dokumentacionit dhe kontrolli i pamjaftueshëm kanë sjellë rinovimin e certifikatave për mjete jashtë kushteve të kërkuara, ndërsa vlerësimi i performancës së linjave është ndërprerë në vitin 2021. Mbulimi me korsi të dedikuara për autobusët është vetëm 11% e totalit të gjatësisë së rrugëve urbane kryesore, biletimi i integruar dhe pa para në dorë nuk ka nisur, megjithëse parashikohej të përfundonte në vitin 2022, ndërsa numri i aboneve nuk mbështetet në studime të dinamikave të popullsisë. Plani Urban i Trafikut nuk është hartuar, Qendra e Monitorimit dhe Menaxhimit të Trafikut nuk funksionon plotësisht dhe Portali Urbani administrohet pa procedurë të brendshme të miratuar. Anketat e kapacitetit të autobusëve për vitet 2023–2025 nuk janë realizuar.

▸ "*Shfrytëzimi i burimeve minerare të kromit*": Planifikimi strategjik dhe monitorimi janë shoqëruar me mungesë të indikatorëve të përditësuar, analizës plan–fakt dhe raportimit periodik. Gjatë periudhës 2011–2025, nga 688 zona minerare të shpallura për shfrytëzim, vetëm 124, ose rreth 18%, janë kthyer në leje shfrytëzimi, ndërsa për vitet 2020, 2025 dhe 2026 nuk rezulton të ketë plan vjetor minerar të publikuar. Procedurat konkurruese dhe të licencimit kanë pasur mangësi e vonesa, ndërsa kontrolli pas dhënies së lejeve është shoqëruar me mosfunksionimin e RevZone dhe raportim jo të saktë. AKBN ka vendosur 105 masa administrative kryesisht për mosdeklarim brenda afateve, pa adresuar plotësisht cilësinë e të dhënave; nga 244 leje, në 42 raste subjektet rezultojnë pa drejtues teknik, ndërsa disa drejtues figurojnë deri në 10 ose 12 subjekte. AKM nuk ka garantuar monitorim të plotë mjedisor, MIE nuk ka vijuar plotësisht procedurat e revokimit dhe rreth 98% e subjekteve aktive nuk disponojnë miratimin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor. Ndjekja e planeve të mbylljes dhe rehabilitimit dhe mbikëqyrja e sigurisë nuk kanë qenë të plota dhe efektive; AKSEM ka funksionuar me strukturë të paplotësuar.

▸"*Shërbimi i Kujdesit Paliativ në Shqipëri*": MSHMS-ja nuk ka ngritur strukturë të dedikuar për organizimin dhe koordinimin e kujdesit paliativ, nuk ka standardizuar rolin e shërbimit në banesë dhe nuk ka siguruar financim të evidentuar veçmas, duke kufizuar përcaktimin e kostos së plotë të shërbimit. Kujdesi publik i specializuar në banesë ofrohet vetëm në Tiranë nga SOB-ja, me shtatë ekipe dhe ngarkesë prej 53–188 pacientësh në vit për mjek, ndërsa, së bashku me OJF-të, shërbimi i organizuar mbulon vetëm 3 nga 12 qarqet. Nuk funksionojnë njësi spitalore të dedikuara, ekipet multidisiplinare janë të paplotësuara dhe janë evidentuar mungesa në barna e pajisje. Financimi dhe rimbursimi janë orientuar kryesisht drejt pacientëve onkologjikë dhe onkohematologjikë, pa mekanizma të barasvlershëm për pacientët me sëmundje të tjera progresive ose terminale; kujdesi paliativ pediatrik nuk është formalizuar si shërbim i veçantë dhe ka mungesa në burime e forma

farmaceutike pediatrike. Protokollet e vitit 2014, të bazuara në ICD-9, nuk janë përditësuar brenda afatit të përcaktuar dhe nuk janë harmonizuar me LBR-në, ku mungojnë 37 barna të parashikuara në to, përfshirë alternativa opioide, duke transferuar kosto te familjet. Bashkëpunimi me OJF-të, referimi dhe shkëmbimi i informacionit nuk janë formalizuar, ndërsa objektivat e Planit të Zbatimit 2022–2025 janë realizuar pjesërisht. Nuk është ngritur sistem i integruar monitorimi; kontrollet janë përqendruar te rimbursimi i recetave. Performanca matet me tregues aktiviteti, pa indikatorë për rezultatet klinike, kontrollin e simptomave, kohën e reagimit dhe kënaqësinë e pacientëve, duke kufizuar vlerësimin e cilësisë, eficiencës dhe ndikimit të shërbimit.

Nga **auditimet e teknologjisë së informacionit** janë konstatuar problematika në qeverisjen dhe administrimin e sistemeve të TI-së, kryesisht në drejtim të kuadrit rregullator, përcaktimit të përgjegjësive institucionale, kapaciteteve njerëzore, menaxhimit të riskut, sigurisë së informacionit, si dhe mirëmbajtjes dhe funksionalitetit të sistemeve informatike, si më poshtë:

- Kuadri rregullator dhe qeverisja e TI-së: Mungesa e përditësimit të bazës ligjore dhe rregullatore, e objektivave të qarta për TI-në, e procedurave të miratuara dhe e mekanizmave të mjaftueshëm të qeverisjes, mbikëqyrjes dhe monitorimit. Gjithashtu, përgjegjësitë, nivelet e shërbimit dhe marrëdhëniet operacionale nuk kanë rezultuar të përcaktuara dhe të formalizuara plotësisht.

▸ *Kapacitetet njerëzore*: Mungesa e personelit të dedikuar dhe e kapaciteteve të specializuara për administrimin e sistemeve të TI-së, si dhe e planeve vjetore të trajnimit.

▸*Menaxhimi i riskut dhe siguria e informacionit:* Mungesa e regjistrave të riskut dhe e procedurave të dokumentuara, mangësi në mbrojtjen e të dhënave personale, administrimin e aseteve, sigurinë fizike dhe logjike, mekanizmat e autentifikimit dhe administrimin e përdoruesve kanë rritur riskun për akses të paautorizuar, humbje të gjurmueshmërisë dhe cenim të integritetit e konfidencialitetit të të dhënave.

▸ *Infrastruktura dhe siguria e sistemeve*: Përdorimi i sistemeve operative pa përditësime sigurie, mungesa e mbrojtjes antivirus dhe e firewall-it të dedikuar.

▸ *Mirëmbajtja dhe funksionaliteti i sistemeve*: Mungesa e procedurave të formalizuara dhe e mirëmbajtjes së vazhdueshme, mosrealizimi i funksionaliteteve të kontraktuara, mospërditësimi i rregullt i të dhënave dhe popullimi i pjesshëm i sistemeve.

▸ *Vazhdimësia e punës dhe rikuperimi (backup)*: Mosrealizimi i objektivave për sistemet rezervë dhe planet e rikuperimit, si dhe ruajtja e kopjeve rezervë në të njëjtin ambient, pa procedura të dokumentuara për verifikimin e integritetit të tyre.

▸ *Administrimi dhe përdorimi i investimeve në TI:* Mangësitë në administrimin e aseteve, kushtet e papërshtatshme të dhomave të serverëve dhe mospërdorimi i pajisjeve të destinuara për ruajtjen dhe administrimin e centralizuar të të dhënave dixhitale.

F. ANEKSET

Aneksi 1. Lista e auditimeve për raportin e zbatimit të buxhetit 2025

Nr.	Auditime
	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
1	Ministria e Financave
2	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
3	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
4	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
5	Fondi i Sigurimit të Kujdesit të Detyrueshëm Shëndetësor
6	Ish-Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
7	Ministria e Drejtësisë
8	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj
9	Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
10	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
11	Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale Mjedisore
12	Autoriteti i Konkurrencës
13	Auditimi i kontratës koncesionare për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë
14	Monitorimi i kontratës koncesionare për ndërtimin dhe operimin e HEC “Sasaj”, Sarandë
15	Auditimi i procedurave të dhënies së lejeve, licencave dhe monitorimit të aktivitetit minerar në Rasek, Shkodër
16	Shërbimi Social Shtetëror
17	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë; ish-Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës; Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë dhe Vorë
18	Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve
19	Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”
20	Auditimi i ofrimit të shërbimit të ushqimit në Spitalin Rajonal Korçë
21	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët
22	Dega Doganore Shkodër
23	Dega e Doganës Kapshticë
24	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
25	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
26	Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
27	Kolegji i Posaçëm i Apelimit
28	Avokati i Popullit
29	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike
30	Bashkia Belsh
31	Bashkia Berat
32	Bashkia Bulqizë
33	Bashkia Delvinë
34	Bashkia Dibër
35	Bashkia Dimal
36	Bashkia Dropull
37	Bashkia Fier
38	Bashkia Finiq
39	Bashkia Fushë-Arrëz
40	Bashkia Gjirokastër
41	Bashkia Gramsh
42	Bashkia Has
43	Bashkia Himarë

44	Bashkia Kamëz
45	Bashkia Kavajë
46	Bashkia Klos
47	Bashkia Kolonjë
48	Bashkia Konispol
49	Bashkia Korçë
50	Bashkia Krujë
51	Bashkia Kuçovë
52	Bashkia Kukës
53	Bashkia Lezhë
54	Bashkia Librazhd
55	Bashkia Lushnje
56	Bashkia Mallakastër
57	Bashkia Mat
58	Bashkia Memaliaj
59	Bashkia Mirditë
60	Bashkia Patos
61	Bashkia Përmet
62	Bashkia Pogradec
63	Bashkia Poliçan
64	Bashkia Prrenjas
65	Bashkia Roskovec
66	Bashkia Rrogozhinë
67	Bashkia Selenicë
68	Bashkia Shijak
69	Bashkia Shkodër
70	Bashkia Skrapar
71	Bashkia Tepelenë
72	Bashkia Tropojë
73	Bashkia Vau Dejës
74	Bashkia Vlorë
75	Bashkia Vorë
76	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
77	Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit, Bashkia Tiranë
78	Mbi problematikën e trajtuar në ankesën me objekt “Rikontruksioni i rrugës Tragjas”, Bashkia Vlorë
	Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
79	Ministria e Punëve të Brendshme
80	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
81	Autoriteti Rrugor Shqiptar
82	Auditimi i përputhshmërisë për kontratat e mirëmbajtjes rrugore
83	Auditimi i përputhshmërisë së kontratës së koncesionit/PPP “Për shërbimet e integruara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimëshe në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”
84	Garda e Republikës së Shqipërisë
85	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
86	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
87	Enti Rregullator i Ujit
88	Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz
89	Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Korçë

90	Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Lushnjë SH.A.
91	HEC Lanabregas SH.A.
92	Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës
93	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier
94	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë
95	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë
96	Enti Kombëtar i Banesave
97	Spitali Rajonal Shkodër
98	Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2 SH.A.
99	Trajtimi i Studentëve Elbasan SH.A.
100	Trajtimi i Studentëve Gjirokastër SH.A.
101	Trajtimi i Studentëve Korçë SH.A.
102	Trajtimi i Studentëve Shkodër SH.A.
103	Trajtimi i Studentëve Vlorë SH.A.
104	AlbaFilm SH.A.
	Departamenti i Auditimit IT
105	Ministria e Arsimit
106	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
107	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
108	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë
109	Galeria Kombëtare e Arteve
110	Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit
111	Agjencia Telegrafike Shqiptare
	Departamenti i Auditimit të Performancës
112	Planet gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe aspektet buxhetore për një popullsi në moshim
113	Shfrytëzimi i burimeve minerare të kromit
114	Qarkullimi rrugor në Bashkinë e Tiranës
115	Ndotja e mjedisit në Bashkinë e Elbasanit dhe Krujës
116	Efektiviteti i komisioneve rajonale të KEMP-it në trajtimin e dosjeve mjekësore
117	Kontrolli i cilësisë, magazinimi dhe importimi i drithërave (me fokus miellin)
118	Kujdesi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale
119	Trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i personave të dënuar
120	Shërbimi i kujdesit paliativ në Shqipëri
121	Roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e mirëqenies së fëmijëve të birësuar
122	Fuqizimi i grave në pozita udhëheqëse dhe vendimmarrëse


Aneks 2- Përmbledhja e dëmit ekonomik dhe efekteve financiare negative, për buxhetin 2025

Në mijë lekë

Dëm Ekonomik	
Shpenzime	**163,627**
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	3,164
Shpenzime të tjera	4,398
Zbatim punimesh / investime	156,065
Të Ardhura	**8,257**
Të ardhura nga aktiviteti doganor	2,788
Të ardhura nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	3,472
Të ardhura të tjera	1,997
Totali	**171,884**

Në mijë lekë

Efekte financiare negative	
Shpenzime	**2,020,615**
Shpenzime për investime	85,629
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	362,419
Shpenzime të tjera	1,572,567
Të Ardhura	**10,307,463**
Të ardhura nga keqadministrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta	135,756
Të ardhura nga aktiviteti doganor	2,683
Të ardhura nga aktiviteti tatimor	1,962,922
Të ardhura të tjera	3,966,432
Te ardhura në urbanistikë	892,482
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen vendore	3,347,188
Totali	**12,328,078**



KONTAKT

Rruga “Abdi Toptani” Nr. 1, Tiranë

www.klsh.org.al

klsh@klsh.org.al

Kontrolli i Lartë i Shtetit

klsh_org_al

(KLSH) Albanian Supreme Audit Institution